



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 22 DHJETOR 2014**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 22. DECEMBRA 2014. GODINE**

**DHJETOR - DECEMBAR
2014**

Rendi i ditës

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015

Dnevni red

1. Prvo razmatranje Nacrt zakona o budžetu Republike Kosova za 2015.god.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuar kryeministër,
Zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,
I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.
Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 81 deputetë, andaj fillojmë me punimet e seancës plenare.

Deputetë të nderuar,
Para se të fillojmë me shqyrtimin e parë të Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015, ju njoftoj se Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e përbashkët me kryetarët e grupeve parlamentare, të mbajtur më 18 dhjetor 2014, ka vendosur njëzëri që Kuvendi t'i propozojë që shqyrtimi dhe miratimi i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015 të bëhet me procedurë të përshpejtuar - shmangie nga Rregullorja e Kuvendit, dhe atë si në vijim.

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015 bëhet në seancën plenare më 22 dhjetor 2014,

2. Komisioni për Buxhet dhe Financa shqyrton Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015 dhe Kuvendit ia paraqet raportin me rekomandime, dhe

3. Shqyrtimi i dytë dhe miratimi i Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015 bëhet në seancën plenare më 29 dhjetor 2014.

Në bazë të nenit 84 të Rregullores së Kuvendit, shmangia nga Rregullorja bëhet me votat e 2/3 të deputetëve të pranishëm në seancë plenare.

Të nderuar deputetë,
Në vazhdim kërkohet deklarimi juaj me votim për miratimin e propozim-vendimit të lartpërmendur. Kërkohet votimi elektronik për praninë e deputetëve në sallë.

Atëherë, votojmë për praninë e deputetëve për arsye se kemi lëvizje të deputetëve të rinj me kartela. Aktualisht janë 96 deputetë. Shikojini kartelat në qoftë se i kanë vendosur mirë.

Jemi duke votuar vetëm për praninë e deputetëve në sallë. Atëherë, lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim! Votojmë tash!

Janë gjithsej 92 deputetë. Kërkoj falje për arsye se i kemi dy lloj pranish. Në votim i kemi 92 deputetë të pranishëm në sallë, në të njëjtën kohë më del se të pranishëm janë 98. Ky është një kontest i aspektit teknik.

Edhe një herë, 92 deputetë janë të pranishëm në sallë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash! Kërkoj falje, gjithmonë jemi duke folur për shmangie nga Rregullorja për arsye se na duhen 2/3 e shumicës.

Edhe një herë përsëritet votimi për shmangie nga Rregullorja për procedurë të përshpejtuar. Kemi ende duke ardhur deputetë. Votojmë tash!

Atëherë, konstatoj se me 95 vota për, asnjë kundër dhe me një abstenim, Kuvendi vendosi që shqyrtimi dhe miratimi i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015 të bëhet me procedurë të përshpejtuar, pra me shmangie nga Rregullorja e Kuvendit.

Vazhdojmë me rendin e ditës:

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për miratim në parim.

E ftoj kryeministrin e Republikës së Kosovës, zotin Isa Mustafa, t'u drejtohet deputetëve të Parlamentit të Republikës së Kosovës.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Ju përshëndes të gjithëve,

Dëshiroj që para jush me disa fjalë t'i prezantoj orientimet makroekonomike, të cilat i kemi për vitin 2015, dhe po ashtu edhe disa elemente nga Buxheti, përkatësisht nga projekti i Buxhetit, i cili është sot në diskutim para jush.

Ky është ligji i parë, që unë para jush e prezantoj në cilësinë e kryeministrit të vendit dhe njëherësh konsideroj që është një ndër dokumentet më të rëndësishme që Qeveria sjell para deputetëve për aprovim. Ky projektbuxhet procedohet shpejt në Kuvend për shkak të shumë arsyeve, që neve na orientojnë ta aprovojmë Buxhetin brenda këtij viti dhe të krijojmë kushte normale që Buxheti të fillojë të realizohet në fillim të vitit të ardhshëm, për arsye se kemi shumë detyrime, të cilat duhet t'i përballojmë.

Të nderuar deputetë,

Në vijim, për shkak të lidhshmërisë së drejtpërdrejtë që ka performansa fiskale në zhvillimet ekonomike, unë do të flas shkurt mbi projeksionet makroekonomike për vitin 2015, pasqyruar në pjesën makrofiskale të materialit të Buxhetit, që sot e keni para jush.

Në vitin 2015, me vlerësimet e tanishme, ne presim që ekonomia e vendit të ketë një normë vjetore të rritjes prej mbi 4%. Në këndvështrimin afatmesëm kjo normë e rritjes

pritet të jetë edhe më e lartë, si rezultat i reformave substanciale që Qeveria planifikon të ndërmarrë gjatë vitit 2015.

Në kuadër të rritjes makroekonomike, pritet që kontributin më të madh ta kenë investimet në veçanti investimet private. Është normale të theksohet se sektori privat do të presë që Qeveria e Republikës së Kosovës, të krijojë ambientin e nevojshëm për bizneset, prandaj theksoj se ne jemi shumë të përkushtuar që ta zhvillojmë një partneritet dhe bashkëveprim me sektorin privat dhe që të gjitha veprimet dhe reformat tona t'i orientojmë drejt plotësimit të gjitha parakushteve për rritjen e sektorit privat për vitin e ardhshëm.

Si rrjedhojë, investimet private pritet që gjatë viteve të ardhshme të rriten me një normë mesatare prej 8,6% dhe, rrjedhimisht, pjesëmarrja e këtyre investimeve në bruto-prodiktin vendor pritet që do të rritet.

Vërtet për ta përmirësuar strukturën e tanishme të ekonomisë së vendit, patjetër duhet që t'i orientojmë politikat tona drejt investimeve, ngase vetëm kështu do të bëhej i mundshëm shtimi i prodhimit vendor, zëvendësimi i importeve dhe zvogëlimi i deficitit tregtar, i cili është shumë i lartë.

Duhet të theksoj se rritja e investimeve është shumë ngushtë e lidhur me kapacitetin e vendit për të eksportuar. Gjatë viteve të kaluara ka pasur një rritje modeste të eksporteve, por duke marrë parasysh se baza e eksporteve është mjaftë e ulët, ne synojmë që në vitet në vijim eksportet t'i rrisim edhe më shumë. Ngjashëm me eksportet e mallrave ne presim që edhe tregu i shërbimeve të zgjerohet dhe ta zgjeroj aktivitetin e tij, dhe kështu ky treg të ndikoj në rritjen e eksporteve të shërbimeve në tregjet e jashtme, edhe në tregun evropian dhe tregun botëror.

Më duhet të them se struktura e eksporteve tona vazhdon të jetë mjaft e koncentruar, e kjo në vete përbën një lloj rreziku për shkak se kemi raporte zhvillimore botërore të cilat nuk e parapëlqejnë shumë këtë strukturë.

Në rënien e çmimeve në tregun botëror, produktet dhe shërbimet që Kosova eksporton në mënyrë të drejtpërdrejtë do të ndikohet edhe në sasinë dhe vlerën e eksporteve të shërbimeve të cilat ne do t'i realizojmë në periudhën e ardhshme kohore.

Prandaj, kërkohet që gjatë viteve në vijim përveç rritjes në tërësi të eksporteve, të punojmë edhe në diversifikimin e mallrave dhe shërbimeve për eksport, si parakusht që ne ta rrisim eksportin e shërbimeve.

Komponentë tjetër shumë e rëndësishme e bruto produktit vendor që është konsumi, është projektuar që në vitin 2015 të ketë një rritje prej 4%, ndërsa konsumi privat pritet të ketë një rritje edhe më të madhe.

Ekonomia e vendit është shumë e hapur ndaj ekonomive regjionale dhe më gjerë dhe çdo lëvizje e çmimeve, mallrave dhe produkteve në nivelin botëror do të bëjë që inflacioni në Kosovë të ndiqet në bazë të këtij trendi.

Ne nuk kemi mundësi, siç e dini, të kontrollit të çmimeve pasi nuk e kemi valutën tonë, që do të mundësonte që Banka Qendrore ta bëjë një gjë të tillë. Megjithatë, duke u bazuar në ecuritë e viteve të fundit si dhe në pritje, për vitet në vijim, ne presim që niveli vjetor i inflacionit gjatë tri viteve në vijim mesatarisht duhet të sillet rreth 1%.

Më lejoni po ashtu, t'ju them se gjatë viteve të kaluara pavarësisht vështirësive ekonomike, dhe të punësimit në shumë vende të Evropës, diaspora jonë ka vazhduar me dërgesat e tyre tek familjarët dhe bizneset në Kosovë, kjo ka bërë të mundur që të kemi një financim stabil të konsumit dhe pjesërisht investime nga remitencat.

Sa i përket viteve të ardhshme, pritet që niveli i dërgesave nga diaspora, të jetë stabile, të vazhdojë me kontributet të cilat janë të domosdoshme për ekonominë tonë. Dua të them se të gjitha këto projeksione të theksuara deri më tani, në masë të konsiderueshme do të varen nga performansa e ekonomive regjionale, ekonomisë evropiane dhe më gjerë.

Kosova sot ka një ekonomi mjaft të integruar dhe çdo lëvizje në ekonominë e vendeve të jashtme potencialisht do të ndikoj edhe në ekonominë tonë. Krahasuar me vitet e kaluara, sot ekonomia e eurozonës duket më stabile dhe më e qëndrueshme, por vazhdon të jetë mjaft e hapur ndaj një numri të rreziqeve potenciale.

Megjithatë, dua t'ju siguroj se Qeveria do ta bëjë më të mirën në mënyrë që varshmëria nga ecuritë të jashtme të bjerë, dhe kështu të bëhet e mundur që ekonomia e vendit të jetë rezistente, për aq sa është e mundur, ndaj tronditjeve në tregjet e jashtme.

Më lejoni në vazhdim të kthehem te Buxheti, respektivisht te të hyrat dhe të dalat buxhetore.

Të hyrat e përgjithshme buxhetore për vitin 2015 janë planifikuar të jenë në nivel prej 1 miliard e 576 milionë euro, që është një rritje prej rreth 8,1%, krahasuar me vitin 2014.

Projeksionet tona për rritje të të hyrave tatimore nuk parashohin rritje të normave tatimore, por rritja e të hyrave do të vijë si rezultat i fitimit, i cili do të realizohet në ekonomi, dhe si rezultat i luftimit të ekonomisë joformale dhe rritjes së ekonomisë vendore, duke u bazuar në parimin e partneritetit dhe bashkëpunimit me sektorin privat.

Qeveria është shumë e interesuar dhe e përkushtuar në fuqizimin e Administratës Tatimore dhe Doganore, për ta rritur nivelin e shërbimeve të tyre, për mbledhjen e tatimeve dhe për rritjen e performansës së tyre.

Komunave do t'ua ofrojmë mbështetjen e duhur, në mënyrë që qeverisja lokale ta rrisë performansën dhe, rrjedhimisht, të rritet pavarësia fiskale e pushtetit lokal nga ai qendror.

Në anën e shpenzimeve, do të vazhdohen investimet në infrastrukturën rrugore, në sektorin e arsimit, të shëndetësisë, në fushën e sigurisë dhe në bujqësi.

Për shumë objekte të infrastrukturës janë kryer obligime kontraktuale nga e kaluara dhe ato kanë bërë që të kemi shumë pak hapësirë për intervenime në këtë projekt të Buxhetit.

Nëpërmjet këtij Buxheti do të bëhet i mundur adresimi i një sërë sfidash në fushën sociale, siç është rasti me kategoritë e dala nga lufta, pensionistët, ish të burgosurit politikë, familjet në asistencë sociale, e kështu me radhë.

Sa i përket rritjes së pagave, në Buxhet është përfshirë rritja nga ky vit, kurse rritjet e tjera të mundshme do të shqyrtohen gjatë vitit në harmoni me mundësitë buxhetore.

Niveli i përgjithshëm i të dalave buxhetore për vitin 2015 është planifikuar të jetë në vlerë prej 1 miliard e 682 milionë euro, që paraqet një rritje prej rreth 6% krahasuar me nivelin e përgjithshëm të shpenzimeve të planifikuara për vitin 2014.

Gjatë vitit 2015 do të fillojmë me implementimin e Ligjit për sigurime shëndetësore dhe Kosova do t'i ketë skemat e sigurimeve shëndetësore për qytetarët e saj. Pas fjalës sime, ministri i Financave do të bëjë një paraqitje më të detajuar të Buxhetit.

Por, më lejoni që edhe një herë të them se presioni kohor që ta aprovojmë Buxhetin sa më parë dhe që në fillim të janarit, Qeveria të mund të operojë normalisht, me pagesat për të punësuarit në sektorin publik, me pensionet, me asistencën sociale, me obligimet që i kemi në lidhur me projektet investuese, nuk na ka mundësuar që ne të ndërhyjmë në tekstin e Buxhetit, të cilin e ka përgatitur Qeveria e deritanishme, prandaj tekstin që e keni marrë sot është tekst që është përgatitur, është një tekst i cili nuk shpreh as dëshirat e kësaj Qeverie, e as dëshirat e Qeverisë së kaluar, por shpreh një situatë objektive të kufizimeve tona sa u përket të hyrave fiskale dhe sa u përket burimeve buxhetore, por edhe obligimeve që i kemi marrë deri më tani.

Por, ne do të bëjmë përpjekje maksimale që të bëjmë disa ndryshime të mundshme dhe të domosdoshme dhe këto ndryshime t'i bëjmë brenda dy leximeve mbi bazën e propozimeve dhe vërejtjeve që do t'i jepni sot në Kuvend, mbi bazën e punës së komisioneve të Kuvendit, sidomos të Komisionit për Buxhet dhe Financa, si dhe të identifikimeve që do t'i kemi nga ministrinë përkatëse gjatë kësaj periudhe, e cila është shumë e shkurtër.

Çështjet më fundamentale që ndërlidhen me realizimin e programit të Qeverisë ne mund t'i përfshijmë dhe t'i adresojmë gjatë procesit të rishikimit të Buxhetit para mesit të vitit të ardhshëm, prandaj ajo do të jetë koha kur ne do t'i adresojmë këto dhe po ashtu do t'i adresojmë edhe shumicën e kërkesave që ju mund t'i keni sot këtu.

Të nderuar deputetë,

Unë ju falënderoj paraprakisht, e pas prezantimit nga ministri i Financave, z. Avdullah Hoti, dhe diskutimeve që do t'i keni, ju ftoj që ta përkrahni këtë propozim të Buxhetit, në

mënyrë që të procedojmë më tutje dhe të arrijmë që ta aprovojmë para përfundimit të këtij viti. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit zoti kryeministër Mustafa! E ftoj ministrin e Financave, zotin Avdullah Hoti, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe ta arsyetojë projektligjin.

AVDULLAH HOTI: I nderuar kryetar i Kuvendit,

I nderuar kryeministër,

Zëvendëskryeministra,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë, ministra,

Sot po e shqyrtojmë në lexim të parë Projektligjin për Buxhetin e vitit 2015, i cili është i rëndësishë së veçantë për funksionim të rregullt të institucioneve shtetërore.

Më lejon i paraprakisht të theksoj që në fillim se ky projektbuxhet që po e shqyrtojmë është dorëzuar në Kuvend nga Qeveria e kaluar brenda afatit ligjor më 31 tetor 2014, por për shkaqe që tani më dihen nuk është shqyrtuar në procedurën e Kuvendit. Sapo është formuar Qeveria e re, ne kemi marrë kërkesë prej Kuvendit të Kosovës që edhe një herë ta kthejmë në Qeveri këtë projektbuxhet për shkak të procedurave dhe kërkesave kushtetuese, gjë të cilën e kemi bërë më 15 dhjetor 2014, në mbledhjen e parë të rregullt të Qeverisë së re të Kosovës.

Janë dy arsye pse na nuk e kemi pasur asnjë mundësi që të ndërhyjmë në këtë projektbuxhet, e para është afati shumë i shkurtër ligjor që ne të fillojmë t'i rivlerësojmë kufijtë buxhetorë të shpenzimeve dhe të të hyrave dhe e dyta është që shumica e projekteve kapitale në listën e projekteve kapitale janë projekte që janë në vazhdimësi, janë të kontaktuar dhe normalisht për shkak të qasjeje institucionale që ne duhet ta kemi parasysh, ne nuk mund t'i prekim ato projekte. Prandaj, ne po e shqyrtojmë të njëjtin projektbuxhet që është proceduar, është përgatitur dhe është proceduar në Kuvend nga Qeveria e kaluar.

Ne mbetemi të përkushtuar që zotimet e Qeverisë së re, për aq sa është e mundshme, të reflektohen në mundësinë e parë që ne e kemi për ta rishikuar këtë buxhet, që është qershori 2015, dhe mandej në buxhetet e ardhshme afatmesme në kuadër të kornizës afatmesme të shpenzimeve, 2016-2018.

Pavarësisht prej kësaj, edhe pse përballemi me një situatë të tillë të afatit të ngushtë ligjor për ta ndryshuar këtë projektbuxhet dhe kontraktimit të shumicës investimeve kapitale, ne do të bëjmë përpjekje maksimale që t'i adresojmë nevojat që i kemi me këtë buxhet. Me këtë buxhet, megjithëse me plot kufizime, ne do t'i vëmë bazat për reformat strukturore, të cilat tash janë të paraqitura me programin qeverisës të koalicionit, i cili shumë shpejt do të kalojë në Qeveri dhe do të vijë për informim në Kuvendin e Kosovës.

Këto kufizime neve nuk do të na ndalin që të punojmë për ta ndryshuar rrënjësisht strukturën e ekonomisë kosovare, nga një ekonomi që momentalisht varet shumë nga

sektori publik, në një ekonomi ku vendet e punës krijohen nga sektori privat. Të krijojmë mundësi për krijim të vendeve të reja të punës nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme si gjenerator kryesor i të ardhurave të familjeve dhe vendeve të punës. Ta rritim aftësinë konkurruese të ekonomisë kosovare, si e vetmja mundësi që ne të konkurrojmë me kompani ndërkombëtare në tregjet vendore fillimisht dhe pastaj edhe në tregjet ndërkombëtare dhe gjithashtu t'i mbështetim për aq sa është mundshme grupet e marginalizuara të shoqërisë për ta krijuar një shoqëri të drejtë ku të gjithë trajtohen njësoj me Buxhetin e Kosovës.

Megjithatë, më duhet të them se suksesi në realizimin e këtyre planeve varet shumë nga disiplina, përkushtimi dhe bashkëpunimi i të gjitha institucioneve të vendit, i Legjislativit, Ekzekutivit dhe Gjyqësorit, si dhe nga përmirësimi i qëndrueshëm i produktivitetit të punës, si në sektorin publik, ashtu edhe në sektorin privat. Çfarëdo rritje substanciale e të ardhurave, e pagave dhe e përfitimeve tjera mund të bëhet vetëm duke pasur rritje ekonomike që vjen nga rritja e produktivitetit të punës në sektorin publik dhe në sektorin privat.

Rrethanat aktuale ekonomike dhe fiskale na detyrojnë që të shpenzojmë me maturi, në mënyrë që ta kemi në ekuilibër në mes të shpenzimeve dhe të hyrave, të kemi ekuilibër ndërmjet shpenzimeve operative dhe shpenzimeve kapitale për ta gjeneruar rritjen ekonomike dhe normalisht të implementojmë nëpërmjet këtij Buxheti politika ekonomike që mundësojnë rritje të qëndrueshme ekonomike për të bërë të mundur implementimin e politikave të Qeverisë dhe të koalicionit të ri qeverisës.

Ne do të jemi shumë të matur dhe ekstrem transparent për mënyrën se si do të mblidhet dhe do të shpenzohet çdo cent i qytetarëve të Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Në këtë kontest, më lejon ta prezantoj fillimisht kornizën makrofiskale 2015-2017, në bazë të së cilës është përgatitur ky Buxhet dhe pastaj të kaloj nëpër disa zëra pak më specifikë të Buxhetit. Struktura e propozuar buxhetore bazohet në projeksionin për ekonominë e Kosovës, duke marrë për bazë edhe efektet e mundshme të krizës në vendet e eurozonës dhe në vendet në rajon. Investimet private si gjenerator kryesor i rritjes ekonomike pritet të rriten me një normë prej 8,6%, duke rritur kështu pjesëmarrjen e tyre në bruto-produktin vendor prej 19%, sa pritet të mbyllet viti 2014, në 21%, në vitin 2017. Dhe, kjo jep sinjale për një mundësi të rritjes së punësimeve dhe të ardhurave në sektorin privat dhe ta kalojmë gjenerimin e rritjes ekonomike nga sektori publik në sektorin privat.

Eksporti pritet të rritet me 7%, ndërkaj importet me 5%, duke mundësuar një zvogëlim sado modest të deficitit të thellë tregtar që e ka Kosova. Konsumi agregat për vitin 2015 është planifikuar të rritet me 4%, gjë që do të ndikoj në kërkesën agregate në vend për ta mbajtur kërkesën për mallra dhe shërbime, e kështu edhe rritjen ekonomike në vend. Ne e dimë që ecuria e çmimeve në Kosovës në masë të madhe varet nga ecuria në tregjet ndërkombëtare. Pritet të ketë një rritje modeste të çmimeve prej 0,5%, që do të reflektohet pak në fuqinë blerëse të të ardhurave të familjeve kosovare, por rënia e

çmimeve të derivateve të naftës kohëve të fundit pritet të ndikojë në zvogëlimin e kostos të gjitha bizneseve në vend, duke rritur kështu aftësinë konkurruese të bizneseve vendore.

Dërgesat e qytetarëve presim të mbeten stabile dhe të ruhet kështu fuqia blerëse dhe niveli i standardit të jetës së familjeve që pranojnë dërgesa nga qytetarët.

Të nderuar deputetë,

Me lejoni që t'i paraqes disa prej zërave kryesorë të projektbuxhetit, i cili derivon nga kjo kornizë makrofiskale, të cilën sapo e prezantova. Në vitin 2015, të hyrat e përgjithshme buxhetore planifikohen të jenë në nivel prej 1 miliardë e 576 milionë, që është një rritje prej 8,1%, krahasuar me këtë vit që po e përmbylim.

Të hyrat nga tatimet e brendshme pritet të rriten me 17%, jo për shkak të rritjes së barrës tatimore për biznese ose për qytetarë, por për shkak të rritjes së kapaciteteve të Administratës Tatimore për ta menaxhuar më mirë ekonominë joformale dhe atë jo nëpërmjet ndëshkimeve të bizneseve për t'i paguar obligimet ndaj shtetit, por duke krijuar insentiva që bizneset ta gjejnë më lehtë mënyrën që të operojnë në sektorin formal të ekonomisë, ndërkaq të hyrat nga Dogana priten të rriten me vetëm 3%.

Rritje planifikohet të ketë edhe te të hyrat e tjera buxhetore, duke përfshirë të hyrat jotatimore me 2,1% dhe të hyrat vetjake të komunave prej 10%. Ndërkaq të hyrat vetjake të nivelit qendror pritet të bien, që reflekton heqjen, uljen e pagesave tjera shtesë, për ish të dënuarit politikë me 11 milionë euro; për veteranët e luftës, 24 milionë euro.

Dhe, kemi rritje të konsiderueshme të subvencionimit në bujqësi, që tani në vitin 2015 planifikohet të jetë 53.6 milionë euro, që reflekton në prioritetin e kësaj Qeverie për këtë sektor të rëndësishëm të ekonomisë për krijim të punësimit dhe të ardhurave.

Te shpenzimet kapitale, ato planifikohen të jenë 470 milionë euro, pjesëmarrja e të hyrave në shpenzime të përgjithshme buxhetore do të mbetet rreth 28%, që është pjesëmarrje e kënaqshme duke pasur parasysh dinamikën e përgjithshme në vend.

Janë planifikuar investime në infrastrukturë rrugore, në arsim, në shëndetësi dhe në fusha tjera. Në infrastrukturën rrugore kryeministri përmendi disa prej projekteve kryesore, është vazhdimi i autostradës Prishtinë - Han i Elezit, ndërtimi i rrugës rajonale Prishtinë - Mitrovicë, ndërtimi i rrugës rajonale Prishtinë - Pejë dhe plot projekte të tjera, që janë në vazhdimësi e sipër.

Të nderuar deputetë,

Më lejoni t'ju ...

(Ndërprerje nga regjia.)

KRYETARI: Ju lutem, regjia! Le ta vazhdojë fjalën, ju lutem! E ka fjalën ministri i Financave, Abdullah Hoti.

MINISTRI AVDULLAH HOTI: Faleminderit!

Në sektorin e bujqësisë, si një prej sektorëve me potencialin më të madh të rritjes së punësimit dhe gjenerimit të ardhurave për ekonominë familjare, në veçanti në ekonominë që jetojnë në zonat rurale dhe në gjithë zinxhirin prodhues të bujqësisë, në Buxhetin e vitit 2015 do të përfitojnë rritje prej rreth 32,3 milionë më shumë se sa kanë pasur në vitin 2014.

Në sektorin e shëndetësisë me qëllim të ofrimit të shërbimeve cilësore dhe qasje të barabartë për të gjithë qytetarët, parashihet rritje prej 2,2 milionë për fillimin e reformës në shëndetësi, rritje prej 10 milionë për zbatimin e Ligjit për sigurime shëndetësore, shumë kjo që do të mbetet brenda kontingjentit të Ministrisë së Financave, si kontribut i shërbyesve civilë në Fondin e sigurimeve shëndetësore dhe janë 5 milionë euro të ndarë për trajtime jashtë vendit.

Në sistemin arsimor është rritur granti specifik për arsim për komuna prej 10 milionë euro, për të mundësuar investimet kapitale, që janë në vijim e sipër në shumicën e komunave.

Në fushën e mirëqenies sociale Buxheti i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për vitin 2015 është rritur për 79,3 milionë euro, për të mbuluar së pari rritjen e pensioneve për të gjitha kategoritë e përfituesve, me 25%, zbatimin e skemës për Ligjin për ish- të përndjekurit politikë dhe rritjen eventuale të përfituesve të skemës sociale dhe të pensionistëve.

Në sektorin e drejtësisë dhe sigurisë është rritur Buxheti për reforma në këtë sektor, për të përmbushur kriteret për liberalizim të vizave dhe kriteret tjera, që kërkohen sipas Raportit të Progresit të Komisionit Evropian.

Në Ministrinë e Punëve të Brendshme do të ketë një rritje prej 9 milionë euro, në Ministrinë e Forcës së Sigurisë, një rritje prej 3 milionë euro, në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, një rritje prej 0,7 milionë euro dhe në Prokurorinë e Shtetit, një rritje prej 0,2 milionë euro.

Në nivelin lokal Buxheti është ndarë në bazë të qarkoreve buxhetore përkatëse. Nga materiale që ju veç i keni, tek tabela 1 të buxheti komunal, ajo tabelë paraqet të hyrat prej 424,1 milionë euro dhe shpenzime për nivelin lokal prej 412,1 milionë euro.

Ne do të vazhdojmë me projektin e emetimit të letrave me vlerë, duke qenë shumë të kujdesshëm, që këto letra me vlerë t'i emetojmë me kosto minimale për Buxhetin e Kosovës duke qenë të vetëdijshëm për të mos krijuar vartësi për gjeneratat e ardhshme për të paguar borxhe që tani ne krijojmë si Qeveri.

Si Qeveri e re, e kemi përpara vetes një detyrë jo të lehtë. Si shtet me papunësi më të lartë në Evropë, kemi shumë nevojë për investime për të ringjallur ekonominë dhe për të parandaluar ikjen e të rinjve nga vendi. Kemi nevojë për investime në fushat me prioritet, që kërkojnë investime të mëdha dhe burime shtesë të financimit.

Ndërkaq, në anën tjetër ne kemi obligim që të ruajmë stabilitetin fiskal dhe financiar të vendit. Në vitin 2013 Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, ku deficitin buxhetor kufizohet me 2% të bruto produktit vendor dhe ne jemi të vendosur, që të ruajmë këtë rregull fiskale në të mirë të stabilitetit financiar në vend dhe në të mirë të ruajtjes së barrës fiskale, për gjeneratat e ardhshme të vendit.

Ne kemi nevojë të zhvillojmë maturinë fiskale në përputhje me këtë rregull fiskale edhe për arsye të kësaj barazie sociale në vend. Ne sot nuk mund t'i rrisim në vazhdimësi shpenzimet publike, pavarësisht kërkesave të shumë organizatave, ose grupeve të tjera, të cilat e vetmja mënyrë që të financohen do të ishte duke rritur tatimet, pra duke rritur barrën fiskale në vend.

Të nderuar deputetë,

Është tepër e rëndësishme, që ne të fillojmë vitin 2015 me Buxhet të aprovuar, prandaj unë ju ftoj shumë që ta konsideroni dhe ta aprovoni këtë Buxhet në kohën sa më të shkurtë që të jetë e mundur. Në ndërkohë, ne në Ministrinë e Financave jemi duke punuar intensivisht që t'i identifikojmë zërat buxhetorë, që duke qëndruar brenda këtyre kufizimeve të hyrave dhe shpenzimeve, t'i identifikojmë mundësitë ku kemi mundësi që t'i shkurtojmë shpenzimet, pa prekur asnjëherë cilësinë në arsim, shëndetësi, ose të shërbimeve të tjera publike, gjë të cilën ne do ta dorëzojmë me kohë në Komisionin për Buxhet dhe Financa. Dhe, unë pres që të kemi mirëkuptimin e anëtarëve të atij komisioni. Faleminderit!

KRYETARI: E falënderojmë ministrin e Financave, Avdullah Hoti.

Të nderuar deputetë,

Pas prezantimit të projektligjit e hapim debatin për diskutim në parim. E ftoj ta marrë fjalën kryetarin e Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa, deputetin Naser Osmani.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Zoti kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Qeveria e Republikës së Kosovës, në pajtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, më 15 dhjetor ka proceduar në Kuvend për shqyrtim dhe miratim Projektligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës, për vitin 2015.

Dorëzimit të Projektligjit të Buxhetit i ka paraprirë përgatitja e kornizës afatmesme dhe shpenzimeve dhe procesi i përgjithshëm dhe ndarjeve buxhetore, proces ky i cili është udhëhequr nga Ministria e Financave.

Projektligji në fjalë përmban të dhëna për vitin e ardhshëm fiskal dhe krahasimet në periudhën paraprake, vlerësimet dhe parashikimet për dy vitet vijuese në lidhje me numrin e të punësuarve në organizatat buxhetore, të cilat do të paguheshin nga ndarjet buxhetore gjatë vitit të ardhshëm fiskal, të ardhurat e përgjithshme të organizatave

buxhetore, duke përfshirë të ardhurat e dedikuara dhe të ardhurat e parashikuara nga tarifat e ndryshme të shfrytëzimit dhe burimit të gjitha këtyre të ardhurave, qoftë nga grante qeveritare, të hyrave vetjake, financimi i jashtëm, apo financimi nga huamarrjet, si dhe të ardhurat e dedikuara për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, sipas Ligjit të AKP-së, të ardhurat e përgjithshme sipas kategorive ekonomike, funksionale dhe programore.

Një përshkrim të ardhurave të dedikuara dhe të ardhurave vetjake për secilën organizatë buxhetore, si dhe çdo ndarje e këtyre të ardhurave të kategorizuara në bazë të programit dhe klasifikimit ekonomik. Planifikimin afatmesëm të hyrave totale të buxhetit komunal, tabela të veçanta dhe të hollësishme të shpenzimeve për institucionet e nivelit qendror dhe institucionet e nivelit lokal, tabela të veçanta të projekteve kapitale për institucionet e nivelit qendror dhe të institucioneve lokale, që barten nga viti i kaluar, si projekte afatgjate të planifikuara për realizim, projekte të reja për vitin e ardhshëm fiskal, si dhe vlerësime të ndikimit financiar të projekteve të tilla në dy vitet e ardhshme.

Të ardhurat nga dividenda, deficitin e përgjithshëm buxhetor dhe stokun e borxhit në harmoni me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, huamarrjet e pritura, si dhe mënyrën e financimit, arkëtimin e të ardhurave, që pritet nga grantet e donatorëve si mbështetje e përgjithshme buxhetore, mjetet buxhetore rezerve, si dhe bilanci i Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës, nga të cilat fonde për ruajtjen e asistencës emergjente për likuiditet të sistemit financiar.

Të hyrat e përgjithshme buxhetore në vitin 2015 parashihet të jenë 1,576 milion euro, duke shënuar një rritje prej 8,1% krahasuar me vitin 2014.

Të hyrat nga tatimet parashihet të arrijnë vlerën 1,350 milionë, prej të cilave 962,2 milionë euro theksojnë të hyrat e mbledhura në kufi apo nga doganat, një rritje prej 28,1 milionë euro, apo 3% krahasuar me vitin 2014.

Ndërsa, të hyrat vendore kanë vlerën 429.6 milionë euro, një rritje prej 62,3 milionë euro, apo 17% nga viti 2014, të hyrat jo tatimore do të jenë rreth 48,8 milionë, të hyrat vetjake 114,2 milionë, prej të cilave 74,2 milionë euro pritet të arkëtohen në nivelin komunal dhe 40 milionë euro në nivelin qendror.

Sa i përket të hyrave tjera, janë parashikuar që shuma 10 milionë euro të jetë nga taksat koncesionare, tantiemat 22 milionë euro dhe nga dividenda 30 milionë euro.

Po ashtu, është paraparë mbështetje direkte buxhetore nga donatorët në vlerë prej 600 mijë euro dhe në formë të granteve të projekteve në vlerë prej 300 mijë euro.

Shpenzimet e përgjithshme për vitin 2015, përfshirë këtu edhe shpenzimet për AKP prej 10,2 milionë euro si të hyra të dedikuara, në bazë të Ligjit gjithnjë për AKP-në, janë planifikuar të jenë në vlerë prej 1,682 milionë euro, që janë 6% më të larta krahasuar me vitin 2014.

Në raport me bruto produktin vendor, shpenzimet e përgjithshme marrin pjesë me 28,6%.

Si rrjedhojë e rritjes së financimit të shtuar për shpenzimet rrjedhëse, si dhe ruajtjes së pjesëmarrjes së lartë të shpenzimeve kapitale, deficitin i përgjithshëm buxhetor për vitin 2015, në përputhje me rregullat fiskale, përjashtuar shpenzimet e AKP-së dhe shpenzimet e financuara me financim të njëhershëm, parashihet të arrijë në 113,3 milionë euro apo 2% e brutoproduktit të brendshëm, që është brenda kufirit maksimal të deficitit të përcaktuar me ligj për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Ndërsa, stoku i borxhit në raport me bruto produktin e brendshëm është paraparë të jetë 12,2% dhe paraqet një rritje prej 1,4% më tepër, se në vitin 2014, por që është brenda kornizës ligjore.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 19.12.2014 ka shqyrtuar në parim Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015 dhe i ka rekomanduar Kuvendit për shqyrtim në leximin e parë.

Komisioni do t'i analizojë të gjitha vërejtjet dhe propozimet e qëndrueshme, që do të ngritën gjatë debatit të sotëm më rastin e amendamentimit të projektligjit dhe raportimit në shqyrtim të dytë. Faleminderit!

KRYETARI: Falënderojmë kryetarin e Komisionit, zotin Osmani.

Tani, kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare e kanë fjalën, si në vijim. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës.

SAFETE HADERGJONAJ: I nderuar kryetar i Kuvendit, zoti Veseli!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektbuxhetin për vitin 2015 dhe në bazë të analizave të bëra ka ardhur në përfundim, se në planifikimin e Buxhetit për vitin 2015 një kujdes i veçantë i është kushtuar ruajtjes së qëndrueshmërisë fiskale dhe zhvillimit ekonomik.

Është bërë planifikim i matur i shpenzimeve, në raport me të hyrat e parashikuara, si dhe shpërndarja efikase e tyre nëpër kategori të caktuara, prandaj Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës do ta përkrahë në parim Projektbuxhetin për vitin 2015 dhe do të japë kontributin e vet maksimal në Komisionin për Buxhet dhe Financa.

Projektbuxheti për vitin 2015 synon transformimin e ekonomisë sonë në një ekonomi më të zhvilluar dhe konkurruese. Është synuar, që nëpërmjet mjeteve jo gjithmonë të mjaftueshme, të adresohen nevojat më të rëndësishme të shoqërisë, të rritet efikasiteti i shërbimeve publike, të adresohen barrierat për avancimin e konkurrencës në sektorin privat, të ruhet trendi i investimeve kapitale dhe të krijohet një ambient më i favorshëm dhe më i sigurt për të gjithë.

Duhet theksuar, se në adresimin e të gjitha këtyre çështjeve me është arritur që të ruhet niveli i ulët i borxhit publik, të respektohet rregulla fiskale duke kufizuar deficitin buxhetor në kufirin prej 2% të bruto-produktit vendor.

Nga të dhënat për indikatorët kryesorë makroekonomikë që janë pjesë e këtij projektbuxheti, vërejmë se do të vazhdohet me trendin e rritjes ekonomike për vitin 2015 prej 4,1%.

Të nderuar deputetë,

Projektbuxheti që na është ofruar për miratim vazhdon me ritme pozitive të rritjes. Të hyrat e rregullta buxhetore për vitin 2015 janë parashikuar të rriten në vlerë 1 miliard e 576 milionë apo vetëm 8,1% më të larta se sa të hyrat e rregullta në këtë vit që jemi.

Pjesëmarrja me 26,8% e këtyre të hyrave është në bruto produktin vendor. Në kuadër të hyrave totale, të hyrat nga tatimet e brendshme dhe ato doganore janë paraparë të rriten 7%, ndërsa vetëm të hyrat e brendshme pritet të rriten 17%. Nëse e shikojmë trendin e rritjes së të hyrave të brendshme nga viti në vit atëherë mund të themi se po fillohet me një zhvendosje në mbledhjen e të hyrave në brendi të vendit dhe kjo ka ardhur në sajë të një efikasiteti më të madh të punës së Administratës Tatimore në grumbullimin e të hyrave, në nxitjen e investimeve dhe në zgjerimin e bazës së tatimit duke zvogëluar ekonominë informate dhe evazionin fiskal.

Rritje planifikohet të ketë edhe tek të hyrat tjera buxhetore duke përfshirë të hyrat jo tatimore me 2,1% dhe të hyrat vetjake të komunave me 10%.

Buxheti i rregullt për vitin 2015 pritet të jetë në nivelin prej 1 miliardë e 682 milionë euro, që paraqet një rritje prej 6% krahasuar me nivelin e përgjithshëm të shpenzimeve në vitin 2014 dhe me një pjesëmarrje prej 28,6% në bruto-produktin vendor.

Buxheti për paga dhe mëditje në këtë vit do të ketë një rritje nga 484 milionë euro sa ishte në vitin 2014 në 549,1 milionë euro në vitin 2015, rritje kjo për 66 milionë euro që ka reflektuar vazhdimin e implementimit të vendimit të Qeverisë të marrë në prill të këtij viti për rritjen e pagave të nëpunësve civilë në nivelin prej 25%.

Nëse analizojmë me një qasje objektive shifrat atëherë vërejmë se janë ulur shpenzimet operative dhe mjetet janë përqendruar në projekte të rëndësishme ku përfitojnë qytetarët, nxitet zhvillimi ekonomik dhe rritet punësimi. Është bërë zvogëlimi i Buxhetit për 34 milionë euro në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve që do të thotë se shpenzimet në këtë kategori janë 15% më të ulëta krahasuar me vitin 2014.

Kategoria e subvencioneve dhe transfereve është planifikuar të rritet për 79 milionë euro, rritje kjo për 39% më shumë krahasuar me vitin 2014, pra nga 230 milionë euro sa ishte në vitin 2014 tani e kemi një Buxhet prej 309 milionë eurove në vitin 2015.

Kjo rritje reflekton vendimin e Qeverisë për rritjen e pensioneve për 25% për tërë vitin 2015, ndarja e 11 milionë eurove për ish të dënuarit politikë dhe 24 milionë euro për veteranët e luftës dhe kemi një rritje të madhe për subvencionimin e sektorit të bujqësisë.

Shpenzimet kapitale janë në vlerën 471 milionë euro. Pjesëmarrja e shpenzimeve kapitale në shpenzimet e përgjithshme mbetet edhe më tutje e lartë me 28% në Buxhetin e përgjithshëm, që është më i lartë i krahasuar në shtetet e rajonit.

Sipas planifikimeve do të vazhdohet me autostradën për Shkup, me ndërtimin e rrugës për Mitrovicë, për Pejë, rrugën në drejtim të Skenderajt, dhe shumë rrugë tjera lokale.

Janë planifikuar mjete për ndërtimin e shkollave, objekteve sportive, kulturore dhe objekte të tjera të cilat janë në interes për qytetarin e Kosovës. Gjithashtu janë planifikuar edhe investime për infrastrukturën hekurudhore. Ky nivel i investimeve kapitale dëshmon vazhdimësinë e projekteve të rëndësishme kapitale që kanë një rol të rëndësishëm në krijimin e parakushteve për një rritje të qëndrueshme ekonomike.

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës është pro votimit të këtij projektbuxheti, sepse vota pro është votë për përmirësimin e politikave bujqësore. Ky projektbuxhet i jep mbështetje sektorit të bujqësisë si një prej sektorëve më të rëndësishëm të zhvillimit ekonomik. Buxheti për këtë sektor është rritur për 33 milionë euro, nga 27 milionë e 170 mijë euro të planifikuara në vitin 2014 tani janë rritur në 60 milionë e 352 mijë euro, që janë të planifikuara në Buxhetin e vitit 2015. Janë rritur subvencionet në sektorin e bujqësisë, pemëtarisë dhe blegtorisë nga 11 milionë në 53 milionë euro.

Është votë për rritjen e Buxhetit në sektorin e shëndetësisë, për të bërë reformat në sistemin e shëndetësisë të cilat janë shumë të pritura nga qytetarët e Republikës së Kosovës dhe është shumë e rëndësishme që po fillon implementimi i Ligjit për shërbime shëndetësore ku janë paraparë 10 milionë euro.

Në këtë projektbuxhet vazhdohet në përmirësimin e kualitetit në arsim, është planifikuar të vazhdohet në ndërtimin e objekteve shkollore, rritjen e cilësisë së arsimit dhe funksionalizimin e universiteteve të reja.

Po ashtu, vlerësojmë rritjen e Buxhetit në Ministrinë e Mirëqenies, rritjen e Buxhetit në sektorin e drejtësisë dhe të Forcës së Sigurisë dhe njëkohësisht edhe forcimin e sektorëve të rëndësishëm të cilët janë prokuroria dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës, të cilët kanë vazhdimisht kërkesa për rritje Buxheti.

Në projektbuxhetin e vitit 2015 është përfshirë edhe Buxheti i komunave ku vërehet se ato përfitojnë 424 milionë euro që synon rritje prej 34 milionë eurove krahasuar me vitin 2014. Komunat kanë planifikuar që 58,5% të mjeteve të shpenzojnë për paga e mëdijte, 78,1% për mallra dhe shërbime dhe 28% do t'i shpenzojnë për investime kapitale, kurse 2,4% për subvencione dhe transfere.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike duke pasur parasysh rrethanat në të cilat është përgatitur ky Buxhet ku për shkak të bllokadës së gjatë paszgjedhore, ku kishte vështirësi në funksionimin e institucioneve tona, vlerëson punën që është bërë nga Ministria e

Financave që ka bërë një përmbledhje të tërë të Buxhetit të gjitha institucioneve dhe nga Qeveria në përgjithësi dhe vlerëson përfshirjen në buxhet të rritjes së pagave për 25% bazuar në vendimin e Qeverisë në prill të këtij viti për të gjithë punonjësit e shërbimit publik dhe për të gjitha kategoritë sociale.

Vlerëson përfshirjen në buxhet të implementimit të reformave në shëndetësi sipas Ligjit të shëndetësisë dhe sipas Ligjit për sigurimet shëndetësore, vlerëson implementimin e reformave në sektorin e sigurisë, rendit dhe ligjit në veçanti, vlerëson kompensimin e përfituesve sipas Ligjit për veteranët e luftës dhe Ligjit për të burgosurit politikë.

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e përkrah në parim projektbuxhetin për vitin 2015 dhe ju fton për votë pro këtij Buxheti për t'i dhënë mundësinë Qeverisë t'i realizojë objektivat e veta për rritje të qëndrueshme ekonomike dhe për një qëndrueshmëri dhe stabilitet makro fiskal. Faleminderit për vëmendjen!

KRYETARI: Faleminderit zonja Hadërgjonaj! Atëherë, nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, zoti Naser Osmani e ka fjalën.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Shpresoj që deputetët nuk do të mërzhiten sot me mua dhe me ministrin e Financave. Më lejoni që ta përgëzoj ministrin e Financave për këtë ditën e parë që sot këtu që ka ditën më të rëndësishme të shqyrtimit në parim të ligjit më të rëndësishëm vjetor, Ligjit për buxhet.

Përgatitja e projektligjit vjetor të Buxhetit të Republikës së Kosovës është pasqyrim i kërkesave ligjore të parapara me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Projektbuxheti përmban kornizën makroekonomike për vitin 2015 që pasqyron të dhëna për rrjedhat makroekonomike aktuale për treguesit makroekonomikë dhe trendin e të hyrave dhe shpenzimeve, si dhe krahasimet me zhvillimet ekonomike me vendet e BE-së në kontest të ndikimeve ekonomike në ekonominë e Kosovës në periudhën afatmesme.

Përveç pjesës tekstuale, projektligji përmban edhe pjesën tabelare me të dhënat për të hyrat dhe shpenzimet e përgjithshme të vendosura sipas burimeve kategorike të tyre për vitin 2015, si dhe parashikimet për dy vjetët vijuese.

Të dhënat pasqyrojnë edhe nivelin e deficitit dhe borxhit publik që po ashtu janë brenda kornizës së përcaktuar me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Në bazë të projeksionit makroekonomik gjatë vitit 2015 rritja ekonomike në normë reale është paraparë të jetë rreth 4,1% në raport me bruto produktin vendor rritje kjo e cila kryesisht pritet të mbështetet nga ngritja e konsumit si rezultat i ngritjes së dërgesave nga diaspora, si rrjedhojë e eksportit të mallrave dhe investimeve, konsum i cili vazhdon të jetë komponentë kryesore në rritjen reale të bruto produktit vendor përgjatë periudhës

2015-2017 pritet të rritet nga një normë reale mesatare prej mbi 3,5% ndërkohë që konsumi privat për kokë banori parashihet të rritet mesatarisht me 3%.

Përveç konsumit janë investimet ato që do të shënojnë performansën pozitive dhe normat reale do të rriten me 7,4% për vitin 2015 ku investimet private në raport me bruto produktin vendor do të rriten për 20% dhe kjo rritje pritet të jetë si rezultat i lehtësirave fiskale në favor të prodhuesve vendorë si dhe progresit të arritur në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit që pritet të ndikojë pozitivisht në investimet private dhe ngritjen e kapaciteteve prodhuese dhe aftësitë konkurruese.

Eksporti i mallrave dhe shërbimeve do të shënojë rritje në një normë mesatare prej 5%. Rritja e eksportit të mallrave do të jetë si rezultat i rritjes së çmimeve të metaleve, ndërkaq rritja e eksportit të shërbimeve i shtyrë nga rritja e eksportit të shërbimeve në udhëtime si rrjedhojë e vizitave të diasporës kosovare.

Në rritjen e eksportit do të ndikojnë edhe indikatorët e investimeve publike në infrastrukturë. Rritja e vazhdueshme e importit të makinave dhe pajisjeve për investimet në bujqësi nga shumë reforma që janë në proces, intensifikimi i marrëdhënieve tregtare me Bashkimin Evropian parasheh një zhvillim dhe përmirësim të aftësisë konkurruese të prodhuesve vendorë ndaj vendeve në rajon.

Importet do të vazhdojnë t'i kontribuojnë negativisht rritjes ekonomike me 2,5%, megjithatë si rezultat i parashikimeve të rritjes së eksportit kjo pritet që të ketë efekt pozitiv në përmirësimin e bilancit tregtar. Planifikimi i të hyrave buxhetore është bazuar në qëndrueshmërinë e kategorive të hyrave në relacion me faktorët relevantë ekonomikë, ndryshimet në politikat fiskale, ngritjen e nivelit të grumbullimit të hyrave doganore dhe ATK-së, masat e ndërmarra si dhe ato që duhet të ndërmerren për zvogëlimin e ekonomisë joformale.

Trendi pozitiv i rritjes së të hyrave brenda limiteve të deficitit do të vazhdojë edhe përkundër lirimeve doganore që kanë ndodhur si rezultat i miratimit të ligjit për lirimet doganore të produkteve të caktuara me prejardhje nga vendet e BE-së dhe fillimit të implementimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me vendet e BE-së.

Megjithatë, si rezultat i pritshmërisë së rritjes së importeve nga vendet e BE-së dhe si rrjedhojë e rritjes së të hyrave në kufi zbatimi i MSA-së do të ketë efekt pozitiv.

Sa i përket strukturës së të hyrave, të hyrat e përgjithshme dominohen nga të hyrat e rregullta tatimore që marrin pjesë me 86% të hyrave totale, të hyrat jo tatimore dhe vetjake me 12% dhe të hyrat nga dividendat 2%.

Të hyrat jo tatimore apo të hyrat vetjake, në total priten të jenë rreth 195 milionë dhe 2,5 milionë euro më të mëdha se në vitin 2014, prej të cilat të hyrat jo tatimore do të jenë rreth 48,8 milionë euro, të hyrat vetjake 114,2 milionë euro, prej të cilave 74,2 milionë euro pritet të arkëtohen në nivelin komunal dhe 40 milionë në nivelin qendror.

Sa u përket të hyrave tjera, janë parashikuar që shuma prej 10 milionë euro të jetë nga taksat konsensioinare, taniema 22 milionë dhe nga dividendat 30 milionë.

Ndarjet e shpenzimeve buxhetore për vitin 2015 janë përpiluar mbi bazën e marrëveshjes së qëndrueshmërisë makrofiskale nëpërmjet aplikimit të rregullës fiskale e cila limiton deficitin e përgjithshëm prej 2%, ndërsa stopi i borxhit në raport me bruto-produktin e brendshëm është paraparë të jetë 12,2% dhe paraqet një rritje prej 1,4%, në krahasim me vitin e kaluar.

Shpenzimet e përgjithshme për vitin 2015 janë 1 miliard e 682 milionë euro, që janë 6% më të larta se në vitin 2014, në raport me bruto-produktin vendor.

Shpenzimet e përgjithshme marrin pjesë me 28,6%. Në kuadër të shpenzimeve për vitin 2015 është përfshirë edhe një numër i projekteve, të cilat financohen nëpërmjet kredive nga partnerët ndërkombëtarë, e që kryesisht financojnë projekte të orientuara në përmirësimin e infrastrukturës.

Struktura e shpenzimeve buxhetore - Gjatë vitit 2015 dominohet nga shpenzimet rrjedhëse prej 1,205 milion, pjesëmarrja e të cilave në shpenzimet e përgjithshme buxhetore ka arritur në 72%, ndërsa si pjesëmarrje në bruto-produktin vendor gjatë vitit 2015 pritet të arrijë në nivelin 20,5%.

Pjesëmarrja e kategorive të shpenzimeve kapitale është 470,9 milionë euro, pjesëmarrja e të cilave në shpenzimet e përgjithshme buxhetore mbetet në nivelin e përafërt dhe është parashikuar të jetë rreth 28%, që tregon rënie krahasuar me vitin 2014 prej 4%, ndërsa si pjesëmarrje në bruto-produktin vendor pritet të jetë rreth 8%.

Rritja më të lartë e shpenzimeve të planifikuara rrjedhëse më 2015, në krahasim me rritjen e shpenzimeve kapitale, vjen si rezultat i disa arsyeve.

Efekti i plotë buxhetor i rritjes së pagave për punonjësit e sektorit publik, efekti i plotë buxhetor i rritjes së pensione dhe kompensimeve bazuar për të gjithë pensionistët për 25%, përfshirë edhe pensionistët e “Trepçës”, me vlerë prej 50%.

Implementimi i reformave në shëndetësi, përkatësisht fillimi i implementimit të Ligjit të shëndetësisë dhe ligjet mbi sigurime shëndetësore, implementimi i reformave në sektorin e sigurisë, rendit dhe ligjit, implementimi, përkatësisht kompensimi i përfituesve nga Ligji mbi veteranët e luftës dhe Ligji mbi ish të burgosurit politikë.

Shpenzimet për pagat dhe mëditje për vitin 2015 janë paraparë në një ndarje prej 549,1 milion euro, vlerë kjo që paraqet një ngritje prej 65,7 milionë euro, apo rreth 13,6% në krahasim me shpenzimet e planifikuara të vitit 2014. Kjo rritje e shpenzimeve reflekton, ndër tjera, koston e rritjes së pagave të shërbyesve civilë për 25%, që ka ndodhur vitin e kaluar, respektivisht 2014, si dhe implementimin e reformës së shëndetësisë, e që ka të bëjë me kontributet, të cilat Qeveria e Kosovës do t'i paguaj për të gjithë shërbyesit civilë në nivelin...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Vazhdoja fjalën, ju lutem!

NASER OSMANI: Mirë, meqenëse e pata dy herë fjalën dhe kam ende gjatë të flas, faleminderit, kryetar!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Osmani! Tani Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”, zoti Besnik Bislimi.

BESNIK BISLIMI: Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,
Sot po e diskutojmë në lexim të parë Projektligjin për Buxhetin e vitit 2015, të cilin Qeveria Thaçi 2 e ka përgatitur për Qeverinë e tanishme. Po diskutojmë për një dokument të përgatitur në nguti dhe pa pikë serioziteti, por të cilit Qeveria e tanishme në mënyrë unanime vendosi të mos ia heqë as edhe një shkronjë të vetme.

Qeveria ia dorëzoi projektligjin Parlamentit për diskutim dhe aprovim, por pa e parë të nevojshme që vetë të merret seriozisht me të. Madje-madje, besoj fuqishëm se shumica dërmuese e Kabinetit qeveritar nuk e ka bërë mundin as t’ia hedhë një sy as ligjit, e as tabelave buxhetore. Në këtë shumicë kam drojën se hyjnë edhe vetë ministri i Financave, zoti Hoti, e edhe kryeministri Mustafa.

I nderuar Kabinet qeveritar,

E keni dërguar në Parlament dokumentin që, siç tha vetë kryeministri, është më i rëndësishëm dhe që pasqyron jo vetëm orientimet tuaja katërvjeçare, por edhe vendosmërinë apo gatishmërinë juaj për t’i realizuar ato.

E keni dorëzuar dokumentin që na tregon se si do të shpenzohet gjithë paraja publike, edhe atë në disa raste edhe përtej vitit 2015, dhe e keni bërë këtë me aq nguti, pa kujtuar që ngutja është armiku më i madh i cilësisë. Po silleni më Buxhetin e vitit 2015 sikur t’i kishim 365 sish për secilën ditë nga një, e jo një të vetëm për gjithë vitin.

E keni marrë me aq lehtësi punën e Buxhetit sikur ta kishim nga një për secilin qytetar të Kosovës, e jo një të vetëm për të gjithë ne.

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Para se të përgatis diskutimin tim, tri orë jam marrë vetëm me Projektligjin për Buxhetin dhe me tabelat buxhetore. E kam përshtypjen se vendimi juaj do të kishte qenë krejtësisht ndryshe sikur edhe ju t’i kishit shpenzuar vetëm tri orë të kohës suaj të çmueshme për këtë ligj dhe për këto tabela.

Të nderuara deputetë,

Paramendojeni sikur kryeministri dhe ministri i Financave ta kishin marrë mundin dhe ta lexonin shpejt e shpejt Ligjin për Buxhetin. Me siguri se do të kishin vërejtur shumë mangësi në të dhe nuk do kishin lejuar procedimin e tij për diskutim sot në Parlament. Ata do ta kishin vërejtur që në start se, për shembull:

Radhitja e termave të përdorur në ligj është krejt e pakuptimtë dhe nuk është normale për një ligj që është përgatitur dhe finalizuar në gjuhën shqipe, dhe për rrjedhojë do të kishin kërkuar ndryshimin e tij.

Do të kishin vërejtur se pika 2 e nenit 5, që i shndërron në të hyra të përgjithshme të gjitha të hyrat vetjake të pashpenzuara të organizatave buxhetore të nivelit qendror është shumë demotivuese dhe mund të ketë ndikim negativ në performansën e këtyre organizatave. Po ashtu, do ta vërenin se një logjikë krejt e kundërt aplikohet për agjencitë e pavarura, të cilave thjesht u barten në vitin vijues mjetet e pashfrytëzuara.

Do të kishin vërejtur se në pikën 2 të nenit 9 thuhet që për një periudhë trevjeçare mediumit propagandistik dhe dezinformues publik, RTK, do t'i ndahen 0,7% e Buxhetit. Kjo do t'i çmendte të dy, sepse do të vërenin se periudha trevjeçare nuk ka as moment startues e as përfundues, por edhe do ta vërenin se me paratë e taksapaguesve ndahen shtatëfish më shumë për RTK-në se sa për të gjitha aktivitetet në hulumtime dhe inovacione, e shumë më shumë se sa mjetet e ndara për bursa të studentëve.

Do të kishin vërejtur se e kanë shkelur vit pas viti Ligjin për veprimtaritë kërkimore-shkencore, në të cilin Qeveria obligohet të ndaj në baza vjetore 0,7% të Buxhetit.

Do të vërenin se në pikën 3 të nenit 9 kërkohet që të gjitha mjetet e grumbulluara të pasqyrohen në tabelat buxhetore, përfshirë këtu edhe mjetet e grumbulluara në pikat doganore në veri të Kosovës, e të cilat pastaj do të derdheshin në Fondin e Mirëbesimit, por që dokumenti i tyre nuk e përmban asnjë informatë për shumat që pritet të derdhen në këtë fond gjatë këtij viti dhe shumat e derdhura në vitin paraprak, duke shkelur me të dyja këmbët, si principin e transparencës, ashtu edhe të gjithëpërfshirjes.

Do të vërenin se në pikën 3 të nenit 10 ende dhe vit për vit kopjohet me kokëfortësi dhe injorancë një provizion i vitit 2011, ku precizohet se kush përfiton e kush jo nga rritja e pagave për 30% e Qeverisë së Kosovës nga fushata zgjedhore e vitit 2010, dhe do të kishin kërkuar përgjegjësi të menjëhershme nga ata që e kanë toleruar një absurd të tillë.

Të nderuar deputetë,

Armiku më i madh i cilësisë mbetet ngutja.

Paramendojeni të nderuar deputetë sikur kryeministri dhe ministri i Financave të kishin shpenzuar disa minuta në leximin e tabelave buxhetore. Do të kishin mundur edhe një herë të binden nëse janë të vërteta pohimet e tyre të përvitshme se Qeveria Thaçi në kontinuitet ka privilegjuar me investimet kapitale komunat e udhëhequra nga PDK-ja dhe i ka injoruar në tërësi ato të udhëhequra nga LDK-ja, përfshirë edhe Komunën e Prishtinës dhe menjëherë do ta kishin stopuar këtë politikë diskriminuese. Meqë nuk e kanë stopuar, del se kanë manipuluar sa herë e kanë akuzuar Qeverinë Thaçi 2.

Po t'i kishin lexuar vetëm tabelat me indikatorët kryesorë do ta kishin vërejtur, si ekspertë të ekonomisë që janë, se parashikimet për vitin 2015, sa i përket performancës së ekonomisë, janë krejtësisht të pabazuara dhe shumë të ndryshme nga që vetë FMN-ja dhe Banka Botërore i ofrojnë. Njësoj siç do ta kishin vërejtur se numrat e paraqitur nga

përpiluesit e tabelave për produktin e brendshëm bruto për vitin 2014 dhe 2015 nuk përkojnë madje as me përqindjet e prezantuara mbi rritjen ekonomike, por janë numra të diktuar dhe imponuar nga ish-ministri i Financave.

Do ta kishin vërejtur se nuk ka asnjë korrelacion ndërmjet ndarjeve buxhetore dhe prioriteteve qeveritare, madje as të Qeverisë Thaçi 2, e as të Qeverisë së tanishme.

Të nderuar deputetë,

Ngutja mbetet armiku më i madh i cilësisë.

Sikur kryeministri dhe ministri i tij i Financave të ishin konsultuar vetëm për 10 minuta me krerët e Administratës Tatimore dhe asaj Doganore, do ta kishin mësuar se rritja e parashikuar e të hyrave në Dogana dhe në brendësi të vendit është më tepër se iluzion. Do ta mësonin se kjo rritje e madhe është kalkuluar, duke i marrë si bazë projektimet e vitit 2014, të cilat fatkeqësisht nuk do të realizohen as në masën e 90-përqindëshit. Do të mësonin se më reale do të ishte të parashikojnë shumë më pak të hyra, madje 150 milionë më pak. Do ta kishin shumë të lehtë t'i numëronin tri apo katër argumente se pse kjo rritje e parashikuar thjesht nuk mund të ndodhë.

Paramendojeni të nderuar deputetë sikur kryeministri i vendit dhe ministri i tij i Financave para se të vendosnin për procedimin në Kuvend të projektligjit të pandryshuar, për pak minuta të ishin konsultuar me ndonjë ekspert të ekonomisë për ta verifikuar kredibilitetin e projeksioneve mbi rritjen ekonomike, burimet e kësaj rritje dhe performansën e të hyrave buxhetore. Do ta kishin mësuar se argumenti i përdorur mbi konsumin si burim i rritjes ekonomike falë rritjes së pagave në vitin 2014 është shumë i palogjikshëm, meqë rritja e pagave nuk ka ardhur nga jashtë si variabël ekzogjen, por duke i zvogëluar pozicionet tjera të shpenzimeve korrente buxhetore. Një politikë e tillë, jo që nuk siguron ndonjë ndikim afatgjatë pozitiv në rritjen ekonomike, por edhe në afat të shkurtër rezulton me efekt negative neto.

Do të ju kishim këshilluar se nuk mund të llogaritni në investimet si burim të rritjes ekonomike për vitin 2015 dhe do të ju rikujtonin se në vetë tabelat tuaja parashikoni si ulje të ndjeshme të investimeve kapitale në sektorin publik dhe tregoni se si investimet private kanë filluar të bien që nga viti 2013.

Paramendojeni të nderuar deputetë dhe deputete sikur kryeministri dhe ministri i tij i Financave për një moment të ishin konsultuar me vetveten dhe t'i rikujtonin deklaratat e veta mbi të njëjtin projektbuxhet që nuk janë më të vjetra se 40 ditë.

Dhe, do kujtoheshin se na kanë dëshmuar se ky projektbuxhet nuk garanton as rritje ekonomike prej 2,5% dhe kanë premtuar se të njëjtit sapo të vijnë në Qeveri do ta përgatisin një Buxhet të ri, që do garantojë rritje trefish më të lartë dhe do ta arrijë shumën prej 2 miliardë. Tash, a t'u besojmë atyre deklaratave, apo Buxhetit që po na e prezantojnë sot? Unë them as njërës, e as tjetrës!

Paramendojeni, të nderuara deputete dhe deputetë, sikur kryeministri dhe ministri i Financave për vetëm pak minuta t'i kishin konsultuar edhe praktikantët e vendeve të rajonit në alokimin e shpenzimeve buxhetore. Për shembull, do ta kishin vërejtur se në Shqipëri i

gjithë Buxheti për paga në sektorin publik është më i ulët se shpenzimet e shtetit shqiptar për arsim dhe shëndetësi, dhe nuk do të kishin pranuar që i njëjti Buxhet në Kosovë të arrijë dyfishin e alokimeve për shëndetësi e arsim.

Paramendojeni, të nderuar deputetë, sikur kryeministri dhe ministri i tij i Financave, e pse jo edhe i gjithë Kabineti, të ishin konsultuar vetëm shkarazi rreth projektbuxhetit me miqtë e shumë ndërkombëtarë që i këshillojnë në baza ditore. Do të kishin mësuar për shumë projekte interesante që këta miq i kanë hetuar në versionin anglisht të draftbuxhetit.

Për argëtimin tuaj, të nderuar deputetë, por pa e shmangur vëmendjen për asnjë moment nga niveli i seriozitetit të çështjes që po diskutojmë, kisha dashur të listoj disa nga projektet që mund t'i gjeni në versionin anglisht:

1. Asphalting of roads in the Komoranit qytezën,
2. Marking vertical and roads horizontal,
3. Construction of houses Poor,
4. Fixing the infrastructure for people with separate needs through inst. publike.

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Vazhdoja fjalën, të lutem!

BESNIK BISLIMI:

4. Contruksion of road in the village Baice susedstvu Kiçin Lek,
5. Labortarike medical diagnostic equipment haematolo,
6. Sports of field. shfmu "Xheva Lladrovci" Vulture,
7. Construction of vood and coal "March 7".

Po ashtu, do të kishin mësuar se projekti kryesor kapital i Drejtorisë për Bujqësi në Komunën e Fushë-Kosovës është 'Castration of street dogs'.

Të nderuara deputetë dhe deputete,

Ka me mijëra mundësi për ta përmirësuar këtë projektbuxhet, e me këtë edhe ndikimin e tij në mirëqenien e secilit prej nesh, por vetëm një mundësi për ta bërë të kundërtën - për të votuar për të.

Ky Buxhet mund të jetë një mjet i mirë për ta përmirësuar jetën tonë, por mjeti i mirë nuk çon peshë kur është në duart e gabuara. Andaj, këtu sot rritet ndjeshëm pesha e vendimit të secilit prej nesh. Ne sot do të deklarohe mi në princip rreth këtij dokumenti. Përgjigjet janë shumë të shkurtra, 'po' ose 'jo'. Por, zakonisht janë mu përgjigjet e shkurtra që kërkojnë më së shumti mendim nga ne. E kemi shumë të lehtë të themi 'po' dhe mbyllim sytë para këtij Buxheti katastrofal. Nëse themi 'jo', na pret shumë punë për ta përmirësuar atë dhe për aq sa të jetë e mundur. Sot mund të fillojmë me hapin e parë, duke votuar kundër këtij projektbuxheti.

Grupi Parlamentar i “Vetëvendosjes” nuk e përkrah këtë projektbuxhet pa u bërë ndryshime substanciale, si në ligj, ashtu edhe në tabelat buxhetore. Faleminderit!

KRYETARI: Aleanca për Ardhmërinë e Kosovë, zonja Donika Kadaj-Bujupi e ka fjalën.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Buxheti i Shtetit e reflekton në mënyrën më të plotë dhe domethënëse politikën e një Qeverie. Buxheti është në thelb një akt politik. Ai e përbën instrumentin kryesorë të aksionit ekonomik të Qeverisë. Dhe, kur zoti Mustafa kërkonte të bëhej kryeministër, rrjedhimisht kjo kërkesë bëhej për ta realizuar një program.

Cili është projektbuxheti, i cili u prezantua sot nga Kabineti i ri, ose cili është ky program? Është dokument i hartuar nga partneri i tyre dhe i ruajtur me fanatizëm nga Qeveria e re, duke mos ndryshuar as pikë as presje, që i bie se insistimi i zotit Mustafa për kryeministër nuk ka qenë ndryshimi nëpërmjet zbatimit të një programi politik, pasi bazuar në këtë dokument Isa Mustafa do ta zbatojë për pikë e presje atë çka e ka shkruar Hashim Thaçi. Dhe, çfarë ka shkruar Hashim Thaçi, ose cili është ky program dhe çfarë përmban ky projektbuxhet?

Më 31 tetor, që i bie 53 ditë nga sot, përgjigjen në këtë pyetje e ka dhënë vetë doktori i ekonomisë, Avdullah Hoti, i cili sot e kërkon votën e deputetëve dhe e kërkon votën e deputetëve për një material, të cilin para 50 ditëve e ka quajtur si material të mashtrimit, kur ka thënë që me këtë lloj qeverisje kosovarët duhet të presin plot 28 vjet për t'i dyfishuar të ardhurat për kokë banori, apo një gjeneratë e tërë. Dhe, ju pyes sot, kryeministër e ministër: Për çfarë po e kërkon votën e deputetëve? Që qytetarët e Kosovës të presin 28 vjet që të përmirësohet mirëqenia e tyre, ose gjendja e tyre socioekonomike? Këtë e keni thënë vetë!

Do të kthehem te pjesa përmbajtjesore e tekstit. Është e njëjta e vitit 2014 dhe 2015. I keni pasur më shumë se dy javë që të paktën ta filloni një ndryshim, mirëpo po shihet që vullneti nga kryeministri Mustafa për çfarëdo ndryshimi është zero.

Ndoshta edhe s'po jua japin mundësinë dhe jeni të pafuqishëm përballë partnerit, i cili ju ka detyruar ta sillni projektbuxhetin e njëjtë për të cilin po e theksoj se mungojnë raportet e shpenzimeve për vitet 2013 dhe 2014.

Opinionit dhe institucionet nuk e kanë idenë si janë shpenzuar paratë e qytetarëve gjatë dy vjetëve të kaluara dhe tash po vjen një projektbuxhet i ri pa raporte paraprake të shpenzimeve.

Në këtë dokument, pjesa e të hyrave është pesimiste. Keni deklaruar vetë në programin e partisë tuaj që vlerësohet se janë rreth 500 milionë euro taksa, që bizneset i shmangin nga pagesa nëpërmjet ekonomisë joformale.

Pse nuk e filluat të paktën me 200 milionë euro të hyra shtesë në vitin e parë, apo s'keni

guxuar ta ndiqni klientelën tuaj dhe të partnerit tuaj, t'i ndiqni firmat mike, aksionarët tuaj dhe të PDK-së? Ata le të vazhdojnë edhe për 4 vjet ta zhvatin shtetin në kurriz të kompanive dhe të biznesit të ndershëm.

Kur Qeveria e shkruan që s'ka të hyra shtesë, do të thotë është lajm i mirë veç për kontrabandistët. Do të thotë që ju nuk e keni paraparë asnjë veprim për ta luftuar krimin e organizuar ekonomik, evazionin fiskal dhe korrupsionin.

Para disa ditësh, ministri, në një thënie diku në televizion, thotë 'ne nuk mund ta shpërndajmë atë që nuk e kemi'. Dhe, kjo prapë është një mashtrim, sepse po tentoni ta luani rolin e viktimës, duke kërkuar mirëkuptim, sepse po të ishit te gatshëm t'u qaseni vetëm dy resorëve, dhe këtu po flas për Administratën Tatimore dhe Doganën, minimumi i të hyrave në Buxhet do të ishte për 200 milionë euro më shumë. Dhe, me këto mjete do të mund të zbatohet pikë për pikë Kontrata Kolektive për të gjithë punëtorët, duke filluar nga punëtorët e sektorit privat, të cilët s'po i përmendni askund. Ata vazhdojnë të paguhet 200 euro, pastaj për Administratën, për mjekët, për arsimtarët, për Policinë e Kosovës dhe për kategoritë sociale. Sepse, me 200 milionë shtesë do të përmbusheshin edhe transferet sociale të veteranëve dhe invalidëve të luftës, për gratë e dhunuar, për pensionistët dhe të tjerët.

Madje, edhe 60 milionë euro të cilat i keni shkurtuar për këtë vit sa u përket investime kapitale do të mund të mbuloreshin, sepse zbatimi i plotë i kontratës kolektive kushton 90 milionë euro në vit, e jo më shumë. Por jo, kryeministër! Ju keni zgjedhur që të bashkëjetoni me krimin dhe të pajtoheni, duke u kënaqur me poste ministrore dhe të zëvendësministrave, të këshilltarëve, të asistentëve dhe luksit që po e shijoni duke e neglizhuar punën dhe interesin e vendit.

Dhe, se sa pak seriozisht e keni marrë punën Shtetit, flet dokumenti më i rëndësishëm, e thatë edhe ju, për të cilin po e krijoni përshtypjen që as nuk e keni shikuar dhe analizuar paraprakisht. Ky është një dokument i mjerë.

Dhe unë ju pyes, kryeministër Mustafa, pasi jeni ekonomist me profesion, që të na jepni një shpjegim: Me këtë trend të investimeve, si po mendoni t'i ndalni autobusët plot me qytetarë të vendit tonë që po ikin nga Kosova?

Këta njerëz po ikin nga varfëria, po ikin nga papunësia, po ikin nga qasja jote dhe e Skender Hysenit, i cili thotë që duhet të dënohen me nga 7 mijë euro ata që migrojnë ilegalisht. Si mund të dënohet popullata, e cila është varfëruar deri në atë masë sa detyrohet të kërkojë ushqim nëpër kontejnerë të mbeturinave? Na trego me këta parametra makroekonomikë si do t'i ndalësh fëmijët të mos përsëritet rasti i Fushë-Kosovës?

Ju e keni dënuar shoqërinë me veprimet tuaja. A ka dënim më të madh se ta lëshosh Kosovën si në vitet e '90-ta? Nëse atëherë kanë ikur prej dhunës, ata sot po ikin prej varfërisë së skajshme.

Te pjesa e analizës, në projektbuxhetin për të cilin po kërkon votë vetë e keni shënuar: Investimet nga jashtë dhe investimet e brendshme kanë rënë, sidomos në sektorin privat. Na tregoni, kryeministër, se si mund të gjenerojë 120 mijë vende pune një ekonomi, e cila të gjithë parametrat makroekonomikë të zhvillimit i ka negativë?

Tash po shpaloset në mënyrë shumë të qartë se partneri juaj, Hashimi, i ka mashtruar votuesit në fushatë, edhe kjo marrëveshje e nënshkruar me sindikatat më 18 prill 2014 ka qenë mashtrim i tij. Po shihet që në këtë Buxhet nuk është përfshirë as rritja e pagave për 23%, nuk ka as fond për punësim, dhe nuk ka as mision të ri. Në fakt, nuk është as 43-përqindëshi i premtimeve të zotuar nga ju.

Ky vit mbaroi. Viti i ardhshëm është i paracaktuar të jetë përsëritje e vitit 2014, vetëm se pritet të kemi edhe më pak mjete dhe më pak investime, më shumë varfëri, e të mos harrojmë - më shumë ministra!

E pasi po i përmend ministritë, ju i keni shtuar dy të reja, mirëpo nuk i ke paraparë 300 mijë euro shpenzime të ndara për kabinete. Do të thotë, 300 mijë euro janë shpenzime veç për staf, për kabinete, duke lënë jashtë ministrat. Prandaj, na tregoni ku do t'i hiqni këto mjete? Cilës shkollë, cilit bujk, shëndetësisë, apo kategorive sociale, të varfërve? Në llogarinë e kujt do të hiqen këto 300 mijë euro për ta paguar stafin e dy ministrive shtesë? Kafshatën e kujt do ta merrni?

I nderuari kryeministër, të nderuar kolegë deputetë,
I prezantova para jush disa nga faktet dhe dilemat në lidhje me projektbuxhetin. Si Aleancë, ne kemi i ngrehur shumë herë shqetësimet tona edhe kundrejt qeverive të kaluara, duke kërkuar ndryshim. Mirëpo, siç po shihet me këtë projektbuxhet, jo që nuk do të ketë ndryshim, por, në fakt, do të ketë prapakthim dhe përkeqësim.

Sot, qytetari i Republikë së Kosovës është një prej qytetarëve më të dëshpëruar në botë, sepse është i lodhur nga keqqeverisja e vazhduar. Është i lodhur nga pagesat astronomike për kilometër të autoudhës dhe nga mostransparenca e skajshme.

Neve edhe sot këtu po na servohet një projektbuxhet pa kurrfarë llogaridhënie për buxhetet e kaluara. E drejta jonë kushtetuese si deputetë, si qytetarë të Kosovës, është që ta kemi këtu sot raportin e harxhimit të Buxhetit të kaluar cent për cent.

Dhe, pas të gjitha fakteve të hidhura në këtë projektbuxhet, më lejoni që edhe një herë të konfirmoj, në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, se ne nuk do ta përkrahim, nuk do ta votojmë këtë projektbuxhet dhe do t'i luftojmë këto politika të këqija, të cilat vendit do t'i sjellin regres edhe në të ardhmen. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Grupi Parlamentar Lista serbe, zoti Sasha Milosavljeviq e ka fjalën.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala predsedniče!
Poštovani premijeru,

Članovi Vlade,

Dragi kolege,

Poslanička grupa Srpske liste je razmatrala Nacrt-zakona o budžetu, i mi se ne slažemo sa raspodelom sredstava ovog budžetu na severu Kosova. Ne slažemo se sa predviđenim budžetom za Ministarstvo za zajednice i povratak. Ne slažemo se sa predviđenim budžetom za Ministarstvo lokalne samouprave i pojedinih opština na jugu Kosova. Sve ovo ćemo pokušati da promenimo sa amandmanima u predviđenom roku između dva čitanja, a danas ćemo podržati ovaj Zakon u načelu. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “Nisma”, zoti Jakup Krasniqi e ka fjalën.

JAKUP KRASNIQI: I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Nëse nisemi nga fakti se jemi vonuar, ndoshta edhe mund të arsyetohet mënyra e punës me vrap për miratimin e Projektligjit për Buxhetin e vitit 2015. Ne po miratojmë me nguti, por në asnjë formë nuk guxojmë ta lejojmë shfrytëzimin e tij pa një kontroll rigoroz sipas planifikimit, edhe pse nuk jemi të bindur se projektbuxheti është planifikuar më së miri.

Gjatë gjithë këtyre viteve të katër legjislaturave të shkuara nuk mund të themi se kemi treguar ndonjë përgjegjësi në shfrytëzimin e parasë publike. Nuk ka asnjë shpresë që kjo praktikë të ndërpritet edhe në Legjislaturën e Pestë, kur janë bërë bashkë elefantët, të cilët e kanë bërë një kabinet prej elefantësh të shumtë e të pangjishëm për grabitjen e parasë publike dhe natyrisht që do të merren me çështje të tjera që nuk janë interes i këtij vendi, e as i qytetarëve. Këto gjëra shpresojmë se do të shihen së shpejti.

Buxheti i vitit 2015, në tërësinë e tij, është orientuar vetëm në mbulimin e shpenzimeve të domosdoshme dhe të luksit për institucionet dhe agjencitë shtetërore. Ky konstatim del nga vetë fakti i indikatorëve të projektbuxhetit të vitit 2015, ku tregohet se 71% e tërësisë së Buxhetit u dedikohen shpenzimeve rrjedhëse të institucioneve, prandaj është i vështirë që të quhet Buxhet i qytetarëve të Kosovës. Nëse r kemi parasysh faktin se në vitin në vazhdim do të kemi shtimin e ministrive të reja, me shumë ministra, me shumë zëvendësministra e zëvendëskryeministra, de fakto, jo vetëm që nuk kemi ngritje të fuqisë buxhetore, por kemi rënie të saj. Kur kësaj ia shtojmë mënyrën e planifikimeve të shpenzimeve të Buxhetit nga njësitë buxhetore, siç ka ndodhur në vitet e shkuara, Kosovën do ta përcjellin vështirësi dhe pakënaqësi të shumta.

Orientimi i Buxhetit për vitin 2015 nuk premtion asnjë shenjë të përkrahjes të zhvillimit ekonomik të vendit nga vetë fakti se në këtë drejtim institucionet bartëse të zhvillimit ekonomik nuk kanë ndarë buxhet për investime të tilla. Fakti se vetëm Ministria e Bujqësisë e ka një përkrahje të zhvillimit të këtij sektori dhe vihet në shifrën më pak se 3%, që besoj do të duhej të ishte së paku 5%, tregon më së miri indikatorët negativë në planin e zhvillimit ekonomik për vitin 2015.

Buxheti i subvencioneve për rreth 26% të Buxhetit është i orientuar kryesisht në përkrahjen sociale dhe subvencione të ndërmarrjeve publike, të cilat vazhdojnë të jenë barë e Buxhetit të Kosovës. Shpenzimet kapitale, të cilat marrin pjesë me 28% të Buxhetit, do t'i dedikohen kryesisht infrastrukturës rrugore. Është karakteristikë se te kjo kategori e shpenzimeve për projekte kapitale në nivel qendror, të cilat do ta kapin shifrën rreth 350 milionë e 894 mijë e 447 euro, pjesa më e madhe e tyre janë projekte që i takojnë vitit paraprak. 89% e këtyre investimeve janë projekte të bartura nga viti 2014 dhe vetëm 11 projekte janë të reja, të vitit 2015.

Projektligjit të Buxhetit të vitit 2015 vazhdon t'i mungojë transparenca, sepse është i paraqitur në pozicione shumë të përgjithësuara, siç janë: paga; mallra dhe shërbime; shpenzime komunale; subvencione; transfere; shpenzime kapitale dhe rezerva. Kjo paraqitje e sintetizuar lë hapësirë për spekulime prej më të ndryshmeve. Shtrohet pyetja: Sa brenda pozicionit 'mallra dhe shpenzime' do të jenë shpenzimet për telefona, derivate, reprezentacion, apo sa Qeveria do të shpenzoj për blerjen e veturave, mobileve, kompjuterëve e tjera, kur dihet se ka prirje të shpenzimeve të shumta të mëdha parash për këto pozicione.

Në vitin 2014, në këtë zë buxhetor janë bërë keqmenaxhime dhe keqpërdorime të mëdha të Buxhetit të Kosovës. Ka shpenzime të pakontrolluara për aparatet e mençura të telefonisë, pajisja e zyrtarëve me telefona të mençur dhe përgjithësisht aparatet e telefonisë mobile e tabloidë duhet të ndalohen me ligj të veçantë. Të hyrat e parashikuara për Buxhetin e vitit 2015 janë kështu, ndërsa shpenzimet dihen, e si mund të realizohen të ardhurat, i kanë disa pikëpyetje të mëdha që lidhen me mirëvajtjen e ekonomisë për vitin e ardhshëm.

Totali i të ardhurave në Buxhet këtë vit pritet të jetë 1 miliard e 576 milionë, me një rritje në krahasim me vitin e kaluar prej rreth 118 milionë. Rritja e planit të ardhshëm është shumë ambicioze në kushtet në të cilat ka performuar ekonomia e vitit 2014. Gjithsesi nga ky planifikim pritet që qytetarët e varfër dhe bizneset me bilance jo të favorshme të paguajnë 118 milionë euro më shumë se në vitin 2014.

Parashikimi i rritjeve të të hyrave për 8,1% më shumë se në vitin paraprak vë shumë pikëpyetje. Pikëpyetjet shihen qartë edhe në vetë arsyetimin e kornizës makrofiskale për vitin 2015, ku si bazë kryesore arsyetimet e kësaj rritjeje merret vetëm ngritja e efikasitetit të agjencive të grumbulluara, të ATK-së dhe Doganave. Derisa pritet një rritje nga tatimet në importe nga Dogana për 3% dhe tatimet e brendshme rreth 17%, nuk kemi asnjë specifikacion për llojet përkatëse të tatimeve që do ta mundësojnë këtë arsyetim të rritjes. Pra, në kornizën makrofiskale mungojnë të dhënat për secilin lloj të tatimit të shprehura në shifra: taksa doganore; akciza, tatimi në të ardhura; tatimi në të ardhurat e korporatave; TVSH-ja, tatimi në pronë.

Mungesa e këtyre informacioneve e bën më skeptik realizimin e këtyre të hyrave.

Të hyrat e paparashikuara janë përafërsisht 78,97 milionë. Këto të hyra do të vinin nga tantienat: hekuri; nikeli; plumb - zink; metalet bazike; materialet ndërtimore dhe çështjet

tjera. Pra, janë diku rreth 78,79 milionë. Do të thotë se po të bëhej ky evidentim i këtyre të ardhurave, Buxheti do të rritej dhe mundësia për t'i kryer obligimet ndaj kategorive të cilave u është premtuar rritja do të ishte më e madhe. Për të gjithë të punësuarit do të kishte mundësi të rritej paga 15%, kurse vetëm në arsim rreth 20%.

Mosgatishmëria dhe heshtja në këtë rast për ta penguar kontrabandën me resurset minerale të egra të Ballkanit, si dhe fakti i planifikimit dhe i inkasimit të burimeve kryesore që do të garantonin zhvillim dhe mirëqenie, fatkeqësisht argumentojnë faktin se Kosovës nuk i mungojnë resurset për një mirëqenie më të mirë, por i mungojnë politikat dhe gatishmëria e institucioneve për ta ulur krimin dhe korrupsionin. Ky projektbuxhet, i cili duhet t'u shërbejë rreth 2 milionë qytetarëve, kështu si është, e më shumë se si po shfrytëzohet, nuk mund të garantojë siguri për një jetë të dinjitetshme për qytetarët, veç oligarkisë politiko-financiare, e të bëra së bashku. Kjo pasiguri për punë dhe jetë ka bërë që ta kemi një valë të re të shpërnguljes së qytetarëve në drejtime të ndryshme - "kah sytë këmbët", thotë populli. Kjo është shpresa që ua jep ky koalicion i elefantëve. Fjala 'elefant' nuk është zbulim imi.

Ne i themi kryeministrit se është në përgjegjësinë e tij që ta zvogëlojë për 50% Kabinetin qeveritar, në mënyrë që ato mjete financiare t'i dedikohen arsimit, shëndetësisë, veteranëve, të pastrehëve...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Regjia, vazhdojani fjalën dhe mos ua ndërprit grupëve parlamentare, të lutem!

JAKUP KRASNIQI: ...Kosova e varfër nuk e ka luksin të ketë kaq shumë ministra, zëvendësministra, zëvendëskryeministra, e zyrtarë të tjerë të shumtë parazitë. Shumësia zyrtareve të lartë ekzekutivë edhe te institucionet e pavarura janë bërë gangrenë rrënuese për mirëqenien e qytetarëve dhe për ekonominë e vendit. Një ngritje më e mirë e të hyrave mund të bëhet me politikat e planifikuara ekonomike dhe fiskale.

Na duhet disiplinë financiare me adresim të veçantë në kufijtë veriorë të Kosovës, ku kemi evazion fiskal. Në Dogana ka shumë vrima e ikje, ku këto vrima janë dukshëm janë të mëdha. Janë goxha të mëdha edhe për faktin se e kemi një lidhje simbioze ndërmjet bizneseve dhe të politikës. Aty ku e kemi këtë lidhje, kemi edhe ikje nga obligimet doganore, akciza dhe TVSH-ja. Bizneset nuk janë bërë me ju pse ju duan, por pse nuk kanë mundur të mbijetojnë ndryshe. Veprimet e tilla e shkatërrojnë ekonominë e vendit.

I nderuari Koalicion qeverisës,

Të nderuar deputetë,

E dimë që në përbërjen e këtij Koalicioni qeverisës të elefantëve ka shumë njerëz që kanë sakrifikuar shumë për Kosovën, por ju lutemi në emër të atij sakrifikimi të djeshëm, për çka ju falënderojmë, e qytetarët ndoshta ju janë mirënjohës, por sot mos e sakrifikoni Kosovën për mirëmbajtjen e standardit të lartë, që ju më mirë se ne e dini se si e keni krijuar. Faleminderit për vëmendje! Faleminderit kryetar!

KRYETARI: Faleminderit zoti Krasniqi! Grupi Parlamentar “6+”, zoti Fikrim Damka e ka fjalën.

FIKRIM DAMKA: Sayın Meclis başkanım, bakanlar, milletvekilleri!
Kosova Bütçe Yasa Taslağının parlamento grubu olarak dikkatlice incelediğimizi ve Bütçe yasa taslağının aciliyeti söz konusu olması açısından ilk önce grup olarak bir an önce onaylanması için destek verdiğimizizi belirtmek isterim.

Dünya ekonomi dengeleri göz önünde bulundurduğumuzda Kosova da bu ekonomik büyümede nasibini alacağını göstermektedir. Petrol fiyatlarındaki düşüşler ister istemez Kosova ekonomisini dolayısıyla tüketici fiyatlarını olumlu yönde etkileyecektir. Kosovada Tüketicinin yüksek olması, ister yerli üretimi isterse de ithalatı artıracığı kesindir, bu da gelir ve gümrük vergilerini arttıracaktır.

Kosova’da ki siyasi gelişmeler 2014 yılı ekonomi büyümeyi olumsuz etkilediğini ve ekonomide bir durgunluğun baş gösterdiği özellikle de Kamu ve özel yatırımlarda ciddi bir düşüşün yaşanmasına sebebiyet verdiğini rakamlardan görmekteyiz.

Gelirlerdeki hedeflere ulaşıldığı özellikle de gümrük vergilerinin geçen yıla oranla artarak toplandığına sevinelim mi üzülelim mi bilmiyorum. Gümrük vergilerin çok fazla toplanması, ithalatın fazla olduğunu ortaya koymaktadır, bu da yerli üretimden çok uzakta olduğumuzu, ekonomi gelişmesi açısından olumsuz bir tablo olduğunu ortaya koyacaktır. Özellikle gümrük hedeflerine ulaşmak için faturalardaki tutarların haksız olarak yükseltilmesi dürüst işadamlarımızın devlete olan güvenini yitirmektedir. Gümrük noktalarında çifte standart uygulamalarına bence son verilmelidir. İşadamlarımızın mağdur ve hırsız durumuna düşürülmemeli.

2015 yılı bütçesini incelediğimizde geçen yılki bütçeden bazı değişiklikler arz etmektedir. Tabi ki yine gelirlerin büyük bir kısmını gümrük vergileri oluşturmaktadır. Ama gelir vergilerin toplanmasında yüzde 17 lik bir artış öngörülmesi olumlu olarak değerlendirmekteyiz. Vergi toplamada sistemin doğru ve adaletli bir şekilde herkese eşit uygulanacağını umut ediyorum. Elbette ki iç vergilerin artırılması devletin gelir kaynağını ana kalemni teşkil etmektedir. Ama iş dünyasında ve yatırımı ve iş yapması açısından da olanaklar ve destekler devlet sağlamalıdır.

Bugün vergi toplarken vergi sistemimizde bazı değişiklikler yapmamız şarttır. Ben sadece bir sektörü burada zikredeceğim, iki yıl çabamıza rağmen çözülmeyen kuyumcular veya altın piyasasıdır. Kosovada haksız bir şekilde altına uygulanan gümrük vergi oranı kuyumcularımızın dürüst şekilde çalışmalarını engellenmektedir. Bu yüzden ki geçen yıl Kosovaya sadece 3 kilogram altın girişi sağlanmıştır. Bir an önce bölgede ya da en yakın olan Arnavutluğu örnek alarak bu sektörü sistem içine dahil etmeliyiz. Artık silahlı gümrük memurları tarafından dükana basıp altın toplama devri geçmiştir. Brakalım dürüstçe çalışmalarını yapsınlar. Devlete de düşen görevi yerine getireceklerdir.

Giderler tablosuna baktığımızda özellikle maaş ve subvansiyonlarda ciddi bir artış olduğunu görmekteyiz, yaklaşık olarak 120 milyon euro, emekli ve diğer kategorilere ödemelerin artırıldığını ayrıca geçen yıl yüzde 25 lik maaş artışının giderlere yansıtıldığını görmekteyiz. Bu da bütçeye ek olarak 60 milyon euro yansımış durumdadır.

Bizi düşündürmesi gereken konu, geçen yıla oranla kamu yatırımlarında düşüşün olmasıdır, geçen yıla oranla yaklaşık olarak yüzde 10 luk ya da 60 milyon euro az yatırımın gerçekleşeceğidir. Bu elbette ekonominin daralmasına olanak yaratacaktır.

Bütçeye ek yük olarak bu yıl uygulamaya geçileceği sağlık sigorta fonunun oluşmasıdır. Devlet çalışanları adına bu fona gerekli parasal desteği aktarması, özel sektördeki bu çalışanları adına bu fona gerekli parasal desteği aktarması, özel sektörde bu çalışanlar adına ek ödeme yapmaları ister istemez özel sektördeki çalışanları etkileyecektir. Devlet olarak özel sektörü desteklemek açısından çeşitli destek politikaları geliştirmemiz kaçınılmazdır. Dış yatırımları da artırmak adına hızlı bir şekilde serbest sanayi bölgelerinin kurulması için çalışılmalı ve dış yatırımı Kosovaya çekebilmemiz için bürokrasiyi azaltmalıyız ve rüşvet hastalığına karşı hepimiz elbirliği ile savaşmalıyız, aksi takdirde üreten değil sadece tüketen toplum olmaya devam edeceğiz.

Geçen yıl Topluluk Bakanlığına itirazlarımıza rağmen bu yıl da yine bu bakanlıkta diğer topluluklara ayrı ekonomik kodları ayrılmayıp. Buna bu yıl da itirazımız devam ediyor. Sadece bu bakanlıktan bir topluluğun faydalanması, bu topluluk bakanlığının olduğunu göstermez. Rom, Türk, Boşnak, Aşkalı ve diğer topluluklar da bu bakanlıktan nasibini almalıdır.

Devlet bakanlığı bütçeleri artırılmalı, çünkü diğer görevleri dışında devlet bakanlıklarının da topluluklara önem göstermesi gerekecektir. Rom eğitiminin kapasitesi artırılmalı. Eğitim Bakanlığında ve topluluklar bakanlığında Rom eğitimine ayrı bir önem ve ekonomik kod ayrılmalıdır. Türk ve Boşnak eğitiminin kitap ve yardımcı kitaplarının basımı için yeterli bütçe ayrıldığını görmekteyiz. Özellikle eğitim bakanlığında Türk ve Boşnak eğitim ofislerinin olması gerekmektedir. Aksi takdirde bu, eğitimi kontrol ettiğimizi söylememiz doğru olmaz.

“6+” grubu olarak bu rakamları göz önünde bulundurarak Kosova yüzde 4lük ekonomik kalkınmayı önümüzdeki yıl yakalayacağına inanarak Bütçe Taslağını “6+” grubu olarak desteklemekteyiz.

KRYETARI: Faleminderit, zotëri Damka!

Atëherë kemi përfunduar fazën e diskutimeve nga grupet parlamentare. Kisha kërkuar që nga ju vetë, veçanërisht nga shefat e grupeve parlamentare, ta bëjmë një pauzë tani për drekë, apo po vazhdojmë?

E bëjmë një pauzë? Në orën 13:00? Atëherë vazhdojmë me pjesën e diskutimeve sipas radhës nga deputetë e paraqitur për diskutime.

I kemi disa deputetë pa grup, do ta ftoja deputetin Nenad Rashiq për diskutim. Mirë! Atëherë zoti Shpejtim Bulliqi nga Lidhja Demokratike e Kosovës. Më vonë! Zoti Ramush Haradinaj, nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

RAMUSH HARADINAJ: Të nderuar deputetë,
Kolegë të pranishëm,

Projektbuxheti që sot e kemi para nesh paraqet një dështim të plotë të kësaj Qeverie për ta parashikuar një zhvillim të përshpejtuar ekonomik, për ta ulur papunësinë në vend dhe për ta zvogëluar prapambetjen ekonomike krahasuar me ekonominë e rajonit.

Parashikimi i rritjes të të hyrave buxhetore për vitin 2015 për vetëm 8%, në krahasim me vitin që po e lëmë pas, dhe parashikimi që për vitin 2016 të hyrat buxhetore të jenë për 3 milionë më të ulëta se ato të vitit 2015, ndërsa të hyrat e vitit 2017 të jenë më të mëdha se ato të 2015 vetëm për 23 milionë, na tregon se për çfarë projektbuxheti bëhet fjalë dhe çfarë rritje ekonomike parasheh Qeveria. Pra, ky është një Buxhet i thellimit të varfërisë, të papunësisë dhe të prapambetjes të mëtejme ekonomike të Kosovës.

Nëse e analizojmë strukturën e të hyrave të planifikuara në këtë projektbuxhet, po ashtu vërejmë se kjo Qeveri nuk e ka paraparë asnjë reformë fiskale, as të nevojshme për krijimin e klimës së biznesit dhe për përtëritjen e investimeve të vendit dhe të huaja. Edhe me këtë projektbuxhet të vitit 2015, po ashtu për vitet 2016 e 2017, Qeveria parasheh që mbi 61% e të hyrave buxhetore të krijohen nga Dogana. Me këtë, Qeveria vazhdon të marrë para nga bizneset për mallrat që ende nuk janë shitur. Po ashtu, kjo është në kundërshtim edhe me idenë që të hyrat nga Dogana duhet të shkojnë drejtë zeros, e jo të jetë zëri kryesor buxhetor, meqenëse se vetvetiu është edhe nën direktivat e Bashkimit Evropian. Të hyrat doganore në çdo shtet që synon integrimin shkojnë drejt zeros, e në Kosovë vazhdojnë të mbeten zëri kryesor buxhetor.

Duke i analizuar mirë të hyrat e këtij projektbuxheti, vërehet qartë që Qeveria nuk pret asnjë rezultat nga fiskalizimi, nga lufta e krimit, korrupsionit dhe ekonomisë joformale. Pra, që në start hetohet se është pranuar një gjendje aktuale e tillë. Nëse i analizojmë me kujdes të hyrat nga konsensionimi dhe të hyrat nga tantiemat, edhe më qartë vërehet se kjo Qeveri nuk pret asnjë investim serioz në rritjen e kapaciteteve ekonomike në vend. Nuk është paraparë po ashtu investimi në ngritjen e kapaciteteve të reja energjetike dhe po ashtu nuk është paraparë ndonjë investim tjetër, me të cilin do të ndryshonte gjendja. Vendi me këtë qeverisje shkon drejt mjerimit. Nëse shkojmë më tutje dhe i analizojmë të hyrat nga Fondi i Mirëbesimit, ato për vitin 2015, si dhe për dy vitet në vazhdim, parashihen të jenë zero. Atëherë, shtrohet pyetja se çfarë rezultatesh pret Qeveria nga procesi i likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore të privatizuara dhe për likuidimin e të cilave AKP ka paguar miliona euro.

Me ligj, pjesa e Fondit të Mirëbesimit që u përket ndërmarrjeve të likuiduara duhet automatikisht të futet në Buxhetin e Shtetit. Pra, Qeveria nuk ka parashikuar asnjë rezultat në tre vjetët e ardhshëm. Nëse, të hyrat nga Fondi i Mirëbesimit parashihet të jenë zero, shtrohet pyetja: Si do të krijohet Fondi i punësimit, i propaganduar aq zhurmshëm nga zoti Thaçi dhe i adoptuar nga koalicioni i tashëm PDK – LDK.

Nuk do të ketë me këtë trend as edhe një vend të ri të punës. Se sa do të jetë ky projektbuxhet jozhvillimor na tregon edhe struktura e shpenzimeve buxhetore.

Shpenzimet për paga dhe për mallra e shërbime janë për 63% më të larta, se shpenzimet kapitale.

Edhe ky zë i projektbuxhetit na jep të kuptojmë, se Kosova në aspektin e zhvillimit ekonomik do të stagnojë dhe më tutje do të jemi një ndër vendet me prapambetjen më të thellë ekonomike, jo vetëm në rajon.

Krejt në fund, me projektbuxhet është paraparë rritje ekonomike, përkatësisht rritje e bruto produktit vendor për 4,3%, edhe pse kjo rritje ekonomike nuk është e besueshme, kjo rritje nuk e ulë papunësinë, përkundrazi e thellon atë.

Nuk mund të jetë rritja ekonomike e besueshme, nëse të hyrat buxhetore nuk rriten, nëse investimet e huaja bien, nëse nuk janë paraparë ngritje të kapaciteteve energjetike, nuk është paraparë aktivizim i minierave dhe nëse shpenzimet kapitale janë më të ulëta se sa ato të vitit 2014, për 60 milionë euro.

Pra, ky projektbuxhet si i tillë nuk bën të miratohet, duhet të ribëhet dhe të diskutohet në Parlament.

Në fund, një sugjerim, meqenëse, unë mendoj se në Kosovë jemi në një gjendje krize, pra shkaku që ikin qytetarët, shkaku që ekonomia është në gjendje të rëndë, kishim mundur të bënim diçka. Koalicioni e ka kapacitetin për ta bërë, meqenëse i ka edhe numrat në Kuvend, të shkohet me dy veprime e që në fillim nuk do të ishin të lehta, por me kalimin e kohës do të mund të ndikonin direkt në gjendjen ekonomike në vend.

Veprimi i parë që propozoj të ndodhë në Kosovë, është që të ndryshohet politika fiskale në tërësi, pra të kalohet në taksë të sheshtë. Është paralajmëruar më herët taksë e sheshtë, si për taksën në pagë, në fitim, në TVSH, pra të jetë një. Kuptohet, që të praktikohet edhe pushim tatimor për investitorët për një periudhë kohore, të lajmërohet vetë pushim tatimor për një periudhë të caktuar, të lirohen prej TVSH-së ato produkte bazë, meqë kemi një pjesë të popullit që jeton në varfëri, që janë bazë për jetesë.

Në këtë mënyrë do të ishte një sinjal i parë, që në Kosovë po fillojnë ndryshimet. Është një politikë tatimore e djathtë, por është e lehtë për t'u zbatuar dhe ndihmon në hapat tjerë në luftimin e informalitetit në mënyrën e progresit të mëtejshëm në ekonomi.

Çka do të mund të ndodhte tjetër në Kosovë, në rast se duam vërtet ta ndihmojmë e ndryshojmë gjendjen në këtë vend. Me qenë se, po filloni me një qeveri të madhe, kuptohet është çështje e akomodimit. Ju mund të përgatisni ligjin për Qeverinë, sepse s'ka një ligj për Qeverinë, e në këtë ligj për Qeverinë në një afat të ardhshëm kohor, pasi të jeni të konsoliduar, ta reduktoni Qeverinë në 10 ministri. Pra, t'i bashkoni disa ministri, në një, që janë sektorë të përafërt, të reduktohet numri i zyrtarëve politikë të këtillë, pra të kësaj natyre, dhe të jepet një sinjal, një mesazh në vend.

Krahas taksës së sheshtë edhe një qeverie racionale, pra do të mund të bashkëjetonin këto dyja. Taksa e sheshtë e krijon një mungesë të hyrave në fillim, Qeveria racionale jep një sinjal se mund të mbulohet kjo. Në të njëjtën kohë, luftimi i informaliteteve, aspekteve tjera do të mund të jepen në shpresë në vend, që ka ndryshim.

Nuk po ju obligojmë që këtë ta bëni sot në nisje, por po ju lusim që ta përgatisni një ligj për Qeverinë, së bashku, në kohën adekuate kur të mundeni dhe, kështu të paktën do t'i mbetet Kosovës një veprim juaji që e keni bërë në kohën kur keni mundur ta bëni, e që në të ardhmen Kosova nuk do ta kishte problemin e Qeverisë, sikur është e tashmja.

Një lutje, po ashtu, meqë filloni tash me Qeverinë, e kuptojmë, jemi të gjithë politikanë, udhëheqim parti, akomodimin, mendojmë, se nuk është momenti për ta përmbyllur akomodimin me zëvendësministra. Do të ishte shumë me e mençur, të paktën këtu të bëhet një veprim racional, të mos ketë mbi një zëvendësministër për një ministri. Pra, partitë kanë mënyra të tjera për të akomoduar kolegë, por në këtë situatë do të ishte më mençur të shkohet me vetëm një.

Edhe njëherë po kthehem te fjala që thash, na vjen keq që Kosova në momentin e këtillë, çfarë e ka nuk e merr një lajm të mirë sot në Parlament për një buxhet, për veprime, që do të mund të ndryshonin gjendjen pjesshëm, afatshkurtër, pra menjëherë, se është gjendja emergjente dhe gradualisht të shihet një trend zhvillimor. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E ka fjalën zoti Muhamet Mustafa.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuar kryetar i Kuvendit,

I nderuar kryeministër,

I nderuar Kabinet qeveritar dhe kolegë deputetë,

Mendoj se ne sot kemi obligim, që të japim një mesazh kryesor nga ky debat e ky mesazh duhet të jetë, se Qeveria e re edhe Kuvendi po e marrin detyrën në një situatë të vështirë ekonomike dhe buxhetore. Këto vështirësi rrjedhin nga shumë fakte, por 4-5 janë kryesore.

E para, rritja ekonomike është gati përgjysmë më e vogël se sa ajo që kemi planifikuar para një viti dhe që ka qenë e paralajmëruar me Buxhetin e vitit 2014.

E dyta, ka një zvogëlim të investimeve private, edhe atyre vendore edhe atyre të jashtme.

E treta, nuk janë realizuar parashikimet për të ardhurat buxhetore, as nga Administrata Tatimore, as nga dogana.

E pesta, mbetet një deficit brengosës në bilancin tregtar.

E gjashta, papunësia mbetet e lartë.

Dhe, natyrisht krejt kjo ka prodhuar një situatë, kur qytetarët presin me të drejtë nga të gjithë ne, kuptohet edhe nga Qeveria, që kjo situatë të ndryshojë. Pra, situata duhet të

ndryshojë dhe unë jam koincident se kjo Qeveri ka të gjitha kapacitetet, që ta ndryshojë këtë situatë, por ne të gjithë duhet ta kuptojmë se situata është e vështirë.

Për të ndryshuar situata nevojiten kthesa të vendosura në këto pesë fusha, që njëkohësisht përbëjnë edhe komponentët kryesorë të qeverisjes makroekonomike. Së pari, rritja ekonomike duhet të ngritet me këtë Buxhet nga 2-3%, sa ka qenë në 2-3 vjetët e fundit, në mbi 4%, e që unë mendoj se realisht këtë vit ne nuk mund të presim ndonjë rritje më të madhe.

Dhe, unë mendoj se kjo rritje është e mundshme nëse përmirësojmë klimën biznesore, pra nëse e ndërpresim trendin e zvogëlimit të investimeve private dhe sigurojmë rritjen e investimeve private.

Përgjatë tre vjetëve të kaluara investimet private kanë rënë dhe, ky është indikatori më real, më i besueshëm për klimën jo të volitshme të biznesit në Kosovë. Ne kemi pasur, domethënë shumë deklarime se klima e biznesit është përmirësuar, se kemi ngritur domethënë një rangimin në studimin e Bankës Botërore, mirëpo faktikisht, jeta po tregon se klima e biznesit është e ngarkuar, nuk është e përshtatshme, nuk ekziston një optimizëm aktualisht në sektorin privat dhe kjo është detyra kryesore, që ne duhet ta ndryshojmë.

Natyrisht, se te klima biznesore kemi të bëjmë me një spektër ndikimesh negative, që nga politikat joadekuate në disa sektorë deri te dobësitë në zbatim të këtyre politikave, te niveli i korrupsionit, dobësitë në zbatimin e shtetit ligjor.

Është tërësisht e qartë, se vëmendja kryesore, pra e të gjithë neve duhet të përqendrohet në ringjalljen e aktivitetit të bizneseve në sektorin privat, pasi që ky sektor aktualisht mbetet i vetmi që mund të gjenerojë rritjen ekonomike më të madhe.

Rritja ekonomike në vitet në vijim nuk mund të mbështetet shumë, as në rritjen e investimeve publike e as në remitancat, për arsye se edhe në projeksionet që i kemi marrë, shihet se ne do të mbesim përafërsisht në nivelin e njëjtë të investimeve publike dhe të remitancave përgjatë këtyre viteve, me disa oscilime të vogla.

Shikuar nga aspekti i politikave makroekonomike dhe i kapaciteteve absorbuese të shoqërisë, niveli i investimeve do të duhej të rritej, pra kryesisht duke u bazuar në investimet private nga 26% të GDP-së, sa e kemi tani, në diku 30-32% të GDP-së. Kjo do të duhej që të ndikonte, që rritja ekonomike vjetore duhet të lëvizë nga 3-4% sa është tash, shpejt, domethënë mundësisht në gjysmën e dytë të vitit 2015 dhe në vitin 2016 me 5%, për të shkuar pastaj kah fundi i vitit 2016 në 6-7%, ashtu siç ka qenë edhe programi ynë elektoral e që do të fillonte të ndalë rritjen e papunësisë, sepse vetëm me këtë normë të rritjes ne mund ta ndalim papunësinë dhe të krijojmë një hapësirë për të punësuar, për të hapur 25 mijë vende te reja të punës dhe 5 mijë të tjerë që shkojnë në pension, domethënë për të punësuar diku rreth 30 mijë veta në vjet, që do të shënonte për herë të parë një periudhë zvogëlimin e papunësisë në Kosovë.

Pra, krahas vetëdijesimit të të gjithë neve dhe opinionit, se situata është aktualisht mjaft e vështirë, duhet të dërgojmë edhe mesazhe se ndryshimi i kësaj situatë është i mundur dhe është i domosdoshëm dhe, për këtë e kemi zotimin edhe të Qeverisë së re dhe kryeministrit. Pra, ky është një problem me të cilin duhet të ballafaqohemi, por, problem me të cilin duhet të ballafaqohemi është njëkohësisht edhe vetëdijesimi i bizneseve, vetëdijesimi i qytetarëve, se kemi situatën e vështirë, por situata nuk është pa rrugëdalje.

Fatkeqësisht, në periudhën elektorale ne kemi rritur pritjet për rritje të menjëhershme të pagave, kemi rritur pritjet për rritje të menjëhershme të pensioneve, kemi rritur pritje për vende të punës të shumta përnjëherë, këto duhet t'i menaxhojmë.

Mendoj, se puna e parë që duhet të bëjmë edhe Kuvendi dhe të gjithë, ne duhet të ballafaqohemi me këtë situatë dhe, të gjithë qytetarët duhet ta dinë se këto gjëra nuk mund të bëhen përnjëherë.

Ne e kemi një Buxhet, që tash është rreth 1 miliard e 600 dhe, ai buxhet duhet të shihet se si do të ndahet më së miri dhe të adresohen nevojat e domosdoshme e që duhet pra, të shohim realisht, t'u themi njerëzve sa mund të rriten pagat, kur mund të rriten pagat. Është krijuar një konfuzion, ndoshta edhe me rastin e pranim-dorëzimit të detyrës nga dy ministrat e financave, sepse aty tha që me këtë Buxhet janë paraparë edhe të gjitha mjetet për paga, për rritje 25%.

Dhe, njerëzit mendojnë se tash njëra, Qeveria e kaluar ka paraparë rritjen, por Qeveria e tashme nuk po lejon rritjen. Është çështje e gabuar. Domethënë, 25%-i është 25-përqindëshi i vitit të kaluar dhe domethënë në këtë Buxhet, as Qeveria e kaluar, edhe po të ishte sot Qeveria e kaluar nuk do të kishte mundësi të rriste 25% edhe në vitin 2015.

Pra, kjo duhet të jetë shumë e qartë dhe, ne duhet të shpjegojmë, se pse. Duhet t'i menaxhojmë këto pritje, që i kemi krijuar vetë. Dhe, kjo është një çështje shumë e rëndësishme. Gjithashtu, kemi mundësi që të bëjmë ndoshta, një auditim rigoroz të transfereve sociale, të cilat përbëjnë një barrë të rëndë për Buxhetin tonë dhe ne është dashur domosdo që t'i adresojmë edhe veteranët edhe kategoritë që kanë probleme sociale dhe të gjitha tjerat.

Por, në atë pako, të them ashtu në atë grumbull kemi shumë përfitues, ndoshta që s'e meritojnë, prandaj, puna e parë e ministrit të Çështjeve Sociale dhe të Punës, është që të bëjë një auditim shumë rigoroz dhe aty të mbesin vërtetë ata që e meritojnë dhe në mënyrë që të krijohen disa hapësira për t'i adresuar problemet të cilat janë të ngutshme.

Sigurisht, se nuk është dashur, ka qenë pritje joreale, unë po i dëgjoj këtu që për dy javë Qeveria ta rriste, ta prezantojë këtu filozofinë e re buxhetore, për arsye edhe të ngushticës kohore, por ne presim me të drejtë, unë kam biseduar me ministrin e Financave, se diku në prill do të na vijë me kornizën e shpenzimeve afatmesme, e cila duhet të jetë e rristur, në pajtim me nevojat që i ka Kosova dhe zhvillimi i Kosovës. Dhe, aty duhet ta shohim filozofinë e re të kësaj qeverie, e cila ka mundësitë dhe hapësirat që të bëjë, por duhet pra ta ngremë nivelin e qeverisjes makroekonomike.

Kjo ngritje e nivelit të qeverisjes duhet bërë midis tjerash edhe me ngritjen e profesionalizmit dhe të analizave makro-ekonomike. Aktualisht, ne kemi një situatë që në Ministrinë e Financave kemi një njësi që është përgjegjëse për parashikimet makroekonomike edhe analizat makroekonomike, por aty kanë mbetur 3-4 veta, më tha një slloven që ishte aty momentalisht duke dhënë një asistencë.

Gjithashtu, statistikat tona prodhojnë indikatorë shumë të varfër, me të cilët ne mund të mbështetemi në krijimin e politikave. Nuk ka statistika mbi prodhimin, sot ne nuk dimë çka prodhojmë në Kosovë. Nuk ka statistika mbi punësimin, askush nuk mund të thotë me siguri, se sa njerëz punësohen brenda vitit...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Vazhdoja fjalën, ju lutem regjia!

MUHAMET MUSTAFA: Pra, mundësitë që i ka Kosova e të cilat i ka prezantuar ky koalicion qeverisës të shfrytëzohen dhe unë mendoj se Qeveria ka të gjitha kapacitetet dhe mundësitë, që të krijojë këtë perspektivë të re, të cilën me të drejtë e presin qytetarët e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Mustafa! E ftoj zotin Albin Kurti.

ALBIN KURTI: Deputetë të Kuvendit të Kosovës,
Nëse i kujtojmë fjalët e këtyre qeveritarëve në fushatën zgjedhore dhe i krahasojmë me shifrat e tyre për Buxhetin, bëhet e qartë se ata karakterizohen përgjithësisht prej premtimeve revolucionare, që pasohen me veprime që nuk janë as reformatore.

Projektligji për Buxhetin 2015 nuk dallon, as në orientim e as në përmbajtje nga Buxheti për vitin 2014. Ky mos ndryshim është pozicionim politik i LDK-së, se jo vetëm fjalët e premtimeve, por edhe shifrat e shpenzimeve në të kaluarën paskan qenë në rregull.

Në anën tjetër, PDK-ja hoqi dorë nga rritja e pagave të qytetarëve në sektorin publik, duke bërë koncesion me të vetmin qëllim, që udhëheqja e saj t'i mbajë pagat e veta, duke mbetur në Qeveri.

Pra, PDK-ja hoqi dorë nga rritja e pagave të mbi 80 mijë qytetarëve, që t'i mbajë pagat e nja 80 mujsharëve.

Kam shumë për të thënë për këtë Buxhet që nuk premtton gjë, por do të kufizohem në tri çështje:

E para, energjia. Në Buxhetin për vitin 2015 për energjinë janë vetëm 4 pozicione, me ç'rast pjesa dërmuese i dedikohet më parë pagave dhe mëditjeve të institucioneve si ZRRE-ja ose për agjenci, se sa për ndonjë projekt aktiv. Përpos pagave, mallrave dhe shërbimeve, si dhe shpenzimeve komunale, Departamenti i Energjetikës do të merret vetëm me eficiencë.

Nga tërë vlera e destinuar për këtë departament 1 milion e 460 mijë euro, ose 21.4% janë destinuar për efikasitet, mirëpo duke marrë parasysh që 4 milionë e 500 mijë euro janë ndarë për kompensim të rasteve sociale, shihet se nuk kanë edhe ndonjë punë të madhe, së paku sipas vlerave të angazhuara.

Për vitin 2015 kjo Qeveri parasheh 4 milionë e gjysmë euro për kompensimin e pagesave për raste sociale, të cilat janë vendosur në pikën buxhetore, importi i energjisë, raste sociale.

Duket se tërë energjia për rastet sociale do të importohet. Shtrohet pyetja: Pse është bërë ky kombinim dhe cili është kuptimi i tij? Më tutje, Departamentit të Energjetikës iu kanë ndarë 200 mijë euro si investime kapitale për çështje të efikasitetit dhe burime të ripërtërishme të energjisë. Përveç kësaj, është edhe një investim prej 1 milion e 260 mijë eurosh për implementimin e efikasitetit që është vazhdim nga viti 2014. Aty thuhet që këto para do të shpenzohen për zbatimin e masave të efikasitetit energjetike nëpër ndërtesat publike, mirëpo, nuk është e qartë se për cilat ndërtesa mendohet dhe si erdhën te kjo shifër e caktuar për shpenzimet e nevojshme.

Për shembull, jepet hollësia për shpenzimin prej 5 mijë euro për ujësjellësin në fushën sportive në Dragash, në komunën e Sharrit, por jo edhe hollësitë që përbëjnë këtë 1 milion e 260 mijë euro.

Ne kemi vërejtje të madhe, që nuk janë inkuadruar edhe:

1. Investimi për projektin e fuzionimit të sistemit energjetik Kosovë-Shqipëri, cilat do të ishin efektet pozitive nga fuzionimi i tillë?
2. Krijimi i fondit qeveritar për stipendimin e studentëve në vend dhe jashtë, në bachelor, master, doktoratura dhe specializime profesionale për elektro-energjetikë, rregullim e automatikë, teknologji informative, makineri, teknologji, hidrologji, xehetari, mbrojtje të ambientit, fizikë e kimi.

Këtu duhet inkuadruar edhe bashkëpunimin shkencor në lëmit e përmendura e sidomos në trajtimin e thëngjillit.

3. Do të duhej të trajtohet edhe projekti i vetëdijesimit të popullatës për kursim të energjisë elektrike, drurit, ujit, naftës dhe burimeve tjera energjetike, projekti për zgjerimin e ngrohjes qendrore me koogjenerim nëpër tërë Kosovën, si dhe projekti për zgjerimin e koogjenerimit për ujë të ngrohtë.

Në raportin e ZRE-së, për vitin 2014 paraqitet një varfërim kadrovik dhe varshmëri e patolerueshme e ZRE-së nga Qeveria, posaçërisht në domenin e pagave. Kësisoj, Qeveria ka futur nën zgjedhje dhe kontrollon ZRE-në. Pa marrë parasysh që tani ZRE-ja përbëhet nga marionetat e Qeverisë dhe se nxjerrja e ZRE-së nga dizgjinët e tyre nuk do të ketë efekte të mëdha, mendoj se dalja e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë nga buxheti i Qeverisë dhe kthimi në formën fillestare të investimit do të krijojë ca parakushte për pavarësimin dhe heqjen nga vasaliteti i saj ndaj Qeverisë.

Në pikëpamje financiare kjo do të jetë kalim nga një xhep në tjetrin. Në një anë do të shkarkohet Buxheti e, në anën tjetër, pjesa dërrmuese e obligimeve i bie prapë qytetarëve, por në cilësinë e konsumatorit të energjisë elektrike, të cilët edhe ashtu krijojnë të hyra të operatorëve, të cilët do të jenë klientë të ZRE-së.

Çështja e dytë, që dua të theksoj është Buxheti i Serbisë për serbët në Kosovë, e që bëhet edhe përmes strukturave të saj, po del të ketë qenë përafërsisht 300 milionë e 700 mijë euro për vitin 2014, ndërkaq nëpër medie dhe OJQ serbe, llogaritet 350 milionë euro në vit. Pra, këto janë para që hyjnë në Kosovë.

Deri diku, e zbërthyer në linja të veçanta, ajo është si në vijim:

Zyra për Kosovë, 43 milionë euro;
Arsimi, 44 milionë;
Shëndetësia, 130 milionë;
Komunat, 30 milionë;
Kulturat, 500 mijë;
Mediat, 450 mijë;
Mbrojtja sociale, 530 mijë;
Refugjatët, 1.2 milionë euro;
Qarqet apo rrethet: i Kosovës, 140 mijë; i Pejës, 520 mijë; i Mitrovicës, 120 mijë; i Anamoravës, 420 mijë.

Pyetja për Qeverinë është: Kur e ka përpiluar Buxhetin 2015 kjo Qeveri, a e ka pasur parasysh, që njëra pakicë është kaq shumë e privilegjuar tashmë? Sepse, kjo qeveri nuk po e kontrollon e as ndalon këtë financim selektiv, që e bën shteti armik i Kosovës, Serbia brenda Kosovës.

Pra, meqë nuk e ndalon dhe nuk e kontrollon, a e ka së paku parasysh, apo po i mbyll sytë? Nëse është kjo e dyta, atëherë Qeveria e Kosovës po bashkëpunon me Serbinë, në diskriminimin e shqiptarëve dhe të pakicave jo serbe në Kosovë.

Çështja e tretë, është një krahasim i shkurtër me Buxhetin e Shqipërisë për disa fusha.

Interesante është rëndësia që kanë shëndetësia dhe arsimi në Buxhetin e Shqipërisë, 12% dhe 15%, krahasuar me Kosovën, 3% dhe 4%. Po ashtu, Ministria e Brendshme shpenzon pjesë të madhe të Buxhetit të Kosovës, 11%, krahasuar me atë të Shqipërisë, 7%, edhe pse në Shqipëri, kohët e fundit kemi pasur aksione të mëdha të Ministrisë së Brendshme si: Lazarati, anti-droga e të tjera, ndërsa në Kosovë, Policia përdoret vetëm për të shtypur protesta, ose për t'i ruajtur punimet në parkun cinik të paqes në urën mbi lumin Ibër në Mitrovicë.

Në Buxhetin e Kosovës, deputetë të Kosovës, krijimi i ministrive me buxhet qesharak në 1%, tregon dëshirën për rehatim të individëve nëpër pozita e pushtet dhe njëkohësisht tregon se ato para do të përdoren thjesht për rroga të pushtetarëve e jo për ndonjë investim real, pra jo në të mirë të publikut.

Ndërkaq, zhvillimi ekonomik dhe industrial, pra shtylla e punësimit, është një ndër sektorët më të lënë pas dore, siç tregon edhe Buxheti i shpërndarë për të, apo më mirë të themi, Buxheti që mungon për këtë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E ka fjalën deputeti Shpejtim Bulliqi.

SHPEJTIM BULLIQI: I respektuar kryetar i Kuvendit,
Të respektuar Kabinet qeveritar,
Kolegë të respektuar deputetë,
Ju përshëndes.

Kur flitet për buxhetin e shtetit, faktikisht kemi të bëjmë me njërën prej shtyllave kryesore të funksionimit të shtetit. Sigurisht, që ne pasi e patëm në dorë këtë material dhe arritëm ta analizojmë, shpeshherë na u krijua përshtypja, që vërtet ky buxhet është shpërndarë në mënyrë jo të barabartë, në nivel të Kosovës dhe në dobi të të gjithë qytetarëve të Kosovës, në mënyrë të barabartë.

Sigurisht, që gjatë krejt këtyre ndarjeve buxhetore që janë bërë, faktikisht vërehen një numër relativisht i madh i disproporcionit në këtë ndarje, sepse faktikisht kemi një numër të madh të komunave, të cilat vërtet janë stimuluar me një sasi të madhe të projekteve të ndryshme, pothuajse në të gjithë sektorët, ndërsa kemi një serë komunash, të cilat faktikisht kanë mbetur me numër shumë të vogël të këtyre projekteve. Unë vetëm sa për ilustrim, do të kisha dashur që të përmend disa raste, duke filluar nga Ministria e Infrastrukturës. Në këtë Ministri, në bazë të një analize që është bërë vërehet që vërtet kemi një disproporcion të madh të shpërndarjes së Buxhetit.

Vetëm po ju marr një shembull, nga 33 milionë e 755 e 172 euro për rrugë të reja dhe rehabilitim të rrugëve vetëm në njërën komunë janë ndarë diku mbi 5 milionë euro, që në qoftë se e kthejmë në përqindje krejt të këtij Buxheti na del që kemi diku 14,5% të krejt këtij Buxheti të dedikuar për rrugë që u janë dhënë vetëm një komune. Në qoftë se doni po ua përmendi edhe emrin.

Por në rast se e marrim edhe një projekt tjetër që gjithashtu bën pjesë në projekt kapital, që edhe ai kap shumën mbi 5 milionë euro, faktikisht na del që vetëm brenda atij territori shumë të ngushtë i kemi diku nga 27% të Buxhetit të përgjithshëm për rrugë të reja dhe meremetime të rrugëve.

Dalim te Ministria e Shëndetësisë. Në bazë të asaj që duket, me këtë ndarje buxhetore faktikisht që llogaritet në shpenzime kapitale diku nga 9 milionë euro, rreth 9 milionë euro, atëherë na del që me këto shpenzime kapitale vetëm 2 komuna u është dhënë prioritet për të vepruar, me dy projekte dhe ajo në shumë prej nga 400 mijë euro. Qendra kryesore e Mjekësisë Familjare në Kaçanik dhe Skenderaj dhe pjesa tjetër e këtyre mjeteve kapitale faktikisht janë të destinuara vetëm në destinacione tjera, e jo në nivel të komunave.

Kur shkojmë te Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve në shumë raste, brenda kësaj Ministrie kemi një pozicionim të mjeteve buxhetore, të cilat vërtet janë të paqarta ose të

paktën për mua ishin shumë konfuze. Për shembull, rinovimi i palestrave ekzistuese në qendrat regjionale, 200 mijë euro. Ne dimë cilat janë qendrat regjionale po ndoshta kishte me qenë e rrugës për t' u specifikuar dhe mos të kemi mundësi tash të bartjes së projekteve herë në një pjesë herë në tjetër, varësisht nga interesat e ministrisë gjegjëse.

2. Shtigjet e atletikës në stadiumet regjionale, një tjetër projekt, prapë 200 mijë euro.

3. Ndërtimi i pishinës në regjionin e Prishtinës. Tash nuk përcaktohet ku se regjioni i Prishtinës i ka një sërë komunash tjera, një shumë diku prej 500 mijë eurosh.

Pastaj palestrat sportive, që më bëri një përshtypje shumë të madhe, një shumë prej 400 mijë eurove në një lokalitet, në një fshat. Më bëri shumë përshtypje kur kemi shumë qyteza të mëdha, qytete në Kosovë që realisht u mungojnë edhe sot e kësaj dite këto palestra dhe të cilat janë jashtëzakonisht të nevojshme.

Te arsimit, te Ministria e Arsimit. Faktikisht këtu një çështje që më ra në sy, për të gjitha universitetet e sapoformuara publike janë ndarë nga një shumë mjeteve prej 1.5 milionë euro. Mirëpo e pashë që mungon Universiteti i Prishtinës si universiteti më i vjetër publik, që mendoj e ka pasur vendin që në rast se jo me atë shumë të madhe të mjeteve të paktën një sasi e shumës së mjeteve prej Buxhetit të Kosovës të ndahen në destinacion, sepse ne e dimë shumë mirë që kërkesat janë jashtëzakonisht të mëdha edhe në aspektin e shërbimeve të mallrave, por njëkohësisht edhe në aspektin e investimeve kapitale.

Tash në qoftë se i shikojmë krejt këto, unë desha të ndalem në mënyrë konkrete. Po e shoh që mungojnë një numër i madh i projekteve të cilat mendoj që janë jashtëzakonisht me prioritet të lartë dhe të cilat realisht është dashur të përfshihen në këtë Buxhet të Kosovës, por për fat të keq domethënë nuk i hasëm në asnjërën prej këtyre kornizave buxhetore.

E para, një shqetësim që dua ta ndaj. Ne po shohim që në shumicën e rrugëve regjionale dhe magjistrale, janë bërë një sërë investimesh të ndryshme, pothuaj se në të gjitha drejtimet të cilat shpijnë në kryeqendrën e Kosovës. Mirëpo, një rrugë që ka pasur jashtëzakonisht shumë nevojë dhe që është njëra prej rrugëve më të ngarkuara është rruga Prishtinë- Podujevë, e cila realisht edhe në këtë vit buxhetor, domethënë, nuk është paraparë askund. Sikur që e dini, edhe autostrada ka mbetur në një pjesë atje dhe nuk e di se a do të vazhdohet më tutje, a jo. Po mendoj që edhe shpreh mendimin e qytetarëve që do të ishte jashtëzakonisht e rëndësishme që në këtë drejtim të krijohen së paku edhe dy korsi, të cilat kishin për ta zhvilluar ose kishin për të krijuar kushte të përshtatshme për zhvillimin e një komunikacioni normal në këtë drejtim.

Tjetra që desha ta ceku si një problem eminent. E pashë te Ministria e Mjedisit. Kjo ministri për fat të mirë ka marrë parasysh faktin dhe kishte ndarë disa shuma buxhetesh në drejtim të rregullimit të shtretërve të lumenjve, që mendojmë është shumë e mirë, sepse gjendja e lumenjve tanë është katastrofike në nivel Kosove. Mirëpo, po më brengos një fakt, ne kemi në komunën e Podujevës atje, një liqe të Batllavës, nga i cili liqe faktikisht furnizohen nja 6 ose 7 qytete kryesore të Kosovës.

Unë vetëm dua të ju njoftoj edhe ju deputetë të respektuar, edhe ministrat, po njëkohësisht edhe qytetarët e Kosovës, të ju bëj me dije se faktikisht ky ujë të cilin e përdorin këto 6 komuna është prej ujërave më të ndotura dhe mendoj që ka pasur një nevojë emergjente të ndahet një shumë e mjeteve për ta rregulluar kanalizimin e atyre lokaliteteve të cilat gjenden përbri liqenit të Batllavës, për arsye se kemi një ndotje enorme të ujit dhe kur ka mundësi që në shumë rrjedha ujore të investohen me shuma marramendëse të mjeteve, mendoj që ky ka qenë njëri prej prioriteteve kryesore dhe do të ishte në rregull që ta merrni parasysh dhe ta merrni për bazë që eventualisht në ndonjë ndryshim, domethënë të futet, sepse është në interes të qytetarëve jo vetëm të një komune, por të gjithë atyre të cilët e shfrytëzojnë ujin nga liqeni i Batllavës.

Një tjetër shqetësim që desha ta shpreh para juve kështu, sigurisht se shumicës së juve kolegë të respektuar, por edhe ministrave ju ka ra në vesh dhe ju ka ra rasti të dëgjoni sa e sa herë në këtë periudhën e fundit një objekt shkollor në komunën e Podujevës që është në lokalitetin e Halabakut, i cili objekt shkollor është sigurisht me një vjetërsi barake prej nja 50 vjetëve dhe në cilin objekt shkollor nxënësit e asaj shkolle zhvillojnë mësimin në kushte të jashtëzakonshme.

Për atë objekt shkollor po ju them përafërsisht, sepse nuk jam ndonjë ekspert i asaj fushe, mund të ishin nevojitur nja 150 mijë euro maksimalisht që të mund ta zgjidhnim problemin e atyre nxënësve. Mirëpo, nuk është i vetmi shqetësim për atë pjesë, për arsye se po në gjendjen e njëjtë të vështirë e kemi objektin e shkollës fillore “Emin Duraku” në Bajçinë që prapë është një objekt ku ka qenë më herët një kooperativë bujqësore dhe në cilin objekt edhe sot e kësaj dite mësimi zhvillohet në gjendje të jashtëzakonshme, në të njëjtën gjendje është objekti i shkollës fillore në Llapashticë të Poshtme dhe në lokalitetin e fshatit Llugë.

Tjetër që desha të shpreh shqetësimin për Ministrinë e Shëndetësisë. Komuna e Podujevës për dy vjet me radhë ka ndarë një buxhet nga mundësitë e saj financiare për ndërtimin e një objekti të maternitetit.

Ky objekt i maternitetit faktikisht ka ardhur deri në një fazë të zhvillimit, edhe të ndërtimit të tij dhe është edhe e nevojshme një shumë e caktuar e mjeteve për inventarizimin e tij dhe pajisjen me mjete të nevojshme që mendoj Ministria e Shëndetësisë duhet ta kishte parasysh, edhe ajo që ka shkuar, po njëkohësisht edhe kjo tash që vjen që në këtë segment të punohet në këtë drejtim.

Po ashtu nga Ministria e Kulturës, pashë që janë paraparë një sërë objektesh të qendrave kulturore, po ashtu po u bëj me dije se aty do të ishte...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ia vazhdon fjalën, regjia!

SHPEJTIM BULLIQI: ...shumë e nevojshme edhe për komunën e Podujevës, do të thotë, të ndahet një fond i caktuar për ndërtimin e një objekti të tillë.

Dhe një tjetër shqetësim, shqetësimin gjendjes së rrjedhave ujore të lumenjve të cilët janë në pjesën verilindore të Kosovës dhe të cilët në rast se nuk do të investohet me kohë, sigurisht se ato do të shkaktojnë probleme të mëdha në rrjedhat tjera të mëposhtme ujore, prandaj edhe këtu në këtë segment është dashur të kihet parasysh.

Dhe një shqetësim, që prapë duhet ta ndaj me juve, është pozicionimi i Buxhetit për shërbime mallra në drejtori të arsimit. Ju e dini shumë mirë që rritjet e pagave, që janë bërë për punëtorët arsimorë, në vitet që i lamë pas, faktikisht kanë ndikuar që një shumë relativisht e madhe e mjeteve financiare të ndahet nga nivelet e buxheteve komunale me qëllim të mbulimit të këtyre shpenzimeve për pagesa.

Unë ju bëj me dije që vetëm në komunën e Podujevës ta zëmë kemi një zvogëlim të kategorisë së shpenzimeve kapitale diku për 700 mijë euro për shkak se është dashur shuma të mëdha të ndahen në pagesën e të ardhurave personale për të punësuarit në këtë komunë, prandaj kërkohet që edhe në këtë segment domethënë të rishikohet mundësia e ndryshimeve në këto segmente të Buxhetit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, i nderuar Balliçi. Atëherë, ftoj deputeten Duda Bale. Ndërkohë, derisa të vijë e nderuara deputete, të nderuar deputetë të gjitha kërkesat konkrete është mirë të adresohen nëpërmjet amendamenteve të Komisioni përkatës.

DUDA BALJE: Zahvaljujem! Ja bih samo hteo da se nadovežem na članove moje grupe koji govore u ime Parlamentarne grupe 6+ vezano za Ministarstvo koju ovog puta vode Bošnjaci, a to je Ministarstvo bes portfela. Znam da je više puta bilo govora o tome i da je suma koja je odvojena za ovo Ministarstvo relativno je jako mala u zavisnosti od toga da mi Bošnjaci po prvi put imamo ministarstvo i da ovo je Ministarstvo bez portfela koja ostavlja mogućnost da se odlučimo da radimo nešto za one koje u Ustavu i zakonu nazivamo ostalima, a to su sve one zajednice koje nisu albanske i srpske.

Naravno da će ovo Ministarstvo biti posvećeno i njima ali smo u saglasnosti i sa svim drugim zajednicama, znači sa Bošnjacima, Turcima, Romima, Aškalijama, Egipćanima i Gorancima dogovorili da se malo više skoncentrišemo na nas.

Čuli smo da do sada nismo bili zadovoljni sa radom Ministarstva za zajednice i povratak, da je to Ministarstvo bilo iskocentrisano više na Srbe i da mi ovoga puta imamo potrebu da imamo jedno takvo ministarstvo i ja se nadam, daćemo amandman, evo gledam i na premijera i njega molim da od strane njegovog kabineta ovo Ministarstvo bude malo više finansijski podržano jer ove zajednice imaju veoma veliki broj prioriteta, nisu do sada imali neku konkretno mesto na koje bi mogle da se obrate za svoje prioritete i potrebe i smatram da ovo Ministarstvo treba ovog puta da bude više zastupljeno u budžetu i finansijski. Hvala vam!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Zenun Pajaziti e ka fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar!
Kryeministër, Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

E di që jemi në një periudhë kohore jo krejt komode tash edhe për ta trajtuar në mënyrën më të mirë të duhur Buxhetin për vitin që po vjen, edhe për shkak të rrethanave të cilat kaluam muajve të fundit, megjithatë, mendoj që debati mund të kontribuojë që eventualisht në fazën vijuese do të mund të korrigjohet diçka.

E di që sfida kryesore, përveç tjerash, është sfida me pagat. E di që ka pasur dhe mbetet një presion i vazhdueshëm për shkak të nivelit të standardit të familjeve tona. Është mirë që jo vetëm për ato që kanë qenë premtime, por për ato që janë zotime ligjore, që dalin si obligime nga ligjet që veç ne në këtë Parlament i kemi zbatuar, të shikohet mundësia në një partneritet edhe me sindikatat që këto ditë nëse mund të amendamentohet diçka që mund t'i kontribuojë kësaj gjendjeje.

Ndërsa, shkurtimisht dëshiroj të potencoj një çështje krejt tjetër. Te infrastruktura, e di që janë një varg projektesh, unë i pashë edhe linjat buxhetore në këtë drejtim të lansuara në Buxhetin e Ministrisë së Infrastrukturës. Ka qenë në vitin e kaluar i lansuar një projekt për një linjë buxhetore, në fakt që unë nuk po e shoh projektin e rrugës Gjilan – Prishtinë, bëhet fjalë për një projekt të kërkuar, të miratuar nga Qeveria e kaluar. Unë e di që kemi informata, por meqenëse nuk kemi qenë funksional si Kuvend, nuk kam pasur rastin ta pyes ministrin, ish- ministrin dhe mendoj që do ta konsumoj të drejtën ta pyes ministrin aktual, të shoh si ka shkuar ky projekt. E di që një kompani e ka fituar të drejtën për ta bërë projektin e kësaj rruge dhe nëse po, duhet të dimë, nëse është dashur për të lansuar mjete edhe për fillimin e ndërtimit të kësaj rruge. Nuk do të ishte korrekte nëse cilado rrugë regjionale pas rrugës Prishtinë-Shkup, të fillojë para se të fillojë një rrugë e cila e lidh një regjion të tërë, është fjala edhe për Luginën e Preshevës, për Bujanocin dhe Preshevën, një rrugë e cila ka mbetur tërësisht nga vitet 70-ta dhe është tashmë një pengesë edhe për zhvillimin ekonomik të një regjioni.

Mendoj se fillimisht duhet ta dimë, ta kemi të qartë se si ka shkuar ai projekt, a është Buxheti, a është paguar e tash s'po figuron këtu, e tjera e tjera, dhe nëse jo atëherë duhet të shoh unë edhe mundësinë nga informacionet që do t'i marr nga ministri aktual, në mënyrë që të amendamentohet eventualisht, të sigurohet e të kryhet ky projekt dhe të fillojë edhe implementimi i projektit për fillimin e kësaj rruge. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet! E ftoj deputeten Valdete Bajrami.

VALDETE BAJRAMI: Faleminderit!

Unë nuk do t'ju marr shumë kohë, mirëpo do të ndalem te sektori i bujqësisë. Një ndër sektorët më të rëndësishëm të ekonomisë tek ne në Kosovë, padyshim është ai i bujqësisë me të gjitha fushat e saj. Këtë e mundësojnë parakushtet me të cilat disponon vendi ynë, duke pasur resurse humane, resurse tokësore, kushte klimatike si dhe traditën po ashtu.

Mirëpo, për fat të keq, edhe sot e kësaj dite kjo degë e ekonomisë është mjaft ekstensive ngase deri më tani fare pak ose aspak nuk është bërë që kjo lëmi të intensifikohet ngase nga ana qeveritare nuk është bërë asgjë dhe ajo as që është bërë edhe pa ekspertizë profesionale.

Toka bujqësore me hapa gjigantë tek ne në Kosovë po humbet. Në veçanti nga tjetërsimi i saj, andaj është e domosdoshme që ajo të ruhet e sidomos të rritet prodhimtaria e saj për njësi prodhimi qumështi e mishi, për kokë lope, deleje apo dhie, si dhe prodhimi për hektar duke përfshirë drithëra, pemë, perime e rrush.

E kjo për t'u realizuar lypset dije në veçanti mjete financiare ku Qeveria jonë as që i përmend.

Për t'u arritur objektivat e lartpërmendura, fermerët tanë duhet të pajisen me dije dhe informata që këto duhet t'i marrin nga shërbimet e ekstensionit nëpër komunat e tyre si dhe nga Qendra e transferimit të teknologjive të reja, që kjo qendër duhet të ngritet nga Qeveria.

Ngritjes së produktivitetit dhe intensifikimit të bujqësisë në masë mjaft të madhe mund t'i ndihmojë, përveç granteve qeveritare, subvencioneve, edhe ndihma e fermerëve në derivate, plehra e repromaterial duke përfshirë farë, preparate mbrojtëse e tjerë, si dhe aftësimin në tërësi të sistemit të ujitjes ku në këtë mënyrë do të ishte shmangur bujqësia e tipit lotari.

Edhe një herë, tani për tani, e para gati dhe e vetmja degë e ekonomisë për të nxjerrë vendin nga kriza ekonomike është bujqësia, në radhë të parë për ta siguruar ushqimin për popullin tanë, për të eksportuar dhe gjeneruar vende pune mjaft shpejt dhe me pak mjete financiare.

Andaj edhe Buxheti i Kosovës i paraparë duhet ngritur minimum 5% nga tërësia e Buxhetit dhe duhet shpërndarë në ekspertizë tejet profesionale që për fat të keq Qeveria jonë këtë nuk e di dhe nuk e ka. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E ka fjalën deputetja Margarita Kadriu!

MARGARITA KADRIU: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Deputet i pavarur Arben Gashi, përshëndetje nga lart!

Përshëndes Kabinetin qeveritar dhe të gjithë deputetët,

Të nderuar deputetë,

Duke u bazuar se unë për herë të parë jam këtu në Kuvendin e Kosovës dhe kam ardhur pas një pune dhe një përvoje rreth dy dekadash në fushën ekonomike dhe në fushën e medias së shkruar, ku informatat konsiderohen dhe janë realisht resurs ose aset shumë i vlefshëm, nuk mund të hezitoj dhe as të shmang informatat që i kam dhe të cilat duhet t'i ndaj me ju, siç janë ato rreth planifikimit të Buxhetit të Shtetit, rreth mbledhjes së tatim-taksave, ku problem të posaçëm paraqet shtrirja horizontale e mbledhjes së të gjitha tatimeve, sikur edhe ajo vertikale.

Sot, ndonëse është një seancë e parë punuese e kësaj legjislature të re, në rend dite e kemi Ligjin për Buxhetin e Shtetit të Kosovës dhe jam e sigurt se kur flasim për të shpresoj ta ndaj mendimin edhe me ju se bëhet fjalë për diçka tepër të rëndësishme dhe kruciale për

ndërtimin, zhvillimin dhe mbajtjen e të gjitha shtyllave të shtetit, pa të cilat shteti nuk bëhet funksional.

Sikur edhe ju, draftin e propozuar nga Qeveria e kemi marrë vetëm para pak ditësh, ngase edhe Qeveria e re është formuar vetëm para dy javësh, si një projekt tanimë të përgatitur nga Qeveria e kaluar.

Dhe këtu, sa u përket ditëve, shpresoj të mos jetë problemi. Vërejtjet për këtë Buxhet janë të panumërta, mirëpo konsideroj se problemi krucial qëndron në diçka që përsëritet e përsëritet për rreth 15 vjetët e fundit lidhur me projektimin real apo jo të të gjitha buxheteve.

Të gjithë të mirë informuarit e dinë dhe e thonë se po të zbatoheshin ligjet dhe Kushtetuta nga institucionet e vendit, Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2015 do të kapte shifrën prej së paku 3 miliardë euro. Jam shumë e sigurt se këtë informatë e kanë dhe e dinë edhe qeveritë e gjertanishme, sikur edhe kjo Qeveri e zgjedhur dhe e rizgjedhur para dy javësh.

Duke marrë parasysh faktin që e theksova më parë se të gjithë qeveritarët që e kanë udhëhequr vendin, për arsye që vetëm ata i dinë, gjer më sot nuk na e kanë thënë të vërtetën e madhe, respektivisht asnjëherë nuk janë zotuar se do t'i mbledhin të gjitha taksat e tatimit në zbatim të ligjit e të Kushtetutës në tërë horizontalin e saj gjithëpërfshirëse, duke i trajtuar të gjithë pa dallim të barabartë para ligjit, të gjitha bizneset dhe të gjithë qytetarët, pa bërë asnjë diskriminim, por edhe pa e krijuar ose pa u bërë favore selektive, gjë e cila ka ndodhur në vazhdimësi dhe e cila nuk do të duhej të ndodhte në një ekonomi tregu.

Javën e kaluar për herë të parë një presidente vendi foli troç para jush këtu dhe para Kabinetit qeveritar dhe u tha pa ekuivokë, ndër të tjera vetëm po e ndaj këtë fjali: Lehtësimi i konkurrencës së lirë dhe zhbërja e karteleve dhe monopoleve mundësojnë rritje të qëndrueshme gjithëpërfshirëse ekonomike të mbështetur te frytet e iniciativës së lirë, te inovacioni dhe hulumtimit e zhvillimit. Nëse e duam një shoqëri të lirë, e ky sigurisht duhet të jetë synimi ynë kryesor, ne duhet ta nxisim konkurrencën e lirë dhe të pamundësojmë koncentrimin e pushtetit në duart e një pakice, e cila pastaj e keqpërdor sistemin për t'u siguruar të drejta të padrejta realisht individëve dhe grupeve të caktuara të interesit, të cilët edhe i financojnë.

Kjo nuk është ekonomi e lirë e tregut, të nderuar, por ekonomi e elitave të vetëquajtura që shndërrohen në pengesë të zhvillimit tonë të gjithëmbarshtëm.

Prandaj, edhe unë si deputete e pavarur, duke qenë se i kam informatat e plota dhe të besueshme për realitetin rreth mbledhjes së Buxhetit, propozoj që para se të miratohet Buxheti dhe të bëhet shpërndarja e tij ta formojmë një komision hetimor parlamentar, të përbërë nga të gjitha përfaqësimet në Parlament, me një kryesues dhe shumicë anëtarësh po nga opozita, i cili do t'i hetonte dhe do t'i bënte gjetjet e qëndrueshme dhe të besueshme për të vërtetën reale në mbledhjen e tatim-taksave.

Këtë veprim po e bëj në pajtim të plotë në të drejtat e deputetit të Kuvendit të Kosovës dhe për t'i kontribuar përfundimisht së vërtetës dhe mirëqenies në vend, duke i siguruar Buxhetit, respektivisht qytetarëve të vendit edhe më shumë se 1 miliard euro, të cilat ju këtu nuk i keni në këto letra, mirëpo janë para që hyjnë në Kosovë, ngase unë botërisht u kam premtuar atyre se do të jem zë i tyre në Parlament.

Sa i përket këtij propozimi për Buxhetin 2015, unë mendoj se duke marrë parasysh faktin se pas një ngërçi të paparë këtu te ne për afro më shumë se 6 muaj, duhet të jemi të përgjegjshëm për vendin dhe për qytetarët, që vendin ta bëjmë sa më shpejt me Buxhet, por e theksoj, me kusht që gjetjet e komisionit hetues parlamentar të inkorporohen në rishikimin e Buxhetit në qershor të vitit 2015, gjë që nuk ishte dashur t'i pengojë askujt, sepse në këtë mënyrë do të mund ta rritnim Buxhetin për së paku 50%, pra një Buxhet dukshëm më të madh në interes të qytetarëve dhe zhvillimit të këtij vendi.

Jam e bindur se komisioni i posaçëm hetues parlamentar do ta ketë mundësinë për t'i bërë gjetjet dhe konstatimet e besueshme se si i kemi humbur për çdo vit kalendarik nga një buxhet të tërë, duke i adresuar gjurmët e shpërdorimeve eventuale të cilitdo zyrtar të lartë, të mesëm dhe të ulët në të gjitha pushtetet.

Ka shumëçka për të propozuar në këtë draft-buxhet, shumëçka u tha edhe nga opozita sot, e që nuk është në rregull, por në interes të vendit dhe qytetarëve. Unë personalisht në asnjë moment nuk do të jem pengesë që vendin ta futim në krizë buxhetore. Ne edhe ashtu-kështu, të nderuar, jemi në krizë të qeverisjes së mirë për afro hiç më pak se 15 vjet. Është koha e fundit të reflektojmë pozitivisht në të mirë të shtetit dhe qytetarëve të vendit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit deputete! Me mirëkuptimin tuaj, pasi është edhe koha e drekës për një orë e gjysmë do të bënim pauzë, në orën 14:30 pastaj e vazhdojmë seancën.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes pas pauzës
Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

E vazhdojmë seancën me diskutime nga deputetët, të cilët janë lajmëruar për diskutim në seancë. Para se deputetët ta marrin fjalën me radhë, e lus ministrin e Punëve të Brendshme, pasi e ka një replikë, në bazë të Rregullores - 2 minuta.

MINISTRI SKENDER HYSENI: Të nderuar deputetë,

I nderuar kryetar,

Ministër Hoti,

Unë pandehja se sot do të bisedojmë për Buxhetin, përkatësisht për projektbuxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015. Ndërkohë këtu para jush u transmetua një e pavërtetë ordinere, të cilën unë jam i detyruar ta sqaroj deri në fund.

Shumë shpejt juve do të ju shpërndahet edhe një komunikatë që ka të bëjë me çështjen e migruesve të paligjshëm. Është çështje e dhimbshme, e cila po na mundon të gjithëve dhe unë jam i sigurt që secilin prej jush e mundon baras kjo çështje. Nuk është çështje mbi të cilën mund të ndërtojmë kapitale politike, mund të bëjmë prova, të bëjmë kapitale politike, por ju siguroj që çdo përpjekje për të bërë kapital politik në këtë çështje është e dështuar.

Ambasadori austriak në Kosovë e ka shpërndarë për media, për politikanët dhe për anëtarët e Legjislaturës një komunikatë, në të cilën, ndërmjet tjerash, thuhet se 'secili migrues ilegal që zihet në ndonjë vend 'shengen' mund të ngarkohet me shpenzime administrative deri 7 500 euro për ta kthyer prapa. Domethënë, nuk bëhet fjalë assesi për dënime që mund t'i shqiptojë Qeveria e Kosovës, ose institucionet e Kosovës, por bëhet fjalë për ngarkesa administrative prej 100 deri më 7 500...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Vazhdoja regjia, të lutem!

SKENDER HYSENI: Kujtoj që është me interes të bëjmë apel te të gjithë kosovarë secili prej nesh - mos paguani para nga buxheti juaj familjar për t'u futur në telashe, sepse ambasadorët e vendeve të cilat i kanë destinacion kryesor emigrantët nga Kosova po na e thonë qartë që gjasat për të fituar azil janë gati zero. Prandaj, apeli im është që të mos detyrohen njerëzit tanë të paguajnë shuma aq të majme - taksa administrative në Austri, Gjermani e në Francë për t'i paguar shpenzimet për kthimin e vet në atdhe. Domethënë, fjala është për shpenzime dhe dënimet që i shqiptojnë vendet anëtare të Bashkimit Evropian, e assesi Republika e Kosovës, dhe unë ju siguroj që ministri i Brendshëm, Skender Hyseni, asnjëherë nuk e ka thënë një gjë të tillë. Faleminderit!

KRYETARI: Arben Gashi, deputet i nderuar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, e keni fjalën.

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Se si më thirrë kështu, thashë mos ka ndonjë apel të veçantë.

Sot para vetes e kemi një ligj, i cili ka karakteristika të veçanta dhe karakteristika e tij specifike në kuadër të këtij debati ka të bëjë me pasqyrat për të hyrat dhe shpenzimet që do t'i bëjë Republika e Kosovës në vitin 2015.

Dhe ky ligj në vetvete me këto pasqyra ka për qëllim që t'i përfaqësojë politikat qeverisëse për vendin në vitin 2015.

Meqë bëhet fjalë për politika qeverisëse, atëherë normalisht që bëhet fjalë edhe për politika programore dhe politika të ofruara, apo të ofertuara në programin elektoral.

Sot e kuptuam nga zoti Hoti, e po ashtu edhe nga kryeministri Mustafa, se ky projektligj që e kemi sot para vetes është projektligj i përgatitur nga Qeveria paraprake.

Prandaj, ka edhe shumë probleme dhe mospërfaqësim politik të programit politik të Lidhjes Demokratike të Kosovës, por po ashtu na u tha se programi politik i Lidhjes Demokratike të Kosovës pritet të inkorporohet në Buxhet ndoshta me rishikimet buxhetore, ose me projektbuxhetin e vitit 2016.

Nga ajo që u diskutua këtu dhe që u pa po ashtu në projektligjin për Buxhetin dhe në pasqyrat të cilat janë prezantuar na rezultojnë që i kemi disa probleme. Ajo që është deklaruar dhe që e presin shumica e punëtorëve në sektorin publik të Kosovës - rritja e pagave prej 20%, nuk ekziston.

Po ashtu, zbatimi i Kontratës Kolektive me të gjitha fushat e saj do të jetë problematik. Po ashtu, nuk marrim garanci për zbatimin e plotë të Ligjit për sigurimet shëndetësore dhe këtu po ashtu nuk e kemi të përfshirë sigurimin shëndetësor dhe sigurimin jetësor për kategori të veçanta me rrezikshmëri në punë, siç janë Policia dhe zjarrfikësit, për të cilin ne e kemi diskutuar si pjesë e programit të Lidhjes Demokratike të Kosovës, por që do të punojnë besoj në të ardhmen që të përfshihet ndoshta me rishikimin buxhetor.

Pra, ne mund të konkludojmë se sot e kemi një projektligj, i cili i ka disa pasqyra të cilat parashikojnë të hyra dhe shpenzime. Të hyrat relativisht dihet saktë se sa janë, përveç se nuk e kemi të qartë nëse do të kemi të hyra të menjëhershme, siç jemi mësua t'i shohim katër vjetët e fundit në Buxhet, të cilat i janë referuar procesit të privatizimit, ndoshta privatizimit të Postë-Telekomit të Kosovës, apo institucioneve tjera. Dhe, zoti Hoti këtu ndoshta mund të na japë ndonjë shpjegim.

Dhe, po ashtu, në të njëjtën kohë, ne i kemi edhe disa çështje, të cilat duhet t'ua themi qartë qytetarëve të Kosovës se Projektligji për Buxhetin, apo Buxheti i vitit 2015 nuk parasheh rritje prej 25%, sepse nuk ka para.

Nuk parashihet zbatimi i plotë i Kontratës Kolektive, si në shujtat e ngrohta, ashtu edhe në çështjet tjera që kanë të bëjnë me vjetërsinë në punë, apo çështje tjera.

Programi politik partiak nuk është përfshirë, sepse është projektbuxhet i propozuar nga Qeveria paraprake dhe për shkak të kohës nuk ka mundur të ndryshohet, por pritet të ndryshohet në të ardhmen.

Dhe prioritetet e punësimit dhe aspektit të zhvillimit ekonomik akoma nuk janë të qarta, sepse disbalanca e këtij projektbuxheti ka të bëjë edhe me çështjet e prioritetëve programore, prioritetëve zhvillimore, me infrastrukturën fizike, me projektet kapitale, të cilat normalisht janë të kontraktuara në masën, u tha këtu mbi 85%, më duket, nëse nuk gaboj.

Dhe, do të kisha pasur dëshirë që nëse zoti Hoti ka diçka që mund të thotë për këto çështje, sa i përket rritjes së pagave, Kontratës Kolektive, Ligjit për sigurimet shëndetësore, sigurinë në punë, prioritetet e Qeverisë, prioritetet zhvillimore dhe për sigurimin shëndetësor le të na sqarojë pak më shumë dhe ne do të ishim pak më të qetë si përfaqësues të qytetarëve të Kosovës dhe si votues në këtë Parlament, në mënyrë që ne ta marrim vendimin e duhur dhe ta japim qëndrimin tonë si qëndrim të bindjeve tona mbi projektligjin që e kemi përpara. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Fatmir Limaj e ka fjalën.

FATMIR LIMAJ: Të nderuar kolegë deputetë,
Sot po bisedohet për projektligjin më të rëndësishëm për një qeveri, sidomos një qeveri, e cila e ka marrë mandatin tani dhe pritet ta qeverisë vendin në katër vjet e ardhshme.

Me vjen keq që këtu nuk është kryeministri këtu, por sido që të jetë unë do t'i shpalos disa pikëpamje të mia rreth këtij projektligji.

Besoj që jo vetëm deputetët, por praktikisht vetë ministrat dhe vetë kryeministri nuk kanë pasur kohë për ta parë këtë buxhet dhe studiuar në tërësi. Prandaj, edhe ne nuk mund ta japim një analizë të gjithanshme të asaj çka presim në vitin e ardhshëm.

Ngutja - unë personalisht kam pritur që Qeveria e re do t'i japë kohë vetes të paktën një muaj, që dalëngadalë ta rishikojë e ta rindërtojë një Buxhet, i cili do t'i përshtatet programit, ose objektivave të qeverisjes së re.

Nga ajo që ne sot kemi në dorë shihet që ky projektbuxhet, ashtu siç e thanë edhe kryeministri edhe ministri i Financa, është Buxhet i Qeverisë së kaluar, pa ndryshuar asgjë, që do të thotë se edhe këtë vit buxhetor, në viti i rin e ri do të futemi me Buxhetin e Qeverisë të përpiluar dhe të përgatitur sipas parametrave, objektivave dhe politikave të Qeverisë së kaluar.

S'ka asnjë dilemë më besoj. Një pjesë e madhe e kolegëve e thanë se nga ky nuk kemi Buxhet zhvillimor, ne vazhdojmë me teori të vjetra, e ky është buxheti i varfërisë dhe e thellimit të varfërisë, është Buxhet i cili nuk ka asnjë lidhje, asnjë shpresë, asnjë indicie që do të mund ta çojë vendin drejt zhvillimit. Me një fjalë, ky Buxhet për vitin e ardhshëm është i pashpresë për rezultate pozitive.

Ju e patë edhe vetë ministrin e Financave që me siklet foli në arsyetimin e këtij projektbuxheti, sepse nuk është punë e tij. Domethënë, nuk është punë që e ka punuar ky vetë. Është diçka që e ka përgatitur Qeveria e kaluar dhe ky normalisht u mundua në aspektin që me ndershmëri profesionale të mund ta interpretojë dhe të përmendë anët pozitive të këtij projektligji, që fatkeqësisht pak ka diçka të mirë aty.

Çfarë po ndodh? Qytetarët e Kosovës janë gënjyer vazhdimisht, e sidomos vitin e fundit dhe në fushatë elektorale, por sot në numrat e flasin të vërtetën.

E vërteta është, ashtu siç e tha njëri nga parafolësit kolegë deputetë: “Kosova për 3-4 vjetët e fundit është duke u ballafaquar vazhdimisht me zvogëlimin e rritjes ekonomike, me zvogëlimin e të hyrave buxhetore, me zvogëlimin e investimeve private. Këtë vit e kemi po ashtu edhe zvogëlimin e investimeve kapitale nga punët publike. Domethënë, vendi ynë, në vend që të shkojë drejt një reforme për të dhënë shpresë për ndryshimin e gjendjes, po shkon në një gjendje edhe më të keqe sesa ka qenë.

Siç e thashë edhe më herët, me vetë faktin që është thirrur seanca në mënyrë të përshpejtuar për ta miratuar Buxhetin në mënyrë të përshpejtuar, e unë po ju them që nuk ka gjë më të rëndësishme se Buxheti, dhe nuk duhet të shpejtohet në këtë çështje, aq më shumë për një qeveri, e cila e ka startin e vet, atëherë ne në mënyrë të përshpejtuar do t'i përmendim disa nga pikat për të cilat është trumbetuar shumë dhe është gënjyer qytetari i Kosovës.

Siç e pamë tashmë të gjithë dhe po pranohet edhe nga kryeministri dhe nga ministri i Financave, nuk ka rritje të pagave 25%. Nuk ka! Kjo do të thotë që qytetarët e këtij vendi janë gënjyer ashiqare dhe sot fatkeqësisht ata duhet ta mësojnë të vërtetën dhe shpresoj që kjo e vërtetë do të ngulitet në mendjen e tyre dhe të mos mashtrohen herrave të tjera. Nuk ka punësim. Nuk ka! Nuk ka asnjë shpresë, asnjë mundësi, asnjë hapësirë buxhetore që tregon se Kosova nesër do të ketë investime, të cilat do të çojnë në hapjen e vendeve të reja të punës.

Kosova ka rrezik sot të futet, siç e kemi nisur me ministra, në njërën nga qeveritë më të mëdha në Evropë. Rreziku më i madh është me zëvendësministrat, numri i të cilëve po shkon duke u rritur. Dhe, në njëfarë mënyre ta kemi njërin ndër kabinetet më të mëdha në Evropë.

Mungesa e investimeve tregon për politikën ekonomike të këtij vendi. Zvogëlimi i rritjes ekonomike, që është trumbetuar se do të ketë rritje, e tregon më së miri gjendjen në të cilën është ky vend.

Të gjitha këto çojnë porosi dhe mesazh të keq për ata të cilët presin nga kjo qeveri - që nuk do të ketë ndryshime.

Unë nuk e di ku është bashkimi ose fuzionimi i programeve politike dhe ekonomike të dy partive, të cilat janë në koalicion, sepse në këtë Buxhet nuk shihet. Këtu e kemi një

mentalitet të bartur, të trashëguar, i cili do të vazhdojë të qeverisë edhe me këtë vijë buxhetore.

Në vitin 2015 s'ka asnjë projekt të ri. Mbi 90% e të gjithë Buxheti që sot e kemi para nesh janë punë të bartura nga viti 2013 e 2014 për të vazhduar më 2015. Asnjë gjë të re nuk do të ketë as nuk do të fillojë në Kosovë në vitin 2015 sipas këtij Buxheti. Asnjë gjë! Asnjë projekt, gjithmonë po flas sipas këtij Buxheti.

Do të thotë, punët e bartura, problemet, borxhet, kaosi, çdo gjë që ka ndodhur për këto 2-3 vjet do të vazhdojë të bartet edhe në vitin 2015, e kjo fatkeqësisht është gjendje me të cilin do të ballafaqohemi në të ardhmen.

Ku është fondi i punësimit? Ku janë mundësitë ekonomike? Cilat janë politikat fiskale që e mbrojnë prodhimin e këtij vendi? Cilat janë ato politika stimulative që i stimulojnë investimet private, bizneset e vogla e të mesme? Asgjë nuk ka aty!

Sot çfarë kemi ne para vetes është thjesht se mbi 70% e këtij Buxheti do të shpenzohet në paga, mallra dhe shërbime, të evidentuara në projektbuxhet. Por, nga logjika që kemi, nuk mbetemi në 70%, do të shkojë diku mbi 85% në shpenzime për paga dhe mallra, sepse, siç u tha, Kabineti qeveritar, kur të fillojnë pastaj edhe punësimet tjera, do ta shihni se si do të shpërndahen këto para.

Me një fjalë, ministri i Financave e ka një punim, sikur të themi të dilet të mbrohet punimi i huaj shkencor. Merreni me mend, një punim shkencor që e ka bërë dikush tjetër dhe duhet të dalësh ta mbrosh atë që e ke parë ti sikur ne. Imagjinojini ministrat! Ministrat që e marrin një ministri me e drejtua u duhet së paku - së paku një muaj e gjysmë për t'i parë prioritet e veta aty, për t'i paraqitur objektivat e veta aty, së bashku me stafin atje, për t'i futur brenda ministrisë objektivat programore të partisë së tij dhe pastaj t'i propozojnë Qeverisë miratimin e Buxhetit.

Ministrat tanë nuk kanë pasur kohë as zyrat e veta t'i shohin, e atyre po u shkon Buxheti. As Buxhetin e ministrisë së tyre ata vetë s'e kanë parë. Imagjinojeni, ata do të drejtojnë ministri që objektivat edhe rezultatet e punës që priten vitin e ardhshëm t'i realizojnë janë të parapërgatitur nga ish-ministrat tjerë. Dhe, ju do t'i dëgjoni ministrat këtu duke i mbrojtur këto politika. Praktikisht, sikur që thashë, edhe ministrat dhe vetë ministri i Financave është sikur ta mbrojnë një punim shkencor të dikujt tjetër, e ti të dalësh ta arsyetosh se sa i mirë, e sa kompetent, e sa të mirë e kemi bërë atë punim.

Kjo është, të nderuar kolegë, shumë joserioze. Prandaj, kryeministri dhe ministrat kanë pasur mundësi të kërkojnë kohë të paktën një muaj për t'i fuzionuar objektivat e veta për ta parë një qeverisje ndryshe, për të filluar realizimin e atyre për të cilat ata janë zgjedhur. Dikush mund të thotë 'jo s'ka pasur kohë për shkak të rrogave'. Nuk është e vërtetë. Ky Parlament i Kosovës jo rrallë herë e ka miratuar Buxhetin edhe në janar, shkurt dhe mars.

Kujtojeni qeverisjen 2007-2008, diku në mars, nëse nuk gabo, është miratuar Buxheti vjetor. Dhe, së paku gjatë janarit komplet me ekspertë të fushave të caktuara është dashur

t'u jepet mundësia ministrave t'i ndërtojnë objektivat e tyre, propozim-buxhetin e tyre në dikasteret përkatëse dhe pastaj të ndërtohet një Buxhet si duhet.

Kjo çfarë ka ndodhur sot, kjo është zgjedhje e tyre natyrisht, por është joprofesionale dhe aspak shpresëdhënëse, e unë habitem se si ata njerëz drejtojnë dikastere me projektbuxhetin e përgatitur, ose me politikat ekonomike të përgatitura nga ata...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Vazhdojani fjalën, ju lutem!

FATMIR LIMAJ: ...që këta kanë qenë kritikuesit e atyre politikave të kaluara dhe sigurisht kanë shpresuar ta ndryshojnë.

Dhe, kjo mendoj që tregon për joseriozitetin e një projektligji më të rëndësishëm në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Për një Qeveri nuk ka asnjë gjë më të rëndësishme se sa projektbuxheti. Prandaj, duhet dhënë kohë vetes. Duke i dhënë kohë vetes, duke u dhënë kohë edhe komisioneve, na kishin dhënë kohë edhe ne dhe do t'i kishin dëgjuar edhe grupet e interesit. A ka ndodh kjo Qeveri që për këto 10 ditë të ulet me grupet e interesit dhe ta bisedojë çështjen e Buxhetit, me ndonjë sindikatë, me bizneset, qofshin të mesme, qofshin të vogla, me investitorët. Asnjë gjë! Jo, sepse këta vetë s'kanë pasur kohë. Janë ngutur. Por, në fund, rezultati është ky që është. Nuk ka paga, s'ka rritje të pagave, s'ka punësim. Dhe mirë që disa nga kolegët këtu po flasin hapur dhe po ua thonë qytetarëve të Kosovës që t'ua zbresin pritjet, t'u thuhet e vërteta - e hidhur, e rëndë, e keqe, por e vërteta është shumë më e mirë se të vazhdohet me avazin e vjetër.

Në fund dua ta përbyll fjalën time duke i bërë apel kryeministrit dhe Qeverisë: Mos i rritni numrat e zëvendësministrave, mos bëni atë që ne po dëgjojmë që do ta bëni! Mos bëni, sepse ne nuk do të lëmë asnjë gjë pa bërë për të ju penguar në kuptimin institucional për këtë punë. Nuk keni të drejtë! Qeveria nuk është çiflig. Miratojeni ligjin e Qeverisë, merreni me ligj edhe njëqind zëvendësministra bëjini, por jo mënyrën siç është shkuar që katër vjet. Mos e bëni se ne nuk do ta pranojmë. Në të gjitha format demokratike do të ju pengojmë se nuk keni të drejtë këtë vend ta ngarkoni me 50 zëvendësministra, as me nga 2 zëvendësministra në ministri.

Ndalen, se kjo nuk është në rregull! Mos harroni - 10 mijë euro sot kushton një vend pune. 10 mijë euro për hapjen e një vendi të punës. Llogariteni me 50 zëvendësministra se sa vende të punës mund t'i hapni, nëse i marrim parasysh shpenzimet e tyre.

Apeli im është: Kujdes! Ndërsa çfarë u tha, në prill, maj, qershor - rishikim - të gjithë këtu që janë deputetë të vjetër dhe profesionistë e dinë që s'ka hair prej asaj pune, s'ka rishikim. Ia pafshim hairin me këtë me këtë projektbuxhet, ky Buxhet do të shkojë deri në vitin e ardhshëm. Asnjë mundësi, ose mundësi shumë të kufizuara do të ketë për të bërë rishikime, aq më tepër në një vend ku ka mungesa të mëdha buxhetore. Faleminderit!

KRYETARI: E ftoj deputeten Time Kadrijaj ta marrë fjalën.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit kryetar!

Të nderuar deputetë,

Ky Buxhet që i është propozuar Kuvendit të Republikës së Kosovës edhe më tutje vazhdon të jetë Buxhet shpenzues pa perspektivë dhe pa shpresë për një jetë më të mirë të qytetarëve.

Është Buxhet i varfërisë dhe nuk siguron zhvillim ekonomik, që do të rezultojë me krijimin e vendeve të punës.

Nëse e shohim dhe e analizojmë mënyrën e ndarjes së Buxhetit nga Qeveria vërehet fare qartë se pjesën më të madhe të parave po e merr asfalti, kurse pjesën më të vogël bujqësia, arsimi, shëndetësia e mbrojtja sociale.

Megjithëkëtë, Buxheti për shëndetësi do të vazhdojë të mbetet pothuajse i njëjtë.

Ministria e Shëndetësisë ka rritje për rreth 2,2 milionë euro, që kryesisht reflekton në reformën e sektorit të shëndetësisë, duke përfshirë edhe implementimin e Ligjit për sigurimet shëndetësore, ku janë planifikuar 10 milionë euro në formë të kontigjentës në Ministrinë e Financave.

Shëndeti i popullatës kosovare vazhdon të mos jetë prioritet i kësaj qeverie, e cila edhe për vitin 2015, por edhe në vitet në vijim, për sektorin e shëndetësisë e ka përjetuar një buxhet tejet të vogël, i cili as për së afërmi nuk i plotëson kërkesat reale të popullatës. Sipas statistikave, Kosova ka përqindje më ulët të Buxhetit që ndan për shëndetësi, në krahasim me vendet e rajonit, e nëse kësaj ia shtojmë faktin se edhe ky buxhet i vogël keqmenaxhohet, atëherë nuk kemi si të presim shëndetësi më të mirë dhe as që jemi optimist se kjo do të ndryshojë për të mirë të paktën me këtë Qeveri.

Se keqmenaxhimi është i pranishëm pothuajse në të gjitha aspektet dhe nivelet e shëndetësisë, kjo më së miri shihet në fushën e diagnostikës, aty ku pacientët vuajnë dhe në të njëjtën kohë paguajnë më së shumti, sepse aparatet diagnostike, siç janë CT-ja dhe rezonanca magnetike më shumë nuk punojnë se sa që punojnë, e kjo u jep mundësinë mjekëve që punojnë edhe në sektorin publik, por edhe privat, që t'i rekrutojnë pacientët në ordinancat e tyre private, ku ata detyrohen ta paguajnë një tarifë të lartë.

Fakti që një ministri nuk ka arritur t'i zgjedhë drejtorët e klinikave për 4 vjet me radhë, nuk do koment. Pastaj zhvillimet e tjera në lëmin e shëndetësisë, me theks të veçantë në çështjen e barnave, ku ato ilegale dhe me banderola të falsifikuara e kanë mbushur tregun kosovar. Furnizimi i institucioneve shëndetësore nga vetë Ministria e Shëndetësisë me barna me afat të skaduar, mungesa e citostatikëve, insulinat, penjtë kirurgjikë, çështjet e specializantëve të cilët me vetëfinancim e paguajnë specializimin, është e papranueshme, sepse ne detyrimisht po i detyrojmë kuadrot tona të emigrojnë jashtë. Të gjitha këto e kanë diskredituar sistemin shëndetësor.

Me gjithë këto parregullsi, nuk është investuar fare në inspektorate, as atë shëndetësor, e as farmaceutik, të cilat institucione e mbikëqyrin respektimin e ligjshmërisë dhe monitorimin e kodit etik dhe profesional, por sa mund të arrihet e gjithë kjo me kaq pak inspektorë?

Për kaosin që e ka kapluar Ministrinë e Shëndetësisë flasin më së miri skandalet e shumta të cilat tashmë janë bërë dukuri e zakonshme. Në këtë institucion dhe në institucionet vartëse të tij, aferat korruptive, procedurat e shumta disiplinore, gjetjet e shkeljeve ligjore në prokurimin publik dhe keqpërdorimet me tenderë të shoqëruar edhe me arrestimet e zyrtarëve të tij. Buxheti për barna është jashtëzakonisht i varfër, e nëse e marrim një krahasim shumë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Nëse u është ndalur fjala, e lus regjinë t'ia vazhdojë. Mund të jetë çështje teknike. Në qoftë se i është ndalur fjala, e lus regjinë që t'ia vazhdojë.

TIME KADRIJAJ: ...Buxheti për barna është jashtëzakonisht i varfër dhe nëse e bëjmë një krahasim shumë të thjeshta ndërmjet Kosovës, për shembull, dhe Sllovenisë, me një numër afërsisht të njëjtë të banorëve, mund të themi se mungesa do të ketë për arsye se një buxhet kaq i vogël për barna dhe material shpenzues është larg të qenët normal dhe larg të qenët diçka stabile për ta furnizuar me barna gjithë këtë popullatë. Mbajtja e kësaj status quo-je financiare nuk është e mirë, pasi gjendja në shëndetësi nuk është e mirë.

Në sistemin shëndetësor mungojnë aparaturat, mungojnë barnat dhe çdo gjë nuk përkon me zhvillimin e një shëndetësie moderne. Mosrritja e Buxhetit për shëndetësi tregon se nuk ka asnjë qasje serioze për përmirësimin e gjendjes në shëndetësi. Ne kërkojmë që shëndetësia të jetë njëra nga prioritetet qeveritare ku do të rriten investime, do të rritet transparenca dhe menaxhimi i përgjegjshëm i parasë publike. Kërkojmë që njëherë e përgjithmonë sektori i shëndetësisë të nxirret nga rruga skandaleve, e korrupsionit dhe keqmenaxhimit. Të rritet Buxheti për shëndetësi, të përshpejtohen reformat shëndetësore, veçanërisht për funksionalizimin e sigurimeve shëndetësore.

Shëndetësia sot i ka këto të veçanta, ndodhet në një formë legislative, me aktet përcjellëse nënligjore, si statuti që mund të thuhet me paqartësi në raport me ligjin. Cilat janë standardet bazike akredituese për institucionet shëndetësore konform legjislacionit të BE-së? A janë të parapara këto në Buxhet, qoftë të këtij viti, apo në kornizën afatmesme të shpenzimeve? Sa janë në gjendje spitalet t'i përmbushin obligimet që dalin nga një mori udhëzimesh administrative nga shumë ministri që kanë implikime buxhetore në institucionet shëndetësore, si për shembull: kushtet e sigurisë në punë; kriteret teknike për qasje të barabartë në institucione; shkallët e amortizimit të pasurive; edukimi i vazhdueshëm profesional; asgjësimi i mbeturinave medicinale, e shumë e shumë udhëzime - rregullore tjera.

Buxheti i propozuar në kategoritë e pagave dhe mëditjeve e mbulon pagën ekzistuese, pa paraparë asnjë numër shtesë të personelit, ndërsa kërkohet hapja e shërbimeve të reja. Buxheti për mallra dhe shërbime e mbulon vetëm ruajtjen e status quo-s. Asnjë nga

kriteret e amortizimit të pasurive të parapara me udhëzim administrativ nuk mund të realizohet me ndërhyrje tek-tuk. Trajnimi dhe edukimi i personelit me këtë Buxhet nuk mund as përafërsisht të realizohet.

Shërbimet komunale - i njëjti Buxhet me vite, e çdo herë shtrenjtim i rrymës, i ujit. Investimet kapitale - i njëjti Buxhet.

Ky Buxhet nuk mund t'i përmbushë të gjitha premtimet e partive të koalicionit qeverisës që i patën dhënë gjatë fushatës zgjedhore. Nga përvoja e deritashme, buxhetet e kaluara, të cilat janë të ngjashme me atë të vitit 2015, nuk kanë sjellë zhvillim të mjaftueshëm ekonomik. Pra, në qoftë se e ndjekim një shpërndarje financiare, çfarë kemi bërë deri më tani, kur të gjitha paratë i çojmë vetëm në rrugë, pak në investime kapitale, gjithërajonale dhe pak në formim të Gjyqësorit, të edukimit dhe shëndetësisë, ose të vetë sektorit privat. Atëherë është pak e pritshme që të ketë ndonjë ndryshim të madh të situatës ekonomike.

Me këtë Buxhet nuk do të ketë rritje të pagave të nëpunësve civilë, ashtu siç është premtuar. Zyrtarët qeveritarë nuk kanë treguar gatishmëri dhe seriozitet karshi zotimeve të bëra.

Shifrat zyrtare të papunësisë dhe varfërisë gjatë këtyre viteve nuk kanë shënuar ndonjë rënie të madhe, ndërkohë që për shumë qytetarë thuhet se gjendja e tyre ekonomike dhe sociale vetëm sa është përkeqësuar. Institucionet e Kosovës karshi këtyre problemeve gjatë këtyre viteve e kishin hartuar strategji e dokumente të ndryshme për ta tejkaluar këtë gjendje të rëndë ekonomike dhe sociale, por sipas njohëse të çështjeve ekonomike nuk kanë ndodhur ndryshime të dukshme, të cilat do të ndikonin në përmirësimin e mirëqenies të qytetarëve. Dhe, për këtë e vetmja shpresë e qytetarëve ka mbetur migrimi legal në kërkim të një jete më të mirë.

Fondi i asistencës sociale nuk është ndryshuar plot tre vjet. Pra, ka mbetur i njëjtë, 28 milionë. Të shpresojmë vërtet se në këtë vit do të fillojë pagesa për veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, sepse gjithë këto vite ne e kemi neglizhuar kategorinë më të çmuar të shoqërisë dhe si pasojë e dimë sa është numri i veteranëve të vetëvrarë për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike. E bëjmë pyetjen nëse Buxheti është shpërndarë në mënyrë korrekte nëpër komunat e Kosovës dhe nëse do ishte mirë që më shumë të investohet në komunat me zhvillim ekonomik më të dobët? Pse për magjistralen Prishtinë-Pejë është ndarë kaq pak buxhet, kur dihet se ajo rrugë me kryeqytetin lidh diku 500 mijë banorë? Rrugë ajo që mundëson prosperitet e zhvillim ekonomik. Në këtë Buxhet për komunën e Deçanit nuk ka asnjë projekt të ri, me gjithë kërkesat e bëra nga Komuna. Këtu kemi vetëm vazhdimet e projekteve të vjetra.

Komuna e Obiliqit ka bërë kërkesa nëpër ministri për shumë vija buxhetore. Ka kërkuar buxhet për rritjen e numrit të punëtorëve në shumë sektorë për punë efektive profesionale, por me këtë Buxhet po shihet se këto kërkesa janë injoruar, e po ashtu nuk janë përfshirë edhe shumë projekte të tjera kapitale. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E ftoj deputetin Glauk Konjufca për fjalë.

GLAUK KONJUFCA: Qytetarë të Republikës,
Deputetë të Kuvendit të Kosovës

Prezantimi i kryeministrit Mustafa për projektligjin për Buxhetin filloi me dy fjali. Fjalja e parë është: “Po dal këtu në cilësinë e kryeministrit”... Kanë kaluar pothuajse gati dy javë prej kur është zgjedhur dhe ai ende nuk po beson se është kryeministër dhe po ka nevojë të tregojë se është i tillë. Kurse fjalia e dytë ishte: “Ky nuk është Buxheti im, ky është Buxhet i Qeverisë së kaluar”. Zonja dhe zotërinj, çfarë serioziteti e ka kjo Qeveri, kur i pari i saj në prezantimin e ligjit më të rëndësishëm të vendit del dhe thotë se ky nuk është projektligj i Qeverisë sime, por i Qeverisë së kaluar.

Atëherë, duhet ta shtrojmë pyetjen themelore se a jemi në Qeverinë e tashme, apo në Qeverinë e kaluar, e kjo tregon më së miri se kush është kryeministri i vërtetë i kryeministrit Mustafa. Si dhe tregon se kush kujt ia ka mbushur gotën me ujë. Zoti Mustafa tha se ky Buxhet nuk i reflekton nevojat e Qeverisë. Atëherë në asnjë mënyrë këtu nuk paskemi të bëjmë e ndryshimin, të cilin aq shumë e ka trumbetuar Qeveria e re, e ardhur në pushtet. Për arsye se sipas kësaj, Buxheti qenka mishërim i projektimit të plotë të cilin e ka përcaktuar Qeveria e mëparshme.

Kur e kritikoni LDK-në se pse shkoi me PDK-në, arsyetimi që ka mbizotëruar prej anëtarëve të saj ka qenë që megjithatë mund ta arrijmë një shkëputje prej qeverisjes së kaluar, sepse e kemi kryeministrin. Kjo është një gjë shumë me rëndësi, apo jo?! Ta kesh kryeministrin, ta kesh udhëheqjen e Qeverisë dhe sapo thotë se unë jam kryeministri në seancë, fjalia e dytë thotë se ky nuk është Buxheti im. Kjo tregon se këtu nuk kemi pasur të bëjmë madje as me zëvendësim të PDK-së. Bile të ishte zëvendësim i PDK-së!

Kjo është thjeshtë bashkëngjitje në karvanin që ishte duke ecur në të kaluarën. Dhe, pikërisht këto fytyra që i kemi parë edhe në konferenca për shtyp, të cilat kur doli ky projektligj i miratuar prej Qeverisë dhe i draftuar në tetor të këtij viti, dolën dhe nuk lanë gjë pa thënë për këtë Buxhet. Tash është për gjynah se si detyrohen ta mbrojnë po atë Buxhet, të cilin e kishin quajtur ‘të varfërisë, të prapambetjes’, e kështu me radhë.

Unë fjalën time do ta përqendroj më shumë te Prishtina, sepse mendoj që qyteti ynë është diskriminuar dhe se me këtë Buxhet, Qeveria e kaluar i është hakmarrë në mënyrë të veçantë. Por, tash nuk kam shpresë fare që me kryeministrin e ri do ta kemi një ndarje të drejtësisë buxhetore për Prishtinën, aq më tepër që kryeministër e kemi njeriun që e ka humbur Prishtinën dhe nuk kam shpresë se do ta ndryshojë Buxhetin sa i përket Prishtinës, meqenëse ka argumente që pragu buxhetor, në të cilin është limituar Komuna e Prishtinës, është dëmtuar për 13 milionë euro, me qëllim, duke llogaritur këtu edhe të hyrat vetjake të Komunës.

Kuvendi Komunal i Prishtinës më 29 shtator 2014 e miratoi Buxhetin për vitin 2015, në vlerë prej 69 milionë eurosh, që ishte 6 milionë euro më i lartë sesa Buxheti që parashihet me qarkoren buxhetore 2015/02 për kryeqytetin tonë. Ky ndryshim prej 6 milionë eurosh ishte në kuadër të të hyrave vetjake, e jo në kuadër të granteve qeveritare. Ky ndryshim prej 6 milionë eurosh, pra u dorëzua edhe në Ministrinë e Financave më 30 shtator 2014, por kjo ministri, për shkak të tejkallimit të këtyre kufijve, e aplikoi nenin 62 të Ligjit për

menaxhimin e financave publike dhe të përgjegjësi, duke konsideruar se Kuvendi Komunal i Prishtinës ka dështuar ta dorëzojë Buxhetin në pajtim me harkoren buxhetore.

Buxheti për Komunën e Prishtinës, që e kemi para nesh, është një propozim-buxhet i përgatitur nga Ministria e Financave në vlerë prej 65 milionë euro, pra 13 milionë euro më pak se që është miratuar në Kuvendin Komunal të kryeqytetit tonë, i cili është bazuar në Buxhetin e vitit 2014. Mirëpo, ky Buxhet është 6 milionë euro më i vogël, duke i llogaritur edhe të hyrat vetjake dhe gjithashtu është 13 milionë euro më i ulët sesa është miratuar prej vetë deputetëve shumicë në Kuvendin Komunal të Prishtinës.

Tani më lejoni t'u kthehem kufijve buxhetorë të vendosur për vitin 2015. Vlerësimet për Komunën e Prishtinës në kuadër të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të Republikës së Kosovës, të detajuara në qarkoret buxhetore, të lëshuara nga Ministria e Financave janë të pafalshme për zhvillimin e kryeqytetit tonë, si dhe për perspektivën e Prishtinës. Kufijtë buxhetorë për grantin e përgjithshëm dhe për grantin në shëndetësi janë llogaritur duke u bazuar në numrin e popullsisë, sipas regjistrimit të cilin e posedon me statistika edhe Agjencia e Statistikave të Kosovës për vitin 2011.

Sipas këtij regjistrimi, Prishtina i ka 198 mijë banorë, ndërsa në vitin 2013 Qeveria e Kosovës e kishte shfrytëzuar shifrën prej 388 mijë banorësh për llogaritjen e kufijve buxhetorë të Komunës së Prishtinës, bazuar në vlerësimin e po të njëjtës agjenci. Ky vlerësim ishte bërë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, duke u bazuar asokohe edhe në numrin e nxënësve për shkollimin parauniversitar, që konsiderohet si një ndër shifrat më të sakta në Kosovë, duke marrë parasysh vijueshmërinë prej gati 100% të këtyre nxënësve në këto nivele të shkollimit, si dhe duke u bazuar në numrin e ekonomive familjare, si dhe në numrin mesatar të anëtarëve për ekonomi familjare.

Autoritetet komunale kanë hasur në raportime të shumta të banorëve të Prishtinës, të cilat tregojnë se janë të regjistruar p.sh. në vendlindjen e tyre, që nuk është domosdoshmërisht Komuna e Prishtinës, por që jetojnë dhe punojnë në Prishtinë, e që tregon se ajo ka shumë më shumë banorë sesa që pretendohet prej regjistrimit të fundit të popullsisë. Prandaj, kufijtë buxhetorë të përcaktuar për Komunën e Prishtinës janë të pafavorshëm dhe shkojnë në dëm të zhvillimit të kryeqytetit, në dëm të ndërtimit të infrastrukturës, si dhe në dëm të shërbimeve më cilësore për qytetarët dhe për arsim e shëndetësi më kualitative. Në mungesë të një granti specifik për kryeqytetin, Komunës së Prishtinës duhet t'i lejohet financimi i buxhetit të vet nga të hyrat vetjake në masë më të madhe sesa që është përcaktuar prej kufijve buxhetorë, të cilët janë vënë nëpërmjet këtyre qarkoreve, në mënyrë që kjo komunë ta vazhdojë ofrimin e shërbimeve të ndryshme, jo vetëm për banorët e vet, por për të gjithë qytetarët e komunave të Kosovës, duke i pasur parasysh ardhjet e shumta të të gjithë qytetarëve edhe nga komunat e tjera për punët e tyre specifike, të cilat duan t'i kryejnë në kryeqytet.

Prandaj, ky Kuvend, nëpërmjet Komisionit të vet FunkSIONAL për Buxhet dhe në bashkëpunim me Komunën e Prishtinës duhet të gjejë mënyra që kufijtë buxhetorë për kryeqytetin tonë të rriten.

KRYETARI: E ftoj deputeten Emilija Rexhepi që ta marrë fjalën.

Emilija Redžepi: Zahvaljujem se predsedniče!

Poštovani predstavnici Vladinog kabineta,

Kolege poslanici,

Poštovani građani,

I pored velikih neregularnosti koje se svake godine ponavljaju oko investicija u pećkom, istočkom, mitrovačkom i drugim krajevima gde žive Bošnjaci, u potpunosti podržavam ispred Bošnjačke zajednice, koja najvećim brojem živi u prizrenskom regionu, Predlog-nacrta budžeta za 2015. godinu, odnosno sve kapitalne investicije i infrastrukturne projekte, koje će se naredne godine realizovati u ruralnim mestima župskog i podgorskog kraja, a tiču se poboljšanja osnovnih uslova života naših građana. Počevši od 2009. godine, i ove naredne 2015. godine, u saradnji sa direktorom za kulturu, omladinu i sport, direktorom javnih službi, ali direktorom obrazovanja na opštinskom nivou, uvrstili smo veliki broj strukturnih projekata u budžetu opštine Prizren.

Međutim, bez ekonomskog razvoja, gde akcenat posebno stavljam na razvoj poljoprivrede, stočarstva i turizma, prosto je nemoguće zaustaviti proces velike migracije koje poslednjih meseci veoma jak zabrinjavajući problem.

Apelujem na ministra za poljoprivredu, ministra za ambient i prostorno planiranje, posebno kada je u pitanju razvoj turizma na Prevalcu, kao i ministra za ekonomski razvoj, da u ovom mandatu budu fokusirani na razvoj tog geografskog područja, koje poseduje prirodne resurse i potencijale, a pre svega adekvatne ljudske resurse, koji se samo trebaju pravilno iskoristiti, te ovim pametnim potezom, otvoriti mnoga radna mesta za mlade ljude, obezbediti im ekzistenciju njihovih porodica, i zadržati ih na prostorima naše države. Još jednom podržavam Nacrt-budžeta za 2015. godinu i glasaću za njega.

Poštovani predsedniče,

S obzirom da je u nekoliko navrata danas spominjeno Ministarstvo za zajednice i povratak u negativnom smislu, odgovorno želim da demantujem i da se javno zahvalim ministru Jevtiću na investicijama u Bošnjačkoj zajednici u vremenskom periodu od godinu dana, od kada smo mi kao stranka imali svoga zamenika ministra u Ministarstvo za zajednice, i nadam se da ćemo i sa ministrom Jablanovićem nastaviti uspešnu saradnju, posebno kada je u pitanju investicija za Bošnjačku kulturno-omladinski centar u samom gradu Prizrena. Zahvaljujem!

KRYETARI: Faleminderit! E ftoj deputeten Alma Lama ta marrë fjalën.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Para se të filloj të flas për Buxhetin, dua të flas për një praktikë të gabuar parlamentare këtu në Kuvendin e Kosovës. E kam fjalën për mandatet e kaluara, por që duket se do të përsëritet edhe këtë herë, kur në pjesën e fillimit të seancës, që është pjesë sa më e ndjekur nga qytetarët, zakonisht u jepet hapësirë deputetëve burra, e nga fundi, zakonisht

pasdite, atëherë kur vëmendja e publikut bie... nuk është fare për të qeshur, dëgjoni pak!,... u vjen radha edhe grave.

Në këtë mënyrë krijohet opinionimi i gabuar se gratë flasin gjëra të parëndësishme, prandaj ato i lënë në fund, kurse burrat thënë gjëra të mençura, gjë që nuk është e vërtetë. Dua t'ju them, zoti kryetar, se kjo praktikë duhet të rregullohet nga ju si drejtues i seancës, sepse ju e bëni renditjen. Modeli të cilin unë e propozoj është ai i Parlamentit Evropian. Kjo nuk është një gjë që po e shpik unë, por është në institucionin më të rëndësishëm të Bashkimit Evropian, pra në Parlamentin Evropian, i cili e ka konstatuar edhe atje këtë problem, e ka adresuar dhe e ka zgjidhur. Këtë zgjidhje e ka bërë duke ua dhënë fjalën me radhë deputetëve gra dhe atyre burra, duke respektuar radhën gjinore.

Nëse ju, si kryetar, nuk e besoni këtë, ju ftoj të bisedoni me zonjën Lunaçek, e cila ma ka thënë edhe mua këtë dhe do ta shihni se si funksionon Parlamenti Evropian, i cili i ka mbi 700 deputetë dhe besoj se është goxha më shumë e komplikuar renditja se sa këtu në një parlament, me 120 deputetë.

Tani, sa i përket Buxhetit, unë kam pritur që në pjesën hyrëse të këtij dokumenti të shpaloset vizioni i Qeverisë për zhvillimin ekonomik, e jo vetëm një paraqitje teknike, si kjo që e kemi përpara. E kuptoj që është përgatitur nga qeverisja e kaluar, por besoj se do të duhej që ky vizion megjithatë të mos mungonte. Ndërkohë në të njëjtin dokument më vonë flitet për trendet e ekonomisë botërore, pastaj të Bashkimit Evropian dhe shumë pak për ekonominë e Kosovës.

Natyrisht që Kosova është e ekspozuar ndaj kurbës së rritjes, apo rënies, apo vetë krizave që mund ta kaplojnë ekonominë globale, mirëpo Qeveria mund t'ia bëjë një analizë të thellë ekonomisë së Kosovës.

Është alarmante që ekonomia e Kosovës mbështetet në konsum, siç konstatohet vetë në këtë dokument të Buxhetit dhe rreth 80% të të hyrave të Buxhetit mjaft të varfër vijnë nga doganat. Kështu që, Kosova është pra një treg tërësisht i vendeve dhe i prodhimit të mallrave nga vende e rajonit.

Ne nuk prodhojmë, por konsumojmë. Jemi thjesht shoqëri konsumi. Në Buxhetin e Kosovës thuhet se kemi pasur rritje çmimesh për shkak se në prill të vitit 2014, rritja prej 25% e pagave për shërbyesit civilë ka ndikuar në rritjen e çmimeve.

Unë dua të pyes tani, se sa për qind janë ngritur çmimet në shportën e konsumatorit, për shkak të premtimeve të Qeverisë së kaluar për rritje pagash? A janë rritur edhe 25%?

Me sa po shohim përditë, rritja e pritjeve ka çuar në ngritje të papërballueshme të çmimeve, për pjesën më të madhe të konsumatorëve, ndërsa, rritja e pagave të premtuara mbeti vetëm premtim elektoral i PDK-së, me qëllim blerjen e votës. Gjithashtu, në Ligjin për Buxhetin më ra në sy edhe diçka tjetër, me rëndësi të madhe. Gjatë vitit 2014 investimet kanë shënuar rënie në terma realë krahasuar me vitin paraprak dhe për këtë faji i vihet situatës së padefinuar politike.

Nuk mund ta them me siguri, se ky arsyetim nuk qëndron, ama një gjë e di me siguri, se investimet e huaja kanë rënë për shkak të praktikave korruptive në institucionet e Kosovës. Tashmë janë të njohur shembujt, se si kompanitë e huaja që kanë ardhur fillimisht për të investuar në Kosovë, duke qenë se nuk kanë gjetur një ambient të përshtatshëm të të bërit biznes, janë larguar dhe kanë shkuar në vendet e rajonit, për shembull, në Maqedoni.

Unë besoj, se secilit këtu i kujtohet fushata promovuese e ish ministres së Tregtisë, e cila thoshte se e ka përmirësuar ambientin e të bërit biznes në Kosovë, por, ja që faktet në terren po përgënjeshtrojnë secilën nga këto deklarata.

Kërkoj nga Qeveria aktuale, që të marrë masa urgjente që ata investitorë të paktë që shfaqin interes për Kosovën, të priten me shumë interes e jo të krijohen njëmijë barriera korruptive.

Vërejtje tjetër imja lidhet me mungesën e bashkëpunimit me ekonominë e shtetit shqiptar. Mendoj, se duhet të integrohet ekonomia e të dy vendeve dhe nuk besoj se është dikush që po pengon në këtë e sidomos, të krijojmë tregun e përbashkët. Prandaj, e ftoj kryeministrin Mustafa, që ta bëjë prioritet të Qeverisë së tij këtë çështje dhe përfundimisht të dalim nga kurthi i retorikës së deritanishme të bashkëpunimit.

Tani dua të kaloj në një çështje shumë konkrete, të cilën nuk e pash të adresuar në Ligjin për Buxhetin. Kjo lidhet me ligjin që u miratua në mandatin e kaluar, i cili u mundëson grave të dhunuara gjatë luftës të ndihmohen financiarisht. Ky Buxhet ka menduar për shpërblimin e veteranëve të luftës, por edhe për të burgosurit politikë dhe nuk kam asgjë kundër kësaj, por, çuditërisht është harruar kategoria më delikate dhe që ka pësuar shumë gjatë luftës. Është për të ardhur keq, që kjo harresë ka ndodhur pas gjithë atij debati publik.

E di që komisioni nuk e ka kryer ende punën e identifikimit të këtyre grave, ama ky nuk është faji i atyre grave, është sërish faj i Qeverisë. Unë do të propozoj një amendament me një shumë të caktuar, që do ta konsultoj me ligjin dhe një numër të përafërt të grave, që do të përfitonin në momentin që komisioni kryen punën. Dhe, ju bëj thirrje të gjithë juve si deputetë, por dhe Komisionit për Buxhet dhe Financa, që ta mbështesë atë amendament.

Kemi të bëjmë me vuajtje njerëzore dhe secili prej nesh duhet të jetë më i ndjeshëm ndaj kësaj vuajtje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E ftoj deputetin Blerim Shala ta marrë fjalën.

BLERIM SHALA: Buxheti i një shteti është pasqyra më e mirë e mundshme e gjendjes në një vend, në një shoqëri.

Buxheti i një shteti tregon me gjuhën më të qartë të mundshme, me atë të numrave, se çka e pret një shtet dhe qytetarët e tij në vitin e ardhshëm, por, po ashtu edhe në një periudhë afatmesme disavjeçare.

Buxheti i një shteti gjithsesi shfaq në mënyrën më autentike të mundshme synimet e një qeverie, në segmentet kyç të funksionimit të një shteti. Ky Buxhet tregon saktë se çka ka ndërmend të bëjë Qeveria tash e tutje në udhëheqje me një vend, për ta sendërtuar planin e vet për ndryshimin e gjendjes në një shtet.

Le t'i lëmë anash këtu të gjitha ato zotime politike, të gjitha ato premtime parazgjedhore dhe paszgjedhore, që janë bërë prej partive politike, që u dakorduan të udhëheqin me Kosovën në këtë mandat të Kuvendit të Kosovës dhe të mos merremi as me faktin bazik, që aktualisht deputetëve të Kuvendit të Kosovës nuk u është prezantuar as plani qeverisës.

Të gjitha këto nuk çojnë peshë në debatin që do të bëhet sot në Kuvendin e Kosovës. Fjalët tona do të duhej të përqendroheshin në propozim-ligjin e Buxhetit të Kosovës për vitin 2015, sepse ai na përfaqëson të vërtetat kryesore për Kosovën e viteve 2015-2017. Dhe, këto të vërteta na dëftohen prej Qeverisë së Kosovës, nuk na kanë ardhur si raporte ndërkombëtare, as si djersitje mediesh, as opinionistësh, as si përpjekje opozitare për ta diskredituar Qeverinë.

Këtu në këtë Buxhet na flet Qeveria e Kosovës, askush tjetër. Çka mund të kuptohet atëherë nga leximi i draft-ligjit për Buxhetin e Kosovës për vitin 2015? Çka na pret si Kosovë tash e tutje në bazë të këtij Buxheti? Çka e pret qytetarin e Kosovës?

Pyetja mbi të gjitha pyetjet është: A do të jetohet më mirë në Kosovë në vitin 2015 dhe në vitet vijuese? Përgjigja që del si konkludime analizës, që i bëhet këtij Buxheti është fare e qartë. Në vitin 2015 në Kosovë do të jetohet më keq se në këtë vit që po lëmë prapa. Kjo tendencë e përkeqësimit të gjendjes në Kosovës, gjithnjë sipas këtij Buxheti, do të vazhdojë tutje në vitet 2016 dhe 2017.

Si mbërrihet te ky konkludim? Qeveria e Kosovës parashikon që në vitet 2015-2017 të ketë rritje ekonomike në vlerë mesatare prej 4,3%. Minimumi vjetor i zhvillimit ekonomik të Kosovës për ta siguruar ngecjen a vendnumërimin në shkallën e papunësisë, në nivelin e varfërisë është 7%. Minimumi vjetor i zhvillimit ekonomik në Kosovë për të nisur garën me Shqipërinë dhe Maqedoninë, dy shtetet më të pazhvilluara në Ballkan, është 10%.

Këto shifra kanë po ashtu, autorësinë e Qeverisë së Kosovës, kësaj të kaluarës dhe të Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Po del pra, me një krahasim fare të thjesht, që në vitet 2015 – 2017 do të ketë ngritje të papunësisë, thellim të varfërisë, shtim të pakënaqësisë të qytetarëve të rëndomtë të Kosovës.

Si mund të ketë përmirësim të ndjeshëm të jetës së kosovarëve, nëse Buxheti i Kosovës i vitit 2017, ashtu siç figuron në këtë draft-ligj do të jetë vetëm për 9 milionë më i lartë se Buxheti i vitit 2015, nëse të hyrat në Buxhetin e vitit 2017 do të jenë për vetëm 23 milionë më të larta se të hyrat e planifikuara në vitin 2015.

Nëse nuk ka zhvillim të mirëfilltë ekonomik në vitin 2015-2017, nëse nuk ka rritje të Buxhetit të Kosovës, nuk ka dhe nuk mund të ketë as rritje të pagave dhe as të beneficioneve sociale. Prapë, këtu flet vetë Qeveria e Kosovës.

Nëse shikojmë tabelat e Buxhetit të Kosovës, siç na e prezantuan nga Qeveria, del se në vitet 2015, 2016 dhe 2017 nuk do të ketë rritje të rrogave fare. Në vitin 2015 nuk do të ketë as zbatim të marrëveshjes apo kontratës kolektive. Këtë po na e thotë neve, deputetëve të Kuvendit të Kosovës dhe gjithë qytetarëve të Kosovës, Qeveria e Kosovës.

Ndërsa, ky është skenari më i mirë i mundshëm i Qeverisë së Kosovës, i cili parashikon mbushjen e arkës së shtetit nga doganat e Kosovës dhe nga ATK për mbi planin për të hyrat e vitit 2014, i cili sivjet nuk do të realizohet as 90%. Si mund të ketë atëherë rritje substanciale në vitet 2015-2017 në të hyrat doganore tatimore në këtë shkallë të zhvillimit ekonomik, që nuk është as 4,5% në mesatare.

Si është e mundur, që Qeveria e Kosovës edhe në tre vjetët e ardhshme synon që arkën e shtetit të mbushë me të hyra doganore, ndërsa Qeveria e kaluar, jo opozita, në vitin 2011 ka paralajmëruar domosdoshmërinë e reduktimit të varshmërisë së Buxhetit të Kosovës nga Dogana, sepse afrimi kah Bashkimi Evropian nënkupton gjithsesi edhe përqendrimin e qindpërqindtë tek të hyrat tatimore vendore.

Në vitet 2015 e 2016, si pasojë e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me Bashkimin Evropian dhe Marrëveshjes së tregtisë së lirë me Turqinë, ne do të kemi më pak të hyra nga doganat. Si është e mundur që deficitit tregtar, që sa vjen e rritet, sivjet është për 3,2% më i madh se në vitin 2013 e Qeveria e Kosovës ende flet për favorizimin e prodhimit vendor dhe të eksportit.

Si është e mundur, që Qeveria e Kosovës planifikon rritjen e investimeve nga jashtë pas këtij kolapsi në vitin 2014, kur kemi një rënie prej 43% të këtyre investimeve krahasuar me vitin 2013?

Si është e mundur, që Qeveria e Kosovës njëkohësisht flet për trendët jo shumë shpresëdhënëse ekonomike në Euro-zonë dhe pret që në vitet e ardhshme shqiptarët e Kosovës të shtojnë dërgesat e tyre tek familjarët, të cilat në vitin 2017 do të duhej të mbërrinin shifrën prej 695 milionë euro? Apo, këtu llogaritet që mijëra shqiptarë të Kosovës, që po largohen javët e fundit për në Evropë, do t'u dërgojnë ndihma familjeve të tyre.

Me këtë trend që është në fuqi, këto ditë do të kemi dhjetëra- mijëra shqiptarë më pak në Kosovë dhe si pasojë edhe numri i të papunëve do të ulet, apo jo?

Nuk ka pra, aspak lajme të mira për Kosovën, për qytetarët e saj nga ky Buxhet i Kosovës, i cili po shqyrtohet sot. Qeveria e Kosovës po na flet në këtë mënyrë. Kjo qeveri do të detyrohet për të shmangur një katastrofë ekonomike dhe sociale, që na kanoset, të bëjë një 'stand by' aranzhman të ri me Fondin Monetar Ndërkombëtar, rrogat do të ngrihen, TVSH do të rritet, çmimet e rrymës po ashtu. Borxhi publik i shtetit do të rritet shumë në vitet e ardhshme. Borxhe në para dhe telashe të shumta politike do të jetë trashëgimia e kësaj qeverie. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E ftoj deputeten Albulena Haxhiu të marrë fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Të nderuar qytetarë të Republikës,

Të nderuar deputetë,

Ndonëse shumë fjalë e premtime për reformim në sistemin e drejtësisë dhe forcim e pavarësim të tij, si nga kryeministri Mustafa e gjithashtu edhe nga zëvendësi i tij, Hajredin Kuçi, sërish dëshmohet që sikur edhe Qeveria e Kaluar edhe kjo e tanishme, nuk e kanë as në qëllim, nuk kanë as vullnet dhe as plan të mbështesin forcimin e sistemit të drejtësisë dhe deklaratimet publike të tyre janë mashtrime të radhës dhe hedhje hi syve qytetarëve.

Në bazë të parimit të ndarjes së pushteteve, pushteti gjyqësor paraqet njërin nga degët e pushtetit me rëndësi jetike brenda një organizimi shtetëror. Si i tillë, Sistemi Gjyqësor është garanti kryesor për stabilitetin juridik në drejtim të mbrojtjes së ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë së shtetit. Në këtë drejtim, financimi dhe strukturimi i tij është tejet i rëndësishëm, kur flasim për aspektin funksional.

Në strukturën buxhetore të Republikës së Kosovës për vitin 2015, që përfshinë një shumë prej 1 miliard e 576 milionë, ndarja buxhetore për sektorin e drejtësisë është vetëm 31 milionë. Kur kemi parasysh që këtu hyn Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Këshilli Prokurorial, Agjencia për Ndihmë Juridike falas, Instituti Gjyqësor i Kosovës, Gjykata Kushtetuese dhe nëse e krahasojmë ndarjen sipas përqindjes nga totali i Buxhetit të Kosovës, shohim se ekzekutivi ka ndarë për këtë vit 0.02% më pak për sektorin e drejtësisë në krahasim me vitin e kaluar, në relacion me totalin buxhetor.

Pra, jo që nuk ka rritje, siç u tha më parë, por ka madje edhe ulje teksa krimi i organizuar e korrupsioni është në rritje. Kjo ndarje tregon denigrimin që i bëhet degës së gjyqësorit, pra vetëm as 2% në fakt e totalit buxhetor ndahet për sistemin e drejtësisë. Qeveria e shkuar e projektoi Buxhetin ilegalisht, mirëpo kjo e tanishmja nuk pati as vullnetin që të bëjë ndryshimet në përputhje me nevojat e institucioneve, në këtë rast me ato të drejtësisë.

Me ndarjen aktuale kjo qeveri po e saboton sektorin e Drejtësisë, duke tkurrur atë në aspektin financiar. Unë ju sjell në vëmendjen tuaj, të nderuar deputetë, që sot sistemi i drejtësisë ballafaqohet me probleme të ndryshme, që janë serioze.

Kushtet subjektive të gjyqtarëve dhe prokurorëve janë të mjerueshme, numri i madh i lëndëve të pazgjidhura qëndrojnë të pluhurosura në sirtarët e gjykatave e gjithashtu, mungesa e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Kërkesa e Këshillit Gjyqësor ka qenë angazhimi edhe i 30 gjyqtarëve të tjerë, ndërsa Këshilli Prokurorial ka kërkuar 20 prokurorë dhe 50 persona si staf mbështetës. Asnjëra nga kërkesat e tyre nuk janë marrë parasysh, as edhe për një pozitë të vetme, lëre më shumë.

Shtetet të cilat janë të interesuara ta forcojnë sistemin e drejtësisë e reflektojnë atë, së pari në Buxhet. Po e marr një shembull, vendet e rajonit në buxhetet e tyre kanë një ndarje buxhetore prej një mesatareje 4% deri në 5% për sistemin e drejtësisë në Buxhetin e përgjithshëm shtetëror. Nëse vazhdohet kështu, ne jo vetëm se nuk do të arrijmë që ta stabilizojmë pushtetin gjyqësor, por jemi duke shkuar në regres të qartë dhe të qëllimshëm.

Sigurisht, që ne jemi të vetëdijshëm që pavarësisht atyre se çfarë thuhet, këta njerëz asnjëherë nuk do ta forcojnë sistemin e drejtësisë, sepse në fakt interesi i tyre kryesor është mbajtja në këtë gjendje, madje edhe degradim i mëtejshëm. Kështu, këta këtu, të rreshtuar si Qeveria e Kosovës, janë të interesuar të zhvillojnë metoda e mekanizma që mbajnë trupën e gjyqtarëve e prokurorëve nën shantazh e kontroll, qoftë institucional, qoftë jo-institucional. E sigurisht, që ndarja e Buxhetit është një mekanizëm i përkryer për këtë qëllim.

Të nderuar deputetë,

Këshilli Gjyqësor i Kosovës me 2118 personel të të gjitha niveleve ka të parashikuara vetëm 15 mijë euro, ndërsa Ministria e Financave me 1704 të punësuar do të ketë 25 mijë euro, për pagat e tyre është fjala. Pa dashur të vendos masë krahasimi, por si ka mundësi që të na kushtojë më shumë Ministria e Financave me më pak zyrtarë se sa i gjithë Këshilli Gjyqësor i Kosovës?

Prokuroria Speciale me 54 të punësuar për vitin 2015 ka vetëm 510.000 euro në dispozicion, pra një mesatare prej 710 euro në muaj, duke mbajtur parasysh se ka nivele të ndryshme pagesave, pra që mund të ketë dhe më poshtë se kaq, teksa Zyra e Kryeministrit do të shvasë Buxhetit të Kosovës hiç më pak se 773 657 euro, pra edhe 200 mijë euro me shumë se prokurorët special të Kosovës.

Tani veç e merrni me mend të gjithë çfarë kishte parashikuar ministri i Jashtëm i tanishëm, Hashim Thaçi e çfarë po zbaton kryeministri i tanishëm, Isa Mustafa. Tamam luftë të organizuar, kundër “luftës ndaj krimit të organizuar”. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E ftoj deputeten Vjosa Osmani.

VJOSA OSMANI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Gjatë shqyrtimit të Ligjit për Buxhetin, si çdo vit tjetër, pyetja themelore që duhet t'ia bëjmë secili vetes është nëse ky Buxhet siguron zhvillim ekonomik.

Dhe, e vërteta është që pavarësisht sa flasim dhe çka flasim ne sot këtu për orë të tëra, qytetarët mendojnë se përgjigja në këtë pyetje është “Jo”. Së paku, kështu është perceptimi dhe nëse sot dikush thotë që ky perceptim është i parëndësishëm, mjafton të shikohen radhët e gjata të qytetarëve, që bëhen gati për t'u larguar nga Kosova.

Numri i tyre ka qenë jashtëzakonisht i madh edhe vitin e kaluar e ka vazhduar të rritet edhe sivjet, teksa po e mbyllim vitin 2014. Ata thonë, se në Kosovë nuk shohin perspektivë e zhvillim dhe kërkojnë të gjejnë mbijetesën diku tjetër. Prandaj, ajo që duhet të na preokupojë të gjithëve, është nëse me këtë Buxhet dhe mënyrën si është planifikuar ai, ne po ndryshojmë diçka në mënyrë që ky largim masiv nga Kosova, që po e dëmton edhe të ardhmen evropiane të vendit, të ndalohet.

Buxheti që kemi sot para nesh, siç u tha disa herë edhe nga vetë anëtarë të Kabinetit qeveritar, nuk ndryshon shumë nga ai i viteve të kaluara, sepse shkaku i procedurave nuk ka mundur të ndryshohet, sepse është kohë shumë e shkurtër, që u formuan institucionet. Megjithatë, është e domosdoshme që pjesë esenciale e Programit të LDK-së për zhvillim ekonomik, që në fokus e kanë sektorin privat si gjenerues kryesor të vendeve të punës, të reflektohen në këtë Buxhet edhe ndërmjet dy leximeve, por edhe gjatë rishikimit që do të bëhet pas disa muajsh.

Nëse kjo nuk bëhet dhe nëse sektori publik vazhdon të mbetet punëdhënësi kryesor në Kosovë, qytetarët do të vazhdojnë ta kërkojnë perspektivën tjetërkund e jo brenda vendit.

Një çështje tjetër, që po ashtu ka të bëjë me agjendën e integritetit evropian është ajo e rriprimit, riintegritetit dhe riatdhimit të personave që kthehen në Kosovë, pasi t'u jetë refuzuar azili në vendet përkatëse të BE-së. Përkundër një Buxheti të alokuar vitin e kaluar ka pasur probleme jashtëzakonisht të mëdha në mënyrën se si është ndarë dhe shpenzuar ai, në veçanti nga komunat dhe, përsëri ka pasur raportime të shumta për familjet, që përkundër të drejtës së tyre ligjore për të përfutur nga ky Buxhet, kjo nuk u është mundur.

Çështja e dytë që dua të ngre është buxheti për qytetin e Mitrovicës. Fatkeqësisht, mund të hingëllojmë pak lokalistë kur flasim për qytete veç e veç, por arsyeja pse unë flas sot për Mitrovicën është paka më e veçantë. Ky buxhet, fatkeqësisht, sivjet është vetëm 15 milionë, ngjashëm me shumicën e komunave të vogla. Vetëm 1,7 milionë euro, për shembull, janë ndarë për kategorinë e zhvillimit ekonomik për këtë komunë.

Kjo tregon, të nderuar deputetë, se pavarësisht situatës unike, në të cilën është gjendur kjo komunë që nga paslufta e deri më sot, akoma nuk ka trajtim të veçantë, që do të mund të nxiste zhvillim ekonomik dhe punësim. Për shkak të tensioneve të mëdha që rezultuan me mungesë të sigurisë, investimet në Mitrovicë për vite të tëra kanë qenë pothuajse inekzistente. Niveli i papunësisë është ndër më të lartët në Kosovë. Kjo ka bërë që një numër i madh i qytetarëve të kësaj komune të shpërngulen në Prishtinë. Në mënyrë që të

mos vazhdojë diskriminimi që ka ngjarë shkaku i tensioneve politike, ka ardhur koha që Mitrovica si komunë, ashtu siç e ka proklamuar vazhdimisht LDK-ja edhe në të kaluarën, të ketë trajtim të veçantë dhe të ketë një buxhet, i cili do të garantojë zhvillim ekonomik të komunës dhe rritje të vendeve të punës.

Ne vërejtëm që në nenin 9,3 dhe 12 të Ligjit për Buxhetin, tashmë është paraparë fondi i veçantë për veriun. Natyrisht, që unë nuk jam duke propozuar diçka identike për pjesën jugore, pra për komunën e Mitrovicës, por është esenciale të dihet që trazirat politike në këtë pjesë të vendit e kanë prekur si veriun, si jugun, njëlloj. Prandaj, do të ishte diskriminuese të mendojmë vetëm për zhvillimin e njëres pjesë, sepse integrimi mund të arrihet vetëm nëse zhvillohen të dyja anët e lumit Ibër.

Magjistralia apo buxheti për magjistralen Prishtinë-Mitrovicë, në qoftë se shikojmë atë që është ndarë tek Buxheti i Ministrisë së Infrastrukturës, shihet se nuk ka asgjë të ndarë për vitin 2015, por vetëm bartje e mjeteve të vitit paraprak. Duke pasur parasysh vonesat jashtëzakonisht të mëdha në ndërtimin e kësaj magjistraleje, që kanë shkaktuar jo vetëm pakënaqësi tek qytetarët, por edhe dëme ekonomike, është jo e logjikshme që të mos parashihet as edhe një cent i vetëm për vitin 2015, që do të mund të përshpejtonte përfundimin e këtij projekti.

Nga ajo që është parë deri më tani, përkundër vonesave që kanë zgjatur për vite të tëra, edhe cilësia e punës ka qenë shumë e dobët dhe mungesa e shenjave në vend punime ka rezultuar me shumë aksidente. Prandaj, dua të tërheq vërejtjen, që Ministria e Infrastrukturës të ndërmarrë masa urgjente, që të adresohen këto shqetësime të qytetarëve dhe të bizneseve përgjatë kësaj magjistraleje dhe të sigurohet që cilësia e punëve të kryera të jetë në përputhje me lartësinë e investimeve dhe që ky projekt jetik të përfundojë shumë shpejt.

Çështja e tretë, që dua të ngre, është mospërputhshmëria e planit të veprimit të MSA-së apo Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me Buxhetin e propozuar sot për votim. Ka mjaft veprime të parapara në këtë plan për MSA-në, i cili është miratuar në mandatin e kaluar nga ky Kuvend, të cilat nuk janë të parapara, pra kostoja e tyre buxhetore nuk është paraparë fare në Buxhetin e Republikës së Kosovës. Një prej tyre ka të bëjë me shumën, për shembull prej 390 mijë eurosh, e cila është paraparë në MSA, si një ndër veprimet për t'u ofruar mbrojtje gjyqtarëve, dëshmitarëve e paditësve. Nuk po flas këtu për prokurorë, sepse ajo shumë është paraparë dhe po ashtu, po e ripërsëris, kjo ka qenë edhe një ndër çështjet, që LDK-ja i ka avokuar vazhdimisht, pra që mbrojtje të ketë edhe për gjyqtarët e jo vetëm për prokurorët.

Pra, duhet gjatë rishikimit apo edhe gjatë paraqitjes së amendamenteve të kemi të qartë, që plani i veprimit për MSA-në duhet të reflektohet kostoja e këtij plani në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Çështja e katërt, u diskutua nga disa deputetë, ka të bëjë me shëndetësinë. Unë do ta prek vetëm një çështje këtu, një problematikë tepër të madhe që secili prej nesh, që kemi qenë në QKUK e kemi vërejtur dhe kjo ka të bëjë me mungesën e barnave esenciale.

Ish-ministri i Shëndetësisë vazhdimisht nëpër intervista na ka thënë në të kaluarën, që kjo listë nuk mund të kompletohet, sepse mungon Buxheti prej 9 milionë eurosh. Pra, është fjala vetëm për 9 milionë euro, që mund të kushtojë ndonjë rrugicë diku në një lokalitet, të cilat nuk po ndahen në mënyrë që kjo listë e barnave esenciale të plotësohet, në mënyrë që gratë të cilat lindin mos të kenë mungesë të barnave të cilat do t'ua parandalonin trombozën, për shembull ose që foshnjat e porsalindura të mos kishin mungesë të barnave të cilat do ta parandalonin infektimin e tyre, siç ka ndodhur.

Pra, është një çështje kaq esenciale, e cila kushton vetëm edhe 9 milionë ekstra. Unë i bëj apel Qeverisë së Kosovës, por natyrisht edhe të gjithë neve që jemi këtu, deputetë të Kuvendit të Kosovës, që këtë çështje ta kemi si prioritet, para se të votohet versioni final, pra në lexim të dytë i këtij Buxheti ka të bëjë me Ligjin për skemat pensionale. LDK-ja, në mandatin e kaluar ka propozuar një amendament në këtë ligj sipas të cilit të gjithë punëtorëve, qoftë të arsimit, qoftë të shëndetësisë, qoftë të tjerët që kanë punuar gjatë viteve të 90-ta, pra të cilët janë pas larguar nga puna, por kanë vazhduar të punojnë dhe të japin kontribut, t'u njihet stazhi i punës apo koha që kanë punuar në mënyrë që kjo t'u llogaritet në kohën kur të jepen pensionet e tyre si kontributdhënës.

Ne e kemi bërë një përpjekje jashtëzakonisht të madhe që ky Buxhet të kalohet mirëpo fatkeqësisht, në fakt që të kalohet ky amendament, por fatkeqësisht në Buxhetin që po o shohim nuk është e qartë në qoftë se është paraparë edhe kjo kategori apo kompensimi i tyre edhe për përvojën e punës gjatë viteve 89/99 pra deri sa ka përfunduar lufta.

Dhe e fundit, meqenëse u përmend lufta, ka të bëjë me Forcat e Armatosura të Republikës së Kosovës. Ne kemi dëgjuar premtime të shumta për shndërrimin e FSK-së në ushtri, mirëpo në qoftë se e shikojmë Ligjin për Buxhetin unë nuk e di ku është kostoja e paraparë në qoftë se i kemi parasysh ato që janë thënë, qoftë për numrin e rritjes së ushtarëve, pra për rekrutim, qoftë për rritjen e municionit, fatkeqësisht kjo nuk reflektohet në Buxhetin e Republikës së Kosovës. Pra, mendoj që është esenciale që kjo të parashihet në Buxhet në qoftë se premtimet për shndërrimin e FSK-së në ushtri e kemi pasur realitet, unë besoj që kolegu deputeti Anton Çuni do të flasë pak më gjerësisht rreth kësaj teme kështu që unë ju falënderoj për vëmendje. Faleminderit!

KRYETARI: E ftoj deputetin Naim Fetahu ta marrë fjalën.

NAIM FETAHU: I nderuar kryetar i Kuvendit, zoti Veseli, Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni të theksoj që Buxheti i hartuar për vitin 2015 është bazuar në prioritetet strategjike qeveritare dhe kornizën makro fiskale trevjeçare si dhe mbi parimet, kriteret dhe formulat e përcaktuara në kuadër ligjor në fuqi.

Në këtë linjë ne dhe ju mund të konfirmojmë faktin sot para vetes se kemi të bëjmë me një Buxhet të hartuar mbi konceptin zhvillimor dhe gjithëpërfshirës, përkatësisht kemi të bëjmë me një Buxhet të mundësive.

Lidhur me strukturën e projektbuxhetit që sot po diskutojmë fillimisht do t'i fokusojmë pritjet për normën e rritjes ekonomike për vitin 2015, me 4.1%, ndërsa mesatarja për tri vitet e ardhshme, me 4.3% të bazuara të bazuara në projeksionet makro ekonomike të konsumit, investimeve dhe eksporteve.

Të hyrat e përgjithshme pa diskutime të ndryshme se thanë nuk do të rriten, këto do të rriten në krahasim me vitin 2014, për 8,1% , ndërsa gjithashtu do të kemi një rritje të shpenzimeve për 6% në raport me vitin 2014.

Lidhur me strukturën e shpenzimeve për vitin 2015 po fokusojmë kategoritë e subvencioneve, transferove, nuk dua të ndalemi gjatë, sepse thanë edhe parafolësit e mi, që rriten prej 314.1 milionë euro sa ishin në vitin 2014, në 437 milionë euro, në 2015, në një rritje prej 39%.

Më gëzon fakti se kjo rritje reflekton në zbatimin e vendimit të Qeverisë për ndarjen e Buxhetit përkatës si 11 milionë euro për të burgosurit politikë dhe ne na mundëson që të vazhdojmë ta zbatojmë Ligjin për të burgosurit politikë. 24 milionë euro për veteranët e luftës, i kemi paraparë në Buxhetin 2015 dhe ne presim që të përfundojë lista e veteranëve për të përfituar nga 24 milionë euro për vitin e ardhshëm.

Kemi një rritje të madhe për subvencionet në sektorët e bujqësisë, përfshirë sektorin e pemëtarisë dhe blegtorisë, nga 11,8 milionë euro sa ishin në 2014, tani kemi 53.6 milionë euro për vitin 2015.

10 milionë euro i kemi të ndara për sigurimet shëndetësore dhe ne jemi të sigurt se Ligji për sigurimet shëndetësore do të zbatohet në vitin 2015, si dhe kemi ndarë mjete për financimin e fondeve të qeverisë në sektorin e arsimit, të shëndetësisë, administratës publike, sigurisë, ambientit e tjera. Në veçanti ky projektbuxhet reflekton kuadrin e rregullores fiskale dhe kufizon deficitin e përgjithshëm buxhetor në 2% të bruto-produktit vendor, të përcaktuar në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi.

Po ashtu projektbuxhetin të cilin po e shqyrtojmë sot, si dokument i zhvillimit të politikave ekonomike të vendit, reflekton në përmirësimin e mirëqenies dhe standardin e jetesës së qytetarëve, andaj të nderuar deputetë duke pasur parasysh vonesat që janë krijuar prej kohësh unë ju ftoj që ta japim kontributin tonë secili dhe të mbështesim projektbuxhetin për vitin 2015. që e kemi përpara. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E ftoj deputeten Besa Gaxherri.

BESA GAXHERRI: Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Qeveria e re e Republikës së Kosovës sot prezantoi ligjin më themelor për vitin 2015 dhe natyrisht që shumë kolegë deputetë debatuan për ligjin aktual i cili na është prezantuar dhe faktikisht ne në fillim votuam për të shmangur procedurën, domethënë nënkupton se ligji duhet të aprovohet me afate të shkurtuara.

Unë më shumë jam e shqetësuar për strukturën e këtij Buxheti se sa për vetë Buxhetin, apo tabelat buxhetore që na u kanë afruar.

Duke pasur parasysh se struktura e të hyrave buxhetore të Buxhetit të Republikës së Kosovës është ende zhgënjyese, kur e dimë se pjesa dërmuese e të hyrave janë nga të hyrat doganore, me disproporcion shumë të lartë të importit karshi eksportit, si dhe të hyrat vendore janë shumë të ulëta karshi të hyrave doganore.

Kjo strukturë, kolegë të nderuar na jap për të kuptuar se ekonomia e Kosovës është shumë e dobët. Ne ende e eksportojmë keshin, paranë jashtë vendit duke importuar gjërat elementare për tregun e Kosovës. Në kuadër të të hyrave të Buxhetit të Republikës së Kosovës më ka tërhequr vëmendjen dividenda e cila në vitin 2014 nuk ka pasur pare, fjala është për disidenten nga PTK, ndërsa në vitin 2015 parashikohet të jetë 30 milionë dividendë e që kolegë të nderuar ne e dimë gjendjen e kësaj kompanie dhe unë dyshoj shumë se këto 30 milionë kjo kompani nuk do të jetë në gjendje për t'i siguruar, si dhe njëkohësisht kjo qeveri konsideroj se duhet të ketë parasysh që këtë kompani ta mbështesë ose të lejojë që vërtet të investojë për t'i kthyer vlerën kësaj kompanie dhe për t'u përgatitur për privatizim.

Të nderuar kolegë deputetë,

Buxheti total i Republikës së Kosovës është vërtet shumë i vogël, është 1 miliard e 576 milionë dhe kjo shumë prapë për mua është problem struktura e shpërndarjes si është planifikuar.

Paga dhe mëditje është 549,1 milionë, subvencione dhe transfere 437,7 milionë, mallra dhe shërbime, 218 milionë, plus 10 milionë janë parashikuar për sigurime shëndetësore në këtë vit, shpenzime kapitale janë vetëm 470,9 milionë euro dhe në kuadër të kësaj shume pra rreth 28% e tërë Buxhetit është investime kapitale dhe kryesisht këto investime janë të projektuara, pra janë projekte të kontraktuara dhe kjo na jap të tregojmë se vërtet për vitin 2015 është shumë vështirë të bëjmë ndonjë investim kapital të ri.

Të gjitha kategoritë e shpenzimeve që janë në Kosovë, pra organizatat buxhetore duhet ta realizojmë gjendjen në të cilën është Republika e Kosovës dhe të reflektojmë se Buxheti i vogël i Kosovës kryesisht shkon në paga, mallra dhe shërbime, dhe kjo është një gjendje e cila duhet të ndryshojë. E si mund të ndryshojë kjo gjendje? Kjo gjendje mund të ndryshojë kur do të ketë cilësi më të lartë në arsim, kur do të ketë cilësi dhe përgjegjësi më të lartë në shëndetësi, kur do të ketë drejtësi dhe shtet ligjor, atëherë do të kemi kushte për zhvillim ekonomik, atëherë dhe vetëm atëherë, me të cilin zhvillim do të ndryshojë struktura buxhetore dhe gjendja aktuale shumë e rëndë në Kosovë.

Duke pasur parasysh situatën e cila na shtyn që Buxhetin pra ta kalojmë me procedurë të shkurtuar, atëherë është gati e pamundur që të bëjmë ndonjë ndryshim esencial. Megjithatë unë mendoj se mund t'i tërheqim diku prej 15, eventualisht deri në 18 milionë euro nga kategoria mallra dhe shërbime dhe t'i orientojmë në investime kapitale ose në shumë kategori të domosdoshme siç është ushtria në të ardhmen që do ta kemi, e shumë kategori tjera.

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Buxheti aktual i Republikës së Kosovës është vërtet i vogël, por shpresa e juaj nuk duhet të jetë e tillë, sepse Kosova ka mundësi reale për zhvillim dhe këtë së bashku do ta bëjmë.

Kosova për herë të parë pas lufte ka për kryeministër një ekspert të ekonomisë i cili do ta garantojë zhvillimin ekonomik, transparencën e shpenzimit e parasë publike, luftë kundër krimit dhe korrupsionit, shtet ligjor, arsim dhe shëndetësi më cilësore.

Qytetarë të nderuar, dhe të duruar të Republikës së Kosovës,
Buxheti i Republikës së Kosovës nuk do të jetë numra për ju, por do të jetë program ekonomik, strategji zhvillimore, do të jetë shpresë dhe mëkëmbje sociale. Ne do të mobilizohemi si gjithmonë në situata të vështira dhe së bashku do t'ia dalim që Kosovën ta bëjmë një vend në të cilin jetohet mirë, qetë e sigurt, së bashku do t'i ndërpresim rrugët jashtë Kosove, të cilat nuk na shpijnë askund.

Unë konsideroj se Qeveria e re e Republikës së Kosovës për mandatin katërvjeçar, ka shumë punë, probleme të shtresuara dhe shpresoj shumë se së paku 50% do t'ia ndryshojmë strukturën e të hyrave dhe shpenzimeve të Buxhetit të Republikës së Kosovës. Faleminderit për vëmendjen!

KRYETARI: Faleminderit! E ftoj deputetin Pal Lekaj ta marrë fjalën.

PAL LEKAJ: I nderuar kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Ministra, kryeministër,
Po e shoh që pasi pak energjie ministrat dhe shumë shpejt do të dorëzohen, sepse tërë kohën kanë munguar dhe mund të them lirshëm se më jep një përshtypje jo të mirë e sidomos qytetarëve kur debatohet për një rëndësi të veçantë për Buxhetin që u dedikohet qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Buxheti i shtetit i hartuar dhe planifikuar nga Qeveria që mbledhet në muzg dhe sot qytetarëve u afron për një vit, një terr. Ky projektbuxhet karakterizohet me mungesë të diskutimeve, transparencës dhe debateve që munguan me grupet e interesit, diskutimet me biznese, por edhe me qytetarët siç është tash tipar i kësaj mazhorance.

Të gjithë qytetarët, pa përjashtim gjatë vitit fiskal 2015 do të paguajnë më shumë dhe do të bëhen më të varfër, do t'i paguajnë pa përjashtim më shumë derivatet e naftës, faturat e energjisë elektrike dhe një sërë mallrash të tjera konsumi. Ky Buxhet, jo vetëm që nuk jep shpresë për rritje ekonomike, siç pretendon Qeveria, por ai i kërcënon qytetarët me rënie ekonomike dhe recesion.

Qeveria planifikon t'i rritë të hyrat buxhetore 7% nga doganat, ndërsa Administratën Tatimore të Kosovës e llogarit me 17% të hyra. Qeveria nuk ka plan për të luftuar evazionin fiskal dhe tregun informal, nuk ka plan për një organizim më të mirë të ATK-së kur dihet se operimi i shitjeve dhe qarkullimit të bizneseve është diku 33% nga tregu informal. Nuk ka plan funksionimi dhe luftimi të kontrabandës së mallrave në pikat kufitare të doganave në veri.

Numri i përgjithshëm i bizneseve që figurojnë të regjistruar në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, është 135 000, prej tyre 98,1% u takon ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Keni pas premtuar subvencionim dhe mbështetje pa kursyer të këtyre ndërmarrjeve, por Qeveria nuk ka krijuar fonde të garantimit të kredive të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Sipas analizave tona, janë mbi 3 300 biznese që kanë falimentuar apo janë në fazën e fundit të falimentimit të tyre, për arsye të humbjes së tregjeve, humbjes së fuqisë konkurruese në treg dhe ambientit të favorshëm afarist.

Projektbuxheti nuk ka fond të garantimit për zhvillim të aktivitetit ekonomik në sektorin privat. Po ashtu, nuk ka program të detajuar për tërheqjen e investorëve të huaj për shkak të situatës politike jostabile dhe ambientit të gjithëmbarshtëm ekonomik i cili nuk është atraktiv për të investuar.

Qeveria është shumë e ngarkuar me staf. Në këtë periudhë të rëndë ekonomike për vendin, numri i madh i ministrave dhe i zëvendësministrave është shumë i panevojshëm në këtë kohë kur qytetari jonë ballafaqohet edhe me gjërat elementare për të jetuar.

Qëndrimi që të mos rriten pagat për 81 921 shërbyes civilë është një mashtrim elektoral e dyshes Mustafa-Thaçi. Ky Buxhet klandestin i hartuar dhe i formuluar nga Qeveria do të ketë një rritje ekonomike siç tha 4,3%, sepse Buxheti nuk është i orientuar kah financimi i zhvillimit ekonomik, dëshmon edhe rënia e investimeve publike diku 28%. Investimet kapitale janë të orientuara në rajone që vijnë qeveritarët. Janë planifikuar investime në ndërtimin e autostradës Prishtinë- Hani i Elezit, që është domosdoshmëri, mirëpo a thua s'ka pasur ndonjë prioritet tjetër. Ndërtimi, zgjerimi dhe rehabilitimi i rrugës magjistrale Prishtinë- Mitrovicë, që ju e dini se sa probleme i kanë pasur qytetarët që e frekuentojnë në drejtim prej Mitrovice në drejtim të Prishtinës dhe është ndarë një buxhet prej 3 milionë e 900 mijë euro.

Dhe, po në këtë projekt planifikohet një huamarrje prej 20 milionë e 100 eurove, ndërsa kur bëhet fjalë për zgjerimin dhe rehabilitimin e rrugës magjistrale EM... Prishtinë-Pejë janë ndarë 5 milionë euro. Kjo magjistrale ka 4 vjet që ka filluar të ndërtohet dhe si po shihet prapë zonat e caktuara po anashkalohen nga dyshja Mustafa - Thaçi. Tash arsyet janë të njohura, ndarja e fondeve për komunat e Republikës së Kosovës në vlerë prej 424 mijë e 164.655 euro është jo e drejtë. Ne e dimë që regjistrimi i popullatës i ka atakuar mjaft me buxhet komunat dhe kur dihet që edhe për rritjen e pagave që e keni bërë pa ndonjë planifikim dhe qëndrueshmëri ekonomike i ka zvogëluar mallrat dhe shërbimet pa ligj të përcaktuar dhe po e them që e keni zvogëluar 15% të mallrave dhe shërbimeve.

Unë mendoj që ky projektbuxhet i anashkalon shumicën e komunave në ndarjen e fondeve në bashkëfinancim. Ministria e Infrastrukturës në kod projektin 0451 projektet me bashkëfinancim për të gjitha komunat, ka planifikuar të ndajë mjete në vlerë prej 7 milionë e 466 mijë e 268 euro, ndërsa në anën tjetër ka bërë ndarje buxhetore për

bashkëfinancim për tri komunat në veri të Mitrovicës, Zveçan dhe Zubin Potok, me vlerë prej 6 milionë euro. A thua nuk është diskriminim për shumicën e komunave të Kosovës. Është mirë që investohet, mirëpo kur parashihen kërkesat e qytetarëve tanë dhe sa kanë bashkëfinancuar, mendoj se këtu keni dështuar.

Ministria e Shëndetësisë ka bërë një ndarje jo të drejtë të fondeve për komuna për të gjitha komunat, projektet me bashkëfinancim në vlerë prej 1 milion eurove. Ky planifikim është i vogël në krahasim me projektet dhe kërkesat për qendrat kryesore të mjekësisë familjare.

Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport, projektet me bashkëfinancim, kodin 0820 ka planifikuar mjete për komuna në vlerë prej 170.000 euro. Çfarë mund të bëhet për të gjitha komunat me këtë shumë, dhe a mendoni që është shumë pak dhe a mendohet që duhet për të ndërhyrë urgjentisht.

Kur kemi parasysh këto shifra dëshmon rënie drastike të investimeve kapitale në komuna. Mund të them, meqë vi nga Gjakova, a ekziston në hartë kund Gjakova? A ekziston Gjakova që është e barabartë për të gjithë qytetarët?

Sot qytetarët e Gjakovës nuk kanë ngrohje, sepse nuk janë subvencionuar po nga kjo qeveri, sot qytetarët e Gjakovës përballen me mbijetesë, kur vetëm po e përmendi, para tri viteve kam dërguar një projekt që kushton 25 milionë euro dhe në këtë drejtim më është premtuar nga ish- kryeministri Thaçi, por gjatë fushatës zoti Mustafa, zoti Thaçi e kanë paraparë Gjakovën që shumë qytetarë nga komunat tjera të vijnë e të punësohen në Gjakovë. Kjo ka qenë një mashttrim elektoral dhe sot askund në projektet buxhetet e Qeverisë së Kosovës nuk shihet asnjë investim kapital. Dhe a thua nuk është një diskriminim për qytetarët e Gjakovës.

Ajo që mund të them, në shekullin 21 kur qytetarët tanë janë të rrezikuar prej qeneve endacakë. E kam vlerësuar shumë lart vizitën e kryeministrit dhe kryetarit të Parlamentit, në familje. Por, a thua në shekullin 21 a nuk kemi përgjegjësi, a nuk ka përgjegjësi Qeveria e Kosovës, që të lenë luksin dhe në këtë drejtim së paku të ndajë një shumë që vërtet kishte me qenë e pranueshme.

Prandaj...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Vazhdoja, të lutem, regjia!

PAL LEKAJ: ... E përfundova, paradën e sukseseve imagjinare mund t'ju them se nuk e ha askush. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E ftoj deputeten Shukrije Bytyçi ta marrë fjalën.

SHUKRIJE BYTYÇI: Përshëndetje të nderuar kolegë deputetë,

Përsëritje qytetarë të Republikës së Kosovës,
Unë i mbështes parafolësit e opozitës me vërejtjet shumë të arsyeshme të tyre, unë do të ndalem pikërisht në fushën e shëndetësisë.

Duke pasur parasysh shifrën e Buxhetit paraprak për shëndetin dhe Buxhetin e projektuar për vitin 2015, mund të konstatohet se Qeveria edhe në këtë mandat nuk e ka prioritet shëndetin e qytetarëve të Republikës së Kosovës.

E gjithë propaganda për parimet në këtë sektor dhe ligjet e aprovuara si dhe premtimet e bëra për aplikimin e obligimeve në sigurimet shëndetësore për vitin 2015, nuk janë projektuar fare në këtë projektbuxhet.

Ndarja e shumave jo transparente në pozicionet si më poshtë: renovim, meremetim, mirëmbajtje spitalore, mirëmbajtje dhe servisim i aparateve mjekësore, pajisje mjekësore, inventar medicinal dhe administrativ, nuk janë kurrkund të cekura shifrat se sa do të kushtojnë këto renovime dhe ku do të bëhen këto renovime.

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Në krahasim me projektbuxhetin e vitit 2014, në këtë projektbuxhet të vitit 2015 mungon plotësisht transparenca mbi ndarjen e mjeteve për spitalet regjionale. Gjithashtu shuma e destinuar për të sëmurë që kanë nevojë të shërohen jashtë ka mbetur e njëjtë 5 milionë euro, në vend që të synohet që këto shërbime të ofrohen në vendin e tyre.

Shuma e ndarë për kompletimin e repartit të kardiokirurgjisë është e ulët dhe e pamjaftueshme që ky repart të funksionalizohet.

Në Buxhet janë ndarë shumë pak mjete për avancimin profesional të mjekëve dhe kuadrove deficitarë.

Shuma për stimulim të performancës është tepër e ulët. Në asnjë projeksion buxhetor nuk është paraparë marrja përsipër e premive për sigurimet shëndetësore nëse ato pritet të jetësohen në këtë mandat.

Mbështetur në këto shifra ky projektbuxhet shëndetësinë kosovare do të vazhdojë ta lërë në shërbime jo cilësore. Kostoja e lartë e shërbimeve në klinikat private do t'i kushtojë Buxhetit të varfër të qytetarit të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, e ftoj deputetin Visar Imeri ta marrë fjalën.

VISAR IMERI: Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
U tha disa herë që ky Buxhet që e kemi përpara është i njëjti me atë të viteve paraprake, mirëpo nuk është i njëjtë vetëm në mënyrën dhe cilësinë e alokimit të mjeteve por para se gjithash është i njëjtë edhe në mashtrimin që bëhet me të hyrat e projektuara në Buxhet.

Të hyrat e parashikuara për vitin 2015 janë mjaft të fryra. Për këtë është e vetëdijshme besoj edhe Qeveria mirëpo fryrja e të hyrave siç ka ndodhur edhe më herët i duhet që në

Ligjin e Buxhetit mos të kalohet deficitin vjetor prej 2 për qind, i cili kërkohet sipas rregullës fiskale të dakorduar me FMN-në. Qëllimi këtu është që në fillim të vitit të paraqitet një buxhet me deficit brenda kufirit 2%, e kur gjatë vitit të hyrat nën-performojnë, Qeveria t'i eliminojë një numër të projekteve infrastrukturore në mënyrë që edhe shpenzimet të jenë në të njëjtën tempo.

Të hyrat nga dogana për 2014 nuk do ta tejkalojnë shifrën prej 850 milionë euro, kurse buxheti ka qenë për atë vit 934 milionë euro, pra deri në fund të tetorit 2014 janë mbledhur vetëm 700 milionë euro, që i bie se për ta arritur projektimin të mbledhen edhe 234 milionë euro brenda këtyre dy muajve.

Nëse merret kjo parasysh, si dhe marrëveshjet e tregtisë së lirë me Turqinë dhe po ashtu me Bashkimin Evropian, për vitin 2015 të hyrat nga dogana pritet të jenë edhe më të ulëta se të vitit 2014, e lëre më të arrijnë shifrën prej 962 milionë eurove, sa janë projektuar në buxhetin 2015. Pra vetëm këtu ka në shpërputhje prej më shumë se 100 milionë euro.

E njëjta gjë vlen edhe për të hyrat e Administratës Tatimore të Kosovës, të cilat do të kishte qenë sukses nëse arrijnë shifrën mbi 300 milionë euro, e jo sa janë buxhetuar këtu në 367 milionë në vitin 2014, e atë më pak me 429 milionë, që janë projektuar të arrihen në vitin 2015.

Sidoqoftë, ka njerëz që e besojnë ekzistencën e Babadimrit, dhe unë këtu nuk po i gjykoj as këta qeveritarë që e kanë sjellë këtë buxhet.

Po ashtu në tabelat e të hyrave, meqenëse jam në këtë temë, janë disa shifra që nuk janë shpjeguar fare. Pra, vetëm janë vendosur aty ku të rrudhen, e nuk dihet nga dhe si do të mbledhen.

Tek taksa koncesionare thuhet se do të mbledhen 10 milionë për vitin 2015, ndërkohë që për vitin 2014 kanë qenë të parapara 5,5 milionë euro dhe pyetja ime këtu është se sa prej këtyre janë para që vinë nga Aeroporti Ndërkombëtarë i Prishtinës, e cila paguhet në formë të taksës koncesionare, meqenëse është i dhënë me koncesion. Dhe a po përfshihet ose a po përfilllet aty marrëveshja që ka qenë për koncesionimin e këtij aeroporti.

Siç dihet, taksa koncesionare për vitin 2014 ka qenë dashtë të jetë edhe për vitin 2015, sipas marrëveshjes 23% e qarkullimit bruto të kësaj kompanie, ndërsa për vitin 2014 supozohet, e këtu do e kisha mirëprisja një përgjigje, janë paguar vetëm 2 milionë euro, pra sipas një takse koncesionare fikse që ka qenë në vitet e para të koncesionimit.

Po ashtu edhe tek tantiemat thuhet se do të mbledhen 22 milionë euro, sa kanë qenë të projektuara edhe për vitin 2014 dhe nuk tregohet se prej nga, pra sa po paguan "Ferronikeli", sa po paguan të tjerat, sa po paguajnë gurorët e kështu me radhë të gjitha këto që i shfrytëzojnë resurset minerare të Kosovës dhe për të cilat kurrë nuk raportohet se a paguajnë dhe nëse paguajnë sa dhe me çfarë metode.

Një temë qendrore gjatë këtyre ditëve, veçanërisht kur ka filluar të flitet për buxhetin, ka qenë rritja e pagave për sektorin publik, nëse do të ketë rritje apo jo të pagave, si dhe kërcënimet me greva që vijnë nga sindikatat.

Deri tash rritja e pagave, edhe pse e proklamuar me pompozitet nga Hashim Thaçi dhe PDK-ja, ka qenë mjet për blerjen e votave, mjet ky që i ka lënë jashtë punëtorët e sektorit privat, por të cilëve ua ka shtrenjtuar çmimet përmes rritjes së pagave të sektorit publik, duke rritur kështu njëkohësisht edhe inflacionin.

Kjo nuk është se ka ndikuar në mirëqenien e qytetarëve, sepse rritja nominale nuk është përkthyer asnjëherë në rritje reale. Në vend se rritja ta mundte inflacionin, inflacioni e hante rritjen. Por për qëllime elektorale këtë gjë shpeshherë e përdorte edhe Lidhja Demokratike e Kosovës.

Në mars të këtij viti ministri i tashëm i Financave kishte deklaruar se për ta arritur realisht rritjen prej 30% të cilën e proklamonte atë botë Thaçi, rritja nominale duhet të jetë 43% në sektorin publik. Në të njëjtin deklaram zoti Avdullah Hoti kishte thënë që “Rritja duhet të jetë, këtu po citoj: rritja duhet të jetë e rregullt, në baza vjetore, në përputhje me rritjen e çmimeve dhe me rritjen e buxhetit të shtetit”. Meqenëse në këtë buxhet nuk ka rritje të pagave, a do të thotë kjo që Qeveria po thotë që nuk do të ketë as rritje të çmimeve, e nuk ka as rritje të buxhetit? Sepse rritje të çmimeve realisht ka.

Energjia elektrike është shtrenjtuar vetëm këtë viti me dy shtrejtme që i ka pasur për mbi 12%, krahasuar me periudhën e parë të vitit, por edhe buxheti është rritur siç po proklamohet edhe këtu.

Tash ministri mund të na thotë se rritja e pagave, edhe pse është premtuar, nuk ka qenë fare e buxhetuar nga qeveria paraprake, e cila e ka përpiluar këtë buxhet, dhe për të cilin u pranua dhe u tha disa herë që qeveria e re nuk e ka prekur fare. Po pra - kjo e tregon se sa të njëjtë jeni, se premtoni njëjtë, njëjtë nuk realizoni dhe njëjtë mashtroni.

Çështja tjetër që lidhet me këtë është edhe Kontrata kolektive. Në këtë buxhet nuk është projektuar fare kostoja e kësaj kontrate edhe pse ajo është e nënshkruar nga kryeministri i kaluar. Ndërkohë që në deklaramet publike kryeministri aktual Isa Mustafa e vlerëson autostradën për Shkup të shtrenjtë dhe të vështirë për ta përballuar, por po citoj: thotë se është fakt që kontrata është nënshkruar” rrjedhimisht duhet t’i përmbahemi asaj apo jo. Po ç’janë këto standarde të dyfishta pastaj. Kur kemi të bëjmë me Bechtel-in nënshkrimi i kontratës është i shenjtë, e kur kemi të bëjmë me punëtorët e Kosovës, nënshkrimi na qenka i pavlefshëm.

Kur jemi te autostrada për këtë vit janë buxhetuar 90 milionë euro, sa janë buxhetuar edhe për vitin e ardhshëm, për të përfunduar, në këtë projektim që e kemi përpara, me 108 milionë euro për vitin 2017. Kjo dallon nga projektimet e bëra në buxhetin e vitit të kaluar kur për vitin 2014 ishin buxhetuar 85 milionë euro, për të vazhduar me dy vitet pasrëndëse me 100 milionë euro. A jeni në dijeni se kur do të përfundojë kjo autostradë, sepse me këto projekte mund të zgjasë më shumë se 6 vjet, ndërkohë që është thënë se

do të përfundojë për 4 vjet. Apo do t'ia leni edhe këtë vendim, sikur secilin tjetër që ja keni lënë për infrastrukturë Bechtel-it.

Në secilin sondazh, raport, a deklaram që i vë në pah kërkesat e qytetarëve, nevojat e tyre, del se problem kryesor në këtë vend është papunësia, qytetarët kanë nevojë për vend pune e për mirëqenie, ndërkohë që qeveria u jep asfalt dhe atë shumë të shtrenjtë.

E si mund të ketë vende pune kur Bechtel-it i ndahen 1 miliard e 500 milionë euro deri tash, pra 834 + 600 që janë në kontratën e re, e “Trepçës” për këtë vit i ndahen vetëm 1 milion e 700 euro.

Si mund të ketë vende pune, kur nuk investohet fare në rritjen e prodhimit vendor dhe kur nuk investohet fare në produktin vendorë Pra, si mund të ketë vende pune kur bujqësia lihet anash, kur industrializimi asnjëherë nuk zë prioritet, në ndërkohë që të gjitha paratë shkojnë ose në xhepat e ministrave përmes rrogave, ose prapë në xhepat e ministrave dhe kryeministrave, përmes tenderëve të shtrenjtë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ftoj deputeten Njomza Emini, të marr fjalën.

NJOMZA EMINI: I nderuar kryetar i Kuvendit, Veseli,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Dhe kolegë deputetë,

Dhe po ashtu qytetarë të nderuar,

Pasi që pata mundësinë edhe unë si deputete që ta analizoj buxhetin 2015, pata rastin të vërej ngritje të shumës totale në raport me vitin e kaluar, ku ka ngritje të shpenzimeve që është mbi rritjen reale ekonomike. E kjo mund të jetë të hyrave, vije nga rritja e performansës së institucioneve që mbledhin të hyrat në kuptim të luftimit, të ekonomisë informate dhe uljes së evazionit fiskal.

Megjithatë unë më tepër do të ndalem te fjalja ime dhe jam fokusuar tek analiza e buxhetit për sektorin e mirëqenies sociale ku kam vërejtur për këtë sektor se kemi rritje mbi 100 milionë euro.

Vlerësimi im i parë ka qenë shumë impresionues në kuptimin e faktit se skemat sociale dhe pensionale do të kenë përfitime më të mëdha, mirëpo gjatë shqyrtimit kam konstatuar se skemat sociale ekzistuese nuk do të kenë rritje, ndërsa skemat pensionale ekzistuese do të përfitojnë edhe në vitin në vijim vetëm rritje 25% në raport me vitet e kaluara që ka filluar së implementuari gjatë vitit 2014.

Përfituesit më të mëdhenj të kësaj rritje do të jenë veteranët e luftës dhe kategoria tjetër ish- të burgosurit politikë.

Më 24 milionë euro shtesë në buxhet për këtë kategori dhe për ish- të burgosurit politikë që do të përfitojnë 6 milionë euro prej buxhetit.

Rekomandimi im do të ishte për ministrin e Punës dhe Mirëqenien Sociale dhe për Qeverinë po ashtu që të marrin veprime konkrete që t'i rishikojnë listat e përfituesve të ndihmave shtetërore që janë ndihma sociale dhe pensionet me qëllim që këto lista të pastrohen dhe t'u japin ndihma atyre që e meritojnë që të kenë ndihma shtetërore nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Faleminderit për vëmendjen.

KRYETARI: E ftoj deputetin Zafir Berisha të marrë fjalën.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar gjysmë Kabineti qeveritar,

Dhe fillimisht do të shpreh shqetësimin rreth prezencës së Qeverisë dhe kjo është treguese sa janë serioz, përpos shumë gjëra që keni të përbashkët edhe vazhdimësinë e mosprezencës në Parlament e keni të përbashkët dhe një gjë është mu vlerësua veç prezenca e ministrit Kuçi që ka qenë i rregullt.

Sido që të jetë unë do të orientohej pak te buxheti. Është një e vërtetë që edhe kryeministri edhe ministri i Financave nuk e ka bërë këtë buxhet dhe për atë nuk dinë ta prezantojnë edhe ta mbrojnë, por sido që të jetë, unë mund të konstatoj se ky buxhet është buxhet shpenzues.

Ky buxhet, përpos që do t'i shtojë pak kilogramët e qeveritarëve dhe zyrtarëve kurrfarë të mire nuk do të shohin qytetarët e Kosovës nga ky buxhet dhe unë do të tejkaloj pak bacën Jakup, kur tha “koalicion elefantësh” ose Lutën e Gjilanit, me simbolika, sepse sigurisht ka pasur parasysh forcën ose fuqinë e këtij koalicioni. Unë po mendoj se është “koalicion dinozaurësh” për shkak se edhe buxheti është paraparë asisoj për t'u shpenzuar.

Faktikisht pozicionet buxhetore, vijat buxhetore të nivelit qendror dhe lokal janë e njëjta shkollë e cila po mendoj se prioritetet e Qeverisë aktuale kanë mbetur me prioritetet e vitit 2008 ku një pjesë e madhe e buxhetit është e koncentruar në asfalt dhe kupëza. Faktikisht 28% e buxhetit është e destinuar për infrastrukturë dhe në këtë përqindje kur të marrim parasysh se 89% e kësaj përqindje domethënë është pagimi i punimeve që kanë filluar një vit më herët dhe faktikisht shumë pak u ka mbetur për të bashkëbiseduar, po e them për 11% të punimeve në infrastrukturë që do të hapen këtë vit.

Këtë metodë për fat të keq e kanë përcjell edhe komunat dhe unë do të ndalem te komuna e Prizrenit, ku 16 milionë e 500 mijë euro investime kapitale, domethënë 10 milionë është në infrastrukturë. Kjo është një tregues se institucionet si të pushtetit qendror ashtu edhe lokal s'e kanë idenë se çfarë nevojë ka sot Kosova.

Faktikisht një komunë siç është Prizreni me parapa 10 miliona asfalt dhe kupëza dhe 500 mijë euro vetëm për bujqësi një sektor shumë i rëndësishëm dhe i domosdoshëm nuk do koment rreth asaj se ku kjo qeverisje do ta çojë vendin.

Prandaj, ne përpos që do të votojmë kundër, ne shprehim edhe shqetësimin e qytetarëve se faktikisht nuk dua t'ju jap të drejtë por me një farë forme kjo Qeveri e ka sjell situatën

asisoj që premtimet e kryeministrit Mustafa, 150 mijë vende të punë dhe mvarësi i tij Hahim Thaçi, 200 mijë vende të punës do të qëndrojnë në emigrantë politikë a ekonomikë në Evropë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E ftoj deputeten Shqipe Pantina për fjalë.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit!

Kryeministri Mustafa dhe ministri Hoti në kohën sa kanë qenë kryetarë, respektivisht nënkryetarë të Komunës së Prishtinës, vazhdimisht janë ankuar për padrejtësinë që i behej komunës së Prishtinës më rastin e ndarjes së buxhetit, gjegjësisht grandit qeveritar për komuna.

Jo vetëm që pas ardhjes së tyre në qeveri kjo padrejtësi nuk u korrigjua, por përkundrazi ajo u thellua edhe më tepër.

Dhe nuk është fare e nevojshme të jesh ekonomist apo ekspert buxheti për të vërejtur padrejtësitë. Për shembull, nëse të marrim linjën buxhetore për paga dhe mëditje, përderisa shumica e komunave ndajnë mbi 50% të buxhetit të tyre për paga dhe mëditje, e disa prej tyre siç është Artana shkon deri në 84% apo 92,6% për Parteshin, Prishtinës i lejohet që vetëm 40% të buxhetit të saj ta shpenzojë për paga dhe mëditje, edhe pse numri i banorëve të cilëve u ofrohen shërbime në Prishtinë është deri 15 herë më i madh sesa komunat e lartpërmendura.

Kjo padrejtësi prek drejtpërdrejt edhe punëtorët e sektorit publik të Komunës së Prishtinës. Nëse e përpjesëtojmë shumën e alokuar për paga dhe mëditje me numrin e punëtorëve në secilën komunë, i bie që paga mesatare për një punëtor në komunën e Drenasit të jetë 472 euro, ose në Fushë Kosovë 479 euro, apo në komunën e Junikut 525 euro.

Ndërsa në Komunën e Prishtinës mesatarja e pagës i bie të jetë 384 euro, apo 140 euro më pak se punëtori i sektorit publik në Komunën e Junikut, përkundër faktit se vëllimi i punëve për shembull një inspektor komunal apo zyrtar tjetër është shumëfish më i madh në Prishtinë sesa në Junik. E kur kemi parasysh koston e jetesës, pabarazia veç sa thellohet. Për shembull në Prishtinë qiraja për një apartament me 2 dhoma është nga 250 deri në 300 euro, dhe atë në periferi të qytetit, përderisa në Junik jam e sigurt se çmimi është dyfish më i lirë. Ngjashëm është edhe çmimi për metër katror për blerjen e banesave.

Duhet të korrigjohet patjetër padrejtësia që i bëhet Komunës së Prishtinës me rastin e ndarjes së buxhetit. Dhe arsyetimi se ky buxhet është përgatitur nga dikush tjetër nuk qëndron, sepse për mua ky buxhet është prezantuar nga ministri Avdullah Hoti, e që është ministër i Qeverisë Mustafa.

Kur jemi të buxheti i komunave, t'ju them të drejtën ka qenë e vështirë edhe për ta lexuar këtë buxhet për të parë se si janë orientuar fondet e në veçanti investimet kapitale.

Pjesa më e madhe e investimeve kapitale pothuajse në të gjitha komunat është e përqendruar kryesisht në infrastrukturë siç është ndërtimi apo meremetimi i rrugëve, e nganjëherë edhe ndërtimi i shkollave, por mënyra e planifikimit dhe ndarjes nëpër zëra buxhetor është një rrëmujë e vërtetë dhe e bën të pamundur analizën buxhetore.

Kështu në disa komuna investimet në asfaltim të rrugëve, kanalizime apo të ngjashme i kanë nën sektorin e infrastrukturës, dhe besoj se kjo është në rregull, por disa komuna ndërtimin e rrugëve si për shembull komunat e Skenderajt e ka alokuar nën dikasterin e planifikimit urban dhe mjedisor ose në Kaçanik, ndërtimi i rrugëve është nën kategorinë e buxhetit për zyrë të kryetarit.

Kjo tregon jo vetëm mungesë kapaciteti nga këto komuna për planifikim siç duhet të buxhetit, por edhe dështim të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal që nuk ka ndihmuar në ngritjen e kapaciteteve të këtyre komunave.

Pabarazi në investime kapitale në mes të komunave shihet edhe në shpërndarjen e investimeve të bëra nga ministritë. Për shembull për vitin 2015, Ministria e Arsimit ka paraparë meremetimin apo ndërtimin e 5 shkollave në komunën e Drenasit, por asnjë në komunën fqinje të Kastriotit. Kjo bëhet dhe më e paqartë pasi që mungon programi qeveritar e që është e vështirë të kuptohet logjika prapa kësaj ndarje se pse në disa komuna investohet me shumë e në disa prej tyre pothuajse fare.

Por, një elementi tejet flagrant i këtij buxheti është ai për Radiotelevizionin e Kosovës.

Buxheti i ndarë për RTK pa përfshirë këtu edhe të hyrat që ata krijojnë nga reklamat, është 9 milionë e 768 mijë e 500 euro më i madh se buxheti i Kuvendit të Kosovës. Por edhe më keq në asnjë nga këto tabela nuk shpjegohet se çfarë do të bëhet me këto mjete. Sa janë punonjës të RTK-së për vitin 2015, sa nga ky buxhet që është afër 10 milionë do të ndahet për paga, sa për mallra e shërbime, sa për projekte kapitale apo të ngjashme.

Institucioni i cili do duhej të informonte publikun për mënyrën se si shpenzohet paraja publike, dhe të rriste transparencën për mënyrën e menaxhimit të tyre, një gjë të tillë nuk e kanë bërë as për vete. Ky institucion si edhe institucionet tjera të pavarura që financohen nga buxheti i shtetit, është i obliguar që çdo vit të paraqesë në Kuvend raportin për punën e tyre përfshirë këtu edhe raportin financiar për mënyrën e shpenzimit të fondeve publike, e si mund të vlerësojmë këtë raport financiar dhe mënyrën si janë shpenzuar këto fonde, ku ne paraprakisht nuk e dimë se si janë planifikuar ato.

Prandaj, deputetë të nderuar,

Unë ju ftoj që mos ta miratoni buxhetin për RTK pa sjell një formë të detajuar të planifikimit, siç kanë bërë agjencitë tjera buxhetore. Edhe ashtu ky institucion nuk ka mbrojtur interesin publik duke qenë çdoherë në funksion të vetëm një grupi të caktuar interesi dhe duke u bërë çerdhe e punësimit për familjarët dhe militantët e këtij grupi interesi të cilët mirëmbajtura nga buxheti i madh i ndarë për të nga buxheti i vogël i Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E ftoj deputetin Daut Haradinaj.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryetar!

Kryeministër, Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Unë e kam ndarë fjalën time në dy pjesë, në pjesën e parë për Forcat e Armatosura të Republikës së Kosovës si domosdoshmëri e kohës dhe kemi thënë që viti 2015 do të jetë vit i Ushtrisë së Kosovës dhe këtë aq më tepër kur dihet qartë se mekanizma të rëndësishëm ndërkombëtarë i kanë dhënë mbështetje siç është NATO dhe SHBA. Por pyetja është shumë e thjeshtë, më vjen keq që ministri ishte më herët, nuk është tash këtu a po i përgjigjet Qeveria e Kosovës konkretisht Ministra e Forcës së Sigurisë me buxhet dhe detyrimisht përgjigja është shumë e thjeshtë: jo. Si ka mundësi një rritje e kapaciteteve të mbrojtjes pa u rritur buxhet për atë segment aq të rëndësishëm.

Buxheti i propozuar i garanton FSK-së vetëm një segment dhe kësaj mund t'i themi me një fjalë popullore: “bëj bukë e ha bukë”, rritje tjetër jo. Kapacitetet të reja operationale jo. Prandaj del në pah neglizhimi i Qeverisë së Kosovës karshi kësaj teme jashtëzakonisht të rëndësishme.

Brenda këtij buxheti nuk mund të shohim as lexojmë edhe një reshtë të vetëm për themelimin e njësive të reja të domosdoshme që i kanë ushtritë e rregullta. Riorganizimi dhe themelimi i Forcave të Armatosura detyrimisht kërkon buxhet shtesë. E kemi thënë dhe e përsërisim që do të jemi të gatshëm si subjekt politik kurdo që e sjellin në Kuvendin e Kosovës ndryshimet ose amendamentimet kushtetuese për themelimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Kosovës.

Të njëjtën kohë nuk do të heshtim, por do të jemi shumë kritik sa herë që Qeveria e Kosovës e neglizhon këtë segment të domosdoshëm.

Pretendimet jo të sakta për rritje të buxhetit na tregojnë shumë qartë tabelat buxhetore. Në vitin 2014 shpenzimet e përgjithshme për FSK-në ishin jo më shumë se 2,65% e buxhetit të përgjithshëm, ndërsa në projektbuxhetin për vitin 2015 shpenzimet e planifikuara për FSK-në nuk janë më shumë se 2,69% e buxhetit të përgjithshëm. Pra rezulton një rritje vërtet shumë e vogël ose mund të themi 0,05% e totalit.

Pak më tepër, por jo pak e rëndësishme në vitin 2014 buxheti për Ministrinë e FSK-së ishte 42 milionë euro, prej të cilave për paga dhe mëditje ishin 16.5 milionë euro, mallra dhe shërbime, 9.3 milionë euro, investime kapitale 15,4 milionë euro dhe shpenzime komunale diku rreth 800 mijë euro.

Në projektbuxhetin për vitin 2015 nga 45,2 milionë të planifikuara për Ministrinë e Forcës së Sigurisë, shpenzimet për paga dhe mëditje do të rriten në 21,9 milionë, për mallra dhe shërbime 8,9 milionë, shpenzime kapitale 13,6 si dhe shpenzimet njëjtë 800 mijë euro.

Nëse e bëjmë një krahasim shumë të thjeshtë rezulton se pretendimet për rritje buxhetore për FSK-në janë deri diku mashtruese. Krejt çka shohim është lojë numra, duke zvogëluar buxhetin për investime kapitale dhe mallra e shërbime për rreth 2 milionë euro dhe rritje të buxhetit për paga.

Në fakt ka rritje të pagave, por kjo rritje e pagave ka filluar të zbatuari në pranverën e këtij viti, do të thotë nuk do të ketë rritje të pagave për oficerë dhe ushtarë për vitin 2015.

Krejt çka mund të thuami mbi këtë projektbuxhet, Ministria e Forcës së Sigurisë nuk e ka të garantuar transformimin në Forca të Armatosura të Republikës së Kosovës për vitin e ardhshëm.

Ne edhe një herë e themi, do të jemi të gatshëm si Komision që t'i riamendamentojmë dhe jemi të gatshëm për bashkëpunim nga kolegët.

Ndërsa, për Ministrinë e Punëve të Brendshme, po filloj sipas tabelës buxhetore ku fillimisht bëhet fjalë për azilkërkuesit.

Për azilkërkuesit është paraparë tash e sa vite ndërtimi i një qendre për të huaj siç është quajtur që nga viti 2013 për çdo vit janë ndarë nga 350 mijë euro, shumë kjo e cila është bartur nga viti 2013, në vitin 2014, nga viti 2014, në vitin 2015 parashihet po ashtu edhe ndërtimi i kësaj qendre. A thua pse mund të ndodhë kjo? E dini shumë mirë ministër që kjo është kusht edhe liberalizimin e vizave, do të thotë duhet marrë shumë seriozisht.

Hiq më mirë nuk është gjendja edhe për Policinë e Kosovës, sikurse e thash edhe për FSK-në. Po jap një shpjegim të nevojshëm.

Po filloj nga Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave. Dëshiroj ta them publikisht se ky mekanizëm ka bartur nga viti në vit fondin prej 280 mijë euro për ndërtimin e objektit të punës për këtë agjenci. Kjo i bie që vazhdimisht kemi fonde të ndara, por jo edhe ndërtimin e objekteve të domosdoshme. Ne kur kemi parasysh shërbimet emergjente, punonjësit e këtij shërbimi punojnë në kushte tepër të vështira, për çdo ditë i shohim publikisht paralajmërimet për greva dhe protesta, kemi fjalën për zjarrfikës, të cilët çdo ditë rrezikojnë jetën e tyre për t'ju dal në ndihmë qytetarëve të Kosovës.

Zjarrfikësit e Kosovës në kushte të mjerueshme duke ju munguar edhe kushtet më elementare, ndërsa qeveritarët rritin luksin.

Duhet të themi edhe njëherë haptazi aq më tepër kur keni dëgjuar fjalë se paralajmërimi i tyre për protesta është në derë, duhet t'i marrim jashtëzakonisht seriozisht dhe t'ju krijojmë kushtet. Ata do t'i sigurojmë publikisht edhe si opozitë, por edhe si deputetë që do t'i përkrahim si zë i fuqishëm në këtë Kuvend.

Të nderuar deputetë,

Sot ka një numër prej 9013 të punësuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ky mekanizëm është mekanizmi kryesor i ruajtjes së vendit dhe ligjit në Kosovës, si i tillë në

parashikimet buxhetore të vitit 2015 shihet haptazi se nuk është prioritet i kësaj Qeverie bazuar në këtë projektbuxhet ligj, përveç rritjes së pagave që edhe ashtu ka filluar thash edhe për ushtarët në pranverë të këtij viti nuk do të ketë ndonjë rritje të veçantë të këtij buxheti.

Në total buxhet për Ministrinë e Punëve të Brendshme të këtij viti që po vjen duket këtui: Në vitin 2014, në vitin 2015 të punësuar gjithsej në këtë ministri me staf civil, punonjës dhe policë janë 10275 persona.

Ndryshimi në paga dhe mëditje është 14,4 milionë, për mallra dhe shërbime ju keni zvogëluar buxhetin për mbi 4 milionë euro, në shpenzime komunale po ashtu. Po ashtu keni zvogëluar buxhetin për 280 mijë euro në subvencione dhe transfere e shumë të tjera, ndërsa shpenzimet kapitale po ashtu i keni zvogëluar për një milion e 10 mijë euro.

Kjo i bie që për vitin e ardhshëm Ministria e Punëve të Brendshme do të ketë buxhet prej 116 milionë e 122 mijë euro, një përqindje e buxhetit që i bie 6,74% e totalit, flas për vitin e kaluar, ndërsa këtë vit 6,9.

Rritja në total për vitin 2015 të nderuar deputetë do të jetë vetëm 0,17% e totalit. Kur e shikojmë në përgjithësi këtë tabelë buxhetore kemi rritjen rreth 6 milionë, ndërsa zvogëlimin në mallra dhe shërbime po ashtu një shumë të njëjtë për rreth 6 milionë. Marrë në përgjithësi për dikasteret e policisë për vitin që vjen nuk kemi lajme të mira, kjo i bie që trendet negative të cilat janë të paqëlluara në të gjitha raportet ndërkombëtare për Kosovën do të vazhdojnë edhe vitin e ardhshëm.

Ky buxhet nuk garanton rritjen e luftës kundër krimit, por përkundrazi pamundëson forcat e rendit për ta luftuar krimin.

Tek policia kufitare, rritja e buxhetit do të jetë vetëm 150 mijë euro, dhe krejt kjo për avancimin e sistemit 'bienes'. Pra, Ministria e Punëve të Brendshme nuk ka paraparë fonde për fuqizimin e kapaciteteve të kësaj njësie jashtëzakonisht të rëndësishme, për shembull kjo njësi në vitin e ardhshëm nuk do t'i ketë objektet e domosdoshme për ta kryer detyrën.

Qëndrimet politike dhe publike të Qeverisë se ne kemi shtrirë sovranitetin në gjithë territorin e Kosovës, nuk është asgjë tjetër vetëm se një mashtrim publik.

Pra, siç nuk kemi as edhe një cent të vetëm për ndërtimin e postës 1 dhe 31 në veri të Kosovës. Duke qenë dëshmitarë që Kosova kritikohet vazhdimisht ashpër nga Komisioni Evropian dhe Departamenti Amerikan i shtetit për mungesën e kontrollit kufitar, është për t'u shqetësuar se ky buxhet nuk siguron asgjë tjetër përveç kufij të pakontrolluar.

Pra, edhe një herë e theksoj se shpenzimet joracionale të kësaj Ministrie si për shembull 624 mijë euro qira vjetore duke përjashtuar policinë dhe agjencitë tjera s'është asgjë tjetër vetëm një injorim dhe mashtrim i radhës.

Deputetë, kolegë të nderuar,

Avancimi i teknologjisë sidomos i asaj në sektorin e hetuesisë dhe forenzikës është i përhershëm.

Ky projektbuxhet parasheh shpenzime buxhetore të mëdha për analiza dhe mostra në laboratore të jashtme, ndërsa nuk parasheh asnjë cent investime në krijimin e kapaciteteve në Kosovë.

Policia e Kosovës me .. në përgjithësi në punën që i bën i ekspozohet rrezikut permanent, asnjëherë në asnjë Qeveri, përfshirë edhe kjo e sotit nuk kanë paraparë mjete buxhetore për sigurimin e policëve nga rreziqet jetësore.

Të gjithë jemi dëshmitarë se kemi pasur raste të shumta në Kosovë ku dëmtimit të policëve deri në humbje jete, por asnjëherë nuk ka ekzistuar vullneti politik për t'ju dal në ndihmë këtyre rasteve. Kemi raste kur policët e Kosovës ndajnë mjetet e tyre personale për t'i ndihmuar kolegët e tyre.

Duke mos dashur të zgjatemi më shumë vota, sot për këtë projektbuxhet do të shkojë kundër, me arsyen se do të jemi të gatshëm si Komision për riamendamentimit e këtij projektbuxheti. Ju lus që të jemi bashkëpunues dhe ta bëjmë punën ashtu siç na ka hije. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Demaku e ka fjalën.

PUHIJE DEMAKU: Të nderuar qytetarë,

Të nderuar deputetë,

Përgjatë viteve të kaluara, Lëvizja "Vetëvendosje" në vazhdimësi ka shprehur shqetësimin e saj lidhur me mënyrën se si është formuluar, përfytyruar, buxhetuar dhe realizuar politika e jashtme e Republikës së Kosovës.

Vizioni ose mungesa e tij shpërfaqen pikë së pari në dokumentet siç janë objektivat, qëllimet, strategjitë dhe zbatimi apo moszbatimi i tyre. Përkushtimi ndaj këtij vizioni, në çdo institucion normal, konfirmohet përmes buxhetimit. Dhe vendosmëria ndaj vizionit matet vetëm me realizim dhe zbatim.

Për fat të keq, në Kosovë, dokumentet që do duhej të dëshmonin vizionin datojnë nga viti 2008 kur edhe është themeluar Ministria e Punëve të Jashtme. Rëndësia që i është dhënë politikës së jashtme në paraqitje publike, intervista e deklarime të udhëheqësve të shtetit as edhe një herë të vetme nuk është shoqëruar me dokumentet, strategjitë e as edhe buxhetin e nevojshëm. Kështu, që nga themelimi i Ministrisë e deri më sot, është folur për rëndësinë e njohjeve, për partneritetin bilateral e multilateral, për anëtarësimin e Kosovës në organizata rajonale e multilaterale, për mbrojtjen e interesave politike e ekonomike, për imazhin e vendit, për mbrojtjen dhe tërheqjen e investitorëve të huaj, për promovimin e kulturës, e shumë e shumë synime të rëndësishme të lartë por, as edhe një

herë të vetme ky përkushtim verbal nuk është manifestuar në linjat buxhetore e aq më pak në punë.

Buxheti i Ministrisë së Punëve të Jashtme, si një nga resorët më të rëndësishëm të Qeverisë së Kosovës, nuk reflekton as kreativitet dhe as vizion. Përkundrazi, buxheti e reflekton një spektër tepër të kufizuar të buxhetimit që lidhet më së shumti me veturat, renovimeve në ambasada dhe pajisjeve teknologjike e sigurisht që lë shumë për të dëshiruar.

Nga ana tjetër kemi plot dëshmi se sa më i mjegullt të jetë përshkrimi i zërave buxhetor aq më i favorshëm do të jetë implementimi. Në implementim të tij, Ministria e Punëve të Jashtme ka treguar “shkathtësi të mbrapshta” siç i evidenton edhe raporti i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Afro 800 000 euro mbeten shpenzim i paregjistruar dhe paaprovuar. Ka mungesë të inventarizimit të pasurisë nga misionet diplomatike. Përveç kësaj, Zyra e Auditorit dëshmon veprimet ad hoc të Ministrisë së Punëve të Jashtme duke thënë se në të shumtën e rasteve pjesa më e madhe e buxhetit shpenzohet në muajt e fundit të vitit.

Njëherazi Zyra e Auditorit ka dëshmuar në raportin e vitit 2014 se kjo Ministri nuk është aspak e përgjegjshme në raport me vërejtjet dhe përgjegjësinë që e kërkon kjo zyrë nga Ministria e Punëve të Jashtme. Auditori thekson se vetëm 4 nga 19 rekomandimet e bëra në raportin e vitit 2013 janë marr parasysh.

Ministria e Punëve të Jashtme duke qenë bartëse e disa proceseve tepër të rëndësishme për Republikën, do të duhej të demonstronte një përkushtim kundrejt qëllimit parësor: mbrojtjen e interesave të vendit dhe të qytetarëve të Republikës.

Kosovën gjatë mandatit të ardhshëm e presin sfida të shumta në politikën e jashtme, por për fat të keq asnjë nga këto sfida nuk është përkthyer në mbështetje buxhetore, pra ka ngjarë ekzaktësisht e kundërta i tërë buxheti është hartuar në atë frymë që ai do t’u krijojë kushte më të mira ministrit, zëvendësministrave, militantëve, por nuk paraqet mundësi për rezultate pozitive për pozitën e shtetit dhe avancimin e subjektivitetit të Republikës.

Që ta kenë parasysh qytetarët vetëm Zyra e ministrit të Jashtëm do t’i kushtojë Kosovës me pagesat e mëditjet për 10 persona staf dhe shpenzime për mallra e shërbime plot 720 mijë euro për vitin 2015.

Siç veni re qytetarë të nderuar kjo është Ministria e shëtitjeve dhe e mëditjeve. Nga kjo ministri përveç që i presim në marrëdhëniet e mbrapshta do të thotë dëmet e mëdha që do t’i bëhen Kosovës, do të shohim edhe normalizimin e luksit të zyrtarëve të saj.

Edhe unë gjithashtu si kolegët e mi do të jem për votë kundër këtij buxheti. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Kryeministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Zonja dhe zotërinj,

Buxheti i shtetit të një vendi i cili ka pretendime të qarta për t'u zhvilluar dhe për të avancuar zhvillimin ekonomik dhe shoqëror është një nder aktet më të rëndësishme politike në vitin kalendarik të ligjeve që miraton edhe Kuvendi i Republikës. Çdo buxhet do duhej që të reflektonte mbi politikat zhvillimore të një vendi, e në këtë rast si ky apo edhe si ai i vitit që po lemë pas.

Projektligji për buxhetin të cilin po e shqyrtojmë sot edhe pse me vonese në trajtim nga Qeveria e re, por i cili ishte kundërshtuar fuqishëm nga shumë subjekte politike në kohën e aprovimit në vjeshtën e sivjetme që nënkupton edhe nga ministri i Financave, por kuptohet nga një pozicion tjetër, tani ka ardhur para nesh i miratuar në Qeveri pa ndryshime esenciale apo përmbajtjesore, me mungese programore mbi bazën e të cilës do të kishim projeksione të qarta për një zhvillim ekonomik të vendit tonë.

Andaj domosdoshmërisht kërkon vëmendjen tonë si deputet dhe Kuvend duke analizuar me kujdes prioritetet dhe jo prioritetet, për të përmirësuar aty ku mund të përmirësohet, për të parandaluar ndarjet e pa drejta buxhetore si dhe për të parandaluar shpërndarjen selektive të projekteve kapitale.

Shpresa e qytetareve për ndryshime pritet në ligjin më të rëndësishëm vjetor siç është buxheti i Republikës së Kosovës, me pritjen se zhvillimi ekonomik do jetë prioritet e jo inflacioni, se do të ulen shpenzimet e luksit qeveritar e jo të rriten, se shpëlarja e parave do të parandalohet e jo të vazhdohet, me një fjale ky buxhet do përkufizohet si buxhet shpenzues, konsumues për luksin qeveritar i pa perspektivë dhe i pa shpresë për një jetë më të mirë të qytetarëve, buxhet i cili vazhdon ta sjellë ekonominë e Kosovës si në kohërat e kaluara duke e kthyer atë në formën natyrore të këmbimit mall me mall, sepse bizneset e shumta të cilat nuk do të jenë të lidhura me para politikën qeveritare apo ato që nuk do ta kenë fatin e futjes nën logjikën e kësaj tutele, nuk do të kenë mjete për afarizëm të domosdoshëm e kështu do të rritet papunësia e më të edhe varfëria në Kosovë. Pyetja e ngritur se pse ky buxhet nuk mund të quhet zhvillimor e tregon edhe zvogëlimi i shpenzimeve kapitale për 11% dhe me rënien e investimeve kapitale kemi ndikim të drejtpërdrejtë në uljen e punësimit e atë sidomos tek sektori privat.

Për vite me radhe Lidhja Demokratike e Kosovës ka kritikuar këtë qasje të qeverisë së kaluar, sidomos ajo që ka qenë në fokus të investimeve kapitale siç është infrastruktura rrugore, duke kritikuar tenderomaninë, shpronësimet klienteliste të familjarëve të politikaneve të PDK-se, lokaliste, dhe me një disbalance të madhe në ndarjen e granteve për komunat, ku edhe sot me këtë projektbuxhet është e njëjta qasje, pa dashur të bëj ndarje regjionale, por esenca e njëjtë në shpërndarje ku mungojnë në mase të madhe investimet në zonat e Dukagjinit, Anamoravës dhe Podujevës, domethënë vazhdim i politikave të njëjta në investimet kapitale.

Të nderuar kolegë deputet,

Kjo tregon dobësi për zotimet e marra se do këtë ndryshim të politikave zhvillimore nga ato të qeverise së kaluar e cilësuar si jozhvillimore dhe me afëra të mëdha korruptive. Kjo tregon pajtimin me të kaluarën e keqe, mos kërkimin e llogaridhënies, vazhdimin e keqpërdorimit të taksave publike, lënien jashtë investimeve të sektorëve më të domosdoshëm për zhvillimin ekonomik, mos përkrahjen e sektorëve ku luftohet krimi dhe korrupsioni, kjo nënkupton tendencën për mos zbatim të asnjë pike të premtuar para qytetareve të vendit se besimi në institucione do të rritet, se luksi qeveritar do të zvogëlohet, se dikasteret qeveritarë do të shkurtohen sipas nevojave të kohës dhe planit buxhetor, se institucionet e arsimit dhe shkencës do të financohen në bazë të prioriteteve e jo në bazë të politikave ditore, se bujqësia dhe zhvillimi rural do jenë prioritet, se imigrimi i paligjshëm do të parandalohet, se rinia këtu do këtë perspektivë, se kultura dhe sporti nuk do varet nga donacionet dhe interesimi i të huajve, se shëndetësia do të përmirësohet e jo të korruptohet, të gjitha këto me këtë projektbuxhet janë të zbehura, nuk japin shpresë për përmirësim sepse është e njëjta logjike, e njëjta ndarje buxhetore, e njëjta mosgatishmëri sikurse e Qeverise se kaluar.

Lidhja Demokratike e Kosovës dhe deputetët e saj kishin kritikuar rritjen e pagave në premtimet elektorale, sepse kjo nuk ishte rritje konform rritjes ekonomike, sepse një rritje e tillë e pagave pa rritje ekonomike nuk përmirësoj jetën e qytetarëve të vendit por shkaktoj vetëm inflacion ekonomik, andaj edhe lenia e patates së nxehtë për rritje të pagave në vitin në vazhdimësi kishte të njëjtin qëllim vetëm e vetëm atë elektoral.

Neve si deputetë e saj kishin kritikuar po ashtu kostot e mëdha të autostradave, sepse neve kishim premtuar investime me prioritet në shkollë, spitale, furnizimin me ujë i cili mungon në shumë fshatra të Kosovës, trajtimin e mbeturinave dhe ujërave të zeza, bujqësinë dhe sektorë tjerë të cilët janë kurcial për zhvillim ekonomik. Asnjëra nga këto nuk tregohen serioze në këtë projekt buxhet për vitin 2015.

Si mund të kemi stabilitet financiar ku me këtë buxhet ku nuk krijohen kushte që nëpërmjet ngritjes së infrastrukturës dhe kapaciteteve të organeve të sigurisë , të luftohet informaliteti financiar, shpëlarja e parave si dhe luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit?

Në këtë projektbuxhet mungon përkrahja serioze për sektorin e drejtësisë, në të cilat bëjnë pjesë Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Prokurori i Shtetit, Gjykata Kushtetuese, Instituti Gjyqësor i Kosovës dhe Komisioni për Ndihmë Juridike Falas, e sipas këtij projekti, janë të planifikuara me pake se 2% të buxhetit të përgjithshëm.

Gjyqësia e fortë, gjyqësia efikase, gjyqësia e pavarur është shtyllë e ndërtimit të demokracisë së mirëfilltë dhe njëkohësisht është forcë pozitive për zhvillimin ekonomik dhe social, duke e përfshirë edhe rritjen e besimit të investitorëve të huaj. Nga kjo që na është paraqitur duket që fare nuk është marre parasysh gjendja në të cilën ndodhet drejtësia kosovare, fare nuk është marre parasysh që gjykatat janë të stërngarkuara me lëndë, zgjedhja e lëndëve të caktuara stërzgjatet me vite të tëra, fare nuk është marre imazhi i keq gjyqësisë kosovare, fare nuk është marre parasysh se qytetari ynë e ka humbur jo vetëm besimin në drejtësinë kosovare, por edhe shpresën se Kosova do të

bëhet një vend ku sundon rendi dhe ligji, pra mendoj se Qeveria nuk dëshiron të investojë më shumë në këtë sektor, sepse siç duket nuk ka vullnet për të prishur interesat e Qeverise se kaluar për të ndikuar në përmirësimin e jetesës dhe sigurisë, si fizike ashtu edhe juridike të qytetarit tonë.

Të nderuar kolege deputetë,

Neve mendoj se duhet që në mese dy leximeve të paraqesim amendamente për të cilat disa do të zotohem personalisht dhe me të cilat pretendoj se do të përmirësoj se paku disa pika të caktuara që kane të bëje me shpërndarjen buxhetore, orientimet e qarta në përkrahje të dikastereve që merren me sundimin e rendit dhe ligjit, dhe në atë me kryesore për të ruajtur paranë publike shkurtimet e investimeve nga milionat e luksit qeveritar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Paçaku.

KUJTIM PAÇAKU: I nderuar kryesues,

Të nderuar pjesëtarë të Kabinet qeveritar,

Të nderuara deputete,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar shikues,

Të nderuar media,

Komiteti romë është i ndërtuar në dy aspekte filozofik, aspekti i parë filozofik është që ne së pari duhet të jemi pastaj të kemi, ndërsa aspekti i dytë filozofik i popullit romë në Kosovë, regjion edhe më gjerë ka të bëjë me integrim por pa diskriminim.

Në të dy aspektet sipas buxhetit populli rom është diskriminuar. Populli romë bënë pjesë në grupin ekstrem të 11% ku nuk kanë gjërat elementare për mbijetesë. Buxheti nuk ka asnjë kahe ku u drejtohet enkas komuniteteve pakicë, romë shkali ose egjiptian apo shqiptarëve të tjerë të cilët vuajnë dhe janë afër...

Komuniteti romë nuk është i përfshirë për rimëkëmbjen e tyre të varfërisë së skajshme, andaj mendoj që përmes amendamenteve ky komunitet duhet të rimëkëmbët.

Rasti i javës së kaluar tregoi që rrahën kambanat në Kosovë dhe bënë alarm kur fëmija romë 7-vjeçar nga Fushë Kosova duke kafshuar bukën e tij në kontejner të Fushë Kosovës e humbi jetën.

Unë nga këtu nga kjo foltore falënderoj kryeministrin që ishte në shtëpi të kësaj familje dhe shprehu ngushëllimi po ashtu edhe ministra tjerë dhe shefin e grupit tonë parlamentar të cilët vizituan këtë komunitet, por kambanat nuk do të pushojnë sepse ky komunitet dhe ky shembull mund të ripërsëritet prapë.

Dy ditë më vonë qenët endacak sulmuan edhe dy nxënës të komunitet shqiptar në qendër të Prishtinës. Unë mendoj se përmes buxhetit duhet të jepet kahe këtij shembulli negativ ku jo vetëm romët dhe qytetarët e Kosovës shprehen indinjatë dhe ngushëllime për këtë

shprehen edhe dy eurodeputetë romë tanë të cilët i kemi në Këshillin e Evropës edhe romët edhe banorët tjerë nga regjioni dhe nga Evropa.

Andaj, mendoj se këto grupe ekstreme që sipas Bankës Botërore tregojnë 11% të varfërisë së skajshme së paku të mos paguajnë rrymën elektrike, pjesëtarët e komunitetit romë të mos paguajnë tatimet në ekonominë e vogël dhe është liruar nga benificionet, përkatësisht nga taksat administrative. Nuk është respektuar aspak buxheti për t'iu dedikuar 10-përqindëshit, i cili garanton punësim për romët. Në 15 vjetët e fundit, 0,01% të komunitetit rom, ashkalinj ose egjiptian janë të punësuar në institucionet vendimmarrëse, e kjo është shumë e pamjaftueshme. Nuk i kemi personat aty ku merren vendimet dhe ku njoftohemi për situatën e punësimit të komunitetit rom. Buxheti duhet të kërkojë më tepër avancimin e komuniteteve pakicë, gjë që edhe buxhetet e viteve të kaluara nuk kanë qenë aspak optimiste. Ne si grup do ta votojmë këtë buxhet, por besoj fuqishëm se me amendamentet të cilat do të vijnë sadopak do ta përmirësojmë jetën e këtyre qytetarëve të prej vitit në vit po diskriminohen. Faleminderit! Ove nisaste!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Shqip Muja.

SHAIPI MUJA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Ç'është e drejta, unë nuk desha të filloj të shpjegoj për Buxhetin, sepse kjo është një formë e teatrit në formën e prezantimit që i bëhet, ose përkrahjes ose kundërshtimi, që i bëhet. Ky Buxhet është shumë i zgjeruar, që në një ose në dy seanca, por mendoj që ministrat duhet të jenë më të qartë për të arriturat e tanishme dhe ku po duam të shkojmë me këtë Buxhet.

Unë shkova vetëm në disa pika, për shembull, ku shihet përshtetja vetëm nga linjat buxhetore të viteve të kaluara pa ndonjë arsyeshmëri. Shihet se duke filluar nga rriqrat e Malishevës, që janë 90 mijë euro në këtë vit, 90 mijë euro vitin e kaluar, e ne do të kemi prapë ethe hemorragjike, do të kemi prapë rriqra, do të thotë nuk është bazuar në një plan, i cili do t'i ofrohet statistikisht mungesës apo çrrënjësjes së etheve hemorragjike.

Në linjat e Ministrisë së Bujqësisë, për shembull, flitet për pyllëzimin, e kjo tregon se bëjmë vetëm politikë reaktive, e nuk bëjmë politikë financiare preventive, sepse ne më shumë dëmtohem në vit nga djegiet dhe dëmtimi i pyjeve, se sa 450 000 euro që të bëhet pyllëzimi në tërë Kosovën. Edhe ministrat, edhe Qeveria, e këtë problem e kam shtruar edhe në mandatin e kaluar këtë problem, meqë ka shumë produkte nga pastrimi, i cili do të sanojë ose do të prevenojë ndaljen e zjarreve nëpër pyje, dhe do të jetë produkt dhe një fushë e punësimit sezonal të punonjësve në këtë sektor. Do të thotë, që vetëm ndërmjet pastrimit të pyjeve, Republika e Kosovës mund të kalojë me mijëra të punësuar sezonalë për t'i pastruar ato dhe nga ato produkte të kalojë në prodhimin final të briketit, apo të produkteve të ngrohjes.

Provokimi më i madh që m'u duk këtu nga disa përkrahës të këtij Buxheti, kolegë të mi, të partisë sime, por edhe të partive tjera, për çështjen e sigurimeve shëndetësore, me keqardhje them, se dua të jem i vërtetë, por sigurime shëndetësore nuk do të ketë as në

vitin 2015. Nuk është mirë t'u themi qytetarëve dhe punonjësve shëndetësorë që sigurimet shëndetësore do të bëhen në vitin 2015.

Ish-ministri na i ka promovuar sigurimet shëndetësore në vitin 2013 një herë, mandej në vitin 2014, për të filluar në janar të vitit 2015. Prandaj, është johumane, jonjerëzore, por është edhe një kurth për ministrin që vjen tash që ky ta marrë këtë karamele edhe t'u thotë njerëzve që sigurimet shëndetësore do të bëhen. Po nuk u bënë këtë vit, do të bëhen. Sigurimet shëndetësore, në bazë të projeksioneve këtu që i pashë unë, e që e di mirë, deri në vitin 2018 nuk do të jenë funksionale. Prandaj, ne nuk kemi nevojë, e duhet të tregojmë pse po çalojmë kaq shumë gjatë për t'i bërë sigurimet shëndetësore. Mungesa e sistemit të informimit shëndetësor është çelësi i zgjedhjes të të gjitha problemeve në shëndetësi, qoftë në atë private, qoftë në atë publike.

E, dikush nuk është i interesuar që t'i japë një shpejtësi të madhe zgjidhjes së këtyre problemeve. Aq më tepër asnjë ministër i Shëndetësisë deri më tani nuk ka për çfarë të lavdërohet me ndonjë sektor shëndetësor. Për shembull, themi që Kardiokirurgjia përmendet mbi 12 vjet këtu në Parlament, në qytet e në rrugë, e ne prapë kemi sistem të kardiokirurgjisë që po funksionon nëpër privat, por nuk po mund të funksionojë në atë shtetërore. Këtu ka diçka, ose ka një plan, i cili nuk është i interesuar që të funksionojë në sistemin publik dhe ka ndonjë interes, për të cilin unë dua të jem i gabuar, për ata të cilët rrinë për mosfunksionalizimin e kësaj.

Për këto kisha pasur dëshirë që nga ministrat aktualë ne të njoftohemi këtu. Ose Onkologjia. Ne nuk puthemi ta përfundojmë me shkallën maksimale të një kualiteti t'i ofrohem 100% Evropës, por me nja 70% a 80% mund t'i ofrohem me këto shërbime sektoriale. Mandej e shoh në Buxhet në shëndetësi parashihen shumë ndërtime. Unë kam thënë shpeshherë se këta janë menaxherë të krizave të tullave, sepse ata që nuk dinë të bëjnë sistem dhe qëndrueshmëri në sistem, atëherë tërheqin vëmendje vetëm të bëjnë objekt. Por, objekti duhet funksionalizuar, duhet adaptuar sistemit për të garantuar qëndrueshmëri, e kjo nuk garanton.

Edhe sistemi emergjent, unë e shoh edhe hipotetikusht, edhe ai keqpërdoret, edhe duke mos ditur se si të dizajnohet. Problemet tjera qesharake në këtë buxhet, të cilin ne do ta votojmë, sepse nuk kemi kah të shkojmë, se edhe ministrat janë të befasuar siç tha një parafolës i imi këtu, nuk kanë pasur kohë sa ta zbërthejnë dhe ta studiojnë dhe të tregojnë, që edhe disa ministra po ma miratojnë me kokë, e është e vërtetë kjo, është në fushën energjetike. Është shumë qesharake. Është qesharake, sepse për shembull 50 000 euro thuhet do të shpërndahen në edukimin për eficiencë elektrike, duke filluar prej një katundari që është në fshat. E di që nëse e bën shtëpinë e izoluar mirë, kjo është eficiencë, e deri te pjesa akademike, që e dinë edhe strukturën e ndërtimit.

Por, çka po bën shteti që në këtë eficiencë t'i stimulojë, qoftë fabrikat, qoftë prodhimtarinë, qoftë shtëpitë, si po i stimulon që në kreditë, të cilat po merren nëpër sistemin e bankave, në mënyrë indirekte të përfitohet në energjetikë? Edhe shteti të përfitojë, por edhe qytetari të përfitojë. Ka shumë gjëra, të cilat ne i kemi për t'i biseduar këtu, por megjithatë thamë që me përshpejtim e kemi bërë.

Ky buxhet duhet të kalojë dhe unë do ta votoj. Këtu ka shumë vërejtje për të cilat sigurisht në planifikimet buxhetore tjera, ose në rishikimet e mundshme, apo në amendamentimet e mundshme, mund të ndërhyhet në disa fusha, të cilat garantojnë edhe zhvillim ekonomik, edhe shpresë të zhvillimit dhe të qëndrueshmërisë në mendjen e qytetarëve dhe në stabilitetin e tyre, edhe psikologjik, edhe për ta dashur Kosovën, edhe për të jetuar, por jo për t'i parë duke ikur. Prandaj, do ta votojmë dhe ju falënderoj.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kurteshi e ke fjalën.

ISMAIL KURTESHI: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, Unë jam fokusuar më tepër në Buxhetin e arsimit për vitin 2015, se sa është i rëndësishëm Buxheti i arsimit, se nuk është vetëm për arsimin, por ai ndikon në të gjitha sferat e jetës, këtë më së miri e ilustron një përgjigje e ish-kryeministrit britanik Tony Blair në pyetjen se cilat janë tri prioritetet e tij të para. Përgjigjja e tij ka qenë se prioriteti i tij i parë, i dytë dhe i tretë është arsimi.

Se si e ka trajtuar kjo Qeveri arsimin, për këtë më së miri flet Buxheti të cilin ne sot e kemi para vetit. Në Buxhetin për vitin 2015 janë paraparë vetëm 3% të Buxhetit të përgjithshëm për arsim, e që është vërtetë jashtëzakonisht pak për ta nxjerrë atë nga kjo gjendje në të cilën është, bile-bile edhe për ta mbajtur në këtë gjendje në të cilën është. Dhe, nëse e krahasojmë këtë Buxhet të vitit 2015 me atë të vitit 2014, ky është për 10% më i vogël, që do të thotë se kjo Qeveri është edhe më e papërgjegjshme se Qeveria e kaluar në raport me arsimin. Për të qenë e keqja edhe më e madhe, edhe nga ata 46 milionë euro të ndarë, ndarja nuk është aspak e drejtë.

Është brengosës fakti se Buxheti në rastet kur ndikohet në rritjen e cilësisë në arsim dhe në përmirësimin e kushteve të punës është shumë i vogël. Për shembull, për teknologjinë informative në arsimin parauniversitar, Ministria e Arsimit ka paraparë vetëm 150 000 euro, kurse në anën tjetër vetëm për zyrën e ministrit të Arsimit janë planifikuar mbi 200 000 euro. Merre me mend çfarë absurdi është ky!

Për pajisje laboratorike dhe inventar janë planifikuar 2 478 112 euro. Por, është interesante sesi këto dy lloj pajisjesh, që dallojnë shumë nga njëra-tjetra, pajisjet laboratorike që rrallëkund i hasim në shkollat tona, edhe pse janë shumë të rëndësishme për ngritjen profesionale të nxënësve dhe inventari, që po ashtu është i domosdoshëm, por është i një natyre krejt tjetër, janë futur në një vend dhe nuk dihet se sa nga këto mjete do të shkojnë për laborator e sa për banka e karrige. Por, pavarësisht se si do të ndahen këto mjete, janë të pamjaftueshme për t'i përmbushur nevojat e arsimit parauniversitar, goftë me laboratorë, goftë me inventar.

Prezantimi i Buxhetit duke i bashkuar komponentët e ndryshëm dhe përgjithësimet e shumta mundësojnë manipulimin e tij dhe nuk mund të shpjegohet ndryshe ky lloj bashkimi i këtyre komponentëve.

Edhe 374 000 eurot e planifikuara për trajnimet profesionale në të gjitha qendrat të mëdha të Kosovës janë të pamjaftueshme për t'i trajnuar rreth 20 mijë mësimdhënës, që janë të angazhuar në procesin mësimor në Kosovë.

Mjetet e planifikuara për ndërtimin e shkollave, sallave sportive nëpër shkolla, fushave të sportit, laboratorëve, kabineteve dhe punëtorive për shkollat e mesme profesionale janë shumë të vogla, kur kihet parasysh se ende kemi shkolla ku mësimi zhvillohet në tri ndërrime, kurse numri i nxënësve nëpër klasë është mbi numrin e lejuar. E sallat e sportit, laboratorët e kabinetet mungojnë në shumë shkolla të vendit tonë. Edhe mjetet e parapara për fëmijët me nevoja të veçanta janë jashtëzakonisht të vogla për këtë kategori të veçantë të shoqërisë sonë.

Kur jemi te arsimi, Kabineti qeveritar duhet ta ketë parasysh se si rezultat i kufizimit të numrit të mësimdhënësve, që shpesh është në shpërputhje me nevojat reale të shkollave tona, shumë mësimdhënës të punësuar kanë mbetur jashtë listave të pagave. Pra, nuk paguhet, edhe pse janë duke punuar, dhe Qeveria duhet shpejt ta zgjidhë këtë çështje nëpërmjet këtij Buxheti, që besoj se do të korrigjohet.

Duke e pasur parasysh se investimi në arsim është parakusht për avancimin e një shoqërie a shteti, është investim në gjeneratat e reja, është investim në zhvillimin ekonomik të vendit tonë, ne kërkojmë që të zvogëlohen shpenzimet në luks dhe rriten investimet në arsim, sepse kështu do të mundësohet zhvillimi normal i procesit mësimor, i cili garanton arsimim cilësor të gjeneratave të reja.

Qeveria e re me Buxhetin e planifikuar për kulturë, rini dhe sport ka dëshmuar se këto fusha të rëndësishme janë marginalizuar skajshmërisht dhe e kanë të vështirë t'i kryejnë edhe funksionet e tyre elementare.

Gjatë 7-8 vjetëve të fundit, shumë mjete janë shpenzuar në ndërtimin e rrugëve të reja, në zgjerimin e atyre ekzistueseve, në modernizimin e tyre, por nga planifikimet për këtë fushë të infrastrukturës është përjashtuar Anamorava, e cila nuk ka përfituar asnjë lloj buxheti për t'u lidhur më mirë me pjesën qendrore të vendit, edhe pse në atë pjesë të Kosovës jetojnë mbi 15% e qytetarëve të Kosovës. Dhe, në fund, bazuar në krejt atë që e kemi parë në këtë projektbuxhet, del se këtë Buxhet e karakterizon rrudhja e tij në fushat vitale të zhvillimit të shtetit, siç janë arsimi, investimet kapitale dhe të tjera, dhe zemërgjerësia e tij e pakufishme në shpenzimet në luks dhe në mirëqenie të qeveritarëve dhe të njerëzve rreth tyre. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Muharremaj e ka fjalën

BALI MUHARREMAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë të Parlamentit të Kosovës,

Desha të ju njoftoj se Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës i ka përgatitur dy amendamente: amendamenti 1 - zbatimi i Kontratës Kolektive, e cila duhet të hyjë në fuqi më 1 janar të vitit 2015, dhe amendamenti 2 - rritja e pagave për 25%. Kërkoj nga të gjitha grupet parlamentare që të na ndihmojnë që t'i aprovojmë këto dy amendamente.

Nuk ka asnjë dilemë që Buxheti i Republikës të Kosovës si një akt ligjor paraqet bazën më të rëndësishme legale dhe kushtetuese për financimin e mbarëvajtjes së gjithë sistemit shtetëror të vendit. Megjithatë, sipas vlerësimit tim, ky projektbuxhet që na është ofruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës nuk është projektbuxhet që garanton zhvillim ekonomik, që ofron mirëqenie dhe zbutje të papunësisë, që ua kthen dinjitetin dhe shpresën e humbur qytetarëve të vendit, por thjesht është një buxhet që një pjesë të madhe të tij do të shpenzojë për pagat dhe mëditjet e zyrtarëve dhe shërbyesve civilë, të cilët jo rrallë krijojnë vende të punës mbi bazat e përkatësisë partiake dhe kuptohet të partive politike që janë në pushtet.

Nëse e analizojmë mënyrën e shpërndarjes së Buxhetit nga Qeveria, vërehet fare qartë se një pjesë e madhe e parave tona edhe më tutje dhe vazhdon të shkojë në asfalt, kurse pjesa më e vogël në arsim, bujqësi, shëndetësi, e kështu me radhë.

Meqë unë vij nga rajoni i Prizrenit, duhet të ndalem pak në të dhënat tabelare të projektbuxhetit për investimet kapitale për komunat që janë parashikuar të realizohen në këtë pjesë të Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Edhe pse ky rajon ka rreth 500 mijë banorë, apo mbi 30% e gjithë popullatës së Kosovës, kjo Qeveri ka parashikuar që për vitin 2015 ta mbështesë projektin në vlerë prej 31 milionë euro. Në qoftë se e pjesëtojmë për numër të banorëve, diku për kokë të banorit i bie 63 euro. Po ashtu, nëse shikohet Buxheti kapital në nivel qendror, në nivel të investimeve kapitale, shihet se shumica prej tyre janë projekte në vazhdimësi nga vitet e kaluara, e vetëm 38 milionë janë projekte të reja në nivel të Kosovës, që për kokë banori i bie diku 21 euro.

Të nderuar deputetë,

Unë e kam një vërejtje konkrete për mungesën e investimeve kapitale për vitin 2015, edhe për komunën prej nga vij unë, pra Therandë. Zoti ministri i Financave, nuk e di sa jeni në dijeni, por në komunën e Therandës ende ka shkolla me kushte shumë të vështira, të cilat janë ndërtuar në periudhën pas luftës, ose pas Luftës së Dytë Botërore, diku në vitin 1948, dhe aty punohet në kushte mizorie dhe me dy ndërrime. Gjithashtu, në këtë projektbuxhet nuk është paraparë ndërtimi i arteries së rrugës shumë të rëndësishme që lidhë autostradën “Ibrahim Rugova” me bjeshkët e Sharit, përkatësisht me qendrën e turizmit “Brezovica”. Ndërtimi i rrugës Therandë-Shtërpçë do të ndikonte në rritjen dhe zhvillimin e turizmit, në krijimin e vendeve të reja të punës, në shkurtimin e kohës së udhëtimit, si dhe do të nxiste iniciativa dhe biznese private për investimet në turizmin malor të kësaj ane.

Projektbuxheti i vitit 2015 po ashtu nuk ka parashikuar asnjë investim në zonat industriale të rajonit të Prizrenit, nevojën për shtim të investimeve në infrastrukturë të këtyre zonave, si në Prizren, Therandë e Rahovec. Ato janë kruciale për krijimin e kushteve më të favorshme për zhvillimin ekonomik dhe për nxitje të ndërmarrësit në rajonin e Prizrenit.

Zona industriale në Therandë, e cila ka hapësirë prej 168 hektarëve, është funksionale dhe aty ushtrojnë aktivitete biznesore disa kompani vendore, megjithatë ende ka nevojë të shumta për investime në infrastrukturën e kësaj zone, kurse në Prizren dhe Rahovec, edhe pse Komuna ka bërë ndarjen e hapësirave për këto zona, megjithatë deri më tani nuk ka investime dhe si të tilla ato nuk janë fare funksionale.

Të nderuar deputetë,

Besoj që të gjithë e dimë se ndër vatrat më të rëndësishme kulturore në Kosovë është edhe qyteti i Therandës, por kemi mungesë të një shtëpie të kulturës, e cila ende pas 15 vjetësh nuk ekziston në komunën e Therandës. Në këtë projektbuxhet nuk është përfshirë asnjë mbështetje financiare për përfundimin e ndërtimit të shtëpisë së pleqve në komunën e Therandës, megjithëse deri më tani në ndërtimin e këtij objekti nga Komuna janë shpenzuar rreth 490 000 euro. Mospërfundimi do t'i dëmtonte rëndë edhe investimet e gjertanishme të bëra në këtë objekt. Kërkoj nga ministri dhe Komisioni Funkcional që projektet që i përmenda të përfshihen në projektbuxhetin për vitin 2015, me qëllim të përmirësimit të jetës së qytetarëve të të gjithë rajonit të Prizrenit.

Krejt në fund, dua të konkludoj që, për fat të keq, edhe ky projektbuxhet mund të emërohet si Buxhet i mbijetesës, i cili vazhdon të jetë buxhet shpenzues, pa perspektivë dhe pa elemente zhvillimore dhe që nuk ndihmon për shpresën për një jetë më të mirë të qytetarëve të Republikës të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Shala e ka fjalën.

HAXHI SHALA: Zoti kryesues,

Përsëritet Kabinet qeveritar,

Përsëritet kolegë deputetë,

Qeveria e Republikës së Kosovës me këtë Buxhet po e legalizon ngritjen e pagave prej 25% për vitin 2014, e cila ka qenë ilegale, sepse pa miratimin e Kuvendit të Kosovës dhe FMN-së Qeveria e kaluar i ka ngritur pagat për shkak të zgjedhjeve të 8 qershorit, duke menduar se me rishikim do ta mbulojë këtë ngritje, e rishikim nuk ka pasur, por me mbulimin e minuseve të të gjitha organizatave buxhetore të Kosovës, me vendim të Qeverisë i ka marrë 15% nga kategoritë ekonomike e mallrave dhe e shërbimeve, si dhe nga shërbimet komunale, prandaj edhe e quajmë ilegale ngritjen e pagave të vitit 2014.

Buxheti për vitin 2015 lë shumë për të dëshiruar, edhe pse parashihet të ketë një ngritje të tij në total, ku prapë vazhdojnë të jenë të hyrat kryesore të buxhetit nga tatimet dhe Doganat, ku ende vazhdon trendi i rritjes së importit nga jashtë për vitin 2015, i cili ndikon negativisht në rritjen e bruto-produktit, ndërsa me një eksport shumë të ulët, si pasojë e politikave fiskale jo të mira, e siç po shihet nuk do të kemi shpresë për ndryshimin e këtyre politikave me këtë përbërje të Qeverisë.

Rritja ekonomike me këtë Buxhet parashihet të rritet në 4,3% prej vitit 2015-2017, ku baza për ngritjen ekonomike kjo Qeveri llogaritet nga të hyrat nga diaspora apo remitanca, e shumë pak nga eksporti, e mendoj se ky trend duhet të ndryshohet me rritjen e eksportit, duke investuar në bujqësi, prodhimtari e tjera, gjë që do të ndikojë edhe në

uljen e papunësisë. Mirëpo, me këtë ngritje të planifikuar prej 4,3% të zhvillimit ekonomik, importi i mallrave pritet të jetë... në këtë imazh, kësaj ngritjeje ekonomike me 2,5%. Si mund të themi se do të kemi ngritje ekonomike, kur nga ky projektbuxhet shihet se 72% e Buxhetit të Kosovës do të shkojë për paga dhe mëditje, investimet kapitale do të kenë rënie nga 33%, sa ishin për vitin 2014, në 28% për vitin 2015, e që këto investime kapitale priten të shkojnë në rrugë, objekte arsimore, kulturore, shëndetësore e tjera, investime të cilat nuk ndikojnë në ngritjen e zhvillimit ekonomik.

Po ashtu, dua të themi se me këtë projektbuxhet për vitin 2015 është bërë diskriminimi dhe shpërndarja e projekteve nëpër regjione dhe komuna. Në komunën nga vij, ajo e Malishevës, përveç buxhetit komunal, nuk është përfshirë asnjë projekt nga asnjë ministër, e konsideroj se edhe ata banorë të komunës së Malishevës ia paguajnë tatimet këtij shteti dhe duhet të kenë hise në ndarjen proporcionale të Buxhetit sikur banorët e komunave tjera. Si ka mundësi që në vitin 2013, Qeveria e kaluar ka ndarë mjete për ndërtimin e çerdhes për fëmijë, që nuk ka pasur deri me tani, ndërsa nuk është lejuar ngritja e stafit të kësaj komune për ta funksionalizuar këtë çerdhe, e cila është ndërtuar, edhe pse kjo është kërkuar edhe me shkresë disa herë nga Ministria e Financave dhe ajo e Arsimit. Andaj kërkoj që të lejohen mjetet për stafin e nevojshëm për këtë çerdhe, si dhe të ndahen mjete edhe për projektet e Komunës së Malishevës sikur në komunat tjera.

I nderuar kryeministër,

Qeveria në largim, ose Qeveria Thaçi, vitin e kaluar nuk ka ndarë asnjë projekt për Komunën e Malishevës. Për këtë arsye, ajo Qeveri i ka humbur së paku 9 000 vota në komunën e Malishevës. Kërkoj nga ju që ta keni parasysh dhe të ndani mjete të barabarta si për komunat tjera. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Besim Beqaj nuk është këtu, më duket. Anton Quni e ka fjalën.

ANTON QUNI: Faleminderit, zoti kryesues!

Zoti kryeministër,

Ministra,

Të nderuar deputetë,

Vlera e parasë në sektorin e sigurisë do të thotë që shërbimet e ofruara nga ofruesit kryesorë të sigurisë i meritojnë paratë që taksapaguesit paguajnë për to. Ajo siguron që këto shërbime janë në përputhje me nevojat dhe prioritetet e taksapaguesve për siguri. Nga studimi i Buxhetit për vitin 2015, me theks të veçantë në fushën e sigurisë, duhet të arrihet deri te konkludimi nga këto tri çështje me radhë: a i kanë marrë burimet e nevojshme institucionet e sigurisë për ta kryer aktivitetin me koston më të ulët; a do të arrihen aktivitetet e institucioneve të sigurisë me rezultate maksimale nga burimet e dhëna dhe a do t'i realizojnë institucionet e sigurisë objektivat e deklaruara në politika brenda Buxhetit të alokuar.

Unë nuk do ta marr guximin që t'i parashoh konkludimet, pasi faktori kohë nuk e mundëson këtë. Por, sipas praktikave të mira, Buxheti në fazën e miratimit do të duhej të zgjasë për tre muaj duke u trajtuar edhe nga komisionet e specializuara, siç janë në rastin

tonë ai i mbikëqyrjes së sigurisë dhe inteligjencës. Sidoqoftë, shpresoj se institucionet dhe agjencitë e sigurisë, të zbatimit të ligjit, menaxhimit të kufijve, Doganat, shërbimet korrektuese, Shërbimi Inteligjencës, Emergjenca Civile, Këshilli i Sigurisë Kombëtare e tjera do të disponojnë me mjetet e mjaftueshme për mirëmbajtjen, zhvillimin, format dhe ngritjen e kapaciteteve të nevojshme.

Zoti kryeministër, besoj që me Kabinetin juaj, para se të sillni Projektligjin e Buxhetit me variantin final, ta keni në konsideratë vlerësimin e mjedisit strategjik dhe të sigurt të shtetit, kërcënimet e mundshme të sigurisë, me të cilat përballet shoqëria në periudhat afatshkurtra dhe afatmesme, reformat dhe transformimet e institucioneve të sigurisë në aspektin e kostos. Neve mund të na presin situatat të cilat mund ta rrezikojnë shëndetin, cilësinë dhe jetën e qytetarëve, pasurinë e tyre, vitalitetin e institucioneve të Republikës së Kosovës dhe Kosovën si tërësi me të gjitha vlerat e sajë.

Prandaj, është mirë që, përveç debateve në Parlament, ndër të tjera, të nxiten diskutime publike që kontribuojnë për vlerësimin e nevojave dhe prioriteteve të qytetarëve në lidhje me sigurinë. Vota ime është pro miratimit të Projektligjit për Buxhetin 2015, me shpresë që vërejtjet dhe këshillat do të merren në konsideratë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Besa Baftiu.

BESA BAFTIU: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar dhe shumë të respektuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Në projektbuxhetin e planifikuar për vitin 2015 vërehet se shëndeti dhe mirëqenia e qytetarit nuk janë prioritet i kësaj qeverisjeje, ashtu siç nuk ka qenë prioritet edhe e qeverisjes së kaluar. Buxheti i planifikuar për sektorin e shëndetësisë pothuajse është i njëjtë me atë të vitit të kaluar. Derisa në vitin 2014 në total Buxheti për sektorin e shëndetësisë ka qenë 114 707 481 euro, kurse për vitin 2015 është planifikuar të jetë 116 997 668 euro, që do të thotë se është për 2,2 milionë më i lartë, por kjo nuk mjafton, duke e ditur gjendjen e rëndë në shëndetësi, ngase shëndetësia është e sëmurë në të gjitha segmentet.

Po ashtu, është 2% i GDP-së, që është pakrahasimisht më e ulët se secili vend në Evropë, nëse shikohet në tërësi buxheti i planifikuar për Ministrinë e Shëndetësisë, e shohim se është vazhdim i centralizimit. Pra, nuk kemi decentralizim, siç është propaganduar nga Ministria e Shëndetësisë. Do t'i jap disa argumente që janë dëshmi e kësaj:

1. Projektbuxheti i planifikuar i Ministrisë së Shëndetësisë është 31 565 088 euro, ndërsa i Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës është 85 432 580 euro, ku hyn shërbimi dytësor tretësor, pra në fakt është e tërë shëndetësia e Kosovës, pa atë primaren që u takon komunave. Planifikimi i Buxhetit për Ministrinë e Shëndetësisë për vitet e ardhshme është paraparë të rritet për çdo vit, ndërsa për Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës të zvogëlohet. Me këtë planifikim nuk ka përmirësim të gjendjes në shëndetësi.

2. Po ashtu po vazhdon centralizimi i investimeve kapitale. Ministria e Shëndetësisë do t'i shpenzojë 8 975 000 euro, përderisa për Shërbimin Spitalor Klinik Universitar është planifikuar po thuajse një shumë e njëjtë, përafërsisht 9 000 000 euro.

3. Alokimi për mallra dhe shërbime - Ministria e Shëndetësisë për vete ka planifikuar 8 883 000, ndërsa për Shërbimin Spitalor Klinik Universitar janë ndarë 25 910 000 euro.

4. Për odat e profesionistëve shëndetësorë janë planifikuar gjithsej 230 000 euro. Në bazë të ligjit për odat, janë 4 oda të profesionistëve shëndetësorë. Paramendojeni si mund të zhvillohen dhe të pavarësohen këto oda me këtë buxhet kur ai ndahet në katër pjesë.

5. Një çështje tjetër që mund të diskutohet është Buxheti i paraparë për performansë, që është pak më shumë se një milion euro. Këto të holla, me sa e di unë dhe kam njohuri, janë shpërndarë për paga të specialistëve dhe shumë pak për performansë. Pra, nuk janë shpenzuar për çfarë kanë qenë të dedikuara. Unë i bëj pyetje ministrit se si e kanë planifikuar që t'i paguajnë këta mjekë që janë në specializim?

Ndërsa sa u përket sigurimeve shëndetësore, e dimë se nga ministri i Shëndetësisë së Qeverisë së kaluar është premtuar se ato do të fillojnë të implementohen në janar, mirëpo me këtë planifikim të Buxhetit vështirë se do të realizohen edhe në 2-3 vjetët e ardhshme.

Lëvizja “Vetëvendosje” kërkon që Buxheti për shëndetësi të rritet, sepse kjo shkon në mirë të shëndetit të qytetarëve, si dhe sshkon edhe në favor të punëtorëve shëndetësorë. Po ashtu, kursehen edhe mijëra qindra euro që po jepen për shërim jashtë vendit. Shumë herë, i nderuar Kabinet qeveritar, edhe nëse keni të holla për t'u shëruar jashtë vendit, koha është e artë për të vepruar në raste emergjente. Andaj, duhet të jemi shumë të saktë që ta rritim Buxhetin për shëndetësi në mënyrë që të krijojmë kushte për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, po ashtu që të trajtohen baras të gjitha kategoritë në spitalet tona. Faleminderit!

KRYESUESI: Zonja Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Tashmë kur jemi para një akti të kryer, kur koalicioni më i keq i mundshëm u bë realitet, koalicion gjithsesi i dhimbshëm për Kosovën, para vetes e kemi edhe projektbuxhetin për vitin 2015. E kemi edhe më të qartë se e ardhmja, sidomos ajo e afërt për qytetarët e vendit, do të jetë para së gjithash e zyrtë dhe e pashpresë. Se nuk do të kemi zhvillim ekonomik, shëndetësi, kulturë dhe arsim të avancuar, pensione të dinjitetshme, krijim të hapësirës dhe mundësive të reja, sidomos për rininë tonë të pashpresë, këtë e kemi më se të qartë, por se në vend të tyre natyrisht do të kemi rritje të varfërisë, mjerim social, pensione denigruese dhe kriminalizim të mëtejshëm në sektorin e shëndetësisë, korrupsion dhe krim të organizuar gjithandej.

Krijimi i koalicionit qeverisës e ka shuar çdo shpresë të qytetarëve, në veçanti të të rinjve në vendin tonë. Dëshmi e humbjes së çdo shprese është edhe migrimi masiv që nga 19 nëntori i këtij viti. Ky projektbuxhet është vazhdimësi e politikave të njëjta për sektorin e rinisë, që e ka ndjekur edhe Qeveria e kaluar. Kjo do të thotë se Qeveria Mustafa është e njëjtë me Qeverinë Thaçi në trajtimin që ua bën të rinjve në vendin tonë. Ky projektbuxhet nuk ofron premisa për një rritje të qëndrueshme ekonomike, që të rinjve do t'ua kthente shpresën se diçka po lëviz pozitivisht. Ky projektbuxhet dhe ky Ekzekutiv është humbja e shpresës në këtë vend. Nuk ofron investime kapitale të duhura as në arsim, as në fushat tjera që e influencojnë direkt jetën e qytetarëve tanë.

Qytetarët nuk kanë vend pune, nuk u ofrohen kushte për arsim cilësor, kushte për perspektivë, biznes, rekreacion dhe veprimtari tjera, edhe pse dy partitë e koalicionit qeveritar, PDK dhe LDK, gjatë fushatës elektorale janë thirrur pikërisht në zhvillimin ekonomik. Ky projektbuxhet në asnjë mënyrë nuk garanton krijimin e vendeve të reja të punës. Fillimisht, do të dëshiroja të ndalem te lëmi i arsimit, përkatësisht te premtimet e Qeverisë së kaluar që nga viti 2007, atëherë kur ishte premtuar digjitalizim i shkollave, ku ishin ndarë miliona e miliona euro, e sot e kësaj dite nuk dihen destinacioni i tyre, me çka u trajtua edhe një numër shumë i madh i mësimdhënësve në programin e ESDI-elit dhe ato njohuri të marra asnjëherë nuk patën mundësinë t'i aplikojnë, ndërsa ato që nuk praktikohen normal se edhe harrohen.

Premtim tjetër i Qeverisë së kaluar ka qenë edhe arsimi i mesëm i obliguar që asnjëherë nuk u bë, por në Ligjin e arsimit parauniversitar u bë i obligueshëm arsimi parashkollor. Por, fat të keq, jo më shumë se 20% e fëmijëve në Kosovë janë të përfshirë në arsimin parashkollor. Kjo ndodh për shkak të mungesës së hapësirës, mungesës së financave për të hapur vende të reja të punës, për mësimdhënës, përderisa në fakt kemi mjaft të kualifikuar. Pra, nuk shihet asnjë shenjë pozitive në këtë projektbuxhet në këtë drejtim.

Një tjetër rrezik që po i kanoset dita ditës arsimit në Kosovë është edhe mënyra e financimit për kokë të nxënësit. Këtu, në të shumtën e rateve, viktimë janë shkollat nëpër zonat rurale, për faktin që numri i nxënësve po zvogëlohet dita-ditës. Parashikimi i fuzionimit të paraleleve rrezikon me zvogëlim të numrit të punëtorëve në arsim dhe njëkohësisht edhe në shpërnguljen e banorëve nga fshatrat e thella për në qytet. Në rastin konkret, për shembull, në fshatin Goden të komunës të Gjakovës, apo në fshatin Maznik të komunës së Deçanit, e në shumë zona të tjera të thella në Kosovë.

Pra, në këtë rast do të duhej llogaritur financimi për paralele, ndërsa numri i nxënësve të mos jetë më i madh se sa është paraparë me Ligjin për arsimin parauniversitar. Pra, sistemi arsimor në Kosovë, krahasuar me shtetet e rajonit, sa i përket strukturës së shpenzimeve kapitale dhe mallra e shërbime është më i ulët. Sa për ilustrim, përderisa Kosova pra ka vetëm 3% për shpenzime kapitale, 5% për mallra dhe shërbime, Sllovenia ka 8% për shpenzime kapitale dhe 19% për mallra dhe shërbime.

Kështu shpenzimet për nxënës si përqindje e GDP-së për kokë banori janë shumë të ulëta. Vetëm Guatemala, Republika Domenikane dhe El Salvadori kanë shpenzime më të ulëta se Kosova. Se Kosova do të ketë trend të ulët të zhvillimit të arsimit në këtë rast na bind

edhe projektbuxheti i këtij viti, në të cilin nuk janë prioritet kërkimet shkencore në përgjithësi dhe përgatitja e studiuesve të rinj për hulumtim të bazuar në metodat bashkëkohore. Këtë e dëshmon edhe Buxheti i ndarë për zbatimin e strategjisë për veprimtari kërkimore-shkencore në vlerën prej 596 200 euro.

Në vendet e zhvilluara, te arsimi profesional ka një traditë dhe përkujdesje të vazhduar. Atje shteti dhe bizneset private janë përgjegjëse për specializimin e të rinjve. Firmat i identifikojnë vendet për kuadro të kualifikuara. Pra, edhe te ne, në sistemin arsimor do të duhej të riorientohemi në bazë të nevojave të sektorit komercial. Në këtë kuptim, Ministria e Arsimit do të duhej të bashkëpunojë me organizatat e ekonomisë, që ato të marrin pjesë në hartimin e programeve mësimore, t'i identifikojnë nevojat me qëllim të kualifikimit të të rinjve në raport me këto kërkesa, në mënyrë që të punësohen në këto ndërmarrje.

Edhe në lëmin e kulturës, fatkeqësisht, vërehet ndarje e buxhetit në baza partiake, që në fakt në asnjë mënyrë nuk do të duhej të ishte kështu. Ndonëse edhe për shumë projekte të cilat janë paraparë, ne dyshojmë që do të realizohen, ngase ato janë të bartura vit pas viti.

Ndërkaq në fushën e trashëgimisë si pasojë e injorimit të shumë projekteve, vonesës së ndërhyrjes emergjente, shpeshherë ka ndodhur që pas kërkesave të shumta që janë bërë dhe ndërhyrja shumë e vonshme, ose për të mos nuk ka ndodhur fare, ka ndodhur që projektet ose vetë objektet, të cilat janë të shpallura si objekte të mbrojtura të rrënohen tërësisht. Po e përmend vetëm një rast - në fshatin Dobrosh, kulla e Can Pajazitit, e shpallur si objekt i mbrojtur, unë personalisht jam marrë me të me ministrin dhe me të gjithë personat kompetentë në kuadër të Ministrisë, por ajo sot e kësaj dite nuk ekziston. Pra, është rrënuar tërësisht, ngase nuk është ndërhyrë me kohë.

Ish-ministri Beqaj, me rastin e dorëzimit të detyrës, e deklaroi një të pavërtetë shumë të madhe kur tha se në Buxhetin e vitit 2015 është paraparë edhe rritja prej 25%. Pyetja për ministrin e Financave Hoti është: A i besuat të paktën në atë moment? Ku është kjo rritje sot? Çfarë në fakt do t'u thotë ai qytetarëve? Kisha dashur sot t'u thotë. Nuk e di, u përmend këtu nga deputetët e PDK-së se do të ketë rritje, e nga deputetët e LDK-së nuk do të ketë rritje. Vërtet nuk jeni marrë vesh, e këtë po e shohim dita-ditës, por në fakt edhe këto mosmarrëveshje duhet t'i prezantoni më hijshëm dhe të dilni e t'u kërkonit falje qytetarëve për të pavërtetat që po i ngrini.

Më 1 janar 2015, do të duhej të hynte në fuqi Kontrata Kolektive, ngase është nënshkruar kuptohet në kohë fushate, e ja ku jemi sot. Jo rrallë, siç edhe e kemi parë shpesh, edhe në mjetet e informimit, punëtorët e humbin jetën gjatë orarit të punës. Pra, janë të rrezikuar vazhdimisht, pa përkujdesje institucionale, ngase nuk zbatohet as Ligji i punës, duke ngelur kështu vetëm nën mëshirën e fatit. Por, më duhet t'ia rikujtoj edhe një herë ministrin aktual Hoti: Ju si LDK keni deklaruar gjatë fushatës se minimumi i rritjes do të duhej të ishte 30%, ndërsa realiteti 43%. Tani pse nuk jeni marrë vesh ndërmjet vete ju partnerët e koalicionit, por vetëm e keni e keni sjellë të njëjtin të gatuar nga Qeveria Thaçi. Pra, pa premtimin për rritje të pagave, pa rritjen e pensioneve të punës, të cilat në

fakt janë tepër poshtëruese për punëtorët që kanë kryer 40 vjet në shërbim të gjeneratave të këtij vendi dhe në fund u thuhet ju vleni 75% euro.

Ish-kryeministri Thaçi kishte premtuar se do t'i kthente 1,5 miliard nga Trusti dhe privatizimi. Ku janë sot ato? Pse nuk u krijua fondi i punësimit? Projektbuxheti i anashkalon edhe komunat. Mosrindërtimi i urës së Rakovinës, urë kjo e një rëndësie të madhe për tërë rajonin e Dukagjinit për gati dy vjet me radhë është i pajustificueshëm. Papërgjegjësia institucionale e Qeverisë për sigurimin e mjeteve të domosdoshme për funksionimin e Ngrohtores së qytetit në komunën e Gjakovës, për pasojë as sot e kësaj dite, ndonëse jemi në dimër, qytetarët atje nuk kanë ngrohje, aq më tepër nxënësit nëpër shkolla dhe pacientët e sëmurë nëpër spitale. Ku është Qeveria e Kosovës? Ku janë mjetet për këto destinacione? Gjithashtu te ndarja e Buxhetit nëpër komuna, Komuna e Junikut diskriminohet krahas komunave serbe, të cilat përfitojnë, jo vetëm nga Qeveria e Kosovës, por edhe nga shumë donacione të tjera dhe çdo herë janë të diskriminuara pozitivisht. Deri kur kështu?

Komuna e Junikut ka aplikuar me disa projekte. Po i përmendi disa prej tyre që asnjëherë nuk kanë hyrë as në këtë projektbuxhet. Shkolla fillore e mesme e ulët “Edmond Hoxha”, pra projekti i dërguar në Ministri...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Edhe një minutë!

TEUTA HAXHIU: Faleminderit! Meqë nuk iu ndal fjala sot askujt, kërkoj mirëkuptim. Pallati i kulturës ose Qendra Kulturore, të dyja bashkë, gjithashtu dy vjet më parë në Ministrinë e Kulturës; trafostacioni në Junik me kapacitet prej 110 kilovatësh gjithashtu në Ministrinë për Zhvillimin Ekonomik. Asnjë nga këto projekte nuk janë në projektbuxhetin e kësaj Qeverie. Buxheti i Shtetit do të duhej të projektohej në bazë të dy parimeve themelore, prioritetëve të Qeverisë dhe projekteve në terren, pra konform prioritetëve të nevojave të qytetarëve. Fatkeqësisht, projektbuxheti 2015 çalon në dyja këto parime të lartpërmendura, ku të gjitha investimet janë orientuar kah interesat më të ngushta personale dhe partiake, kjo është fatkeqësia e radhës që u bëhet shumicës së qytetarëve në vend. Dhe, krejt çka ka mundur të bëjë LDK-ja me sloganin e vet: “Ne mundemi”, ka mundur që Projekt-buxhetin i cili është miratuar në Qeverinë e ish-kryeministrit Hashim Thaçi, e solli edhe një herë formalisht në Zyrën e Qeverisë, për të thënë që ka bërë diçka, edhe pse nuk ka bërë diçka.

Unë dhe të gjithë e dimë se nuk do të jenë në gjendje edhe po t'ua lëmë edhe 40 vjet të tjera, të bëjnë me këtë njohuri, sepse edhe pse thanë se e kanë një ekonomist në krye të Qeverisë, unë them një ekonomist i dështuar, ka dështuar edhe në udhëheqjen e komunës së Prishtinës, po normal, ajo është skandali më i madh që do t'i ndodhë Kosovës, sepse tani e kemi në krye të Qeverisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Qerim Bajrami.

QERIM BAJRAMI: Zahvaljujem potpredsedniče!

Poštovani poslanici,

Poštovani premijeru,

Poštovani ministri Vlade Republike Kosova,

Koristim priliku da još jednom potvrdim da je ispred Grupe "6+" potvrđeno u načelu da ćemo podržati odnosno glasati za ovaj Budžet, s obzirom da smo dio vladajuće koalicije.

Međutim, rečeno je već i u izlaganjima mojih prethodnika da imamo niz primjedbi odnosno dopuna i izmjena u okviru predviđenog nacrta budžeta. Da samo napomenem neke nedoslednosti vezano za investicije. Dakle, u infrastrukturi u opštinama Peć, Istok, Severna Mitrovica, Leposavić, gde također žive bošnjaci u nekim sredinama. Tamo su samo predviđene generalne stavke. Mi ćemo u daljnjoj koordinaciji pokušati da neke od tih stavki konkretizujemo, dakle za te bošnjačke sredine.

Vezano za opštinu Prizren imali bismo niz dopuna, međutim uzimajući u obzir da je ovaj budžet ipak ograničen i da je ovaj budžet naših mogućnosti, mi ćemo pokušati dakle da u okviru ovih stavki nađemo neke izlaze odnosno neke mogućnosti šta će se prije investirati a šta nešto kasnije. Da napomenem da je u ovim stavkama jako bitna, dakle stavka početka gradnje osnovne škole u selu Grnčare, to je normalno opština Prizren i završetak nekih objekata poput mini domova kulture a jedan od njih je nezavršen, nažalost i u selu Mušnikovo.

Također, da napomenem ovde i još jednom već je spomenuto od nekih izlagača prije mene, da bošnjački kulturni centar koji se već desetak i više godina planira u Prizrenu i nikako da krene početak njegove realizacije, da ćemo mi zatražiti za ovu godinu sredstva za izradu, dakle projekta i početak obezbeđenja terena za taj objekat a nadamo se faznom finansiranju njegove izgradnje. Također, očekujemo jer imamo obećanja od donatora, da će pomoći oko podizanja tog objekta.

Ista je situacija i sa Turskim Kulturnim centrom u Prizrenu. Da uzgred spomenem s obzirom da ne predstavljam ovde samo bošnjake. Glavni razlog zbog koga sam se ja ovdje zapravo javio, nisu samo ova pojašnjenja. Želim da vam kažem da je u toku priprema amandmana ispred poslanika Grupe "6+" i još tri poslanika, dakle koji su van ove grupe ali pripadaju takođe grupi nevećinskih zajednica, to je uvažena poslanica gospođa Emilija Redžepi, poslanik Veton Beriša i poslanik Ethem Arifi sa njihovim potpisima.

Dakle mi tražimo od komisije za Budžet odnosno od aktuelnog premijera da učini sve što je moguće da se povećaju budžetska sredstva za ministarstvo bez portfelja i usput da kažem da svi oni koji kažu da su tih 150 hiljada evra navodno mnogo, da mi ne bismo ni prihvatili ovo ministarstvo ako bi bilo izdvojeno za njega 150 hiljada evra.

Da ne bi svima odugovlačio ovdje, odnosno oduzimao dragocjeno vrijeme ja ću kazati šta će se između ostalih zadataka, koje bude dobilo to ministarstvo od aktuelnog premijere baviti.

Gospodo, poznato vam je da je Bošnjačka Zajednica takođe i Turska Zajednica i Romska Zajednica, Aškalinjska, Egipćanska integrisana zajednica i mi se to često hvališemo okolo i mi iz ne većinskih zajednica a i predstavnici većinske albanske zajednice, i to je u redu. Međutim, te integrisane zajednice imaju mnogo problema u procesu svoje nacionalne nadgradnje ovde na Kosovu a poznato vam je da je Bošnjačka Zajednica na Kosovu vezala svoj proces nacionalne nadgradnje poslije rata na Kosovu.

Oni koji ovdje ne znaju a vjerujem oću da pretpostavim da ta takvih nema, Bošnjačka Zajednica na Kosovu je poslije rata vezala svoje obrazovanje na bosanskom jeziku direktno za kosovski plan i program i totalno je integrisana u kosovski školski sistem. Međutim, danas bošnjački učenici u srednjim školama i u Prizrenu i Dragašu i Peći i u Istoku i u Mitrovici koji zajedno idu, Bogu hvala, zajedno idu dakle sa albancima u Prizrenu i sa turcima i sa romima i tako dalje, nemaju nijedan udžbenik na bosanskom jeziku u srednjim školama. I ta situacija se ponavlja evo godinama.

Ja ću vam reći kao jedan od poznavalaca tog pitanja, jer sam to pokrenuo i nakon ... i tako dalje, da postoje institucionalne praznine da se to pitanje razreši. Jedna od njih je što Zakon o univerzitetskom obrazovanju ne predviđa dakle otkup udžbenika za srednje škole i samim tim Ministarstvo Obrazovanja do sada je uvijek nalazila izgovor da nema sredstva da bi se ti udžbenici štampali na Kosovu ili kupili iz Bosne i Hercegovine od bošnjačkih planova i programa.

Dakle, ovo ministarstvo hteli mi ili ne hteli baviće se i ovim pitanjima. Da kažem da su to sredstva od 50 do 70 hiljada evra. Slični iznos sredstava je i za tursku zajednicu. Prama tome, država Kosova koliko god imala skromni budžet, želeli da pokaže svijetu da želi i sličnu situaciju i sa nevećinskim zajednicama pokazao ga za ovaj način, tako što će izdvojiti 70 evra za Ministarstvo bez portfelja a ono će u koordinaciji sa Ministarstvom Obrazovanja i uz sve moguće potvrde i kontrole obezbediti te udžbenike. Da sad ne navodim niz primera iz kulture, gde je slična situacija.

Ne želim da kažem da nije bilo izdvajanja iz Ministarstva Kulture za nevećinske zajednice, međutim tu ne postoji nikakav sistem i nikakva organizacija. Jednostavno se neke nevladine organizacije iz naših zajednica bave kulturom. Neki put dobije prednost onaj čiji je projekat treće razredan a godinama stoje i dobre knjige na bosanskom, turskom i romskom jeziku neizdate i godinama stoje recimo i druge kulturne manifestacije, koje su samo u projektima ne financirani.

U ovom slučaju će takođe i Ministarstvo bez portfelja baviti se i ovim pitanjem. Prema tome, potrebno je da se ova dodatna budžetska sredstva izdvoje, jer baviti se samo platama ministra i njegovih savetnika uz svo dužno poštovanje nama kao bošnjačkoj zajednici ovo ministarstvo nije bilo potrebno. Već imamo primedbe u našoj zajednici da smo se borili za ministra a ne za ministarstvo.

Dakle, mi se borimo da imamo ministarstvo koje će raditi one poslove u koordinaciji sa drugim ministarstvima, koje godinama stoje nezavršene za ove tri zajednice i da kažem jednu reč na albanskom u mom se rodnom selu kaže: “pritni të hajnë burrat”. Gjysma e

burrave rrinë në këmbë, sepse shumë janë nëpër sofra, nëpër dasma, por do shakaxhinj kalojnë edhe thonë: “pritni të hanë burrat”. Në qoftë se kanë hëngër burrat deri tash, le të hajë edhe ndërrimi i dytë i burrave, pak ne të hanë edhe ata. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ibishi e ka fjalën.

NURDIN IBISHI: I nderuar kryesues,

I nderuar zoti kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë dhe ju të pranishëm.

Unë desha shkurtimisht të paraqes dy propozime, amendamente në projektbuxhetin dhe ka të bëjë:

I pari për investimet përfundimtare në objektin e Pushimores së fëmijëve në fshatin Orllan, investim milionësh që ka qenë një investim i përbashkët në mes të qeverisë qendrore dhe lokale dhe ende nuk ka përfunduar.

Dhe, investimi i dytë është, atë që parafolësi, zoti Bulliqi e përmendi, është çështja e projektit të trajtimeve të ujërave të zeza që derdhen në Liqenin e Batllavës dhe njëkohësisht kontaminojnë edhe ujësjellësin që është për furnizimin e ¼-ës së popullatës së Kosovës, domethënë Prishtinës, Fushë- Kosovës, Obiliqit, Graçanicës, pra edhe të Podujevës.

Në këtë aspekt, unë vetëm desha, janë shumë pak investime që ai objekt i pushimores për fëmijët bonjakë të përfundojë, por nëse ai vazhdon ashtu të qëndrojë, domethënë, pa u përfunduar dhe pa u funksionalizuar, mendoj që do të ketë fatin e objektit të Kuvendit në Gërmë. Dhe, mendoj që duhet Qeveria ta marrë parasysh apo faktikisht, Komisioni t’i propozoj, për seancën e radhës që do të jetë miratimi i këtij projektbuxheti.

Dhe çështja tjetër, e trajtimit të ujërave të zeza në Liqenin e Batllavës. Ju e dini se prej ¼-a e popullatës furnizohet nga ai liqe. Është një fat që është gjatësia e liqenit diku 9 kilometra dhe ai nuk kontaminohet në pjesën ku është tubacioni që e tërheq për Fabrikën e Ujit në Shajkovc, mirëpo çka nëse ndodh një thatësi e madhe dhe zvogëlohen akumulimet, kur mund të vijë deri te kontaminimi?

Dhe, çështja tjetër, nëse vjen deri te vërshimet, normalisht, krejt kjo pjesë e ujit faktikisht ku derdhen ujërat e zeza në pjesën urbane të Orllanit dhe të fshatrave përreth mund lehtë të kontaminojë ujin.

Unë ju them edhe këtë, se në këtë projekt është bërë një projekt i përbashkët mes si edhe trajtimi i ujërave të zeza, po njëkohësisht edhe ndërtimi i ujësjellësit për fshatin Orllan dhe fshatrat tjera, në një formë. Them sikur ajo poema e poetit tonë të famshëm: “pranë dritës i paparë, pranë ujit i palarë”, dhe është një fatkeqësi që fshatarët e Orllanit, por edhe të rrethinës nuk kanë ujë të bollshëm. Atë që e kanë është ujë i kontaminuar, për shkak të vetë kësaj që e thash, çështjes së ndotjes nga ujërat e zeza që derdhen pa kontrollueshëm në këtë.

Pra, llogaris si me interes të veçantë shoqëror edhe për çështjen e shëndetit publik, se ai ujë është si ujë i pijshëm, pra pas fabrikimit edhe llogaritet në aspektin ambiental, për arsye se ndotja është permanente. Çështja tjetër është edhe në aspektin e i industrisë, për arsye se ai ujë shërben edhe për ftohjen e sistemit të termocentraleve në Obiliq. Dhe, kisha lutur që këto do t'i propozoj me shkrim dhe të trajtohen pra si projekte me propozim amendamente për seancën e radhës. Faleminderit !

KRYESUESI: Zoti Sali Salihu e ka fjalën.

SALI SALIHU: Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Kolegë deputetë,

Kolegët parafolës nga “Vetëvendosja” por edhe nga partitë tjera opozitare dhe të pozitës, në përgjithësi argumentuan edhe në fusha të veçanta se edhe ky projektbuxhet i paraqitur sot, nëse arrin të aprovet, Kosovën do ta mbajë në gjendje të rëndë socio-ekonomike dhe të pashpresë për të ardhme më të mirë, për shkak të së cilës kam frikë se radhët e të rinjve dhe familjarëve drejt mërgimit veç sa do të shtohen. Unë e di që ky fenomen ka prekur të gjitha pjesët e vendit, por në rajonin prej nga vi unë, largimi i të rinjve ka marrë përmasa tepër shqetësuese dhe ende po vazhdon. Ministri i Punëve të Brendshme, zoti Skënderi, e dëgjova me vëmendje, u bën thirrje të rinjve të Kosovës që mos të ikin, mirëpo ministri nuk bën pyetje kush e solli vendin në këtë gjendje që të rinjtë të ikin. Ministri nuk bën pyetje se si është e mundur sot një i ri me një rrogë 250-300 euro të jetojë në Kosovë. Ministri asnjëherë nuk mendon për këta njerëz, por u tregon se cilat masa, cilat janë sanksionet të cilat këta të rinj do të ikin, dhe do të ballafaqohen, domethënë nga shtetet ku ata migrojnë.

Unë mendoj që ministri me kolegët e vet më mirë është të merret me projektet që i ka premtuar gjatë fushatës elektorale, me ato 120 mijë vende pune për kohën dhe vendin se ku do te investohen, në mënyrë që të zbutet papunësia e jo t'u tregojë se si ata do të sanksionohen.

Tash do t'i kthehem pak sektorit të bujqësisë, një sektor ky shumë me rëndësi për ekonominë e vendit, me të cilin sektor, po të trajtohej sikur duhet do të kishte mundësi që një pjesë bukur e mirë e këtyre të rinjve të absorboheshin.

Gjatë fushatës, por edhe në fjalimin e parë të kryeministrit të ri të qeverisjes së vjetër, që fatkeqësisht po vazhdon, është përmendur disa herë se bujqësia është prioritet. Por, keni harruar, zoti kryeministër, se bujqësia në gjendje të tanishme që është, në gjendje shumë të rëndë, është sjell pikërisht nga këta njerëz që sot ju bashkëqeverisni.

Të nderuar deputetë, zhvillimi i bujqësisë nuk mund të arrihet me fjalë e retorikë, por me program të qartë, mbështetje buxhetore dhe me angazhim të njerëzve kompetentë e profesionalë, me njerëz të ndërgjegjshëm e të vetëdijshëm për resurset natyrore e humane që ka Kosova për ta zhvilluar këtë sektor.

Buxheti i ndarë për bujqësi është ende shumë i vogël në raport me nevojat që ka ky sektor. Me këtë buxhet, zhvillimi i bujqësisë nuk mund të jetë i qëndrueshëm dhe as i

konkurrueshëm me bujqësinë e vendeve të rajonit që mbështeten më shumë se sa vendi ynë.

Megjithatë, vetëm shifrat dhe shumat që i dedikohen bujqësisë nuk garantojnë zhvillim të bujqësisë, por duhet programe dhe politika adekuate që orientojnë bujqësinë drejt zhvillimit të qëndrueshëm.

Nuk e di se cilin program të bujqësisë do ta shfrytëzojë kjo Qeveri. Në programin e LDK-së të cilin e kanë shpalosur gjatë fushatës elektorale aty janë vetëm 2 faqe e gjysmë që i dedikohen bujqësisë, e nëse bazoheni në programin e PDK-së, është pikërisht ai program që ju keni kritikuar gjatë fushatës dhe është pikërisht ai program, që sjell fermerin e Kosovës në pozitën më të pabarabartë në rajon.

Prandaj, konsideroj se Kosova ka nevojë për politika të mirëfillta që mbrojnë prodhimin vendor, ka nevojë për themelimin e një fondi të veçantë për zhvillimin e bujqësisë, që ju e keni premtuar, ka nevojë për një kontroll të rreptë të imputeve, të plehrave, të farës dhe pesticideve që po e dëmtojnë fermerin e Kosovës, ka nevojë për mbështetje profesionale për bujqit, për një angazhim dhe koordinim të mirë të institucioneve të Kryeministrit, të agjencive që kontrollojnë Kryeministria, Ministrinë e Bujqësisë, Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Tregtisë dhe Industrisë si dhe doganave e gjyqësorit.

Por, a mund ta arrihet kjo me këtë qeveri dhe me njerëz jokompetentë që udhëheqin këtë sektor? Ne nuk besojmë se bujqësia ka pasur nevojë të udhëhiqet nga njerëz njëherë basketbollistë e tashmë sportist e muzikant, ashtu sikur nuk besojmë që Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor nuk do t'i ndihmojë mjeku me barërat e tij.

Si përfundim po themi që kjo qeveri nuk do të ndryshojë gjendjen në këtë sektor. Bujqësia do të vazhdojë me këtë gjendje të rëndë, prodhimi vendor do të jetë i pambrojtur dhe i pabarabartë në treg, fermerëve nuk do t'u ofrohet mbështetje as në cilësi, as në sasi dhe as në kohën kur ata kanë më shumë nevojë.

Dhe, krejt në fund dua të shpreh edhe shqetësimin e qytetarëve të komunës së Vitisë, por edhe të rajonit të Anamoravës në përgjithësi, të cilët vite me radhë janë lënë anash, sa i përket infrastrukturës rrugore, por edhe shkollave. Kemi rastin e shkollës në Pozharan e cila shkollë i ka mbi 1000 nxënës dhe është afër shkatërrimit, që paraqet rrezik për jetën e atyre nxënësve.

Gjithashtu, rruga Viti-Gërlaç, rruga Viti-Klllokot është ndër rrugët më të shkatërruara në Kosovë. Pastaj Komuna e Vitisë është rajon bujqësor, ka mbi 6 mijë hektarë tokë pjellore dhe për fat të mirë Komuna e Vitisë ka një burim të ujit, lumin Binça apo "Morava Binça", e cila ka 6 mijë litra rrjedhje uji në sekondë, dhe asnjë pikë e ujit nuk shfrytëzohet për ujitje apo për ndonjë qëllim tjetër.

Kërkoj që sistemi i ujitjes në komunën e Vitisë, ndërtimi i një pende, ku do të mund të akumulohet ky ujë do të paraqiste një xehorë mbitokësore për komunën dhe fermerët e komunës së Vitisë. Dhe, kërkoj që ky projekt të futet në këtë projekt-buxhet, që tash shpresoj që nuk do të aprovohet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Berisha.

RRUSTEM BERISHA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Unë fillimisht do ta jap një vlerësim që ka të bëjë me projekt-buxhetin për vitin 2015 dhe ky buxhet është në shpërputhje me nevojat dhe pritjet e qytetarëve.

Por, më shumë do të fokusohem në tri organizata buxhetore. Në radhë të parë do të flas, meqë vi nga Peja, për ndarjen buxhetore që i është bërë kësaj komune. Duke ditur se Peja kontribuon shumë në buxhetin e Kosovës dhe duke marrë parasysh se në Pejë ka mundësi që të zhvillohet bujqësia, që të zhvillohet turizmi, sepse i ka bukuritë natyrore, Bjeshkët e Rugovës e që shumë pak është paraparë që të investohet në zhvillimin e turizmit veror dhe dimëror në atë pjesë. Po ashtu, Peja është e njohur edhe me arritjet e sportistëve të Pejës, që në këtë ndarjen e buxhetit nuk pash se ka investime në infrastrukturën sportive të kësaj komune. Kurse, sa i përket bujqësisë, dimë se rrafshi i Dukagjinit dhe Peja ka hapësirë dhe mundësi që të zhvillojë bujqësinë, por bujqësia si mund të zhvillohet, në rast se nuk rregullohet sistemi i ujitjes?

Çështja tjetër, që dua sot ta potencoj, ka të bëjë me Ministrinë e Forcës së Sigurisë, me buxhetin e saj, që mendoj se është një buxhet i pamjaftueshëm, një buxhet i varfër për zgjerimin e misionit të FSK-së dhe për shndërrimin e FSK-së, Forcës së Sigurisë në Ushtrinë e Kosovës.

Diçka tjetër, që dua të potencoj te ky buxhet, ka të bëjë me investimet kapitale të Ministrisë së Forcës së Sigurisë dhe pyetja ime këtu është: Si do të investojmë në disa reparte të Forcës së Sigurisë, përderisa nuk është rregulluar çështja e pronësisë dhe a do të ndodhë që prapë do të investojnë nëpër këto reparte e më vonë të ndërrojmë, të dalim në një repart tjetër dhe ato investime thjesht të jenë investime të gabuara.

Elementi tjetër apo çështja tjetër që dua sot para jush dhe para qytetarëve të Kosovës ta potencoj, ka të bëjë me kompleksin memorial “Beteja e Koshares”. Ne të gjithë e dimë se para tre vjetësh, faktikisht më 9 prill të vitit 2011 është bërë vendosja e gurthemelit në këtë kompleks memorial, por ka dy vjet që ende mbetjet mortore të heronjve dhe të dëshmorëve nuk janë kthyer në Koshare, ndërsa, nga buxheti që sot po diskutojmë, nuk shihet se për vitin fiskal 2015 ka ndonjë investim në këtë drejtim.

Nga Ministria e Planifikimit Hapësinor, 200 mijë euro janë të parapara, por ato 200 mijë euro janë borxh kompanisë, e cila ka kryer punimet e ndërtimit të murit mbrojtës në betejën e Koshares.

Pra, qytetarët, familjarët e dëshmorëve të kësaj beteje edhe këtë vit do të ballafaqohen me mos ndërtimin e rrugës së Koshares nga Botusha deri në Koshare, nuk do të ketë asnjë investim sipas ndarjes së këtij buxheti në kompleksin memorial të Koshares.

Unë rekomandoj dhe propozoj që kryeministri, Qeveria dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa ta shqyrtojë kërkesën e Agjencisë për Mbikëqyrjen e Komplekseve Memorialë dhe ta aprovojë buxhetin, që është kërkesa për... që është e paraparë në kuadër të kërkesës që është drejtuar më 19.12.2014. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Danush Ademi.

DANUSH ADEMI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar kryeministër,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Në fillim desha ta falënderoj kryeministrin, kryetarin e Kuvendit dhe ministrat, të cilët shkuan vizituan familjen Jashari dhe e ndanë dhembjen së bashku me ta në Fushë Kosovë.

Por, para se ta filloj një temë, unë nga buxheti kam ndarë vetëm një fletë, se këtu janë 250 fletë të buxhetit. Po shoh që asnjë projekt nuk është paraparë për komunitetin ashkanlij për këtë vitin 2015.

Këto po shohim që në fakt jemi të gjithë këtu prezent, sepse migrimi ilegal i cili po ndodh për komunitetet tona do të thotë që Qeveria vetë po i fton qytetarët që ta lëshojnë Kosovën, duke paraparë këtu edhe buxhetin, ku thuhet që 3 milionë euro janë për të kthyerit, domethënë, 12 milionë i ka vetëm Ministria e Kthimit, për familjet e kthyerat. Asnjë projekt nuk është i paraparë për komunitetin ashkalinj, për ndërtim apo infrastrukturë.

Unë kërkoj nga Kabineti qeveritar, që së paku nga këto katër kolona, të cilët i kanë ndarë këto, që janë 12 milionë euro për të kthyerit, së paku 1 milion euro të ndahet për këtë komunitet, të jetë një kod i veçantë për komunitetin ashkalinj, rom dhe atë egjiptas, të ndahet kod i veçantë që të kenë të drejtë ta shfrytëzojnë këto komunitete këtë buxhet, sepse deri më tani asnjëherë nuk u shfrytëzua ky buxhet nga Ministria për Kthim dhe Komunitete.

Unë mendoj që ajo Ministri duhet t'i plotësojë të gjitha kërkesat e qytetarëve, jo vetëm të favorizohet një komunitet, sikurse është favorizuar pothuajse plotë 15 vite. Prandaj, edhe mu për atë, kërkoj që edhe nga Zyra e Kryeministrit, që është për çështjet e komuniteteve dhe Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale të ndajnë buxhetin enkas për këtë komunitet, se me të vërtetë ne kërkojmë edhe ju zoti kryeministër, jeni vetë prezent, para tri-katër ditësh - thatë keni shkuar, keni vizituar familjen dhe e keni vërtetuar se në çfarë kushtesh jeton komuniteti jonë ashkali, ai egjiptian, por edhe komuniteti rom.

E keni parë që edhe infrastruktura e cila ndodhet ku janë komunitetet e ndara, nëpër ato lagje është shumë e dobët. Para se të shkoni, ndoshta atje, 30 minuta para se të shkoni është derdhur vetëm një kamion zhavorr, sepse nuk do të kishit mundësi të shkoni e të vizitoni atë familje, nuk do të depërtonit deri te familje, sepse ajo rrugë është plotë baltë. Nuk është vetëm ajo rrugë, por kemi shumë rrugë ku jetojnë komunitetet.

Prandaj, kërkoj nga Kabineti qeveritar, që së paku secila ministri ta ketë përqindjen për komunitetin tonë ashkali, por edhe për komunitetin rom e egjiptas, për të gjitha komunitetet, që së paku 10% të shfrytëzohet fondi për këto komunitete, sepse me të vërtetë ne kërkojmë nga këto 20 ministra, sa janë këtu, sepse po shohim prej të gjitha komuniteteve, janë ministrat këtu, kemi nga komuniteti turk, boshnjak, serb, po edhe të tjerët. Ne nuk kemi ministrin këtu, prandaj ne kërkojmë nga ju që së paku 10% nga buxheti, të cilin e keni, të ndahen për këtë komunitet, se me të vërtetë qytetarët tonë jetojnë në kushte shumë të vështira.

Dhe, mu për atë them , sepse kjo me vetë faktin thotë që 12 milionë apo 13 e gjysmë euro ndahen për familjet që nuk janë ende në Kosovë, mendohet për ta, kurse, për këto familje që i kemi prezentë, pothuajse afër 13 apo 14 vite, fare nuk është duke menduar Qeveria e shkuar, por edhe kjo Qeveri që kemi tash.

Unë mendoj që duhet të mendohet për të gjithë qytetarët njëjtë, edhe pse kryeministri kur e ka vizituar atë familjen u ka dhënë qytetarëve premtimeve, që besoj se do të merret me rregullimin e situatës, të rregullojë infrastrukturës, t'ua rregullojë edhe jetën e atyre qytetarëve, që me të vërtetë jetojnë në kushte shumë të vështira.

Prandaj, kërkojmë edhe nga Ministria e Arsimit, ne kemi pasur një kërkesë vitin e kaluar, që të ndërtohet një shkollë në komunën e Ferizajt. Ne në këtë Kuvend kemi miratuar shumë shkolla që janë ndërtuar, ndoshta kemi miratuar shkolla që janë ndërtuar, ndoshta, kemi miratuar shkolla për 10 nxënës a 20 nxënës, por në komunën e Ferizajt, në fshatin Dubravë jetojnë 510 nxënës, shkojnë nga ai fshat , udhëtojnë nga 3 kilometra në ditë dhe nuk kemi shkollë në atë fshat.

Është paraparë që këtë vit të ndahen 700 mijë apo 800 mijë euro, të rregullohet shkolla në atë fshat. Unë mendoj që i plotëson kushtet për rregullimin e një shkolle përderisa, ne edhe më herët edhe në kuvendet komunale, por edhe këtu kemi rregulluar shkolla për 4, 5 apo 10 nxënës. Për çfarë arsye të mos ta rregullojmë edhe një shkollë në fshatin Dubravë, i cili është i banuar 100% me komunitetin ashkalinj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E ka fjalën Veton Berisha.

VETON BERISHA: I nderuar kryesues Haliti,
I nderuar zoti kryeministër Mustafa,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë,
Qytetarë të nderuar,
Më lejoni që edhe unë të jap mendimin tim lidhur me këtë projekt-buxhet.

Sinqerisht, situata e problemeve të komuniteteve pakicë i është bërë barrë e madhe Qeverisë edhe singërisht, individualisht qysh dalin kështu, nuk e di se si do të shkojmë tutje.

Unë mendoj që plani i Buxhetit do të ishte mirë që të planifikohet në atë formë, që komuniteteve pakicë, në rastin tim komunitetit egjiptian, të mos i ofrohen favore në kuptimin e asaj që të ketë përqindje në ndarje, por t'i ofrohet mundësi punësimi, t'i ofrohen mundësi të cilat këta pjesëtarë të komunitetit tim të kenë mundësi të japin kontribut më të mëdha të gjitha proceseve.

Zhgënjimi më i madh vjen prej komunave të caktuara, të cilat do të ishte e udhës, që këto komuna vërtet të jenë më afër edhe komuniteteve edhe familjeve të varfra dhe në situata të caktuara dhe para planit të buxhetit, i cili është planifikuar më herët, ndoshta të vijjnë me rekomandime. Përpos komunës së Gjakovës, e cila e ka një prioritet ku unë e pash, u mundova me përpikëri ta analizoj projekt-buxhetin, unë jam jurist me profesion, por nuk domethënë me qenë ekonomist për të kuptuar, se çka përmban plani i buxhetit.

Unë shumë pak pash që janë planifikuar investime apo rrugë. U tha këtu që shumë beton, shumë kubëza, ndërsa përpos Gjakovës, Pejës dhe Istogut nuk pash projekte ose kërkesa që kanë ardhur nga komunat tjera. Dhe, aq më tepër komuna e Istogut vjen me një term, ku mund ta shikoni në faqen 62, kodi 61165, i cili vërtet është term që unë nuk po ndihem mirë që është në atë kod. Besoj që ky do të korrigjohet.

Në anën tjetër, kam pritur që nga komuna e Pejës do të vijë, kësaj here, në këtë vit, që të ndërtohet lagja Kristal e cila tani e 15 vjet është e demoluar dhe aty ka banorë, që dëshirojnë të kthehen, ndërsa që 15 vjet nuk ka mundësi të hyjë në planin e buxhetit. E di që mundësitë janë të vogla, që në këtë periudhë kohore të amendamentohet ky projektligj, sepse i di mundësitë të cilat janë, por, po shpresojmë që në proceset e mëtutjeshme, domethënë që edhe në Komisionin ku unë jam, do të mundohem që brenda mundësive buxhetore që i ka kësaj here Qeveria, të propozoj amendamentimin, sidomos për lagjen "Kristal".

Në anën tjetër, fokusi gjithmonë duhet të ndodhë diçka që mediet të arrijnë edhe ta kuptojnë se çka po ndodh me jetën e komuniteteve në Kosovë, siç ishte rasti i fundit i familjes Jashari, por ne kemi plot raste të tjera. Është para një muaji rasti i familjes Shpatollaj, po ashtu fëmijë, mbetet i izoluar dhe vdes duke mbledhur hekura dhe zihet nga vendi ku ka provuar. Në anën tjetër, përpos rasteve të vdekjes, ne po humbim edhe kohë duke siguruar ekzistencën në këso situatash, ne lëmë anash prej procesit mësimor. Sigurisht, se kjo është dukuri e cila neve po na dëmton gjatë gjithë procesit.

Vërejtje dhe shqetësim imi është që Ministria për Kthim dhe komunitete ka qenë gjatë gjithë kohës përfaqësuese e ashtuquajtur, përfaqësuese e komuniteteve, por në fakt nuk ka luajtur rolin e barabartë dhe nuk jemi trajtuar drejt. Në këtë rast po ashtu edhe në këtë plan të buxhetit nuk po shohim se ka shtim, ose ka kërkesë, ose që janë marrë me prioritet kërkesat e komuniteteve tjera. Dhe, me këtë rast kërkojmë edhe nga kryeministri, por edhe nga ministri aktual, që në kuadër të Ministrisë për Kthim dhe Komunitete gjatë këtij viti me buxhetin që ka, të trajtohen rastet me prioritet dhe të ketë parasysh, se ky komunitet ka vërtet nevojë për të ndërhyrë.

Ne kemi kërkesat që me vite të tëra qëndrojnë në kuadër të kësaj Ministrie, ndërsa dalin me deklarata publike ministrat e kaluar dhe thonë që nuk kemi mundësi buxhetore, ndërsa ndërtohen shtëpi, ndërtohen vendbanime e infrastrukturë për familje, të cilat fare nuk banojnë aty, ndërsa, komuniteti ynë është i interesuar të kthehet aty të jetojë dhe nuk ka mundësi buxhetore të investohet në këto pjesë.

Do të ishte korrektësi e madhe edhe prej kryeministrit edhe prej Kabinetit qeveritar të shikohen mundësitë e investimit, aty ku ka nevojë dhe ku do të përdoren, por jo të investohen mjete kot dhe ato të mos përdoren në asnjë moment.

Unë nuk pash një plan, një strategji të investimit, ku këtë komunitet vërtet do ta bëjë të qëndrueshëm dhe s'do t'i japë mundësi, u tha shumë shpesh këtu, të largohen prej Kosovë. Ideja e largimit prej Kosovë nuk është e vullnetshme dhe u diskutua gjerë e gjatë, por sinjerisht, duhet një analizë e thellë dhe te ky komunitet të investohet dhe të jetë i pavarur prej skemave sociale. Nuk jemi të interesuar që t'i bëhemi barrë shtetit, që gjithmonë të kërkojmë mëshirë, por, jemi të interesuar që të japim kontribut dhe ta fitojmë çdo gjë që është për neve.

Në anën tjetër, Ligji për skemën sociale është një prej ligjeve, faktorëve kryesor, i cili vërtet është konsideruar diskriminues dhe është një prej arsyeve, pse edhe komuniteti im, po i gjithë populli i Kosovës, që ka qenë pjesë e kësaj skeme sociale, ka qenë një prej arsyeve e cila për shkak të shkurtimeve buxhetore, që kanë ndodhur në kuadër të këtij buxheti të kaluar, janë bërë largime nga skemat sociale për këto kategori.

Unë do të kërkoja, që brenda mundësive të rishikohet kjo pjesë e buxhetit për skemën sociale dhe në këtë aspekt, sidomos ato familje që s'kanë mundësi të punësohen, që të kenë mundësi më të madhe të punësimit, të ketë të paktën mundësi mbështetjeje institucionale, që ta kenë një vetë ekzistencë.

Shpresë e vetme, e cila mbetet si deputetë të Kuvendit të Kosovës, ku përfaqësojmë komunitete të caktuara, është që në vazhdimësi, domethënë në amendamentim dhe në rishikim eventual, pas 6 muajsh të ndikojmë, por, në anën tjetër kërkojmë prej Ministrisë së Bujqësisë, ku ka mundësi përmes subvencioneve të caktuara komunitetin tim egjiptian ta mbështesë, sepse vërtet dëshiron që të jetë i pavarur prej mëshirës dhe prej asaj që ne vetëm duhet të kërkojmë.

Unë do ta përkrah këtë buxhet, mirëpo në vazhdimësi do të kërkoj, që brenda mundësive në kuadër të ministrive të caktuara, komunitetit tim t'i bëhet e mundur që vërtet ta krijojë një stabilitet, ku edhe do të vazhdojë të krenohet më tutje me Kosovën. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Dërguti.

AIDA DERGUTI: Deputetë të Kuvendit,
Qytetarë të Republikës,

Meqë deputetët e Lëvizjes “Vetëvendosje” diskutuan të gjithë sektorët e Buxhetit, unë dua të ndalem vetëm te një çështje.

Në projektligjin për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015, në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, askund nuk pashë linjë buxhetore të paraparë për viktimat e dhunës seksuale të luftës. Ligji i cili përfshin këtë kategori ka hyrë në fuqi më 20 mars 2014, dhe bazuar në këtë ligj, Qeveria ka pasur për obligim, që brenda 6 muajsh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji të nxjerrë akt nënligjor për zbatimin e ligjit, si dhe formimin e Komisionit qeveritar.

Si rrjedhojë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale është dashur të planifikojë dhe përfshijë një buxhet rezervë për viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës, apo ndoshta kjo Ministri nuk është fare në dijeni, që tashmë ekziston baza ligjore e cila e obligon Qeverinë që ta përfshijë këtë në buxhet?

Mospërfshirja e kësaj kategorie, tregon qasjen joserioze të Qeverisë karshi kësaj kategorie. Prandaj, procedimin e amendamentit, që u përmend më herët në këtë sallë, për kategorinë e viktimave të dhunës seksuale të luftës, grupi ynë parlamentar do ta përkrah fuqishëm.

Gjithashtu, kam një pyetje për Ministrin e Financave lidhur me veteranët e luftës. Deri më tani diku rreth 17 000 veteranë kanë kaluar procesin e verifikimit, një numër i konsiderueshëm i këtyre veteranëve presin kompensimin konform ligjit, duke filluar nga janari i vitit 2015. Edhe pse në tabelën buxhetore ekziston linja për Ligjin e veteranëve, nuk është ndarë as edhe një cent për këtë kategori.

Mirëpo, sot ministri i Financave tha se janë ndarë 24 milionë euro. A ka mundësi të na sqarojë ministri në fjalë, si do të alokohet buxheti për veteranët? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Brahimaj e ka fjalën.

LAHI BRAHIMAJ: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar të pranishëm,

Unë, diskutimin tim lidhur me Projektligjin për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015 do ta fokusoj në bujqësi, si një nga degët më të rëndësishme të ekonomisë vendore.

Buxheti për bujqësi në këtë projektligj nuk përqendrohet, as në shfrytëzimin e resurseve bujqësore e pyjore, e as në avancimin dhe zhvillimin rural. Planifikimet buxhetore sipas pasqyrave tabelore janë në shpërputhje me kërkesat e popullatës tonë; mundësitë e kontributit të këtij sektori në bruto-prodhim vendor ; mundësitë për punësim dhe kërkesat me standardet e BE-së dhe politikave të përbashkëta bujqësore.

Buxheti për vitin 2015, nuk përqendrohet në sigurimin dhe sigurinë e ushqimit, dukuri kjo që prek drejtpërsëdrejti çështjet ekonomike, sociale dhe shëndetin e popullatës.

Qëllimisht, ju të nderuar qeveritarë, buxhetin për vitin 2015 e keni fokusuar në subvencione dhe grante, të cilat ashtu siç ju i keni zbatuar deri me tani dhe si dini t'i zbatoni janë subvencione, që mund t'i quaj subvencione votash dhe nuk garantojnë zhvillimin e sektorit të bujqësisë.

Është e vërtetë se në raport me periudhën e viteve të kaluara, për vitin 2015 buxhetin për bujqësi e keni planifikuar një lartësi 60 milionë, 352 mijë e 651 euro. Dhe, kjo në shikim të parë ishte dashur të çmohet, mirëpo, dinakëria juaj me paranë publike përmes buxhetit të vitit 2015, qëndron në atë se ju planifikoni, mjeshtërisht, nga kjo shumë mbi 88%, përkatësisht 53 milionë, 573 mijë e 922 euro t'i ndani për subvencione dhe grante, që domethënë kjo është ndikim direkt i juaj në përfitimin individual të personave të caktuar, të cilët potencialisht mund të jenë pjesë aktive e pushtetit dhe militantëve të partive në pushtet, për të cilat ata do të kenë ndikim... në vitin e ardhshëm.

Kjo në praktikë i bie blerje e votave direkt me para publike. Ju planifikoni që me paranë publike, militantëve tuaj t'u sillni të mira individuale, pagesa direkte, ndërsa investimet kapitale të cilat do të përfshinin grupe të mëdha të interesit në këtë rast zonave rurale, sipas planifikimit tuaj buxhetor, do të jenë plotësisht të anashkaluara. Kjo do të thotë se nga ky buxhet fermerët nuk mund të presin se do të kenë zgjerim të sistemit të ujitjes, nuk do të kenë prodhimtari intensive, nuk pritët bujqësi e qëndrueshme, nuk pritët stabilitet i prodhimit, nuk do të ketë infrastrukturë për fermerët në zonat rurale.

Si ka mundësi që nga shuma e përgjithshme që ju planifikoni për bujqësi për vitin 2015 e që është mbi 60 milionë euro vetëm 157 milionë të planifikohen për shpenzime kapitale? Në projektligjin e buxhetit 2015 vërehen dobësi prej të cilave po i përmend.

- Buxheti ka mungese të theksuar të investimeve kapitale;
- Buxheti nuk përfshin prioritete të ndara mirë dhe me kohë;
- Buxheti nuk përfshin dhe nuk fokusohet në caktimin e përparësive konkurruese të prodhimeve vendore, në përputhje me kushtet klimatike të vendit tonë.

AAK-ja, nuk është për atë që bujqësia konform buxhetimit jo të drejtë, të na dështojë në të gjitha fushat, madje edhe në politikat e përbashkëta bujqësore.

Po ua citoj objektivin kryesor të këtyre politikave:

Objektivat kryesorë janë për të siguruar një standard të drejtë të jetesës për fermerët dhe për të siguruar një furnizim të qëndrueshëm dhe të sigurt të ushqimit me çmime të përballueshme për konsumatorët, prodhimin e ushqimit, menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe zhvillimin e balancuar të zonave rurale në të gjitha zonat.

Për mua si deputet, buxheti për bujqësi duhet të përfshijë:

- Nevojat e rritjes së konkurrencës për krijimin e instrumenteve të forta në tregun vendor që të përmbushim sa më shumë kërkesa me produkte ushqimore;
- Nevojat që bujqësia dhe zhvillimi rural të përfshijnë përpos prodhimeve bujqësore edhe aspekte tjera të zhvillimit, duke përfshirë edhe ruajtjen e mjedisit;
- Prodhuesit vendor të mos kenë disavantazh.

Buxheti duhet të arrijë efekte më të mira ekonomike në zhvillimin e bujqësisë. Për të arritur këtë, struktura e buxhetit, duhet të distribuohet për:

- Rritjen e përqindjes së mbështetjes strukturore për rritjen e investimeve, futja e standardeve, duke arritur produkte me vlerë të shtuar përmes bujqësisë;
- Reduktimin e shpenzimeve administrative;
- Rritjen e fondeve për zhvillim rural;
- Reduktimin e mbështetjes së të ardhurave;
- Përmirësimi i standardeve të sigurisë ushqimore;
- Mbështetje të kërkesave bujqësore, bartje të njohurive e informacionit në tregun;
- Mbështetje të vazhdueshme të tregut.

Dhe, para se ta përfundoj fjalën time, dua të potencoj edhe për një regjion, që vij unë nga Dushkaja. Është një regjion që vërtet ka vuajtur një kohë të gjatë, jetojnë vetëm me bujqësi. Ministria e Bujqësisë nuk e ka paraparë as edhe një cent të investojë për investime kapitale. Jo vetëm Ministria e Bujqësisë po as Qeveria s'ë ka asnjë projekt për këtë regjion përpos dy rrugica në lagje të Gërkocit dhe Zhuvelit.

Shpresoj se këto vërejtje të mia konstruktive do të shërbejnë për plotësimin e planifikimit të drejtë për projektbuxhetin në sektorin e bujqësisë për vitin 2015. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Grainca.

BLERIM GRAINCA: Faleminderit, zoti kryesues!

Është mirë që më në fund më erdhi radha edhe pse kam kërkuar nga fillimi, shpresoj që ka qenë një lëshim kësaj radhe dhe të mos përsëritet.

Zoti kryeministër,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë,

Para vetes kemi marrë draft-ligjin e Buxhetit për vitin 2015 dhe edhe laikët që nuk kanë qasje në ekonomi e financa e kuptojnë se ky buxhet është hartuar në bazë të infrastrukturës ligjore që ekziston në fuqi dhe e cila ka prodhuar të hyrat e atilla që janë të bazuara kryesisht nga të hyrat që vijnë nga dogana dhe të hyrat vendore.

Nëse shikojmë kategorinë e shpenzimeve po ashtu shohim se kemi një vlerë të madhe të ndarë kryesisht për pagat dhe mëditjet dhe duhet të jemi të vetëdijshëm se kjo kategori është e ndikuar nga disa vendime të Qeverisë së kaluar dhe atë kryesisht nga vendimi për rritjen e pagave në administratën publike, pastaj nga efektet që kanë ligjet e caktuara, siç është Ligji i sigurimit social, veteranët, të ndjekurit politikë dhe rritja e pensione.

Gjithsesi ky buxhet në kategorinë e shpenzimeve normalisht se është i ndikuar dhe i hartuar në atë formë që premtimet elektorale të Qeverisë së kaluar, gjegjësisht premtimet e pa realizuara dhe koston e këtyre premtimeve që ia varrë në qafë Qeverisë së tanishme në mënyrë që fatura për dështimet dhe lëshimet t'i atribuohet kësaj Qeverie.

Të gjithë ne e dimë se objektivat programore të Lidhjes Demokratike të Kosovës kanë qenë të bazuara në rishikimin e politikave fiskale dhe atyre ekonomike me qëllim që të kemi një rritje të produktit vendor, të kemi rritje të eksportit, përmirësim të bilancit tregtar dhe luftimin e evazionit fiskal, e gjithë kjo me qëllim të rritjes së stabilitetit

ekonomik dhe performansës së institucioneve vendore të shprehura në rritjen e buxhetit dhe të hyrave në këtë buxhet.

Por, nëse shikojmë shpërndarjen e shpenzimeve, gjegjësisht ndarjen për ministrinë përkatëse, atëherë rezulton se ata që kanë hartuar këtë buxhet nuk kanë menduar për një rritje ekonomike.

Mjafton të shikojmë buxhetin që është ndarë për Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik që është 28 milionë, për Ministrinë e zhvillimit dhe Industrisë vetëm 5 milionë e 500 mijë, për Ministrinë e Bujqësisë kemi rreth 60 milionë euro dhe e gjithë kjo rezulton se të tri këto ministri kanë buxhet të përafërt me projektin e autostradës.

Prandaj, nuk mund të flasim për një zhvillim ekonomik, nuk mund të flasim për rritje, nuk mund të flasim për përmirësim të bilancit tregtar dhe nuk mund të flasim për investime të huaja direkte nëse nuk krijohet një klimë përmes tri këtyre ministrive të cilat janë të lidhura ngushtë me investimet.

Unë jam i bindur se Qeveria, kryeministri dhe i gjithë Kabineti qeveritar, qoftë përmes amendamentimit apo në rishikimin e buxhetit do të ndikojnë që të përmirësohen këto shifra dhe të kemi një pasqyrë tjetër të shpenzimeve dhe ndarjes përmes kategorive ekonomike.

Unë dua të shpreh edhe një shqetësim që është i lidhur kryesisht në funksionimin e agjencive të pavarura, bordeve të këtyre agjencive, kompanive publike dhe mjafton t' u referohemi shpenzimeve që i kanë këto agjenci për të parë pjesëmarrjen e madhe të pagave dhe mëditjeve që i kanë këto agjenci.

Më lejoni t' ju sjell vetëm një shembull apo dy, sa për ta ilustruar këtë që po them. Bordi i Agjencisë për Rishikimin e Tatimit ka 102 mijë euro buxhet, ka 4 anëtarë dhe kjo i bie që kanë mesataren e pagës mbi 1.300 euro.

Ka edhe shumë agjenci të tjera të cilat nëse hyjmë t'i analizojmë rezulton se kanë paga dhe mëditje më të larta se sa paga mesatare në Kosovë.

Po ashtu nëse shikojmë me kujdes këtë buxhet do të shikojmë se nuk janë përfshirë asnjë nga projektet kapitale të cilat janë promovuar nga Lidhja Demokratike e Kosovës, qoftë në programin qeverisës, qoftë në programin elektorale.

Të nderuar kolegë,

Lidhja Demokratike ka proklamuar, por jo vetëm Lidhja Demokratike, një projekt mjaft të madh i cili do të kishte impakt direkt në zhvillimin e sektorit të bujqësisë dhe ai ka qenë projekti Ibër - Lepenc.

Në projektbuxhetin nuk po shoh se ka asnjë euro qoftë edhe për hartimin e projektit studimor apo fizibilitetit për këtë projekt i cili do të kishte impakt edhe në zhvillimin e bujqësisë, edhe në furnizimin me ujë të pijes dhe ujë industrial.

Po ashtu, nuk shoh se është ndarë asnjë euro as për projektin e I gaverment apo qeverisjen elektronike, të prokurimit elektronik apo projekteve tjera të cilat i kemi programuar gjatë fushatës elektorale.

Dhe në fund, më lejoni që të zbres në rrafshin lokal dhe t'i referohem shifrave që janë të dedikuara për qytetin e Ferizajt, ku edhe pse është qyteti i tretë për nga madhësia, edhe pse në b buxhetin e Republikës së Kosovës kontribuon me 110 milionë euro, prapëseprapë në investimet kapitale për vitin 2015 është pjesëmarrja zero, për faktin se kemi vetëm 2, 3 projekte të bartura nga viti 2014 dhe vlera e të cilave sillet rreth 500 mijë euro dhe për arsye se të gjitha investimet kapitale janë kontraktuar në vitin paraprak.

Shpresoj që Qeveria e ardhshme përmes rishikimit të buxhetit do të arrijë që t'i korrigjojë këto shifra dhe të mundësojë një shpërndarje adekuatë edhe në proporcion me kontributin që kanë edhe qytetarët e Ferizajt, por edhe komuna në përgjithësi.

Në fund më mbetet të besoj dhe të shpresoj se bashkërisht me gjithë juve dhe me Kabinetin qeveritar nëpërmjet rishikimit do të arrijmë t'i ndryshojmë këto shifra. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Selimi e keni fjalën.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Qëndrimet tona rrjedhimisht janë të njëjta për shkak se edhe gabimet në këtë projektbuxhet janë të njëjta sikur në vitet paraprake.

Unë do të flas pak për sektorin e sigurisë apo për projektbuxhetin për sektorin e sigurisë, i fokusuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në Policinë e Kosovës, në Ministrinë e FSK-së, respektivisht në Forcën e Sigurisë së Kosovës, por jo vetëm.

Për Ministrinë e Punëve të Brendshme ka ardhur serish te e njëjta qasje, i njëjtit trajtim, me të njëjtit parametra ndaj kësaj strukture, e cila do të duhej të trajtohet krejtësisht ndryshe, krejtësisht në mënyrë më dinjitoze edhe në këtë projektligj.

Njëkohësisht edhe për Forcën e Sigurisë së Kosovës nuk ka ndryshime, madje ky projektbuxhet nuk siguron as mirëmbajtjen dinjitoze të gjendjes shumë të vështirë të Forcës së Sigurisë së Kosovës, pa lere më të pretendohej për një zhvillim më shumë të kësaj force, për shkak se edhe qasja e Qeverisë së Kosovës ndaj Forcës së Sigurisë së Kosovës, po vazhdon të mbetet e njëjtë, pra edhe në aspektin e trajtimit buxhetor. Pra, ky buxhet nuk garanton tashmë as mirëmbajtje dinjitoze, e lere më një investim serioz në institucionet e sigurisë, si të tillë s'kemi si ta përkrahim këtë projektbuxhet dhe do ta votojmë kundër.

Zotërinj deputetë,

Kjo që sa po lexova, është procesverbali i fjalimit të njëjtë që e kam pasur në një vit më parë për buxhetin që ne tashmë e lamë pas, pra për buxhetin e vitit 2014.

Me qëllim e lexova fjalën time të njëjtë, pra fjalimin e njëjtë për shkak se edhe qasja e kësaj Qeverie është e njëjtë për shkak se edhe Qeveria që po vjen pas asaj është e njëjtë, për shkak se edhe fokusimi është i njëjtë, për shkak se edhe të metat janë të njëjta, andaj njëjtë do ta kundërshtojmë edhe tani.

Për kaq sa shohim për Forcën e Sigurisë së Kosovës është folur shumë vite më herët, është folur edhe për ndryshimin e misionit të saj. Si mund ta ndryshoni, ta bëni Forcën e Sigurisë në ushtri të Kosovës, respektivisht në forca të armatosura të Kosovës kur keni paraparë vetëm 41 milionë euro për këtë Forcë.

Trajtimi në këtë formë, për Forcën e Sigurisë së Kosovës, është heqje dorë nga shndërrimi i kësaj force në Forca të Armatosura të Kosovës, respektivisht në ushtri të Kosovës.

Pra, ju si Qeveri e tashme, trashëgimtare e qeverisjes së kaluar, po i bëni gabimet e njëjta, qasjen e njëjtë për qëllime të njëjta. Pra, për derisa është paraparë që edhe për vitet pasuese, jo vetëm për vitin 2015, por edhe për vitin 2016 e 2017, mesatarisht të mbetet buxheti rreth 2,5 deri në 2,7% për Forcën e Sigurisë së Kosovës, atëherë edhe një herë kjo nënkupton se ju nuk do ta bëni forcën e armatosur të Kosovës, pra nuk do ta bëni Ushtrinë e Kosovës, për shkak se kështu e trajtoni edhe në buxhet e dihet mirëfilli se pa buxhet një gjë e tillë nuk mund të bëhet.

Në raste të tjera, një përqindje e tillë e buxhetit për ushtrinë e vet do të ishte normale për deri sa dihet se buxhetet janë më të mëdha dhe për deri sa dihet se shtetet tjera rreth nesh, sidomos të rajonit, por jo vetëm kanë një shumë përafërsisht 3% për forcat e armatosura të vetat, por ato kanë këtë shumë dhe këtë ndarje të justifikueshme për shkak se e para kanë buxhet më të madh dhe e dyta kanë tash në një forcë të pajisur, kanë një forcë ushtarake, kanë një forcë të cilën vetëm do të duhej ta avancojnë, jo ta formojnë siç kemi ne nevojë.

Është evidente se kjo qeveri, pra nuk e ka ndërmend ta formojë forcën e armatosur të Kosovës, e shumta që kjo Qeveri mund të bëjë nominalisht mund ta ndryshojë, por edhe për këtë ndryshim nominal nevojiten ndryshime kushtetuese, por për këto ndryshime kushtetuese do të duhej ju t'i pyesni ata zotërinjtë lart atje nga Lista Srpska, pra edhe ky ndryshim kushtetues nesër do të kushtëzohet nga kjo masë e padrejtë gjithsesi në dëm të demokracisë, pra edhe ky ndryshim nëse ndodh nominal gjithsesi ju garantoni që nuk do të ketë një ndryshim esencial të Forcës së Sigurisë së Kosovës, garantoni gjithsesi se nuk do të ketë një ndryshim të misionit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, në Forca të Armatosura të Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Deda e ka fjalën.

ILIR DEDA: Faleminderit!
Deputetë të nderuar,
Zonja e zotërinj,

Sot gjendemi përball një paradoksi e ky paradoks është i tillë që Qeveria e re na propozon një buxhet të vjetër dhe na propozon buxhet pa e pasur të aprovuar programin e vet qeveritar dhe pa i pasur të aprovuara prioritetet e veta qeveritare.

Rrjedhimisht, Qeveria e re zbaton politika të Qeverisë së vjetër e nuk mund të flasim se do të ketë ndonjë përmirësim ku ta di çfarë vitin e ardhshëm apo vitin që vjen me buxhetin i cili na është dhënë sot, apo me propozim buxhetin që na është dhënë sot.

Diskutimin do ta bëj në rrafshin e kërkesave të cilat i ka Bashkimi Evropian, të cilat i ka BE-ja për Kosovën në proces të reformave.

Ministri i ri i Jashtëm, zoti Hashim Thaçi, sot thotë: procesi i anëtarësimit në BE është komponenti më i rëndësishëm i reformave të brendshme dhe të jashtme.

Unë nuk kam dëgjua që ekzistojnë reforma të jashtme. Domethënë kjo është një shpikje e ish- kryeministrit dhe zëvendëskryeministrit të parë.

E çka është integrimi evropian? Nuk është reformë e jashtme, por nënkupton rregullim të tillë të brendshëm shtetëror që garanton mirëqenie sociale, ku ka sistem funksional publik, ku shteti ka rregullim të brendshëm koherent dhe qeverisja ka qasje strategjike zhvillimore.

E buxheti që na është propozuar sot, a është në harmoni me deklaratimet e vazhdueshme edhe të kësaj Qeverie të Republikës së Kosovës, se ne e kemi synim integrimin evropian. Po fillojmë prej ndarjes së niveleve më të larta ekzekutive.

Qeveria e re, me politika të vjetra i emëron 21 ministra, dëshiron t'i emërojë 71 ministra, zëvendësministra, më falni, e kjo do të thotë se stafi përkrahës për gjithë këtë numër është diku rreth 460 anëtarë, këshilltarë politikë e administrativë.

Me këtë logjikë, 28 dikastere të Komisionit Evropian në BE, do të duhej t'i kishin rreth 120 mijë staf përkrahës politik e administrativ, e në këtë logjikë me 14 dikastere qeverisëse në Shtetet e Bashkuara diku duhet të punësoheshin 76 mijë staf përkrahës politik e administrativ, me këtë çka po themi ne, domethënë është e qartë se nuk ka që ekziston shpërputhje e jashtëzakonshme e deklaratimit për integrim, përkushtimit dhe realitetit dhe veprimeve të cilat vetëm po paralajmërohen se do të merren.

Më konkretisht, BE me vite na thotë që në Kosovë duhet të ketë forcim të planifikimit fiskal dhe respektim të rregullave fiskale të cilat janë shkelur në mënyrë të vazhdueshme. Ne këtë nuk e pamë sot, në projektpropozim.

Ky projektbuxhet bazohet në kornizën afatmesme të shpenzimeve, 2015-2017. Po kjo kornizë afatmesme e shpenzimeve nuk ka qasje strategjike për zhvillim. Këtë e identifikon edhe vetë Bashkimi Evropian dhe kërkon nga Qeveria e Kosovës apo qeveritë e Kosovës, në mënyrë të vazhdueshme, që buxheti të jetë pjesë e një strategjie zhvillimore të vendit. Nuk e pamë këtë sot.

Në të njëjtën kohë, prapë po e vërtetojmë një mbyllje të syve përballë një realiteti jo të mirë, të keq realisht i cili është para nesh. Ne që një muaj ditë apo më shumë se një muaj, i kemi 500 qytetarë në ditë që e lëshojnë Kosovën. Domethënë disa ambasadorë deklarohen se ky është eksodi i popullit tonë.

Pse pra nuk po merren politika të tilla fiskale të cilat e zbusin nivelin e varfërisë? Rrjedhimisht pse nuk hiqet TVSH-ja, 16% në produktet bazë: miell, sheqer, krip, vaj? Pse nuk po e ndërmerr edhe këtë hap Qeveria në krizën në të cilën na jemi?

Neve po na thuhet, ne do të bëjmë reforma në arsim e gjëra tjera, por me buxhet minimumi për rritje të cilësisë në arsim është 4.3% e buxhetit. Te ne është më afër 3 se sa 4.3. domethënë e kemi huq edhe vitin 2015.

Thuhet, do ta luftojmë korrupsionin e krimin e organizuar. Nuk ka rritje të buxhetit për mekanizma të cilat janë të thirrur që të luftojnë korrupsionin dhe krimin e organizuar.

Kemi shpërputhjen deklarative dhe reale. Prioritet i Kosovës mbetet autostrada 600 milionë euro. Në fakt nuk është as autostradë, e me të gjetura të tjerëve prioriteti duhet të jetë arsimi, energjia, imagjinoni distribuimi i ujit, që 15 vjet ne s'kemi mbërri të kemi rrjet të mirëfilltë të distribuimit të ujit në vendin tonë. Nuk ka forcim të sektorit privat dhe nuk e morëm përgjigjen si do të largohet ndikimi shtetëror në ekonomi.

Kjo po del që ne po kemi përsëritje të buxhetit të infrastrukturës. Me infrastrukturë nuk rritet cilësia dhe me infrastrukturë nuk mbahen qytetarët tonë brenda.

E kam kërkuar dhe kisha lutur ministrin e Financave që të sqarojë, a nuk kam ditur ta gjej unë, apo nuk ekziston në projektbuxhetin e vitit 2015 se me nënshkrimin apo me ratifikimin tonë të MSA-s ne i humbin 200 milionë euro në vit. Këto do të kompensohen, por këto 200 milionë apo më shumë se 200 milionë euro unë nuk e gjeta në projektbuxhetin të cilin e keni dorëzuar.

Është për keqardhje që ne po flasim edhe një herë për buxhet të vazhdimësisë. Shoqëria jonë është në thyerje të madhe. Dhe kjo thyerje apo shembje e shoqërisë tonë nuk na gëzon asnjërin nga ne.

Mendoj që nuk është dashur që të ngutemi që të na jepni buxhetin tash. Ne kemi mund edhe në janar të diskutojmë për një projektbuxhet të përgatitur më mirë, duke marrë parasysh krizën e gjithmbarshme para cilës ndodhemi kishte me qenë më e mirë po t'i kishit ftuar ekonomistët nga çdo grup parlamentar që ta kemi një buxhet të tillë i cili mund të përballë me kërkesat, nevojat dhe me sfidat të cilat do t'i përjetojmë të gjithë vitin e ardhshëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haskuka e ka fjalën!

MYTAHER HASKUKA: Të nderuar qytetarë të Kosovës,
Deputetë të Kuvendit,

Anëtarë të Kryesisë,
Anëtarë të Kabinetit qeveritar,
Ashtu si përkujtoi Iliri, buxheti i Republikës së Kosovës po diskutohet në ditët kur po kemi me dhjetëra autobusë me qytetarë që po ia mësyjnë Evropës.

Ata nuk po ikin për turizëm, por ikin për të kërkuar azil ekonomik. Po ikin nga papunësia dhe varfëria. Papunësia dhe varfëria nuk kanë pikur nga qielli, por janë pasojë e qeverisjes së keqe dhe buxheteve kopi-paste të 15 vjetëve të fundit që si pasojë direkte i lënë punëtorët të pa punë, të pa pronë, ndërmarrësit e vegjël në kredi dhe hipoteka, ndërsa pasuritë e Kosovës të tjetërsuara.

Ky buxhet i propozuar nuk po i adreson çështjet pse po ikin qytetarët e Kosovës. Pra nuk po i adreson papunësinë dhe varfërinë. Buxheti i propozuar është vazhdimësi e qeverisjes 15 vjeçare me logjikën e shtetit kontabilist.

Ky buxhet nuk parasheh investime për të rritur ekonominë, por investime për të ndarë tortën. Prandaj, kemi investime në asfalt, por jo investime në rivitalizimin e “Trepçës”. Ky buxhet garanton vetëm shtimin e varfërisë dhe thellimin e krizës sociale në Kosovë.

Nëse e analizojmë buxhetin shohim që prej 1 miliard e 576 milionë euro, vetëm 69,8 milionë janë ndarë në aktivitete që mund të gjenerojnë punësim. Pra, më pak se 5% të Republikës së Kosovës është e ndarë në bujqësi dhe për subvencione e transfere në kuadër të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik.

Të dy këto fusha, që mund të zhvillojnë prodhimtarinë pra të krijojnë vende të reja të punës, por edhe kaq sa janë parashikuar nuk jam i sigurt që do të shkojnë në destinacionin e duhur duke e ditur se çfarë korrupsioni dhe nepotizmi e pret këtë pjesë të buxhetit.

Çdo qytetar e vëren që ky buxhet nuk është llogaritur për të krijuar vlerë të shtuar, pra për të krijuar prodhimtari dhe punësim e lere më të adresojë shkallën e lartë të papunësisë në Kosovë.

Buxheti i propozuar po ashtu çalon në adresimin e varfërisë. Bazuar në të dhënat e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, në Kosovë jetojnë 121 833 persona në asistencë sociale, respektivisht 29 538 familje me ndihma sociale. Projektligji i propozuar për buxhetin për skemën e asistencës sociale për vitin 2015 ka ndarë vetëm 28 milionë euro. Nëse këtë shumë e pjesëtojmë me numrin e përfituesve të ndihmës sociale, i bie që qytetarët që përfitojnë nga skema sociale marrin vetëm 226 euro në vit, respektivisht 18 euro në muaj apo vetëm 62 centë në ditë.

Nëse marrim parasysh kufirin e varfërisë së skajshme, shifër kjo e kalkuluar për të shikuar nevojën se sa i duhet një personi që të blejë ushqim të mjaftueshëm, që të mos vuaj nga uria sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës edhe kjo e bazuar në vitin 2011 është 1.20 euro për person në ditë. Shifra prej 62 centë as për së afërmi nuk i përmbush

nevojat elementare për ushqim e mos të flasim për një jetë në dinjitet, pra për përmbushjen e nevojave për veshmbathje, arsim dhe shëndet.

Kjo më së miri ndoshta edhe ilustron pse në Kosovë ende fëmijët vdesin duke kërkuar ushqim nëpër kontejnerë të bërllokut. Pamjaftueshmërinë e ndihmës sociale janë duke e konstatuar gati të gjithë qytetarët dhe organizatat ndërkombëtare e po ashtu edhe ato vendore. Shqetësimin e shumë qytetarëve të Kosovës e kanë shprehur edhe organizatat si Rrjeti i grupeve të grave të Kosovës, Shoqata daun-sindrom Kosova dhe të tjerët.

Shqetësim i tyre i përbashkët është që ky buxhet, mbrojtjen sociale e konsideron vetëm si lëmoshë e jo si e drejtë dhe mundësi për punësim.

Në biseda me ndërmarrës të sektorit privat shumë herë dëgjoj që kanë problem t'i identifikojnë punëtorët me shkathtësi dhe aftësi që atyre u nevojitet. Këta mund të jenë elektrikistë, mekanikë apo ndërtimtarë, por ata thonë që kanë problem që t'i identifikojnë këta, pra ata thonë që nuk ka punëtorë që në tregun e punës që kanë shkathtësi të duhura për punë.

Kjo që po ndodh në Kosovë është vërtet e rëndë. Në njërën anë papunësia me mbi 35% në anën tjetër punëdhënës që kanë problem të gjejnë punëtorë të kualifikuar. Dhe ky buxhet i propozuar nuk adreson asnjërin e as tjetrën. As nuk ka buxhet për të ndarë për aftësim profesional dhe as nuk ka buxhet për ndihmë adekuate sociale.

Ky buxhet nuk parasheh as analiza e hulumtime për tregun e punës, për kërkesat e punës, për të verifikuar se cilat janë ato aftësi dhe shkathtësi që kërkohen me qëllim të krijimit të mekanizmave për edukim e aftësim profesional të personave të pa punë. Pra, buxheti nuk parasheh shërbime publike të punësimit, aftësim profesional dhe ofrim të mundësive për zhvillim të aftësive të papunëve.

Për të zvogëluar numrin e qytetarëve të cilët varen nga asistencat sociale ata duhet të mbështeten që të gjejnë punë, e këto nuk bëhen me premtime boshe e as me shpenzimet marramendëse në mallra dhe shërbime të Kabinetit të Ministrisë.

Për të zvogëluar papunësinë dhe varfërinë është e nevojshme të ndahet buxhet për programe aktive që të vendosim në marrëdhënie shkollat profesionale dhe zyrat e punës kudo nëpër Kosovë.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në vend që të paraqesë në buxhetin programet vjetore të punësimit ku do të planifikoheshin investime në masa aktive të punësimit, si trajnim në punë, subvencion i pagës, praktikë në punë, punë publike dhe vetëpunësim, planifikon vetëm paga dhe mëditje, ndërsa vetëm Zyra e ministrit do të marrë nga buxheti 221 mijë 584 euro në vit, në paga dhe shërbime për 8 zyrtarë në Ministri.

Ky buxhet na bën me dije se këtu dhe sidomos qytetarët se kjo Ministri, por edhe Qeveria në tërësi është plotësisht e gatshme t'i buxhetorë të gjitha dëshirat luksoze të Kabinetit edhe për zyrtarë.

Deri më tani të gjitha projektet për masat aktive të tregut të punës janë financuar nga donatorë. Kjo nuk mund të vazhdojë deri në pafundësi. Pra, shteti duhet të investojë në ngritjen e kapaciteteve të punëkërkesve sipas nevojave që kanë ndërmarrësit tanë privatë dhe ndërmarrjet publike, ku shtetet e zhvilluara si Zvicra, Gjermania dhe Franca kanë programe të tilla nuk ka arsye pse Kosova të mos ketë programe të tilla.

Së fundi, nëse arsyetimi për mungesë të këtyre fondeve është që nuk ka të ardhura ose buxheti është i pamjaftueshëm vetëm t'ju përkujtoj që nëse marrim parasysh numrin e banorëve Kosova ka qeverinë më të madhe në Evropë, ku për 1 milion e 800 mijë banorë kemi më tepër se 90 ministra dhe zëvendësministra. Pra ne kemi 1 ministër për 19 mijë banorë.

Me logjikën e njëjtë, Gjermania do të duhej të kishte 4 076 ministra apo zëvendësministra.

Më pak ministra, më pak ministri, më pak burokraci do të mundësojnë më shumë ndihma për prodhimtarinë, më shumë programe aktive për punësim, më shumë ndihma sociale, më shumë dinjitet për qytetarët e Kosovës. Por, për këtë ju nuk jeni të gatshëm, sepse zotimi i juaj është tjetërfare. Zotimi i juaj është shfrytëzimi permanent i burimeve financiare, natyrore e njerëzore të Kosovës. Ky buxhet dëshmon me fakte të pakontestueshme zotimin tuaj për të sunduar shoqërinë e Kosovës e jo për të drejtuar dhe shërbyer asaj.

Prandaj, unë i them jo këtij buxheti. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, zoti Kadri Veseli.)

KRYETARI: Faleminderit! E ftoj deputetin Fisnik Ismajli ta marrë fjalën.

FISNIK ISMAJLI: Faleminderit! Po e përmbyll.

Kolegë deputetë dhe të dashur qytetarë,

Për kuriozitet edhe pse nuk prita se kam për t' u befasuar për të mirë, kërkoja lart e poshtë se mos ky propozim për buxhet përmban diçka për zhvillimin e teknologjisë informative duke qenë se po jetojmë në vitin 2015. Edhe nuk u befasova as për të mirë se nuk gjeta kurrgjë specifike për këtë fushë e as për të keq s' u befasova, sepse nuk prita që i kujtohet ndonjërit prej këtij koalicioni për diçka kaq të rëndësishme si teknologjia, qysh s' u kujtuat asnjëherë për gjëra tjera me rëndësi, për mirëqenien e qytetarit dhe për zhvillimin ekonomik të këtij vendi.

Teknologjia informative, të nderuar kolegë në kohën e sodit nuk është luks por është domosdoshmëri. Kjo fushë jo vetëm se krijon mundësi punësimi dhe nxitje të cilësisë, ngritje të cilësisë së jetës së qytetarit, por mund të bëhet edhe një prej fushave kyçe në zhvillimin ekonomik. Shembull në botë janë plot vende tjera në zhvillim ku fuqia punëtore është e lirë, mosha mesatare është shumë e re dhe kapacitetet për zhvillim janë të mëdha. Modelet ekzistojnë po si gjithmonë vullneti politik vazhdon të mungojë.

Në rastin e Kosovës, në krejt dokumentin e buxhetit, fjalia teknologji ishte në çdo rast e paraprira me fjalën pajisje, dhe atë jo më shumë se veç 25 herë në të gjitha 408 faqet e këtij dokumenti, ngase në krejt buxhetin krejt çka ishte paraparë ishte blerja e pajisjeve për teknologji informative, që në rastin tuaj nënkupton më shumë mausa, ai-peda, tonera, për t'i nxjerrë punë zyrtarëve për fotokopje.

Nuk pashë në asnjë vend që ky buxhet ishte përkushtuar për zhvillimin e teknologjisë informative, e s'po flas për inovacionin që për juve është term i panjohur, e cilat janë domosdoshmëri për integrim në pjesën e civilizuar të botës në të cilën po ngecin në aq shumë fusha.

As sivjet s'po ndryshon asgjë. Qeveria vazhdon duke nënçmuar e nënvlerësuar dijen, deri sa qytetari me iniciativë vetjake e nëpërmes bizneseve private vazhdon t'i shtyjë kufijtë e teknologjisë pa përkrahje institucionale.

Po çka pret tjetër njeriu prej një koalicioni para historikësh si LDK-ja për nga mosha, ashtu edhe PDK-ja për nga inteligjenca. Për këtë arsye edhe gjitha arsyet tjera të cekura nga kolegët e mi të Lëvizjes "Vetëvendosje" unë do ta votoj këtë propozim kundër. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Jemi në fazën kur kanë përfunduar diskutimet e deputetëve. Sido që të jetë e kisha ftuar përfaqësuesin e Qeverisë të marrë fjalën. Pra, ministri zoti Hoti.

MINISTRI AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit,
I nderuar kryeministër,
Deputetë,

Unë me vëmendje i dëgjova të gjitha diskutimet dhe ju falënderoj shumë për sugjerimet, vërejtjet, amendamentet disa që i përmendën për këtë buxhet.

Më lejoni edhe një herë të t them se ky është buxhet i mundësive që i ka Kosova. Megjithë dëshirë do të kishim pasur një buxhet që është 3 miliardë euro dhe të përmbushim edhe për asistencë sociale, edhe për fushat tjera, edhe për arsim, edhe për shëndetësi, edhe për të gjitha fushat që sot u përmendën këtu, por është buxhet i mundësive dhe brenda këtyre mundësive ky buxhet mundohet t'i prekë të gjitha fushat pak a shumë në mënyrë të barabartë. Normalisht unë e thashë në fjalën time, e përmendi edhe kryeministri në fillim që ne duhet të kemi një qasje institucionale, sepse shteti i Kosovës nuk po fillon me këtë qeveri, por është një vazhdimësi.

Pra, duhet të vazhdojmë projekte që tashmë janë të kontraktuar dhe kjo na ka kufizuar normalisht neve në nxjerrjen e një buxheti tjetër përpara juve, por ne zotohemi që prioritetet e Qeverisë së re duhet të shfaqen menjëherë në rishikimin në qershor me kornizën afatmesme të shpenzimeve që deri në prill të cilën duhet ta diskutojmë me të gjitha grupet parlamentare me ekonomistët në veçanti, sepse kjo u kërkuar këtu, me buxhetin e vitit 2016 dhe normalisht me programin qeverisës të cilin e kemi gati dhe kryeministri me fjalën e tij të parë para këtij Kuvendi i ka prezantuar prioritetet

qeverisëse. Ne shumë shpejt në janar do ta kalojmë edhe në Qeveri dhe mandej do e sjellim në Kuvend për informim.

Do të mundohem të prek disa prej çështjeve më konkrete të cilat mund t'i jap qysh tash përgjigje dhe mandej bashkë me Komisionin për Buxhet do të punojmë për atë që është e mundur të marrim parasysh vërejtjet dhe sugjerimet e juaja.

Tek të hyrat ne nuk kemi prekur kufijtë e të hyrave, ndoshta veç sa për informim më të mirë normalisht që pjesa më e madhe e të hyrave buxhetore mblidhen në dogana, por ato janë të hyra vendore, pra mbi 470 milionë euro të hyrave që mblidhen në dogana janë TVSH. Ne po bëjmë planin e punës tani që për dy, maksimum tri vjet të fillojmë mbledhjen e TVSH brenda vendit në mënyrë që bizneset të lirohen nga kjo barrë e parapagimit të TVSH-së.

Tek grandit për komunat u përmendën plotë vërejtje për shpërndarje jo të drejtë në mes të komunave. Unë besoj se kjo është bërë në bazë të Ligjit për financat publike dhe kriterëve që parashihen në këtë grand. Me këtë rast më duhet përmend në veçanti rastin e Prishtinës dhe të disa komunave në veri të vendit të cilat nuk e kanë aprovuar buxhetin e tyre komunal në përputhje me qarkoren buxhetore përkatëse. Normalisht unë ju garantoj në fakt që komuna e Prishtinës do të ketë trajtim të veçantë. Ne kemi përvojë me komunën e Prishtinës në këtë drejtim. Ne do të punojmë shumë shpejt në sjelljen në Kuvend të Ligjit për kryeqytetin i cili do merr parasysh specifikat që ka kryeqyteti, që ka Prishtina si njësi e veçantë administrative në Republikën e Kosovës, ashtu siç parashihet edhe me Kushtetutë.

Unë qëndroj në vlerësimin tim se me këtë buxhet duhen shumë kohë për të dyfishuar të ardhurat për kokë banori. Pra nuk po i ha fjalët e mia aspak. Por, ky është buxhet i mundësive. Me politikat që ne do ndërmarrim në pjesën e parë të vitit do t'i shohim efektet në pjesën e dytë të vitit dhe në vitet e ardhshme, por kjo Qeveri që sot e ka një javë pune, duhet t'ia lejojnë 100 ditë pune, gjashtë muaj dhe pastaj të flasim më konkretisht për masat që ka ndërmarrë dhe efektet e atyre masave.

U përmend shumë kontrata kolektive, një element i asaj kontrate do të vazhdojë të implementohet në vitin 2015, janë sigurimet shëndetësore. Ne po shohim mundësitë pra atë që kemi mundësi që edhe elementet tjera të kësaj kontrate të merren parasysh.

Unë javën që shkoi kam kontaktuar, kam takuar të gjitha sindikatat në Kosovë, u kam dhënë draftbuxhetin, po ju them këtu para jush që shumica e tyre kanë qenë shumë konstruktive në kërkesat e tyre kur i kanë parë mundësitë që ka buxheti i Kosovës, unë u kam garantuar atyre, edhe juve dhe të gjithë qytetarëve të Kosovës që do të jem maksimalisht transparent për çdo cent se si mblidhet dhe si shpenzohet, sepse unë jam vu në krye të këtij resori për të menaxhuar, por ky është buxhet i qytetarëve dhe secili qytetar, secili deputet i Kuvendit të Kosovës ka pronësi mbi këtë buxhet po atë që kam unë si ministër i Financave.

U përmendën politikat fiskale. Ne i kemi paraparë në programin qeverisës siç është mbledhja e TVSH brenda vendit, përshkallëzimi i TVSH-së, lirimet tatimore dhe me këtë rast unë dua të falënderoj edhe Grupin Parlamentar të AAK-së për disa sugjerime të cilat ne veç i kemi në programin tonë qeverisës.

Fondin e privatizimit shumë shpejt do e sjellim para juve. Ligjin përkatës që i liron këto fonde për tu përdorur për zhvillim ekonomik, për t'i përmbyllë të gjitha kërkesat e kreditorëve potencialë. Po punojmë dhe kemi një plan në Ligjin për Qeverinë për të mundësuar që në të ardhmen Kosova të ketë një qeveri sipas nevojave që ka.

Në energji veç kemi pranuar një ofertë. Komiteti ndërmintor ka pranuar një ofertë që duket është mjaft serioze dhe në javën në vijim do kemi vlerësimin për këtë ofertë dhe do të përmbushim zotimin tonë që në fund të mandatit të kemi furnizim të plotë dhe me çmime të pranueshme për qytetarë me energji elektrike.

Ishte rruga Prishtinë-Gjilan nga deputeti i PDK-së, është buxhetuar në buxhet. Pra, 1 milion euro janë ndarë për këtë.

Në bujqësi u përmend shumë fusha e bujqësisë. Ne veç e kemi prioritet këtu. Është e paraparë 32 milionë euro shtesë për buxhetin për bujqësi. Ne do mundohemi të ndërrojmë pak qasjen se si është financuar deri tash bujqësia, ta orientojmë kah autputet e jo kah imputet bujqësore dhe mundësisht të mbulojmë konsumin vendor të produkteve bujqësore me produktet që prodhohen brenda vendit.

Tash çështje më e diskutueshme, ishte për pagat. Më lejoni të bëj shumë të qartë përpara juve që ne kemi trashëguar një buxhet i cili nuk përfshin rritjen prej 25% të pagave, rritje shtesë prej 25% të pagave për vitin 2015, është vazhdimësi e rritjes që ka ndodh në pjesën e parë të këtij viti.

U përmendën disa amendamente prej Grupit të AAK-së në këtë drejtim. Unë me kënaqësi bashkë me Komisionin për Buxhet do t'i trajtojmë ato amendamente, veç na thoni qartë se ku t'i heqim disa dhjetëra miliona euro për të paguar 25% paga shtesë, a të zvogëlojmë shëndetësinë, apo arsimin, apo ndihmat sociale dhe të rrisim pagat për 25%.

Por ju kisha lutur mos e harroni faktin që janë 300 mijë njerëz të pa punë, që presin për një mundësi për të gjetur punë në sektorin publik ose në sektorin privat.

Buxheti për drejtësi është rritur. Janë 300 vende shtesë pune që janë paraparë shtesë në gjyqësi dhe në prokurori që pritet të plotësohen.

Në sektorin e sigurisë u ngrit nga disa deputetë. Unë dua t'i siguroj ata që të gjitha kërkesat e Forcës dhe Sigurisë së Kosovës sa i përket buxhetit shtesë për t'u shndërruar në Ushtri të Kosovës janë plotësuar dhe vetëm është çështje e legjislacionit, përshtatjes së legjislacionit dhe përkrahjes ndërkombëtare normalisht për ta kthyer FSK-në në ushtri të rregullt të Kosovës.

Në MTI u përmend edhe teknologjia informative, edhe projektet tjera. Janë 1 milionë euro që janë paraparë në MTI për përkrahje të NVM-ve edhe për fushën e teknologjisë informative dhe janë shtesë 10 milionë euro të donatorëve në këtë fushë.

Ligji i veteranëve të luftës. Ne po presim që sapo të bëhet verifikimi i tyre të fillojmë, mjetet janë ndarë për këtë kategori.

Nga deputeti i “Vetëvendosjes” gjithashtu u përmend çështja e 200 milionë euro mungesë në buxhet që vijnë nga nënshkrimi i MSA-s dhe marrëveshjes me Turqinë, nuk janë reflektuar në buxhetin e vitit 2015, sepse efektet e tyre nuk vijnë menjëherë në vitin 2015, vijnë në 2016 e tutje, por ato kthehen pozitivisht përmes ndihmës që tanimë është paraparë prej Komisionit Evropian prej 650 milionë eurove për Kosovë për periudhën 2014-2020.

Këto ishin disa nga përgjigjet që mund t’i jap për momentin. Unë do të punoj ngushtë me Komisionin për Buxhet dhe Financa për të akomoduar kërkesat e juaja. Faleminderit !

KRYETARI: Faleminderit zoti ministër Hoti! Në fakt, çështja e diskutimeve ka përfunduar.

(Ndërhyrje)

Ju lutem, më lejon të sqaroj deri në fund, pastaj kisha pasur dëshirë, ndërhyrjet e juaja. Replikë keni mundësi nga 2 minuta. Atëherë e ftoj Donika Kada-Bujupi, pas Donikës është lejmuar edhe Besnik Bislimi. 2 minuta!

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit, kryetar!

Veç edhe një herë t’ia konfirmoj ministrit. Nën 1, s’i mund t’i gjeni mjetet për zbatimin e kontratës kolektive dhe rritjes së pagave, duke i zvogëluar shpenzimet në Qeveri, duke e zvogëluar Qeverinë qysh ju u keni premtuar qytetarëve, duke mos e bërë më shumë se një zëvendësministër për dikaster përkatës dhe mbi të gjitha duke luftuar informalitetin, krimin e organizuar ekonomik dhe korrupsionin e kompanive tuaja mike, lufta ndaj të cilave do të bënte që këtë vit të kemi të paktën 200 milionë euro shtesë në buxhetin e Republikës së Kosovës. Ndërkaq, vetëm 90 milionë euro ju duhen për zbatimin e kontratës kolektive dhe rritjen e pagave.

Dhe, rrjedhimisht ne do të dorëzojmë 2 amendamente duke kërkuar që t’i mbani fjalët, sepse ish- kryeministri Hashim Thaçi nuk ishte në zor kur në prill e ka nënshkruar me të gjitha sindikatat marrëveshjen për zbatimin e kontratës kolektive dhe rritjen prej 25% të pagave për të gjitha kategoritë e punëtorëve që hyn në fuqi me 1 janar 2015. Kjo do të jetë kërkesë e vazhdueshme e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës. Ju keni thënë që brenda një viti mund t’i rritni të hyrat për 500 milionë euro, ne nuk po kërkojmë që t’i bëni 500 milionë euro shtesë, po luftoni informalitetin dhe rritni të hyrat të paktën për 200 milionë euro shtesë dhe zbatoni me përgjegjshmëri ato të cilat i keni premtuar dhe përmes të cilave keni mbërri aty ku jeni. Faleminderit!

KRYETARI: E ftoj deputetin Besnik Bislimi! Për replikë, të lutem 2 minuta i ke!

BESNIK BISLIMI: Deri më tani, gjatë fjalimit të tij, zotëri Hoti disa herë e përmendi se ky është buxhet i mundësive.

A doni të thoni që nuk keni mund të mbërrini më shumë? Pyetja ime specifike, në qoftë se ne si deputetë kishim vendosur t'ju japim një muaj kohë për ta ndërruar buxhetin, a kishit mund për të na pru një buxhet që ofron rritje më të madhe ekonomike apo po thoni se kjo s'ka shans të ndodhë.

Na premtuat se do të jeni transparent për çdo cent të shpenzuar. A mund të na thoni sa të holla kanë për t' u derdhur në Fondin e veriut gjatë këtij viti?

Edhe pyetja e tretë. A e dini që ekziston një ligj mbi veprimtaritë kërkimore shkencore që ju obligon t' i ndani 0,7% për aktivitete hulumtuese?

KRYETARI: Faleminderit për diskutime. Diskutimet përfunduan. Atëherë, të nderuar deputetë, në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të Projektligjit për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015.

Do të votojmë së pari për praninë në sallë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatitën për votim. Votojmë tash. Pra, 81 deputetë janë të pranishëm në sallë.

Lus regjinë dhe deputetët të...

Kërkoj falje, sot Sekretarisë teknika nuk po i funksionon. Janë 96 deputetë të pranishëm në sallë.

Unë flas vetëm çfarë shoh këtu në kompjuter. Kërkoj falje, a ka ndokush nga deputetët që është i pranishëm pa kartelë në sallë?

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votimin e projektligjit dhe votojmë tash.

Konstatoj se me 73 vota për, 22 vota kundër dhe asnjë abstenim, nga 95 deputetë të pranishëm në sallë, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015.

Ngarkohet Komisioni për Buxhet dhe Financa që ta shqyrtojë Projektligjin për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015 dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime para seancës plenare, që do të mbahet me 29 dhjetor 2014.

Me këtë e konstatoj përfundimin e seancën së sotme. Mirupafshim në seancën e radhës! Faleminderit!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*